



## **CIKLI I TRETË I STUDIMEVE**

**TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS**

**POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS NË RAPORT ME SUBJEKTET  
NDËRKOMBËTARE QË NUK E NJOHIN SUBJEKTIVITETIN E SAJ**

**Kandidati**

MA. Gjenis Haxhimehmeti

**Mentori**

Prof. Dr. Abdulla Azizi

Tetovë, 2022

## **Deklarata e ndershmërisë**

Unë, Gjenis Haxhimehmeti, student i doktoratës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj se ky punim doktrate është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë të tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

E nënshkruar: \_\_\_\_\_

Nr. ID-së \_\_\_\_\_

Kandidat: Gjenis Haxhimehmeti

Data: \_\_\_\_\_

Unë, Elhame Arifi, me profesion Lektore, nën përgjegjësi morale dhe materiale, më datë 10.06.2022, jap këtë:

### DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lektuar temën me titull: "Politika e jashtme e Kosovës në raport me subjektet ndërkombëtare që nuk e njohin subjektivitetin e saj", të kandidatit Gjenis Haxhimehmeti.

Pristinë, 10.06.2022

LEKTORE

EMRI DHE MBIEMRI

Elhame Arifi

NËNSHKRIMI

  


Nr. telefonit: 045 379 365

E-mail adresa: lekturim@hotmail.com

*Ky disertacion i dedikohet babait tim të vrarë në Luftën e Kosovës, inspирimit tim që t'i  
shërbej Kosovës dhe diplomacisë së saj!*

## Lista e shkurtesave

<b>AP</b>	- Asambleja e Përgjithshme
<b>BB</b>	- Banka Botërore
<b>BE</b>	- Bashkimi Evropian
<b>BERZh</b>	- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BRISC</b>	- Brazil, Rusi, Indi, Kina dhe Afrika e Jugut
<b>BRSS</b>	- Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
<b>CARICOM</b>	- Komuniteti i Karaibeve
<b>CEFTA</b>	- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
<b>ENC</b>	- Komuniteti i Energjisë
<b>FIFA</b>	- Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Futbollit
<b>FMN</b>	- Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>GjND</b>	- Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
<b>IBRD</b>	- Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>ICAO</b>	- Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
<b>IDA</b>	- Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit
<b>IFAD</b>	- Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë
<b>IFC</b>	- Korporata Financiare Ndërkombëtare
<b>ILO</b>	- Organizata Ndërkombëtare e Punës
<b>IMO</b>	- Organizata Ndërkombëtare Detare
<b>IPVQ</b>	- Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë
<b>ITU</b>	- Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
<b>KB</b>	- Kombet e Bashkuara
<b>KFOR</b>	- Misioni Paqëruajtës Ndërkombëtar i udhëhequr nga NATO në Kosovë
<b>KS</b>	- Këshilli i Sigurimit
<b>MARRI</b>	- Nisma Rajonale për Migrim, Azil, Refugjatë
<b>MIGA</b>	- Agjencia Multilaterale për Garancinë e Investimeve
<b>MPJD</b>	- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
<b>MSA</b>	- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>NATO</b>	- Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

<b>OBI</b>	- Organizata e Bashkëpunimit Islamik
<b>OBT</b>	- Organizata Botërore e Tregtisë
<b>ON</b>	- Organizata Ndërkombëtare
<b>PE</b>	- Parlamenti Evropian
<b>PSSP</b>	- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
<b>R2P</b>	- Përgjegjësia për të Mbrojtur
<b>RCC</b>	- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
<b>RYCO</b>	- Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor
<b>SEECF</b>	- Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
<b>ShBA</b>	- Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>TCT</b>	- Traktati i Komunitetit të Transportit
<b>UÇK</b>	- Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>UEFA</b>	- Asociacioni i Shoqatave Evropiane të Futbollit
<b>UNESCO</b>	- Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
<b>UNIDO</b>	- Organizata për Zhvillim Industrial e Kombeve të Bashkuara
<b>UNMIK</b>	- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>UPU</b>	- Unioni Universal Postar
<b>WHO</b>	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>WIPO</b>	- Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
<b>WMO</b>	- Organizata Botërore e Meteorologjisë

## Abstrakt

Shtetet të cilat, përkundër që plotësojnë kriteret e shtetësisë sipas Konventës së Montevideos por që nuk janë pjesë përbërëse e Kombeve të Bashkuara (KB) dhe hasin në kundërshti për t'u pranuar nga një anëtar i Këshillit të Sigurimit (KS) të KB-së, tentojnë në ngritjen e raporteve në politikën e tyre të jashtme duke marrë njohje dhe krijim të marrëdhënieve diplomatike bilaterale por edhe kontakte joformale apo të formave të veçanta me shtete nga të cilat nuk kanë marrë njohjen e plotë. E njëjta vlen edhe për organizata ndërkombëtare.

Marrëdhëniet ndërkombëtare nuk janë të përhershme dhe të pandryshueshme, fluiditeti gjeopolitik dhe kompleksiteti shumëdimensional i marrëdhënieve ndërkombëtare ndikon edhe në miqësinë apo armiqësinë mes shteteve. Intensifikimi i zhvillimeve në marrëdhënie ndërkombëtare si rezultat i globalizmit dhe zhvillimit teknologjik ka bërë që shumë nocione të bëhen më komplekse, duke u shndërruar në sfidë për teorinë dhe praktikën ndërkombëtare.

Përkundër asaj që mund të aludohet që këto shtete me njohje të kufizuar përbëjnë një grup, në fakt dallimet mes tyre janë tepër të mëdha dhe gjithsecila ka veçantitë e saja të brendshme dhe në raport me mjedisin ndërkombëtar.

Kosova është rast i veçantë (sui generis) në marrëdhënie ndërkombëtare. Të qenurit pjesë e ish-Jugosllavisë me një status brenda Kushtetutës së vitit 1974, dhe me pavarësi të shpallur të rrjedhur pas një procesi ndërkombëtar, po edhe me një ndërhyrje ushtarake humanitare ndërkombëtare në një shtet sovran, paraqet rast me vlerë studimi dhe diskutimi. Kjo në këtë trajtesë bëhet me ndërthurje të një numër të metodave shkencore, përfshirë intervistën.

Me anë të trajtimit të kësaj teme, synohet të jepet si rezultat një pasqyrë se si Kosova, si një shtet sipas elementeve të shtetësisë në të drejtën ndërkombëtare, por i kontestuar nga një numër i subjekteve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, e ka të realizuar politikën e jashtme, marrëdhëniet e saj pikërisht në raport me subjektet nga të cilat kontestohet. Punimi ka për synim të tregon se edhe përkundër pengesave objektive që has një shtet në politikën e jashtme, ka mundësi dhe modalitete për të arritur rezultate pozitive.

**Fjalët kyçe:** *Politikë e jashtme, Kosovë, njohje, organizatë ndërkombëtare, subjekte ndërkombëtare*

## Abstract

States which, despite meeting the criteria of citizenship under Montevideo Convention but are not integral part of the United Nations, facing opposition to being accepted by a member of UN Security Council, tend to establish foreign policy relations receiving recognition and establishing bilateral diplomatic relations but also informal contacts or special forms with states that do not fully recognize them. The same applies to international organizations.

International relations are not static, the geopolitical flow (course) and multidimensional complexity of International Relations also affects friendship or enmity between states. The intensification of developments in international relations as a result of globalization and technological development has made many notions more complex, making them a challenge in international theory and practice.

Despite the fact that it can be alluded that these countries with limited recognition constitute a group, in fact the differences between them are very large and each state is internally unique also in relation to the international environment.

In that regard, Kosovo is a special case (*sui generis*) considering international relations. Being a part of former Yugoslavia with an status under the 1974 Constitution, and with declared independence deriving from an international process, as well as by an international military-humanitarian intervention in a sovereign state, is considered to be a case for study and discussion. In this study, this is done by combining a number of scientific methods, including the interview.

By addressing this topic, the aim is to provide as a result an overview of how Kosovo as a state according to elements of statehood in international law, but contested by a number of other subjects of international law, realizes its foreign policy, precisely its relations with the subjects from which it is contested. Through this, it aims to show and offer that despite the objective obstacles that a state faces in foreign policy, there are opportunities and modalities to achieve positive results

**Keywords:** *Foreign policy, Kosovo, recognitions, international organizations, international subjects*



## Апстракт

Држави кои, и покрај кои ги исполнуваат критериумите за државјанство според Монтевидејска конвенција,, но кои не се составен дел на Обединети Нации(ОН) и наиде на противење да биде прифатена од член на Советот за безбедност (СБ,) обидете се во подигањето на односите во нивната надворешна политика добивањето на признавањето и воспоставувањето билатерални дипломатски односи но и неформални контакти или посебни форми со државите од кои не добиле целосно признание. Истото важи и за меѓународните организации.

Меѓународните односи не се постојани и непроменливи, геополитичка флуидност и повеќедимензионална сложеност на меѓународните односи влијае и во пријателство или непријателство меѓу државите. Интензивирањето на случувањата во меѓународните односи како резултат на глобализацијата и технолошкиот развој предизвика многу поими да станат посложени, станувајќи предизвик за меѓународната теорија и практика. И покрај тоа што може алудираше дека овие држави со ограничено признавање сочинуваат група, всушност, разликите меѓу нив се многу големи и секоја има свои особености во однос на меѓународната средина.

Косово е посебен случај (*suigeneris*) во меѓународните односи. Да се биде дел од на поранешна Југославија со статус во рамките на Уставот од 1974 г., и со прогласена независност произлезена од меѓународен процес, но и со меѓународна хуманитарна воена интервенција во суверена држава, претставува случај што вреди да се проучува и дискутира. Ова во овој процес се прави со комбинирање на голем број научни методи, вклучувајќи го и интервјуто.

Преку третман на оваа тема, има за цел како резултат да се даде преглед на тоа како Косово, како држава според елементите на државјанството во меѓународното право, но оспорен од голем број други субјекти на меѓународното право, ја има реализирано надворешната политика, нејзините односи токму во однос на субјектите од кои се оспорува. Трудот има за цел да покаже дека и покрај објективните пречки со кои се соочува една држава во надворешната политика, постојат можности и модалитети за постигнување позитивни резултати.

**Клучните зборови:** Надворешната политика, Косово, признавање, меѓународна организација, меѓународни субјекти

## **Falënderim**

E shfrytëztoj këtë mundësi për t'i shprehur mirënjohjen e thellë mentorit, prof. dr. Abdulla Azizi, për besimin dhe mundësinë e dhënë që të realizojmë këtë projekt akademik. Përvoja në mentorimin e tij duke më dhënë këshillat e çmuara e duke më përcjellë gjatë gjithë procesit të shkrimit të disertacionit ishte një ndihmesë e vyeshme për mua. Faleminderit edhe gjithë stafit akademik, menaxhues, dhe administrativ të Universitetit të Evropës Juglindore për mundësinë, korrektësinë dhe bashkëpunimin e ofruar.

Familjes sime të cilës i detyrohem shumë për përkrahjen morale e financiare për të arritur deri në këtë stad të zhvillimit tim akademik. Mirënjohje dhe konsiderata të larta nënës sime për gjitha sakrificat e bëra dhe mbështetjen e pakursyer, më meritörja për suksesin tim. Sabiha, e cila u tregua një bashkëshorte tejet përkrahëse dhe e kuptueshme gjatë shkrimit të disertacionit, së bashku me dy fëmijët tanë, Aksën dhe Abdullahun, të cilët gjeja motivimin e kërkuar. Falënderoj vëllain tim binjak, Harisin, që në secilin hap ka ofruar mbështetje të pakursyer për mua.

U jam mirënjohës profesorëve, ambasadorëve dhe profesionistëve të tjerë të cilët pranuan që të japin kontributin e tyre me anë të intervistave të dhëna për qëllimet e këtij disertacioni.

Më me rëndësi, falënderoj Zotin që më dha shëndetin mendor e fizik, si dhe forcën shpirtërore që të kem mundësinë për të arritur në përfundim të studimeve të doktoratës.

## Përmbajtja

<b>Deklarata e ndershmërisë.....</b>	<b>2</b>
<b>Lista e shkurtesave .....</b>	<b>5</b>
<b>Abstrakt .....</b>	<b>7</b>
<b>Abstract .....</b>	<b>8</b>
<b>Апстракт .....</b>	<b>9</b>
<b>Falënderim .....</b>	<b>10</b>
<b>Lista e tabelave .....</b>	<b>13</b>
<b>PARATHËNIE.....</b>	<b>14</b>
<b>HIPOTEZAT .....</b>	<b>18</b>
<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>18</b>
<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>20</b>
<b>1. NJOHJA SIPAS SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>20</b>
1.1 Teoritë e njohjes .....	20
1.2 Kritikët ndaj teorive – drejt një qasjeje të re .....	25
1.3 Llojet e njohjes.....	27
1.4 Njohja e shtetit dhe KB .....	30
1.5 Tërheqja e njohjes në të drejtën ndërkombëtare .....	35
1.6 Njohja e qeverive dhe shteteve – dallimet dhe ngjashmëritë .....	38
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>44</b>
<b>2. EVOLUIMI I KOSOVËS SI SUBJEKT NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>44</b>
2.1 Kosova në periudhën 1999-2008 – administrimi ndërkombëtar .....	44
2.2 Pavarësia e Kosovës dhe kontestimi i saj në GjND në kontekst të njohjeve për Kosovën.....	49
2.3 Kosova, rast <i>sui generis</i> , precedent? Ose të dyja bashkë? Apo asnjëra? .....	56
2.4 Marrëveshjet e Brukselit në kontekst të njohjes së Kosovës .....	58
2.5 Negociatat dhe problemi i tërheqjes së njohjeve .....	67
<b>KAPITULLI III.....</b>	<b>74</b>
<b>3. MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME VENDET E BE-SË DHE ME VENDET E TJERA TË CILAT NUK E KANË NJOHUR AKOMA SHETITIN E KOSOVËS .....</b>	<b>74</b>

3.1 Raporti Kosovë-BE .....	76
3.2 Modalitetet me 5 shtetet jonjohëse të BE-së .....	80
3.2.1 Greqia .....	83
3.2.2 Sllovakia .....	85
3.2.3 Spanja .....	86
3.2.4 Qipro .....	90
3.2.5 Rumania .....	91
3.3 Raporti Kosovë me rajonet e tjera gjeografike .....	93
3.3.1 Evropa Lindore .....	93
3.3.2 Afrika .....	101
3.3.3 Azia .....	102
3.3.4 Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut.....	105
3.4 Shtrirja e aparatit diplomatik të Kosovës.....	106
<b>KAPITULLI IV.....</b>	<b>113</b>
<b>4. DIPLOMACIA MULTILATERALE E KOSOVËS.....</b>	<b>113</b>
4.1 Kombet e Bashkuara .....	114
4.1.1 Modaliteti “alternativ” për një status jo të plotë në KB .....	118
4.1.2 Agjencitë e specializuara të KB-së.....	120
4.2 Kosova në mekanizmat rajonalë .....	123
4.3 NATO .....	125
4.4 Këshilli i Evropës .....	126
4.5 Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë.....	128
4.6 Konventat e Gjenevës .....	129
4.7 Organizata e Bashkëpunimit Islamik .....	130
<b>KAPITULLI V.....</b>	<b>133</b>
<b>5. MBËSHTETJA E ALEATËVE, ROLI I SHQIPËRISË DHE I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA DIPLOMATIKE.....</b>	<b>133</b>
<b>KAPITULLI VI.....</b>	<b>143</b>
<b>6. INTERVISTAT E REALIZUARA SI METODË SHKENCORE .....</b>	<b>143</b>
<b>PËRFUNDIM .....</b>	<b>152</b>
<b>CONCLUSION.....</b>	<b>161</b>

## Lista e tabelave

Tabela 1. Baza e përdorur nga shtetet që kanë njohur Kosovën.....	54
Tabela 2. Ndërveprimi i faktorëve nga BE në njohjen e shteteve të reja .....	75

## PARATHËNIE

Diplomacia si formë komunikimi, është e vjetër po aq sa janë të organizuar njerëzit në shoqëri. Nevoja për komunikim, informim, negociata dhe marrëveshje ka ekzistuar gjithmonë. Zhvillimi i shoqërive, organizimi i tyre në shtete me sovranitet ka sjellë edhe zhvillimin dhe intensifikimin e diplomacisë. Sot, politika e jashtme dhe diplomacia janë disiplina të rëndësishme shtetërore.

Kosova, gjendet në dekadën e dytë të shtetësisë së saj, por me problemin kyç të kësaj trajtese, mosnjohjen e plotë nga një pjesë e shteteve si dhe mosanëtarësimin në KB si organizatë ombrellë e shteteve. Andaj, rëndësia e temës konsiston në faktin e aktualitetit dinamik të marrëdhënieve ndërkombëtare, rrjedhimisht politikës së jashtme të Kosovës. Shembull, Evropa Lindore, në të cilën gravitojnë shtete që kanë qenë ish-Republika Socialiste Sovjetike, është një rajon gjeografik në të cilin Kosova ka mungesë të qasjes, gjegjësisht mungesë të njohjeve nga shtetet e atij rajoni. Këto shtete kanë elemente të përbashkëta si arsye për një qëndrim të tillë ndaj Kosovës, por edhe veçori specifike, që nxitin ashpërsinë e tyre në raport me kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës. Andaj, qasja e institucioneve të Kosovës duhet të jetë e kujdesshme në raport me këto shtete.

Këto shtete ish-sovjetike (Bjellorusi, Moldavi, Ukrainë, Kazakistan, Armeni, Azerbajxhan dhe Gjeorgji), pavarësisht që mundohen të mbajnë marrëdhënie të balancuar mes ShBA-së dhe Ruisë, në mënyrë uniforme nuk njohin pavarësinë e Kosovës.

Arsyet janë të ndryshme, por kryesisht problemet e brendshme territoriale (Azerbajxhan, Armeni, Ukrainë, Gjeorgji, Moldavi), apo sistemi politik jodemokratik dhe influenca e madhe ruse (Bjellorusi) dhe ajo ruso-kineze (Kazakistan).

Faktikisht, disa nga këto shtete janë në grupin e vendeve që trajektorja e qëndrimit të tyre ndaj Kosovës, nga viti 2008 e këndeje e kanë pasur negativ, ku në fillim kanë qenë më neutrale dhe kanë konsideruar njohjen, por zhvillimet e mëtutjeshme kanë bërë efekt negativ (Ukrainë, Armeni), edhe pse me Ukrainën vitet e fundit është shënuar sërish avancim në disa aspekte.

Krahas shembullit të lartcekur këtu me qëllim vetëm ilustrues dhe justifikimit konkret për temën, këtu analizohen pozicionet e Kosovës në raporte të tjera ndërkombëtare dhe

rajonale që do të plotësojnë temën, të tilla si raporti me gjitha rajonet e tjera, me BE dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Kosova në raport me organizatat ndërkombëtare ka ndërtuar relacione të ndryshme. Në disa është anëtare me të drejta të plota, në disa të tjera ka marrëdhënie me status të veçantë, kurse në disa ka mungesë të plotë të qasjes. Specifikat e ndryshme se si këto marrëdhënie janë të ndërtuara, duhet të jenë në interes të analizës nga hartuesit dhe ekzekutuesit e politikës së jashtme të vendit.

Deri më sot nuk ka shumë autorë që kanë analizuar politikën e jashtme të Kosovës, aq më pak në relacion me subjektet me të cilat kanë vështirësi ta pranojnë subjektivitetin e Kosovës dhe kjo shërben si shtysë për të dhënë kontributin tim modest në këtë pjesë.

Një analizë e marrëdhënieve të deritashme të Kosovës me këto vende, do të mund të na japë një pasqyrë për mundësitë që Kosova të mund të qaset në të ardhmen ndaj këtyre shteteve, gjë e cila do të mund të reflektojë edhe në ngritjen e pranisë së Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Si rezultat i këtyre kufizimeve që Kosova përballlet në marrëdhënie ndërkombëtare, rrjedhin edhe vështirësitë në shtrirjen e aparatit diplomatik, e cila paraqet sfidë për diplomacinë e Kosovës dhe realizimin e objektivave strategjike të saj. Kjo sfidë e mospasjes mundësi për qasje, e rëndon edhe më shumë gjendjen objektive të fuqisë së politikës së jashtme të një shteti të vogël si Kosova, me resurse të kufizuara financiare dhe kadrovike.

Mëtej për të paraqitur një tablo më të plotë kemi shqyrtuar rastet studimore si Abkhazia, Sahara Perëndimore, Somalilandi, Osetia e Jugut, Palestina, Izraeli, Tajvani, Republika Turke e Qipros Veriore etj. Nga to ka anëtare të plota të KB-së (si p.sh. Izraeli) por me probleme në marrëdhënie bilaterale me shtete të caktuara, me status më të ulët në këtë sistem ndërkombëtar (si p.sh. Palestina), pastaj shtete të ndaluara të njihen me rezolutë detyruese të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (si p.sh. Qipro Veriore) dhe shtete që ne veprimet e tyre kanë përcaktuar statusin jo të kënaqshëm e të synuar (si p.sh. Tajvani) me politikën e ndjekur të “një Kine”.

Strukturalisht, si punim, në kapitullin e parë shtjellohet aspekti teorik i njohjes së një shteti sipas këndvështrimit të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kapitull do të shtrojmë dhe përplasim mendimet e autorëve eminentë të fushës që në përsiatjet e tyre teorike kanë

ballafaquar idetë e ndryshme mbi koncepte si njohja, sovraniteti, të cilat kanë shtruar bazën për kodifikimin e këtyre nocioneve në të drejtën ndërkombëtare dhe sot shërbejnë në rregullimet e raporteve mes subjekteve ndërkombëtare, gjegjësisht shteteve.

Në hyrje të kapitullit të dytë do të bëjmë një retrospektivë të procesit historik të Kosovës si subjekt që evoluon deri në shpalljen e pavarësisë më 17 Shkurt 2008, periudhë e cila jo pak është trajtuar nga autorë të shumtë, por kompleksiteti i saj dhe dimensionet që do ta trajtojmë është i veçantë dhe bëhet jo rastësisht por që shërben si ndërlidhje me pjesën tjetër të kapitullit. Tutje shtjellohet periudha post-pavarësi e Kosovës, ku Kosova fiton subjektivitetin e saj ndërkombëtar dhe paralelisht me njohjet ndërkombëtare kalon në disa procese që kanë të bëjnë me shtetndërtimin dhe politikën e jashtme, gjegjësisht etablimin e saj. Kontestimi që i bëhet pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) është njëra ndër pengesat e mëdha që Kosova ka hasur menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, të cilën juridikisht e kalon me sukses, ndërsa politikisht ndodhin procese të kontestimit. Gjithsesi kjo sjell një momentum të ri, pas të cilit kemi negociata dhe marrëveshje të shumta në kuadër të Dialogut të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë, të cilat kanë impaktin e madh edhe në politikën e jashtme të Kosovës, me theks të veçantë në betejën për njohje të reja.

Kapitulli i tretë zë vend qendror në punim, për arsye se shtjellon relacionet e Kosovës me Bashkimin Evropian (BE), marrëdhënie të cilat determinohen nga fakti i mosnjohjes së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së. Andaj, kjo shtron domosdoshmërinë që të studiohen raportet edhe me BE-në si një strukturë komplekse mes ndërqeveritare dhe supranacionales, por edhe raportet e Kosovës me shtetet e veçanta, të cilat nuk janë në një nivel të njëjtë në secilin rast. Prandaj, është e rëndësishme që hartuesit dhe ekzekutuesit e politikës së jashtme të Kosovës, qasjen ta kenë të veçantë ndaj këtij grupimi shtetesh, me shumë rëndësi për të ardhmen e Kosovës në kontekstin e integritimit evropian dhe jo vetëm.

Në vazhdim të kapitullit analizohen raportet e Kosovës me rajonet e tjera më të largëta gjeografike, duke ditur mirëfilli që Kosova si shtet i vogël dhe i ri, ka mungesë të resurseve kadrovike, financiare dhe administrative për prezencë dhe shtrirje të gjerë diplomatike. Megjithatë specifikat e Kosovës, mosnjohja dhe moskontakti i duhur i saj në rajone të largëta, kontestimi që asaj i bëhet, propaganda e Serbisë që në ato pjesë ka një rrjet të gjerë dhe jo të zakonshëm për madhësinë që ka si shtet, janë kamberë alarmi për Kosovën. Këto



rajone përfshijnë: Evropën Lindore pastaj kontinentet e tjera si Afrika, Azia, Australia, Oqeania, Amerika Jugore dhe Amerika Veriore.

Duke qenë koshientë që për një shtet i cili has vështirësi për t'u pranuar nga shtete të tjera, është tejet i rëndësishëm aktiviteti multilateral, kapitulli i katërt trajton pikërisht diplomacinë multilaterale të Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë, politika e jashtme e Kosovës paralelisht me procesin e fitimit të njohjeve bilaterale nga shtetet sovrane dhe anëtare të KB-së, ka synuar anëtarësimin në organizata ndërkombëtare të të gjitha kategorive, duke arritur suksese të konsiderueshme por duke u ndeshur edhe me mungesë të sukseseve në raste të caktuara. Aktiviteti i tillë është në vazhdim, tejet kompleks dhe është pjesë e punës së përditshme të angazhimit të diplomatëve të Kosovës. Modalitetet e ndjekura, koha për aplikim, konstelacionet ndërkombëtare, arsyeshmëria e (mos)anëtarësimit janë vetëm një pjesë e elementeve që duhet të merren parasysh nga vendimmarrësit. Gjithashtu multilateralizmi shërben edhe si mundësi e rëndësishme për kontakte bilaterale sidomos me shtete me të cilat është i vështirë vendosja e kontakteve.

## **HIPOTEZAT**

### **Hipoteza kryesore**

- Ngecja e njohjes së plotë të Kosovës në arenën ndërkombëtare konsiderohet të jetë si pasojë e pozicionimit gjeostrategjik të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare.

### **Hipotezat ndihmëse**

- Për qasje në organizata ndërkombëtare, Kosova e ka domosdoshmëri kërkimin e aleancave dhe mbështetjen nga shtetet e tjera.
- Qasja e Kosovës vështirësohet në raport të drejtë me largësinë gjeografike të subjekteve që e kontestojnë, duke e bërë të nevojshëm planifikimin e duhur për qasje në regjionet e largëta.
- Shtrirja gjeografike e aparatit diplomatik dhe konsullor është e varur në raport të drejtë me numrin e njohjeve nga rajone specifike.

## **METODOLOGJIA**

Për realizimin e këtij punimi, në varësi të kapitujve dhe në funksion të zgjidhjes së dilemave të ngritura janë përdorur disa metoda shkencore kryesore:

- Metoda e analize-sintetizuese;
- Metoda historike;
- Metoda krahasuese;
- Metoda e dokumentacionit dhe
- Intervista.

Janë realizuar 12 intervista gjysmë të strukturuar me shkrim ose të drejtpërdrejta me ekspertë të fushës që hapën dimensione dhe horizonte të reja për përmbushjen cilësore dhe empirike të punimit.

Kjo metodologji nuk është zgjedhur rastësisht, edhe pse duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e anketës si metodë moderne për rezultate shkencore, megjithatë në bazë të konsultave dhe hulumtimit që kam bërë dhe marrë parasysh specifikat e temës që synoj ta

trajtoj, që bie në domenin e diplomacisë, kësaj fushe tejet specifike, komplekse dhe që kërkon zell dhe mjeshtëri përtej opinionin publik, kam konsideruar që intervistat e fokusuara me njerëz të profesionit, diplomatë të rangjeve të larta, profesorë etj., janë metoda e duhur për të nxjerrë rezultatet e dëshiruara konform temës së përzgjedhur. Gjithashtu, realizimi i intervistave i jep temës atë brumin e rëndësishëm, pasi aktualiteti i temës shpesh pason me mungesën e literaturës në nivel të kënaqshëm që trajton politikën e jashtme të Kosovës pas pavarësisë, posaçërisht me subjektet nga të cilat nuk e njohin.

Duhet thënë që secila metodë do të vihet në përdorim në funksion të arritjes së qëllimit në varësi të temës në kapitujt përkatës, por pashmangmërisht, të gjitha këto në një formë konglomerati do të gjejnë përdorim në punimin si tërësi.

### **Pyetjet kërkimore**

- A duhet të rikonceptohet rrjeti diplomatik i Kosovës, në drejtimin e zgjerimit të tij dhe specializimit të stafit?
- Si ndikon kohezioni i brendshëm politik në Kosovë në rritjen e efikasitetit në politikën e jashtme?
- Cili është bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë dhe aleatët e tjerë në rritjen e efikasitetit në aspekt të politikës së jashtme?
- Cili është ndikimi i kundërshtarëve të pavarësisë si Serbia, Rusia dhe Kina në tërheqjen e njohjeve për Kosovën?
- Cilat janë ngjashmëritë e Kosovës me subjektet e tjera që posedojnë elementet e shtetësisë por pa njohje të plotë (anëtarësim në KB) dhe cilat janë veçoritë që Kosovën e bëjnë rast *sui-generis*?

## KAPITULLI I

### 1. NJOHJA SIPAS SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

#### 1.1 Teoritë e njohjes

Secila përsiatje teorike mbi njohjen dhe diskutimin mbi teoritë kryesore të njohjes së shtetit, qoftë me synim të argumentimit apo kundërshtimit të tyre, pashmangshëm ka si prerogativë kriteret e shtetit sipas Konventës së Montevideos 1933. Kjo Konventë mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve e lidhur mes shteteve amerikane, por e pranuar gjerësisht në të drejtën ndërkombëtare për shkak që është llogaritur se i përkiste të drejtës zakonore përcakton kriteret si më poshtë:

1. Popullsinë e përhershme;
2. Territorin e caktuar, ku nuk kërkohen kufijtë të precizuar por një nukleus territorial i padiskutueshëm;
3. Qeverinë apo pushtetin sovran;
4. Aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera (Konventa e Montevideo për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve, neni 1., 1933).

Thomas Grant thekson se kriteret e shtetit të kodifikuara në këtë Konvente gjenden thellë në të drejtën zakonore, deri në të drejtën romake si dhe në shkrimet e autorëve William Hall, Georg Jellinek, James Loriner, George Scelle, Hannis Talyor, dhe Henry Weaton (Grant, 1999, fv. 6-9, cituar sipas Radan, 2021, f. 49).

Kriteri i katërt, kapaciteti për të hyrë në marrëdhënie me jashtë, është sfidë serioze për shumë entitete që i përmbushin tre kriteret e tjera (territorin, popullsinë, pushtetin efektiv). Shembull entitetet Bantustan në Afrikën e Jugut që nuk ishin njohur fare nga komuniteti ndërkombëtar (Bophuthatswana, Ciskei, Transkei dhe Venda). Andaj, sipas së drejtës ndërkombëtare, nga cilado teori aplikuese, është problematike dhe i pasaktë grupimi i këtyre entiteteve në shtete (qoftë si shtete që nuk kanë asnjë njohje).

Nina Caspersen argumenton se shtetet e panjohura kanë ekzistuar në çdo kohë, por arsyet e mosnjohjes kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Më e rëndësishmja, argumenton se

sovrانيتeti nuk ishte një dimension i jashtëm dhe në të shumtën e rasteve në histori sovraniteti u pohua nga brenda dhe kështu të gjitha shtetet ishin të panjohura, përveç një niveli të njohjes diplomatike (Caspersen, 2012, f. 27). Por rrjedhat ndërkombëtare, sidomos pas Paqes së Westfalisë 1648 kur merret edhe si pikënisje e periudhës së “diplomacisë klasike” dhe marrëdhënieve mes shteteve si subjekte të barabarta juridike, e posaçërisht pas Luftës së Parë Botërore kur diplomacia multilaterale mori hov dhe po ashtu e drejta e vetëvendosjes me insistim të presidentit amerikan Uillson, sollën intensifikim të marrëdhënieve mes shteteve e edhe të praktikave që më parë nuk ishin të njohura.

Ryan Griffiths shpreh mendimin se njohja e shteteve gjithmonë ka qenë një rivalizim i traditës liberale dhe asaj sovraniste (Griffiths, 2016, fv. 7-8). Ai këtë e argumenton me një qasje historike ndaj procesit të njohjes që nga rendi evropian i para 1816-ës ku mungonin normat liberale, duke potencuar edhe ndikimin e Napoleonit në njohje, pastaj periudha deri më 1918 ku vetëvendosja u potencua si e drejtë negative dhe epoka post 1945 me njohje normative (Griffiths, 2016), dhe përderisa analizon evoluimin gjatë procesit historik të njohjes së shteteve të reja nga siç e quan ai “klubi” i shteteve sovrane ekzistuese, kur arrin në epokën e fundit thekson se shembulli i Kosovës e sjellë potencialisht një rrugë të re drejt pavarësisë, e cila bazohet në të drejtat e njeriut. Gjithashtu dhe pasigurinë e Kosovës për t’u njohur nga të gjitha shtetet ia atribuon erërave të kundërta normative të jetës ndërkombëtare (Griffiths, 2016).

Si rrjedhojë, marrëdhëniet ndërkombëtare midis shek. XX dhe XXI po i sfidon edhe fenomeni i “shtetit virtual” siç i emërton Blerim Reka, apo i entiteteve të panjohura si shtete, por që në praktikë veprojnë si të tilla. Këto shtete njihen me terminologji të ndryshme, si: shtete *de facto* (Pegg, 1988), kuazi shtete (Kolstø, 2006), shtete të kontestuara (Deon, 2009), shtete që nuk njihen (Kurtulus, 2005), shtete virtuale (Reka, Bashota, & Sela, 2016) etj.

Nuk ka dyshim që për një shtet, njohja nga të tjerët është e rëndësishme, qoftë nga shteti nga i cili është ndarë, ose nga një fuqi e tretë. Njohja nga shteti nga i cili është pavarësuar është shumë e rëndësishme për arsye që i largon mëdyshjet te shtetet e tjera, por kjo nuk duhet shikuar si një dhuratë e pavarësisë, por si një njohje e një realiteti të ri (Hall, 1880, f. 74). Shembull njohja e Timorit Lindor nga Indonezia apo e Sudanit të Jugut nga ana e Sudanit.

Dy qasjet tradicionale në të drejtën ndërkombëtare për studimin e njohjeve janë: qasja konstituive dhe qasja deklarative.

Njohja e shtetit është hasur fillimisht në Teorinë Konstituive; Thomas Grant mendon që thelbi i saj mund të gjendet që në Kongresin e Paqes së Vjenës më 1815, ku akti përfundimtar i këtij kongresi njohu vetëm 39 shtete sovrane në Evropë, dhe gjithashtu përcaktoi se çdo shtet i ardhshëm mund të njihej si i tillë vetëm përmes pranimit nga shtetet ekzistuese të mëparshme (Holsti, 2004, fv. 128-129). Autorë të tjerë si Ilir Kalemaj njohjen e shteteve në të drejtën ndërkombëtare e lidhin me periudha të tjera:

- a) krijimi i shteteve-kombe me revolucionet e 1848;
- b) procesi i dekolonizimit dhe formësimi i shteteve të reja në Afrikë dhe Azi dhe
- c) shpërbërja e shteteve federative apo proceset unifikuese në periudhën pas '90-tave dhe krijimi i shteteve të reja (Kalemaj, 2012, f. 6).

Megjithatë si teori konstituive prejardhjen e vet e ka në konceptet e shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX. Ajo është zhvilluar në praktikën e shteteve evropiane që nëpërmjet “koncertit evropian” vendosnin për pranimin e ndonjë shteti në bashkësinë ndërkombëtare (Gruda, 2009, f. 78).

Lassa F. Oppenheim që njihet si një ndër përfaqësuesit eminent të së drejtës ndërkombëtare dhe përfaqësues i teorisë konstituive, konstaton se e Drejta Ndërkombëtare nuk thotë që një shtet nuk ekziston për sa kohë që nuk njihet, por ai nuk e vë re atë para njohjes së tij. Përmes njohjes vetëm dhe ekskluzivisht një shtet bëhet një subjekt i së drejtës ndërkombëtare (Oppenheim, 2012, f. 117). Apo siç Grant e përkufizon njohjen si një procedurë gjatë të cilës shtetet ekzistuese i përgjigjen një ndryshimi të ndodhur në sistemin ndërkombëtar (Grant, 1999).

Sistemi i KB-së, i themeluar pas luftës së ftohtë, ka përforcuar teorinë konstituive deri në një nivel që shtetet e shohin të rëndësishme anëtarësimin në këtë organizatë. Madje John Dugard e obligon anëtarësimin në KB me ekzistimin si shtet (Dugard, 1987). Sipas David Raič (Raič, 2002, f. 442) zhvillimet moderne të marrëdhënieve ndërkombëtare si pranimi i normave themelore dhe ndalimi i agresionit ka bërë që nëse në të kaluarën ka qenë më gjerësisht i pranueshëm pozicioni se formimi i shteteve është çështje faktike e jo juridike, por kjo nuk qëndron në të drejtën ndërkombëtare bashkëkohore.

Problemet me teorinë konstituive qëndrojnë se nuk ka fuqi detyruese për shtetet për të njohur një shtet, pavarësisht që Hersch Lauterpacht propozon që shtetet kanë një detyrë ligjore të njohin njëri-tjetrin kur kushtet e shtetësisë ekzistojnë (Lauterpacht, 1947) (Lauterpacht, 1944, f. 385), andaj është në vullnetin e tyre individual që a të pranojnë atë shtet apo jo. Dhe një shtet i papranuar, gjithsesi është i presupozuar të pranojë të drejtën ndërkombëtare, pavarësisht nga mosnjohja nga të tjerët, e që sipas teorisë konstitutive ai në këtë rast nuk do të kishte të drejta dhe detyrime nga ligji ndërkombëtar.

Gjithsesi, edhe praktika nuk korrespondon me vullnetin e Lauterpacht mbi obligueshmërinë e njohjes së shteteve të krijuara sipas kriterëve. Pra, shtetet nuk pranojnë shtete të tjera përkundër plotësimit të kriterëve të Montevideos. Gjithsesi kjo nuk duhet të ngatërrohet me mendimin e Hans Kelsen mbi njohjen e shteteve pa plotësuar kriteret e shtetësisë, ku ky e ngrit në nivel obligimi mosnjohjen në të tilla raste. Sipas tij, një shtet shkel ligjin ndërkombëtar nëse njeh si shtet një komunitet i cili nuk plotëson kërkesat e së drejtës ndërkombëtare (Kelsen, 2011, fv. 191-192).

Teoria deklarative në formën e saj tradicionale mund edhe të mos quhet një teori e njohjes, por më shumë një teori që na tregon se si krijohen shtetet dhe e largon njohjen si faktor vendimtar. Sipas kësaj teorie ekziston një rregull i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare që një shtet është i tillë nëse i plotëson kriteret, pavarësisht njohjes (Nicholson & Grant, 2020, f. 25). Pra, përkundër që nuk është universale, Konventa e Montevideos, në nenin 3 e kodifikoi si ligj ndërkombëtar teorinë deklarative: “Ekzistenca politike e shtetit nuk lidhet me njohjen nga shtetet e tjera.” Në mënyrë të përmbledhur njohja sipas teorisë deklarative është vetëm një “njohje” apo vetëdije formale mbi një fakt të mëhershëm.

Komisioni i Badinterit i formuar nga Komuniteti Evropian për Jugosllavinë, ishte i bazuar në teorinë deklarative ku në lidhje me shtetet e reja të dala nga Jugosllavia theksonte se shtetësia është një çështje fakti dhe efektet e njohjes nga shtetet e tjera janë thjesht deklarative (Komisioni i Badinterit cit. sipas Nicholson & Grant, 1991, f. 26). Pastaj njohja e Bosnjës si shtet, më shumë i përgjigjet teorisë konstituive, pasi ajo ndodhi kur pushteti efektiv nuk ekzistonte. Shaw njohjen e Bosnjës nga ShBA dhe Komuniteti Evropian e cilëson edhe si njohje të parakohshme (Shaw, 2003, f. 383), kurse Türk vë theksin se njohja e Bosnjës dhe pranimi i shpejtë në KB nuk ishte i nxituar (Türk, 1993, f. 69).

Thuaje në të njëjtën kohë BE doli me kushtet e reja nëpërmjet Deklaratës së Udhëzimeve për Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore, e cila ngrit në një nivel më të lartë dhe i shërben teorisë konstituive të njohjes, ku përveç kriterëve të Montevideos, shtohen kriteret shtesë për njohjen e shteteve të Evropës Lindore në ndryshimet që po ndodhnin pas rënies së Perdes së Hekurt. Kriteret kërkonin respektimin e kufijve, të drejtave të njeriut, të minoriteteve, zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, mosnjohjen e entiteteve që krijohen si rezultat i agresionit dhe asnjë zhvillim të aktivitetit nuklear.

Hans Kelsen në nocionin “njohje” e bën një dallim në mes të aktit politik të njohjes dhe aktit juridik të njohjes. Akti politik i njohjes së një shteti ose qeverie do të thotë që shteti njohës është i gatshëm të hyjë në marrëdhënie politike dhe marrëdhënie të tjera me shtetin ose qeverinë e njohur, marrëdhënie të llojit që normalisht ekzistojnë midis anëtarëve të familjes së kombeve. Kjo njohje mund të bëhet ose nga një deklaratë e njëanshme e shtetit njohës, ose nga një transaksion dypalësh, domethënë, nga një shkëmbim shënimesh midis qeverisë së shtetit njohës, nga njëra anë, dhe qeverisë së shtetit të njohur ose qeverisë së njohur nga ana tjetër, të cilat janë të parëndësishme nga pikëpamja ligjore. Deklarata e tillë mund të ketë rëndësi politike për atë që njihet, por nuk ka pasoja ligjore. Akti politik korrespondon me karakterin deklarativ të njohjes (Kelsen, 1941, fv. 605-610).

Ndërsa Akti juridik i njohjes është vërtetimi i një fakti, nuk është shprehje e një vullneti. Vetëm ekzistenca e tij ligjore, ekzistenca e tij siç gjykohet nga e drejta ndërkombëtare, jo ekzistenca e saj "natyrore", ka rëndësi. Ekzistenca e tij juridike është identike me ekzistencën e saj si shtet, d.m.th., si subjekt i ndërkombëtarizimit. Prandaj, akti juridik i njohjes ka një karakter posaçërisht konstituiv (Kelsen, 1941).

Dallimi mes këtyre dy teorive qëndron në atë se derisa teoria deklarative mbron idenë se shteti me plotësimin e kriterëve të shtetësisë bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare, sipas teorisë konstituive shteti i duhet njohja për tu bërë subjekt i së drejtës ndërkombëtare (Musliu, 2018, f. 114).

Përmbledhtazi për atë që u tha deri më këtu, ndoshta shtjellimi i një definicioni më kuptimplotë i njohjes është dhënë nga Peter Radan se “ligji ndërkombëtar i njohjes mund të kuptohet më mirë si një bashkim i normave, praktikave dhe rregullave juridike dhe politike, të cilat janë në diskrecionin e shteteve për të zbatuar në përputhje me interesat e tyre” (Gëzim, Newman, & Doyle, 2019, f. 6). Ky diskrecion i përgjigjet edhe epokës aktuale,



rrjedhimisht njohjes së Kosovës, siç do të shohim në kapitujt vijues, por qartazi në epokën moderne përgjatë viteve teoria konstituive ka fituar terren ndaj asaj deklarative, por që edhe kjo është e pamjaftueshme.

## **1.2 Kritikkat ndaj teorive – drejt një qasjeje të re**

Është praktika ndërkombëtare e cila mund të shtyjë në krijimin e normave, gjegjësisht teorive të reja. Shembull është shteti i Izraelit, që nëse shikohet nga teoria konstituive është i njohur nga komuniteti ndërkombëtar përmes pranimit në anëtarësi në Kombet e Bashkuara, ndërsa sipas teorisë deklarative, ende nuk njihet nga një pjesë e shteteve arabe. Gjithashtu kemi rastin e Vatikanit, i cili paraqitet goxha sfiduese nëse rendisim kriteret e shtetësisë, mirëpo është i njohur ndërkombëtarisht dhe këtu del në pah teoria konstituive.

Pra, njohja ndërkombëtare e një shteti ka ndryshuar jo vetëm në akse hapësinore, duke iu referuar argumenteve gjeo-politike, sa dhe atyre legale, por edhe në akse kohore, duke pësuar një metamorfozë në përputhje me vetë natyrën dinamike të së drejtës ndërkombëtare publike (Kalemaj, 2012, f. 6).

Teoria deklarative njërën ndër kritikrat fundamentale e ka se si mund të pajtohet ajo me mosnjohjen e një shteti i cili i plotëson kriteret e shtetësisë por që u shfaq pas shkëlqes së jus cogens<sup>1</sup> (Papić, 2020, f. 23). Teoria konstituive kritikohet edhe pse është në kundërshtim me parimin e vetëvendosjes së popujve sepse shfrytëzimi i kësaj të drejte do të kushtëzohej me pranimin nga shtetet e tjera, gjë që në esencë do të thotë mohim i saj (Gruda, 2009, f. 79).

Kjo shpjegon kompleksitetin e debatit Konstituist kundrejt atij Deklarativist. Është një problem logjik vështirë i tejkalueshëm nga autorët e teorisë deklarative, vështirësia e argumentimit të teorisë që pa pasur shteti së paku ca njohje nga shtetet e tjera me të cilat ka relacione. Sepse nëse vlen plotësisht vetëm teoria deklarative, atëherë bie ndesh me obligueshmërinë e kushtit të katërt të shtetësisë, hyrjen në marrëdhënie me shtetet e tjera.

Andaj, një debat i vjetër që ka ndarë shumë autorë midis teorive konstituive dhe deklarative, ofron shpjegime të logjikshme për teorinë e njohjes, por si të vetme, praktika ka treguar që janë të pamjaftueshme për të shpjeguar fenomenet e ndodhura me shtetet e reja dhe njohjen e tyre gjatë shek. XX por dhe XXI. Andaj, ashtu siç edhe autorë të ndryshëm

---

<sup>1</sup> Jus cogens janë rregullat e detyrueshme, të cilat palët nuk mund t'i ndryshojnë.

(Lauterpacht, Grant, Dugard, Schoiswohl, Visoka etj.) kanë shtuar zërat mbi qasje të reja, disa nga të cilët i përkrahin mendimet evoluese të teorive ekzistuese tradicionale, e disa për qasje të ndryshme. Visoka (2019) kritikon mungesën e qasjes kritike ndaj teorive të njohjes. Ai kërkon që të sfidohen teoritë pozitiviste tradicionale, kërkon kritikën edhe ndaj fenomeneve të ndërlidhura me njohjen si: shteti, sovraniteti, integriteti territorial apo pushteti legjitim.

Se këto dy teori ndaras nuk janë të mjaftueshme për të shpjeguar njohjen në rrethanat e reja, dëshmon dhe rasti i Kosovës. Shikuar arsyetimet që shtetet kanë dhënë për njohje të Kosovës (të cilat do të diskutohen në kapitullin 2), japin elemente të përzierjes së dy teorive të njohjes, pra jo si një teori e ndërmjetme, por si një teori e përbërë nga ndërthurje e të dyjave. Pra, shtete të shumta që kanë dhënë arsyetimin për njohje të një realiteti të ri. Megjithatë të tjerë kanë përmendur kriteret shtesë sipas Ahtisaarit, themelimin e marrëdhënieve diplomatike, shterjen e negociatave, qartësimin e statusit të Kosovës etj. (Taillefer, 2011, fv. 54-65).

Disa zëra janë në drejtim të shtimit të kriterëve shtesë për njohjen si plotësim i teorive tradicionale. Kriteret tilla si respektimi i të drejtave të njeriut apo qeveria demokratike. Mirëpo këto dhe kriteret tilla nuk janë gjerësisht as të përhapura e as të pranueshme (Grant, 1999, f. 216). Edhe Peter Hilpold e vë theksin se ndarjet lindje-perëndim dhe rivalitetet veri-jug kanë çuar në një situatë ku njohja e një vendi, shumë vështirë kushtëzohej nga respektimi i vlerave të caktuara pasi mund të interpretohet si ndërhyrje e paligjshme (Hilpold, 2009, f. 59). Andaj, si të tilla nuk mund të marrin statusin e normës në të drejtën ndërkombëtare. Kriteret të ngjashme i përmendëm ato të përcaktuara nga Komuniteti Evropian në Deklaratën e Udhëzimeve për Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore, dhe në Deklaratën për Jugosllavinë (United Nations, 1991). Megjithatë këto kriteret të reja të aplikuar nga Komuniteti Evropian ndaj Jugosllavisë, janë problematike të funksionojnë si kriteret shtesë të kriterëve tradicionale të njohjes, apo t'i zëvendësojnë ato, në rastin e njohjeve të Kroacisë dhe Bosnjës (Ryngaer & Sobrie, 2011, f. 477).

Kjo qasje e re, mund të jetë në variantin si qasje e tretë që është në mes të dy qasjeve deklarative dhe konstitutive, duke ezauruar nga të dyja mjaftueshëm për të shpjeguar praktikën ndërkombëtare, e jo si një qasje përjashtuese ndaj dy teorive të mëparshme.

### 1.3 Llojet e njohjes

Krahas teorive të njohjes të diskutuara më lart, që përfshinte teoritë tradicionale apo tendencat për qasje të reja teorike të njohjes, në të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare nga autorët janë radhitur edhe llojet e njohjeve.

Sipas Konventës së Montevideos, “njohja e shtetit mund të jetë *e shprehur* ose *e heshtur*. Kjo e fundit rezulton nga çdo akt që nënkupton qëllimin e njohjes së shtetit të ri” (Konventa e Montevideo për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve, neni 7).

Njohja e shprehur është njohje që mund të jepet me diçka e cila lë gjurmë. Ajo rëndom mund të jetë nota diplomatike, si formë e zakonshme e korrespondencës diplomatike dhe paraqet formë zyrtare, eksplicite dhe të shprehur të njohjes. Por gjithashtu mund të jetë një letër, deklaratë nga shefi i shtetit ose ministri i jashtëm.

Njohja e heshtur paraqet formë kur nuk është dhënë njoftimi zyrtar për njohje, por nuk lë dyshim që është bërë njohja. Ajo sipas Zejnullah Grudës mund të paraqitet në disa forma: lidhja e një marrëveshjeje me shtetin e ri, pranimi i dërgimit të një përfaqësuesi diplomatikë, pranimi i shteteve të treta i konsujve të shtetit të ri. Po ashtu pjesëmarrja e delegacionit zyrtar të një shteti në solemnitete me rastin e fitimit të pavarësisë interpretohet si njohje heshtazi (Gruda, 2009, f. 83).

Njohja mund të jetë edhe *de facto* dhe *de jure*. Ker-Lindsey është i mendimit që këto nocione tradicionalisht më shumë janë përdorur për njohjen e qeverive, por janë të aplikueshme edhe për njohjen e shteteve (Ker-Lindsay, 2012, fv. 7-8).

Njohja *de jure* është njohje e përhershme dhe e plotë, që përfshin vendosjen e marrëdhënieve të plota me atë shtet. Jepet nëpërmes një akti formal, dhe nuk revokohet (Gruda, 2009, f. 81). Në njohjen *de facto*, shtetet krijojnë marrëdhënie por për arsye të ndryshme nuk shprehet njohja e plotë, por megjithatë pranohet një realitet mbi kontrollin efektiv mbi një territor të caktuar. Në rast të ndryshimit të rrethanave, kjo njohje mund të revokohet. ShBA tërhoqi njohjen *de facto* për Republikën Armene duke e njoftuar këtë se e ka bërë pasi “ka pushuar së ekzistuari si shtet i pavarur” (Chen, 1951, f. 261). Njohja *de facto* mund të konsiderohet edhe si njohje paraprake, përderisa entiteti të fitojë të gjitha

atributet e shtetësisë. E tillë ndoshta mund të konsiderohet njohja që ShBA i bëri fillimisht Izraelit nëpërmjet presidentit Truman, para se të shndërrohet në njohje *de jure* nëpërmjet KS të KB-së. Shembull tjetër është Bashkimi Sovjetik, që nga krijimi i tij më 1917, u njoh *de facto* nga Britania e Madhe më 1921, ndërsa njohja kaloi *de jure* më 1927 (Shaw, 2003, f. 382).

Në praktikë ekziston edhe *njohja e kushtëzuar dhe njohja e pakushtëzuar*. Konventa e Montevideos thekson se "...Njohja është e pakushtëzuar dhe e parevokueshme" (Konventa e Montevideo për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve, neni 6). Prandaj, njohja e kushtëzuar është e kritikuar për shkak se përmban elemente politike të njohjes, por megjithatë e zbatueshme në praktikën ndërkombëtare. Në të kaluarën Kongresi i Berlinit njohu Serbinë, Bullgarinë, Rumaninë e Malin e Zi me kushte të caktuara që ndërlidheshin me çështje fetare. Në rastin e njohjes së Kosovës nga ana e Maqedonisë së Veriut ka pasur informacione se kjo ka qenë një fazë e kushtëzuar me demarkimin e kufirit mes dy vendeve. Gjithashtu njohja nga Izraeli, si kusht duket të jetë themelimi i misionit diplomatik në Jeruzalem. Edhe pse nga prizmi se si erdhi kjo njohje nëpërmjet marrëveshjes së Uashingtonit mund edhe të mos interpretohet në këtë qasje kushtëzimi, pasi nuk u kushtëzua drejtpërdrejt nga pala që njohu.

Kelsen është i mendimit që njohja politike sipas teorisë deklarative mund të jetë njohje e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar, ndërsa si njohje juridike apo konstituive nuk mund të kushtëzohet (Kelsen, 2011, fv. 611-612). Kurse Hall njohjen e kushtëzuar e ndan në dy tipe: njohje të bashkëngjitur me kushtet e precedentit dhe njohje të bashkëngjitur me kushte *sub modo* (subjekt i ndryshimit ose kërkesës). Në rastin e parë njohja mund të tërhiqet për shkak të mospërbushjes së kushteve, kurse në rastin e dytë mosplotësimi i kushteve apo obligimeve të marra përsipër i jep të drejtë njohësit t'i përmbushë ato qoftë me ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike apo me intervenim për përmbushje të tyre (Hall, 1924, f. 113).

Njohja *individuale* dhe *kolektive*. Siç mund të kuptohet edhe nga vetë emrat, njohjet mund të jenë individuale nga shtetet veç e veç ose kolektive nga të gjitha shtetet (ose një grupi por që marrin vendim kolektiv për njohje). Në shekullin XIX dhe fillimshekullin XX, në mungesë të një organizate panbotërore, ka mbizotëruar forma e kongreseve apo koncerteve ndërkombëtare të Fuqive të Mëdha për njohje kolektive të shteteve të reja. Kjo ka ndodhur

në Kongresin e Berlinit, siç u cek më lart janë njohur disa shtete ballkanike, pastaj Konferenca në Londër 1913 e njohu pavarësinë e Shqipërisë, etj. Këshilli Suprem i Aleatëve pas Luftës së Parë Botërore mori këtë funksion në njohjen e vendeve (Crawford, 2012, f. 150). Më pas me themelimin e Lidhjes së Kombeve, e pas Luftës së Dytë Botërore me KB, njohja kolektive është në domenin e këtyre mekanizmave ndërkombëtarë. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia që njohja kolektive të ndërmerret edhe nga ana e ndonjë organizate me karakter rajonal.<sup>2</sup> Shtetet e Bashkimit Evropian njohën kolektivisht Sudanin Jugor me anë të një komunikate zyrtare më 9.07.2011 (Pop, 2011). Të tilla mund të konsiderohen dhe rezolutat e OBI-së (Organizata e Bashkëpunimit Islamik) e të PE-së (Parlamentit Evropian) që bënin thirrje për vendet anëtare të njohin pavarësinë e Kosovës.

Disa teoricientë kanë diskutuar edhe për *njohjen e parakohshme*. Njohja e parakohshme paraqitet në raste kur një shtet njihet, pa i plotësuar ende kriteret e shtetësisë, si shembull kontrollin e territorit, i cili ende mund të jetë nën kontroll të shtetit paraprak. Megjithatë kjo njohje e parakohshme nuk ka ndikim në ligjshmërinë e shtetit të ri, i cili nëse konsolidohet dhe i përmbush kriteret e shtetësisë nuk mund të konsiderohet shtet ilegal vetëm pse është njohur para kohe (Milano, 2019, f. 23). Siç e kemi cekur më lart, autorë të ndryshëm e kanë cilësuar njohjen e Bosnjës si të parakohshme për shkak të moskontrollit të territorit (Shaw, Tusk). Megjithatë njohja e parakohshme e Bosnjës, por edhe e Kroacisë, mund të justifikohet për shkak të abuzimit të të drejtave të njeriut e spastrimit etnik. Pra, një ndalim i njohjes së parakohshme që ekziston në të drejtën ndërkombëtare, nuk vlen në raste të tilla (Berlin, 2009, f. 569).

Milano jo në definicionin e përdorur për njohjen e parakohshme, por në një formë tjetër tenton të ndërlidhë njohjen e Kosovës në vitet e para të pavarësisë deri më 2012, si njohje të parakohshme për shkak që Kosova ka qenë në fazën e mbikëqyrjes së pavarësisë (Milano, 2019, f. 14). Megjithatë, mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës nuk ka qenë për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të shtetësisë, përfshirë kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me jashtë, por më shumë si një garancë që shteti i ri ndërmerr të gjitha obligimet me rastin e shpalljes së pavarësisë. Pra, mbikëqyrja e pavarësisë nuk ka

---

<sup>2</sup> Organizata e Bashkëpunimit Islamik ka diskutuar mbi Kosovën. Përkundër skenarëve optimistë të menduar, nuk ka qenë e mundur arritja e ndonjë konsensusi mbi njohjen e Kosovës. Ajo i është lënë në dorë shteteve veç e veç.

funksionuar si një pushtet mbishtetëror, e as që ka paralele me administratën e UNMIK-ut deri në shpallje të pavarësisë.

#### **1.4 Njohja e shtetit dhe KB**

Njohja për shtetet që nuk pranohen në sistemin ndërkombëtar, gjegjësisht nuk janë anëtare të KB-së, edhe pse këtu më pak bën pjesë Kosova për shkak të numrit të lartë të njohjeve dhe integritit në shumë mekanizma ndërkombëtarë, është tejet vitale për të arritur garancinë për sovranitetin e tyre të brendshëm që tashmë e ushtrojnë. Këto shtete në raste të caktuara funksionojnë edhe me kohëzgjatje disa-dekadëshe dhe kanë institucione stabile, por me njohje të kufizuar, paraqesin raste tipike të sovranitetit të brendshëm të plotë, por pa sovranitet të jashtëm. Rëndom janë tre rrugë që mund të rrjedhin ngjarjet për këto entitete:

1. Njohja e plotë nga komuniteti ndërkombëtar, dhe integrimi në sistemin ndërkombëtar që sot simbolizohet me KB-në (shembull Timori Lindor, Eritrea dhe Sudani i Jugut);
2. Vazhdimi i status qou-së, që për shkak të pamundësisë së arritjes së njohjes së jashtme, rëndom nga përplasjet gjeopolitike në KS të KB-së, por edhe pamundësisë së shtetit që ushtron sovranitet “nominal” mbi territor për ta kthyer kontrollin efektiv, favorizon një zvarritje të situatës me pak ndryshime, kur shtetet e tilla, për kohë të gjatë nuk bëjnë asnjë hap për subjektivitet ndërkombëtar, por as nuk kthehen në pozitën që kanë qenë;
3. Shuarja e shtetit, kur këto entitete ripushtohen nga shtetet nga të cilat synonin pavarësinë (shembull Tamil Eelam që ekzistoi në vitet 1986-2009, Republika Srpska e Krajnës në territorin kroat ekzistonte në vitet 1991-1995, dhe së fundi Republika e Artsakh, ekzistente 1991-2020). Marrëveshja e 09.11.2020 mes Ruisë, Armenisë dhe Azerbajxhanit, ia rikthen Azerbajxhanit shumicën e territorit, ndërsa një pjesë mbahet e kontrolluar nga autoritetet armene, por pa ndonjë lloj statusi autonom (Kremlin).

Pranimi në anëtarësim në KB është sigurisht tërheqës si një formë e konfirmimit të statusit, por është e vështirë të shihet se si pranimi në anëtarësi ishte menduar ndonjëherë të rezultojë në krijimin e një shteti pasi një propozim nga Norvegjia për këtë qëllim në

konferencën e San Franciskos u refuzua. Në fillim të funksionimit së KB-së u argumentua se "shtetet ish-armike, në parim, janë jashtë rregullave të Kartës". Kështu disa shtete nuk mund të pranoheshin kurrë në KB, dhe megjithatë, nuk u parashikua që ato të mos ishin shtete (Worster, 2009, fv. 163-164).

Andaj, edhe KB në filllet e saj nuk e kishte paraparë vetën si një mekanizëm që do të japë legjitimitetin e shtetësisë me anëtarësimin në të. Megjithatë rritja e rëndësisë së inkuadrimit në KB u vu në pah me zhvillimet ndërkombëtare në epokën që pasoi (rritja enorme e numrit të shteteve sovrane, kryesisht si rezultat i procesit të dekonolizimit), duke e bërë këtë organizatë më kredibile se secila organizatë paraprake përfshirë "paraardhësen" Lidhjen e Kombeve, për shkak të universalitetit të saj dhe mosndërhyrjes në sovranitetin e shteteve.

Në aspektin juridik, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë joshtetërorë nuk i njohin dhe nuk mund t'i njohin shtetet. Si çështje e së drejtës ndërkombëtare, as KB dhe as ndonjë aktor tjetër joshtetëror nuk mund t'i japin vlefshmëri ligjore krijimit të shtetit. Ajo mbetet një çështje praktike e shteteve (Ker-Lindsay, 2012, f. 6). Ashtu siç diplomati amerikan, ish-sekretar i shtetit, Foster Dullas kishte deklaruar gjatë një adresimi në KB më 1957: njohja e shtetit asnjëherë nuk është një e drejtë, por një privilegj, njohja e shtetit mbetet një praktikë politike (Ker-Lindsay, 2012), megjithatë njohja mund të jetë një zgjedhje politike por ekziston brenda një konteksti ligjor (International Law Association, Mars 2014).

Në të njëjtën linjë ishte edhe interpretimi ligjor që UEFA i bëri anëtarësimin të Kosovës në këtë organizatë sportive si përgjigje ndaj kundërshtimeve serbe, e cila juridikisht e tejkaloi pengesën e mosanëtarësimin në KB për Kosovën që delegacioni serb insistonte se ishte kriter për anëtarësim në UEFA. Sipas interpretimit të zyrtarit ligjor në UEFA, Alasdair Bell në Kongresin e UEFA-s: "Kombet e Bashkuara nuk kanë kompetencë për t'i njohur shtetet, por shtetet i njohin shtetet. Nëse nuk je anëtar i KB-së nuk do të thotë se nuk je shtet. Katër kriteret e të qenit shtet janë përcaktimi i territorit, popullata, qeveria dhe aftësia për të arritur marrëveshje me të tjerët. Prandaj anëtarët e Kongresit do të vendosin vetë nëse Kosova e meriton të pranohet në UEFA apo jo" (TopSporti, 2016). Andaj, edhe Zvicra, ndër themelueset e UEFA-s më 1954, u bë anëtare e KB-së tek më 2002 dhe asnjëherë nuk ka qenë problem statusi në KB për të, në mënyrë që të anëtarësohet në ndonjë mekanizëm ndërkombëtar.

Pra, rasti i Zvicrës është tregues që të mos qenurit anëtar i KB-së nuk ta konteston shtetësinë. Ajo u bë anëtare e KB-së në vitin 2002, edhe pse si shtet me ekzistencë disashekullore. U anëtarësua pas një referendumi të suksesshëm.<sup>3</sup>

Edhe për mikroshtetet të cilave nuk iu është kontestuar shtetësia, gjatë historisë së KB-së ka pasur debat se si duhet të jetë anëtarësimi i tyre. Si rezultat i kësaj, mikroshtetet si San Marino, Monako apo Lihtenshtajn janë bërë anëtare të KB-së me të drejta të plota pas vitit 1990.

Pavarësisht nga sa u tha më lart, Karta e KB-së përcakton se vetëm shtetet mund të jenë anëtare të KB-së, pra së pari duhet të jesh shtet pastaj të bëhesh anëtar i KB-së (Karta e KB-së, neni 4, paragrafi 1, a.d.). Andaj, të qenit anëtar i KB-së është konfirmim eksplicit i shtetësisë. Por kjo nuk e përjashton të qenurit shtet jashtë KB-së, mirëpo jo të jesh anëtar i KB-së dhe të mos jesh shtet.

Një doktrinë e zhvilluar nga KB, që mund të japë sinjale zgjidhjeve nëse një entitet i caktuar i përmbush në mënyrë efektive kërkesat e shtetësisë është doktrina e njohjes kolektive dhe mosnjohjes kolektive (Wilson, 2009, fv. 461-462). Nëpërmjet kësaj KB ka pranuar shtete anëtare të saj, duke e shndërruar një gjendje faktike në një gjendje juridike. Edhe pse të qenurit anëtar i KB-së për dy shtete, nuk do të thotë që rrjedhimisht këto shtete e njohin njëra-tjetrën, përkundër që janë pjesë së bashku në një traktat ndërkombëtar (në këtë rast KB). Izraeli si anëtar i KB-së, nuk pranohet nga shumë shtete arabe, gjithashtu anëtare të sistemit të KB-së, por me vendim të Asamblesë së Përgjithshme pas rekomandimit të Këshillit të Sigurimit, Izraeli është pranuar në mënyrë kolektive si anëtare në KB. Shtuar kësaj faktin e marrjes së statusit anëtar vëzhgues në KB për Palestinën në vitin 2011, shtetësia e të cilës nuk njihet pikërisht nga Izraeli, e bën edhe më komplekse situatën. Por, ndoshta vetë jetëgjatësia e KB-së për dallim nga Liga e Kombeve dhe organizatat e mëhershme, si një organizatë panbotërore, konsiston në faktin e gjetjes së formulave dhe mundësive për akomodimin e interesave të ndryshme dhe shpesh diametralisht të kundërta mes anëtarëve të saj.

---

<sup>3</sup> Zvicra më herët kishte refuzuar me referendum anëtarësimin në KB. Më 1986 me 76% që votuan kundër anëtarësimin. Por viti 2002 solli rrethana të reja, ndryshimet gjeopolitike diktuan rezultatin që ishte për një përfshirje më të madhe zvicerane në çështjet globale.



Në anën tjetër, ka pasur raste kur entitete të caktuara që kanë pretenduar të jenë shtete (ka raste që ende vazhdojnë pretendimet e tilla si Qipro Veriore), janë ndaluar në mënyrë kolektive nga KB për të qenë pjesë e saj. Kjo ndodh rëndom kur entitetet që pretendojnë t'u njihet shtetësia e kanë krijuar situatën faktike duke shkelur normat themelore të së drejtës ndërkombëtare, siç është agresioni apo përdorimi i jashtligjshëm i forcës. Të tilla janë Katagna, Rodezia, Biafta, Republika Turke e Qipros Veriore<sup>4</sup> si dhe Katër Entitetet në Afrikën e Jugut. Njohjen paraprake të Qipros Veriore, e kishte tërhequr Bangladeshi dhe Pakistani pas rezolutës 541 nga KS i KB-së. Megjithatë, entitetet e tilla sipas Raič nuk pushojnë së qeni shtete por dështojnë të jenë shtete që pranohen nga e drejta ndërkombëtare për shkak të shkeljeve (Raič, 2002, f. 442). Mosnjohja kolektive është zbatuar në përgjithësi mbi bazën e principeve, e jo në parimin e integritetit territorial të shtetit (Dugard & Raič, 2006, f. 132). Rasti i pranisë së jashtligjshme të Afrikës së Jugut në Namibi (Afrikën Jugperendimore), u trajtua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila me dha opinionin e saj më 1971 mbi këtë rast dhe shërben si referenca parësore gjyqësore e konfirmimit të ekzistimit të një detyrimi sipas të drejtës ndërkombëtare për mosnjohje (International Court of Justice, 1971).

Megjithatë kemi edhe qëndrime më ekstreme, siç përmendëm Dugard i cili shkon përtej qasjes së Lauterpacht, ku thekson nevojën që një shtet të jetë anëtar i KB-së për të qenë shtet. Ai me këtë mbron një qëndrim konstituist të artikuluar mjaft rreptë të njohjes së shtetit (Dugard, 1987).

Geldenhuis (2009) shtetet që nuk njihen i ndan në disa nivele, sipas kriterit të njohjes që i është bërë këtyre shteteve nga ana e shteteve anëtare të KB-së, dhe atë:

1. Njohje titullore (titular recognition) u referohet shteteve me njohje të gjerë dhe me pranim nga disa organizata ndërkombëtare por që iu mungon “certifikata e lindjes” ose “konfirmimi i shtetësisë” që merret me anëtarësim në KB. Autori në këtë grup përmend Palestinën dhe Saharën Perëndimore.
2. Njohje e pjesshme (partial recognition) u referohet shteteve që marrin njohje *de jure* nga një pjesë e shteteve të KB-së (më pak se kategoria e parë) dhe nuk kanë anëtarësim në KB. Në këtë grup autori përmend Kosovën, por marrë parasysh që

---

<sup>4</sup> Përkundër rezolutës së KB-së, Republika Turke e Qipros Veriore, ende mbetet një konflikt i ngrirë sipas presidentit turk Erdogan. Ai në fjalimin e mbajtur në këtë vend me rastin e 37 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së pjesës turke të ishullit, kërkoi zgjidhje “2 shtete” për ishullin.

- shkrimi daton nga viti 2009 kur Kosova ende ishte në fillet e shtetësisë dhe të njohjes ndërkombëtare, sipas kritereve, tani Kosova do të bënte pjesë në kategorinë e parë.
3. Njohje të vogël (paltry recognition) kur një shtet është i njohur vetëm nga një grusht shtetesh (shembull Biafra gjatë ekzistimit të saj). Niveli më i ulët i kësaj kategorie është njohja nga së paku një shtet josponsorues i shtetësisë (shembull njohja e Çeçenisë nga Afganistani).
  4. Njohje nga patroni (patron recognition), shembull konkret Republika Turke e Qipros Veriore dhe raporti i saj me Turqinë.
  5. Njohja reciproke kolegiale (peer recognition) i referohet kategorisë kur shtetet të kontestuara, përveç shtet-patronit njohin njëra-tjetrën. Osetia e Jugut, Abkhazia apo katër shtetet Bantustans të Afrikës së Jugut që njihnin vetëm njëra-tjetrën bëjnë pjesë në këtë kategori.
  6. Zero njohje (zero recognition) është kategoria e fundit, kur shteti i pretenduar nuk njihet nga askush. Katagna dhe Rodezia kanë qenë raste tipike.

Sidoqoftë, ndërsa e drejta ndërkombëtare i gjen burimet e saj në traktatet e nënshkuara nga shtetet me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre, kjo është një arsye e mjaftueshme për të pohuar se interesat kombëtare janë padyshim në themel të rregullave të tilla ligjore. Sidoqoftë, rregullat ndërkombëtare mund të zbatohen vetëm nëse një organ ndërkombëtar dhe i pavarur themelohet me fuqinë për të deklaruar se cili shtet i plotëson kërkesat për shtetësinë dhe cili jo. Një organ i tillë nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë rrethanë nga vullneti i një autoriteti tjetër ndërkombëtar, megjithëse anëtarësia dhe vëzhgimi i tij do të varet nga një entitet i tillë. Një zgjidhje për të kapërcyer këtë problem do të ishte sigurimi i një mekanizmi ligjor për zgjedhjen e anëtarëve të tij. Pavarësia e tij duhet të garantohet me anë të një sistemi “check and balance” me Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin e Sigurimit (Murphy & Stancescu, 2017, f. 12-13). Kjo shtron debatin se sa objektiv dhe parimor do të ishte një organi i tillë?! Në kohën e shtimit të zërave për reformimin e Këshillit të Sigurimit të KB-së (Haxhimehmeti, 2016, fv. 149-150) dhe përdorimit politik dhe joparimor të së drejtës së vetos nga anëtarët e përhershëm të KS të KB-së, një mekanizëm i tillë krijon pashmangshëm dhe me arsye një pasiguri. Në anën tjetër, nëse jo në kuadër të KB-së, që si organizatë aq shumë ka kontribuar në kodifikimin e së drejtës ndërkombëtare, atëherë

momentalisht nuk ka institucion ndërkombëtar kredibil të cilit do të mund t'i lihet në diskrecion vendimmarrja për një çështje të tillë kruciale.

Por që sa e rëndësishme është të qenit anëtar i KB-së për një vend, më së miri sqaron pjesa vijuese kur do të flasim për tërheqjen e njohjes. Duke qenë anëtar i KB-së, shteti nuk e ka problem nëse shtetet e tjera nuk e kanë njohur paraprakisht, pasi vetë anëtarësimi në KB është një lloj garancie dhe njohje nga të tjerët (me raste tepër të veçanta që bëjnë përjashtim). Andaj, praktika e tërheqjes, suspendimit apo mohimit të njohjes, pastaj lufta që bëhet për konfirmim të njohjeve, ruajtje të tyre, rifitim të ndonjë njohjeje të humbur nuk do të ishte kaq me vlerë, nëse shteti do të ishte anëtar i KB-së.

Anëtarësimi në KB, i jep shtetit mundësi më të madhe ndërveprimi në ambientin ndërkombëtar. E kjo është mjaft e rëndësishme për sukses në rrafshin politik, ekonomik dhe të sigurisë, veçanërisht në kohën e rritjes së numrit të subjekteve ndërkombëtare si dhe aktorëve të tjerë joshitetërorë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Nuk është hipotezë e saktë nëse parashtrohet që të qenurit anëtar i KB-së, a priori je më i zhvilluar apo më i sigurt, pasi edhe shtete të papranuara në KB kanë zhvillim të konsiderueshëm, krahasuar me dhjetëra shtete anëtare të KB-së, por që llogariten shtete të dobëta në secilin parametër. Megjithatë raporti i mundësisë për përparim shumëdimensional është më i lartë duke qenë anëtar në KB por edhe në mekanizma të tjerë ndërkombëtarë. Kjo përputhet me teorinë e Griffiths që njohjet historikisht (edhe para KB-së) janë bërë nga "klubi" i shteteve ekzistuese (Griffiths, 2016).

### **1.5 Tërheqja e njohjes në të drejtën ndërkombëtare**

Në gjuhën angleze janë disa nocione që e përshkruajnë fenomenin e tërheqjes së njohjes: *Derecognition, withdrawal of recognition, revocation of recognition, abolition of recognition* etj., por ne do ta përdorim në gjuhën shqipe si tërheqje të njohjes.

Profesori i së drejtës ndërkombëtare, Enver Hasani, sqaron se në doktrinë instituti i çnjohjes<sup>5</sup> për herë të parë është shtruar në mes të dy luftërave botërore në rastin e Armenisë, pas gllabërimit të saj nga ish-BRSS. Këtë e përmend dhe trajton në doktrinë një autor italian, Gaetano Arangio Ruiz. Ai me këtë rast ka thënë se kur Armenia u gllabërua nga

---

<sup>5</sup> Profesori Hasani e përdor termin *çnjohje*.

ish-BRSS, nuk ka pasur nevojë fare të bëhet çnjohja e saj. Kjo sepse Armenia kishte pushuar së ekzistuari në momentin e aneksimit të saj nga ish-BRSS. Kjo sot, megjithatë, nuk do të ishte e vlefshme sepse okupimi me forcë i territorit të huaj shtetëror nuk njihet ligjërisht dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik ndaj titullit të sovranit aktual. Efektet e okupimit ushtarak janë vetëm faktike dhe krejt të përkohshme. Kjo shihet qartë me Krimenë, Republika Srpskan, Ingushetinë, Transdnjestrinë, Republikën Turke të Qipros Veriore, ish-Rhodezinë (Zimbabveja e sotme) dhe kështu me radhë. Këtë e ka konstatuar kësisoj edhe vetë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) në mendimin e saj për Kosovën në verë të vitit 2010 (Hasani, 2020).

Siç e kemi përmendur në llojet e njohjes, njohja *de facto* sipas së drejtës ndërkombëtare mund të tërhiqet. Pra, në raste të caktuara, kur një shtet *de facto* i njohur dështon të përmbush kriteret e shtetësisë, mund t'i njoftohet tërheqja e njohjes. Ndërsa njohja *de jure* nuk mund të tërhiqet sipas të drejtës ndërkombëtare, përveç nëse shteti pushon së ekzistuari me humbje të ndonjëres nga kriteret e shtetësisë. Por pasi në praktikën ndërkombëtare ekziston fenomeni i tërheqjes së njohjeve, sipas argumenteve, kjo na paraqitet si një akt politik apo kemi të bëjmë me një rregullim të drejtës ndërkombëtare, paqi që Konventa e Montevideos që përcakton “parevokueshmërinë” e njohjes është pjesë e së drejtës zakonore. Prandaj, është e rëndësishme të trajtohet ky fenomen nga një prizëm më kritik.

Danny Auron është njëri nga autorët që ka bërë thirrje për një Qasje të Tërheqjes së Njohjes. Ashtu sikurse ekzistojnë teoritë e njohjes, duhet të jetë edhe tërheqja e njohjes. Ai theksin e vë në atë që një qasje e tillë e tërheqjes së njohjes duhet bëhet si një qasje jo e dhunshme e ndërhyrjes, që mund të stimulojë një rezistencë paqësore, duke mos i konkurruar mekanizmave që i posedon e drejta ndërkombëtare për ndërhyrje por si shtesë e tyre. Sipas tij, kjo qasje duhet përdorur me mençuri nga shtetet, të mos shpërdoret duke u përdorur për qëllime politike apo gjeostrategjike. Pra, si një parim që duhet të zbatohet me kujdes në raste ekstreme të nevojës dhe me konsensus sa më të gjerë (Auron, 2013, f. 445). Pra, një qasje e cila tërheqjen e njohjes e ngrit në stad edhe të diskutimeve për të gjitha shtetet në përgjithësi. Auron shton se kjo mund të jetë edhe si një alternativë paqësore e parimit “përgjegjësia për të mbrojtur” (Auron, 2013, f. 459).

Sa i përket tërheqjes së njohjes në të drejtën ndërkombëtare, Chen edhe këtu sjell teoritë tradicionale të njohjes për të dhënë përgjigje. Nga pikëpamja e teorisë deklarative, njohja nuk ka efekt, andaj as revokimi i saj, nuk paraqet asgjë, përveç nëse është shuar njëri nga kriteret e shtetësisë, por përfundimi i tillë nuk është as shkak e as rezultat i ndërprerjes së njohjes. Vënia në dukje e mosekzistencës së entitetit ekzistues nga një shtet i huaj është një akt i ri i njohjes së një fakti të ri, dhe jo tërheqja e njohjes së mëparshme. Ndërsa sipas teorisë konstituive njohja juridike, tërheqja e njohjes të një entiteti të njohur paraqet kundërthënie dhe është pikëpamje ekstreme që nuk mbrohet nga autorët (Chen, 1951, f. 259). Ky lloj i mostërheqjes së njohjes *de jure* u kodifikua në vitin 1936, kur Instituti i së Drejtës Ndërkombëtare miratoi një rezolutë për këtë qëllim, duke ndaluar revokimin e njohjes *de jure* (Hingoriani, 1984, f. 97).

Chen më tutje sugjeron modifikim të pikëpamjes konstituive mbi tërheqjen e njohjes, ku revokimi duhet të konceptohet jo si një akt arbitrar i politikës, por si një akt i zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, si një deklaratë se kanë pushuar së ekzistuari shkaqet objektive të njohjes. Kjo mund të bëhet në rast të shkeljes së vazhdueshme të së drejtës ndërkombëtare (Chen, 1951, f. 260). Ashtu siç Bangladeshi dhe Pakistani tërhoqën njohjen që i kishin bërë Qipros Veriore, pasi rezoluta e KB-së e cilësoi këtë entitet si në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Përveç pikëpamjeve të deklarativistëve dhe konstituistëve mbi këtë çështje, Visoka identifikon edhe një grup tjetër të autorëve që sipas pikëpamjes i quan diskrecionalistë (teoria diskrecionale), të cilës edhe vetë i përket, që nxjerrin në pah natyrën e parregulluar të kësaj çështjeje dhe për sa kohë që mbetet e tillë e parregulluar në të drejtën ndërkombëtare, ajo do të mbetet në praktikë në diskrecion të shtetit (Visoka, 2020, f. 319).

Marrëdhëniet mes shteteve sjellin situata të ndryshme. Andaj, është mirë të analizohen dhe kuptohen drejt. Raste të tilla janë shembull se çka ndodh me një shtet kur në vend të tij lindin shtete të reja? A duhet të revokohet njohja që i është bërë? Apo nëse një shtet që pretendon njohje ndërkombëtare, i ndodh tërheqja e njohjes, atëherë çfarë situatë paraqitet në raport me shtetin nga i cili është ndarë? Po me territorin që një entitet i ri është krijuar e që ai shtet paraprak më nuk ka asnjë kontroll, por tashmë si shtet i tretë e ka tërhequr njohjen e shtetit të ri që realisht funksionon efektivisht mbi atë territor? Delaney na shpjegon se nëse një shtet i njohur pushon së përmbushuri kërkesat e shtetësisë sepse

është shuar, në shumicën e rasteve ai shtet zëvendësohet nga shtete të tjera dhe megjithëse ish-shteti nuk është çregjistruar shprehimisht, ekziston një mosnjohje implicite me njohjen e shteteve të reja mbi territorin e ish-shtetit (Delaney, 2008, f. 15). Ndërsa sipas Visokës, tërheqja e njohjes për shtetin pretendues paraqet a priori një rinjohje e shtetit bazë që ishte çnjohur në shkallën e parë nga njohja e shtetit pretendues (Visoka, 2020, f. 318). Visoka është tejet kritik në tërheqjen e njohjeve të shteteve të porsalindura duke e cilësuar këtë si sulm të papërgjegjshëm për rendin ndërkombëtar, pasi rezulton me zgjerim të territoreve të paqeverisura, paqëndrueshmëri dhe pasiguri rajonale dhe rivalitet mes fuqive (Visoka, 2020, fv. 320-321).

Megjithatë, ai jep një sërë syresh (Tajvani, Saharaja Perendimore), ku tërheqja e njohjeve nga shtetet stimulohet dhe arsyetohet në praktikë nga pesë arsye: përfitimet ekonomike, dinamikat e brendshme politike, interesat gjeopolitike, zgjidhja e konflikteve dhe kapaciteti i shtetësisë (Visoka, 2020, f. 324). Të gjitha këto arsye bëjnë pjesë në domenin e arsyeve politike dhe interesit shtetëror për të vepruar në atë mënyrë duke tërhequr njohjen, por janë vështirë të pranueshme si arsye në të drejtën ndërkombëtare.

## **1.6 Njohja e qeverive dhe shteteve – dallimet dhe ngjashmëritë**

Njohja e shtetit dhe e qeverisë megjithëse mund të duken dhe janë mjaft të ngjashme, ato nuk janë e njëjta gjë. E drejta dhe praktika ndërkombëtare krahas njohjes së shtetit, trajton edhe njohjen e qeverive.

Qeverisja, pushteti apo cilin do term që përdorim është njëra nga kushtet e padiskutueshme të shtetësisë. Rrjedhimisht njohja e një shteti nuk mund të bëhet pa njohjen e qeverisë, pasi nëse nuk do të ekzistonte qeveria, nuk do të kishte as shtet sipas të drejtës ndërkombëtare.

Kelseni të njëjtin dallim si në njohjen e shteteve, e bën edhe në njohjen e qeverive, duke ndarë në akt politik dhe juridik të njohjes. Pra, akti politik është vërtetim i një fakti se një individ ose grup personash përbëjnë qeverisjen e një shteti, ndërsa akti juridik është shprehja e gatishmërisë për të hyrë në marrëdhënie me këtë qeveri. Është e mundshme që një shtet të mos dojë të hyjë në marrëdhënie me një qeveri, pra të mos e njoh politikisht

atë, por juridikisht është e ndërlidhur me njohjen e shtetit, pasi nëse nuk e njeh qeverinë atëherë nuk e njeh atë shtet sipas së drejtës ndërkombëtare, pasi është e pamundur një shtet të mos ketë qeveri sipas kriterëve të Montevideos (Kelsen, 2011, f. 615). Ai është i mendimit që kjo mosnjohje e qeverisë mund të lejohet vetëm në një shkallë të kufizuar, por edhe ai është koshient që praktika e shteteve mund të ndryshojë nga këto parime (Kelsen, 1941). Britania e Madhe çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare e kishte lënë për ta caktuar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, mirëpo nuk e vunë në dyshim njohjen e Shqipërisë si shtet (Talmon, 1999, f. 501).

Ndërsa Crawford është i mendimit se mosnjohja e një regjimi të veçantë nuk është domosdoshmërisht një përcaktim që bashkësia e përfaqësuar nga ai regjim nuk kualifikohet për shtetësi. Mosnjohja e një qeverie mund të nënkuptojë që ajo nuk konsiderohet si qeveri për sa i përket pavarësisë dhe efektivitetit, ose se shteti që nuk njeh nuk dëshiron të ketë marrëdhënie normale ndërqeveritare me të për arsye të ndryshme (Crawford, 2012, f. 151). Në të njëjtën linjë, Shaw argumenton se “njohja e një shteti do të ndikojë në personalitetin e tij juridik, qoftë duke krijuar apo pranuar atë, ndërsa njohja e një qeverie ndikon në statusin e autoritetit administrativ e jo të shtetit” (Shaw, 2003, f. 379). Njohja e një qeverie e kthen në domosdoshmëri njohjen e shtetit, por jo dhe anasjelltas (Shaw, 2003). Megjithatë, kjo shtron debatin e njohjeve të qeverive në ekzil të shteteve që nuk njihen. Në këto raste, kontaktet ekzistojnë me ato autoritete që merren si përfaqësuese, por nuk njihen si qeveri të shteteve të shpallura. Shembull qeveria në ekzil e Kosovës që performonte si qeveri e Republikës së Kosovës kishte kontakte me shtete të tjera, por të cilat nuk njohën pavarësinë e saj.

Sikurse njohja e shtetit, aq më shumë njohja e qeverisë mund të kushtëzohet. Kjo mund të kushtëzohet nga karakteri demokratik i regjimit, pranimi i pretendimeve të veçanta, ose dhënia e ndërmarrjeve ekonomike, pastaj trajtimin e pakicave (Crawford, 2012, f. 151).

Në përgjithësi standardi i vendosur nga e drejta ndërkombëtare në rastin e njohjes së qeverive, është kontrolli i sigurt i territorit, në tërësinë ose në shumicë të madhe (Crawford, 2012). Megjithatë siç është e njohur nga praktika, ka raste kur edhe me kontroll efektiv të një pjese më të vogël territoriale janë njohur qeveri si përfaqësues të atij shteti dhe

popullsie. Kjo ka ndodhur edhe gjatë dekadës së kaluar në Libi<sup>6</sup> dhe në Siri. Andaj, kundruall teorisë së kontrollit efektiv, ekziston teoria e legjitimitetit, pra është e mundur që nuk mund të kesh kontroll efektiv mbi shumicën e territorit, megjithatë në rrethana të caktuara njihesh si qeveri legjitime.

Praktika ndërkombëtare dëshmon rastet kur qeveria e larguar për shkak të rrethanave nga pushteti nga një qeveri tjetër ose kryengritje, vazhdon në ekzil. Në këtë rast bëhet i pamundur ushtrimi i kontrollit efektiv mbi territorin.

Në këto raste është i vështirë përcaktimi se cili është vullneti i popullit për qeverinë. Departamenti Amerikan i Shtetit pas konsultimit refuzoi vazhdimin e njohjes së qeverisë në ekzil të Shqipërisë së Mbretit Zog në janar 1943 pasi ishin të mendimit që nuk kishte autoritet jashtë vendit për të përfaqësuar forcat dhe grupet e rezistencës brenda vendit (Talmon, 1999). Pushtimi i Kuvajtit nga ana e Irakut më 1990, nuk e vuri në dyshim njohjen e qeverisë në ekzil të Kuvajtit, përkundër moskontrollimit të territorit.

Për t'u njohur një qeveri në ekzil si përfaqësues i shtetit, sipas Talmon (1999) duhet të plotësohen disa kushte:

1. Shteti;
2. Karakteri përfaqësues;
3. Pavarësia;
4. Paligjshmëria ndërkombëtare e qeverisë në vend.

Fitimi i njohjes për një qeveri është i rëndësishëm sepse dhënia e legjitimitetit të qeverisë e dallon atë në të drejtën ndërkombëtare nga “qeveritë e okupuara”, “qeveritë kukulla”, “qeveri të aparteidit” etj. (Talmon, 1999, f. 536).

Në të drejtën ndërkombëtare përmendet edhe njohja e kryengritësve. Në kushte të caktuara në një konflikt (kryengritësit të kenë një organizatë politike të organizuar, të përfillin normat e luftës dhe të kontrollojnë një territor të caktuar në mënyrë efektive), pala kryengritëse mund të njihet. Në këtë rast njohja e saj në të drejtën ndërkombëtare sipas attributeve më shumë i ngjan njohjes së shtetit sesa njohjes së qeverisë (Kelsen, 2011, f. 537).

---

<sup>6</sup> Për më shumë mbi njohjen e qeverisë në Libi shiko: Hamed Hasyemi Saugheh & Rohaida Nordin, Legitimacy as a Precondition for the Recognition of New Governments: A Case of Libya, Sriwijaya Law Review, Indonesia, 2018.



Sistemi për njohjen e qeverisë është jokonsistent dhe kryesisht i lihet gjykimit të shteteve individuale dhe organizatave ndërkombëtare. Në kontekstin e regjimeve të dhunshme, pretendohet se tërheqja e njohjes është një mënyrë e justifikueshme për të ushtruar këtë diskrecion (Auron, 2013, f. 464). Madje parimet dhe doktrinat që janë bazuar shtetet për këtë gjë, i kanë ndryshuar përgjatë historisë. ShBA nëpërmjet presidentit Uillson ka kërkuar që në raport me Amerikën Latine, qeveritë çdoherë të mbështeten në përkrahjen e popullit. Në bazë të kësaj, ShBA nuk e ka pranuar gjeneralin Huerta që ka ardhur në pushtet me dhunë dhe vrasje të kryetarit legjitim në Meksikë (1913). Në të njëjtën linjë është edhe doktrina e Tobarit, e cila i rekomandon qeverisë amerikane të konsultohet para se të bëjnë njohjen e ndonjë qeverie të ardhur me forcë (Gruda, 2009, f. 88).

Të kundërtën e kësaj teorie e ka kërkuar ministri i jashtëm meksikan, ku në bazë të tij njihet si Doktrina e Estrados, sipas të cilës shtetet nuk duhet të gjykojnë pozitivisht apo negativisht ndryshimet e qeverive në shtete të tjera. Pra, një doktrinë e bazuar mbi parimin e mosndërhyrjes dhe neutralitetit. Kjo doktrinë, pati përdorim të gjerë dhe u aplikua nga shumica e shteteve të fuqishme, ku në vend të mosnjohjes së qeverive, në rast mospajtimi aplikohet tërheqja e misionëve diplomatike (Gruda, 2009, f. 89). Aplikimi i kësaj doktrine e uli ndjeshëm përdorimin e “njohjes së qeverive” në praktikën ndërkombëtare.

Njëri ndër problemet që paraqitet në rast të konflikteve, kur nuk njihet qeveria e një vendi, është rasti kur atë qeveri e njohin palë të treta, ndërsa asaj qeverie përkundër që i është tërhequr njohja nga disa shtete, “detyrohesh” të takohesh pasi që mbetet përfaqësuese legjitime e shtetit në mekanizma ndërkombëtar (Damrosch, 2001). ShBA dhe shtetet e tjera në raport me Sirinë dhe njohjen që i bënë Këshillit Kombëtar Sirian si përfaqësues të popullit sirian ishte i tillë.

Pra, në përgjithësi kontrolli mbi territorin është kriteri kryesor për njohjen e qeverisë. Përpjekjet për shtimin e kritereve shtesë për njohjen e qeverive gjithherë kanë qenë problematike. Ka qenë e pamundur për t’u dakorduar mbi kriteret shtesë që duhet të merren për t’u njohur qeveritë. Vlerat e ndryshme që do të mund të avancoheshin në kritere nuk kanë konsensus (Peterson, 1997, f. 51).

Essen i rendit tre kritere për njohjen e qeverive:

1. Ushtrimi i kontrollit efektiv ka qenë tradicionalisht kriteri kryesor për njohjen qeveritare;
2. Stabiliteti ndërkombëtar dhe roli i drejtësisë dhe paqes shpesh kanë peshë në vendimet e njohjes;
3. Praktika bashkëkohore e shtetit. Situatat në 2011 në Libi dhe Bregu i Fildishtë janë shembuj të faktit se kontrolli efektiv nuk është më kriteri më i rëndësishëm për njohjen (Essen, 2012, f. 48).

Ndërsa Petersen përveç kontrollit mbi territorin, kriteret shpesh i ndanë në dy grupe:

Në të parën i rendit: Mbështetjen popullore, legjitimitetin si dhe aftësinë dhe vullnetin për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare;

Ndërsa në grupin e dytë që janë më të reja i rendit edhe mosvarësia nga mbështetja ushtarake nga jashtë, respektimi i të drejtave të shteteve të tjera, përmbajtja nga dhuna e tepruar (e paligjshme) gjatë marrjes së pushtetit<sup>7</sup> (Essen, 2012) dhe respektimi i të drejtave të njeriut (Peterson, 1997, fv. 52-85).

Talmon bën dallim në mes të legjitimitetit dhe legalitetit të qeverisë në kuptimin e mbajtjes së statusit sipas së drejtës ndërkombëtare, ku në raste kur qeveria e humb legjitimitetin, nuk do të thotë që e humb dhe legalitetin, ajo ende mbetet qeveri. Kjo mund të ndodhë shembull gjatë gjenocidit, kur ajo qeveri më nuk ka legjitimitet, por mund të mbetet si qeveri (Talmon, 2013, f. 239).

Njohja e shtetit dhe ajo e qeverisë të dyja janë pjesë përbërëse e së drejtës ndërkombëtare. Ato kanë shumë ngjashmëri, për sa i përket llojeve të njohjes, *de facto* apo *de jure*, me kushte apo pa kushte, të shprehur apo në heshtje apo sipas mënyrës individuale ose kolektive etj. Mirëpo dallimet të cilat në dukje mund të mos jenë të mëdha, në esencë përbëjnë diferencë të madhe. Shteti është subjekt i së drejtës ndërkombëtare, e cila përfaqësohet nëpërmjet një pushteti (individ apo qeveri). Nuk mund të flasim për njohje të qeverisë, pa njohjen e shtetit, ndërsa e kundërta është e mundshme.

Në të dyja rastet (për shtet apo për qeveri) si rezultat i zhvillimeve ndërkombëtare, janë të nevojshme qasjet kritike, në mënyrë që pjesa normative dhe ajo praktike të jenë

---

<sup>7</sup> Për herë të parë u aplikua pas grushtit të shtetit serb të vitit 1903, i cili përfshinte vrasjen e mbretit dhe mbretëreshës, disa anëtarë të kabinetit dhe një numër të afërmve të mbretëreshës. Qeveria Britanike refuzoi njohjen deri në vitin 1906 kur mbreti i ri ra dakord të tërhiqte oficerët që ishin përfshirë drejtpërdrejt në krim.

kompatibile me njëra-tjetrën. Autorët duhet të diskutojnë për to, të mos mbeten peng i praktikave të kaluara dhe të përdorin qasje kritike dhe proaktive, qoftë edhe sfiduese ndaj konturave tradicionale të të shpjeguarit të këtyre fenomeneve mjaft të ndërlikuara që determinojnë në masë të madhe marrëdhëniet ndërkombëtare në ditët e sotme.

Atë që Hans Kelsen e kishte thënë në dekadën e 5-të të shekullit të kaluar se problemi i njohjes së shtetit dhe qeverive nuk është zgjedhur kënaqshëm as në teori e as në praktikë, me zhvillimet e reja në marrëdhëniet ndërkombëtare, rritjen e numrit të shteteve, aktorëve joshtetërorë, dinamizimit të marrëdhënieve nëpërmjet ndryshimeve që solli globalizmi, që i japin të drejtë edhe tani 80 vite pas.

## KAPITULLI II

### 2. EVOLUIMI I KOSOVËS SI SUBJEKT NDËRKOMBËTAR

#### 2.1 Kosova në periudhën 1999-2008 – administrimi ndërkombëtar

Njohja është akti që pason pas shpalljes së pavarësisë. Pra, nuk mund të flasim për njohje, përderisa nuk kemi shpallje të pavarësisë. Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008. Megjithatë shtetndërtimi i Kosovës, periudha e betejës për rritjen e subjektivitet ndërkombëtar, fitimin e njohjeve, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, apo siç politikanë të ndryshëm e quajnë rrumbullaksimi i shtetësisë (pavarësisht që ky term konsiderojmë që është jo i duhur dhe paraqet probleme për vetë shtetësinë e Kosovës), nuk janë akte e as procese që kanë filluar më 17 shkurt 2008. Vetë procesi i bërjes shtet i Kosovës është proces i gjatë i një luftë diplomatike, ku Kosova si entitet kishte shpallur pavarësinë njëherë më 1991, por që nuk arriti të marrë njohje përtej Shqipërisë. Për këto arsye, përkundër që nuk është në vatër të tezës aspekti historik, e shoh të përshtatshme dhe të nevojshme një kalim telegrafik në formë hyrëse të evoluimit të Kosovës si entitet apo subjekt deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, e pastaj të kalojmë në proceset post-pavarësi, që u karakterizuan nga “lufta e njohjeve”, betejat për legalitetin e shpalljes së pavarësisë, negociatat e vështira e të zgjatura, skenarët që i ka ndjekur Kosova në kontest të rritjes së njohjeve dhe skenarëve që po i vazhdojnë Kosovës edhe rreth 13 vite nga momenti i pikëprerjes historike me shpalljen e pavarësisë.

Kjo pjesë është e rëndësishme edhe për të kuptuar shumëdimensionalitetin dhe kompleksitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare, vendimmarrjes së shteteve dhe mekanizmave ndërkombëtarë gjatë periudhës shumë të ngjeshur të ngjarjeve që ndodhën. Përderisa në Kosovë ka ndodhur një proces i brendshëm, i cili arriti të vë në lëvizje në ambientin ndërkombëtar pothuajse çdo subjekt ndërkombëtar, aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, shtetet përreth që u afektuan drejtpërdrejt nga ngjarjet në Kosovë, Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të saj të cilat kishin interes të tyrin para së gjithash për përcjelljen dhe orientimin e ngjarjeve në Kosovë, fuqitë më të madhe botërore të kohës si

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleancën më të madhe ushtarake NATO-n, si dhe organizatën më të madhe botërore KB-në.

Kjo nuk u arrit vetëm në një proces të brendshëm në Kosovë, mes shqiptarëve dhe serbëve etnikë, mes pushtetit të Serbisë, dhe popullit të Kosovës që ndërtoi institucionet e veta dhe armatën e vet, por ky proces u bart në ambientin e jashtëm, aty ku zhvillohej betejë e madhe për “të vërtetën” e problemit dhe fitimin e “njohjes”. E këtë betejë e bën diplomacia, jo në kuptimin e aparatit të ekzekutivit të politikës së jashtme, por në një kuptim të gjerë të nocionit të saj.

Statusi i Kosovës evoluoi në kuadër të Jugosllavisë. Më 1969 u miratua një status më liberal për Kosovën me reforma që vazhdonin. Pastaj me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, u njoh autonomia e Kosovës brenda Serbisë, që ishte *de facto* një status republike, përveç emrit (Weller, 2011, f. 74). Gjitha këto zhvillime në Kosovë, në veçanti pas Kushtetutës së 1974, u panë me dyshim nga udhëheqja serbe, të cilët më 1976 përgatitën një “analizë kritike” që studionte funksionimin e republikës serbe dhe krahinave autonome të Vojvodinës dhe Kosovës (Vllasi, 2017, f. 213). Më 24 shtator 1986, në rrethana të reja të zhvillimeve dhe mbi shembullin e Librit të Kaltër u hartua “Memorandumi SANU” i publikuar nga Akademia Serbe e Shkencave që kritikonte ashpër kushtetutën e 1974 e cila Kosovës i siguronte një autonomi. Këtë autonomi të Kosovës e shfrytëzoi për kauzë dhe ngritje politike nacionalisti serb Slobodan Millosheviq, i cili në këtë mënyrë arriti të bëhej president i Serbisë. Por me të ardhur në pushtet, ai suprimoi autonominë e Kosovës më 1989 dhe inicioi një fushatë shtypëse shtetërore të hegjemonisë kundruall popullatës shqiptare, e cila ishte shumicë dërrmuese në Kosovë (Kirkpatrick, 2007, fv. 239-241).

Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 kishte tri veçori:

1. Mëvetësinë politiko-kushtetuese;
2. Veçorinë e njësisë federale si pjesë konstituive; dhe,
3. Veçorinë e autonomitetit si “korporis separatum” në kuadër të strukturës komplekse kushtetuese-juridike të Republikës së Serbisë. Veçoria e tretë në pozitën kushtetuese të Kosovës, në esencë, ishte kufizimi i subjektivitetit politik të popullit shqiptar në multinacionalitetin e Jugosllavisë (Zajmi, 1995, f. 182).

Gjeneza në ndërkombëtarizim të çështjes së Kosovës mund të thuhet që u regjistrua me vizitën e delegacionit të PE më 29-30 maj 1989 që inspektuan gjendjen në vend pasi që autonomia u suprimua (Ukshini, 2008, f. 114). NATO në mënyrë publike u njoftua me gjendjen në Kosovë shkurtazi në Konferencën e Hagës më 7 shtator 1991, udhëhequr nga Peter Kerington, lordi britanik që shërbente si kryediplomat në Britani por edhe si Sekretar i Përgjithshëm në NATO. Kosova në këtë Konferencë u përmend shkurtazi si problem nga delegacioni slloven, ndërsa fokusi ishte më shumë në Jugosllavinë si tërësi, ruajtjen e status quos dhe respektimin e minoriteteve (Ukshini, 2008, fv. 115-116).

Presidenti amerikan Bush në atë që njihet si “Kërcënimi i Kërshëndellave” për herë të parë përmendi Kosovën në dhjetor 1992, ku shkeljet që u bëhen shqiptarëve dhe që ShBA do të ndërhynte për të mbrojtur, pra që problemi i Kosovës do të trajtohej më shumë sesa një problem i brendshëm i Jugosllavisë (Kirkpatrick, 2007, f. 244).

Shpallja e Republikës më 1990, pastaj shpallja e pavarësisë më 1991 pas një referendumi, sollën vetëm njohjen e atij rezultati nga Shqipëria. Pra, Komisioni i Badinterit e as Haga e Dejtoni nuk u morën me njohjen e Kosovës dhe në përgjithësi me çështjen e Kosovës duke qenë të fokusuar në Kroaci e Bosnje. Disi u realizua parashikimi i Fukuyamas që Jugosllavia nuk do të jetë as në paqe e as demokratike në një të ardhme të afërt (Fukuyama, 1992, f. 36).

Por që nga kjo kohë kemi dendësim të aktivitetit diplomatik. Ky aktivitet u intensifikua me intensifikimin e ngjarjeve në terren. Paraqitja në skenë e UÇK-së, ndodhi kur edhe në kryeqendrat evropiane po vlonin aktivitetet diplomatike për Kosovën (Kiçmari, 2017) (Kiçmari, 2012, fv. 312-320).<sup>8</sup> Si rezultat i zhvillimeve ku diplomacia parandaluese nëpërmjet diplomatit amerikan Richard Holbrooke nuk arriti të ndalë luftën në Kosovë. Misioni i OSBE-së për sa funksionoi në Kosovë, mblodhi fakte që nuk mund të hidhen poshtë mbi shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë (OSCE, 2013).

---

<sup>8</sup> Ambasadori i karrierës, Sabri Kiçmari, gjatë luftës ishte përfaqësues diplomatik i UÇK-së, ku nëpërmjet qindra aktiviteteve sensibilizoi dhe ndërkombëtarizoi tezat e vërteta për UÇK-në, që ishte një luftë çlirimtare, me motive kombëtare, pa ndërhyrje ekstremiste, duke kontribuar në njohjen e kësaj organizate si palë kryengritse sipas së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë dhuna po rritej dhe u thirr konferenca e Rambujesë, nga e cila doli një marrëveshje, që u refuzua nga Serbia, e u pranua nga pala kosovare<sup>9</sup> (Buja, 2007, f. 380) (Weller, 2011, fv. 242-243) (Capussela, 2015, f. 19). Bombardimet e NATO-s sollën kapitullimin e Serbisë dhe Rezolutën 1244 të KS të KB-së (Rezoluta 1244), që është moment historik dhe determinues për shumë zhvillime, debate, e ngatërresa në luftën diplomatike edhe sot mbi dy dekada pas. Sipas kësaj, Kosova “*de jure*” nuk ishte pjesë e Serbisë, mirëpo, “*de facto*” nuk ishte e pavarur, por, ishte nën administrim ndërkombëtar të KB-së (Murati, 2020, f. 113).

Suksesi i intervenimit humanitar në Kosovë, i cili erdhi pas dështimit në Srebrenicë por sidomos në gjenocidin në Ruanda, sekretari i KB-së e filloi debatin e brendshëm më 1999 brenda organizatës për parimin “përgjegjësia për të mbrojtur” (R2P) i cili u lansua më 2001, ku individit ka përparësi ndaj shtetit dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të reagojë në aktet masive dhe sistematike të dhunës nga ndonjë shtet. Pra, u bë një kapërcim edhe gjuhësor jo i paqëllimshëm nga “intervenimi humanitar” në “përgjegjësinë për të mbrojtur” (Badescu, 2009, fv. 81-83). Autorët Vaclav Havel dhe Jürgen Habermas gjatë kohës së luftës në Kosovës përdorën këto argumente për ndërhyrjen ushtarake ndërkombëtare.<sup>10</sup> Ky parim u përdor gjithashtu me sukses në Libi, por dështoi në Siri. Ndërsa si shumë parime, edhe ky i lartpërmendur, rreziku i përdorimit të tij politik është evident. Rusia e keqpërdori R2P për të përlligjur intervenimin në Gjeorgji më 2008 (Ziegler, 2016, fv. 75-97).

Administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut në Kosovë (Bashota, 2018), që kishte pushtetin *de jure*, të deleguar nga Rezoluta 1244 (Rezoluta 1244), bashkëpunonte me institucionet e Kosovës, të cilat nuk kishin ministri të punëve të jashtme. Si rezultat, në këtë periudhë, e

---

<sup>9</sup> Pala kosovare me insistim arriti të pranojë një draft ndryshe nga ai fillestar, pasi u premtua që pas 3 viteve do të zgjidhej statusi i Kosovës me anë të referendumit.

<sup>10</sup> Përkundër mungesës së rezolutës së Këshillit të Sigurimit, ndërhyrja në Kosovë konsiderohet legale bazuar në Kapitullin VIII të Kartës së KB-së që u lejon organizatave rajonale siç është NATO ndërhyrjen ushtarake për të ruajtur paqen, dhe legjitim për shkak se u realizua pas masakrave të tmerrshme ndaj civilëve nga ana e ushtrisë dhe paramilitarëve serbë dhe pas dështimit të negociatave për ndaljen e dhunës nga ana e shtetit serb si dhe kërcënimit real për gjenocid. Madje edhe disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit (Rezolutat: (UNSC Resolution 1203, 1998) dhe (UNSC Resolution 1199, 1998)) para intervenimit ushtarak bënë thirrje për ndaljen e dhunës ndaj civilëve në Kosovë.

sidomos në intensifikimin e negociatave nga viti 2005, institucionet e Kosovës formuan “Grupin negociator”, si trup politik për t’i përfaqësuar në negociatat e Vjenës.<sup>11</sup>

Lufta diplomatike përfshiu edhe shtetet që mbështesnin palët. Rusia dalëngadalë nga një qëndrim më i qetë dhe që do të angazhohej dhe pranonte një zgjidhje në kuadër të KB-së, filloi të cilësonte Kosovën jo si rast sui generis (Lauka, 2007) (Baleta, 2018) dhe të përkrahte qëndrimet serbe. Të gjitha përpjekjet për zgjidhje në kuadër të KB-së, shtatë draftrezoluta në verë 2007, nuk shkuan përpara si rezultat i kërcënimit të vetos ruse (Knoll, 2009, fv. 131-132). Rusia kundërshtoi tezën që Kosova është sui generis, duke e shtyrë idenë që çdo zgjidhje për Kosovën duhet të jetë me karakter universal dhe të paraqet precedentë (Weller, 2011, f. 342). Negociatat e Vjenës sollën Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të hartuar nga ndërmjetësi Martti Ahtisaar në shkurt 2007, por siç është e njohur u refuzua nga Serbia dhe nuk mund të kalonte në KB nga pengimi rus.

Pengimi rus për të kaluar Planin e Ahtisaarit në KB solli situatën e zhagitjes së procesit, duke i dhënë shanse edhe njëherë diplomacisë. Trojka BE-ShBA-Rusi provuan edhe për 4 muaj dhe dorëzuan raportin e tyre i cili ka disa pika që Rusia i pranon. Qëllimi sidomos i Ischinger ishte që të arrihet ndoshta modeli i dy Gjermanive (Tadić e pranon këtë variant, kurse Koshtunica e refuzon pas udhëtimit të tij në Moskë). Është shumë i rëndësishëm të theksohet se në Raportin e Trojkës të dorëzuar në KS të KB-së në dhjetor 2007, në konkluzione pika 4 dhe 5 theksojnë se “nuk do të ketë kthim prapa në statusin para 1999” dhe se “Beogradi nuk do të qeverisë më Kosovën” (Security Council Report, 2007).

Për shkak të pjesëmarrjes ruse në Trojkë, kjo paraqet rëndësi pasi në një dokument të KS të KB-së, me pjesëmarrje edhe të Ruisë, jepen këto konkluzione. Megjithatë dështimi i Trojkës, e bëri të qartë që ka ardhur koha për përgatitje të shpalljes së Pavarësisë në mënyrë të koordinuar me aleatët.

Muaji janar 2008 përdoret nga amerikanët për t’i demarshuar shtetet, që Kosova po lëviz me pavarësi, duke u shpjeguar sfondi dhe se si ka shkuar procesi dhe kjo çka do të ndodhë, është rrjedhë normale logjike e procesit (Brajshori, 2021).

---

<sup>11</sup> Tërë aktivitetin diplomatik të Kosovës, gjatë viteve 90-ta, me përfaqësuesit e qeverisë dhe të UÇK-së, si dhe aktivitetet diplomatike gjatë administrimit ndërkombëtar nga IPVQ dhe “grupi negociator” në teorinë politike njihen si protodiplomaci.



## **2.2 Pavarësia e Kosovës dhe kontestimi i saj në GjND në kontekst të njohjeve për Kosovën**

Pas dështimit që të gjendej në zgjidhje në negociatat e Vjenës mes Kosovës dhe Serbisë dhe pamundësisë që në KB të kalojë një rezolutë për Kosovën që për bazë do të kishte Planin e Ahtisaarit, atëherë në një proces të koordinuar me aleatët, përfaqësuesit e Kosovës shpallën pavarësinë më 17 Shkurt 2008. Menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, Kosova dërgoi letër 192 shteteve të KB-së (përfshirë Serbinë) duke kërkuar njohjen e saj. Që këtu filloi beteja diplomatike, tani për fitimin e njohjeve nga ana e Kosovës, gjegjësisht lufta për ndalimin e tyre nga ana e shtetit serb. Megjithatë nëse analizohet me kujdes procesi, lufta diplomatike për njohje kishte filluar që para shpalljes së pavarësisë, gjegjësisht nga momenti kur u kuptua që Kosova do të bëhet shtet jashtë sistemit ndërkombëtar, jashtë KB-së, me lobimin amerikan dhe të aleatëve të tjerë.

Data 17 Shkurt nuk ishte zgjedhur rastësisht. Kjo ka ndodhur që dita e shpalljes të jetë ditë pushimi, mundësisht një vikend i gjatë, që ndërlidhej me një festë dhe të jetë pushim në KB. Pra, që sa më pak fluks të ketë dhe sa më pak ambasadorë të jenë prezentë. Kjo pasi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) juridikisht kishte autoritetin të ndalojë veprimet e Kuvendit të Kosovës për shpalljen e pavarësisë. Andaj, për këtë sipas Brajshorit, Kosova duhet të jetë mirënjohjese edhe ndaj administratorit të atëhershëm të UNMIK-ut, Joachim Rücker dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, Ban Ki-moon, që i “mbyllën sytë” pavarësisht protestave ruse (Brajshori, 2021).

Menjëherë pas pavarësisë, akti i parë serb ishte reagimi në KS, letra e dërguar më 17.02.2008 nga presidenti serb, Boris Tadić, nëpërmjet ambasadorit Pavle Jevremović, duke dënuar shpalljen e pavarësisë dhe kërkuar tërheqjen e njohjeve nga shtetet që kishin ndërmarr një hap të tillë (KS i KB, 2008).

Periudha pas pavarësisë ishte periudha e artë për Kosovën në aspektin e njohjeve. Momentumi i krijuar pas shpalljes, pavarësisht që nuk ndodhi siç shpresohej nëpërmjet KB-së, solli një numër të konsiderueshëm të njohjeve. Vetëm për më pak se një muaj e gjysmë (shkurt-mars 2008) Kosovën e njohën 35 shtete, në mesin e të cilave 3 anëtare të përhershme të KS të KB-së (ShBA, Franca, Britania e Madhe) si dhe shtetet e mëdha si

Gjermania, Italia, Turqia, Japonia etj., duke dhënë një mesazh se pavarësia e Kosovës do të njihet ndërkombëtarisht.

Për ta ndalur këtë trend, diplomacia serbe kërcënoi që do të tërheqë ambasadorët nga secili vend që njeh Kosovën. Përpos këtij akti politik, Serbia shpalljen e pavarësisë menjëherë u përgatit ta kontestojë në mënyrë legale. Me nisëm e Serbisë, KB miratoi rezolutën 63/3 (Rezoluta e AP të KB-së, 2008) më 8 tetor 2008, duke kërkuar opinion nga GjND-ja mbi legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Vetë në prezantimin e tekstit të draft rezolutës, ministri i jashtëm serb, Vuk Jeremiq, theksoi se Serbia ka vendosur të mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial nëpërmjet diplomacisë dhe të drejtës ndërkombëtare (Ministry of Foreign Affairs, 2018).

Në publikimin e konkluzionit të përmbledhur të mendimit këshillues të GjND-së thuhej: Gjykata ka ardhur në përfundim se miratimi i Deklaratës së pavarësisë së 17 shkurtit 2008 nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme, rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese dhe rrjedhimisht miratimi i asaj deklarate nuk shkeli ndonjë rregull të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare (ICJ, 2010, f. 53). Për dallim nga Rezoluta 1255 (1999) ku Këshilli i Sigurimit ka përcaktuar që zgjidhja e konfliktit Abkhazi dhe Gjeorgji duhet të zgjidhet brenda shtetit të Gjeorgjisë, Rezoluta 1244 nuk parasheh statusin e Kosovës, rrjedhimisht nuk e ndaloj shpalljen e pavarësisë (Beha, 2019, f. 48). Pra, për dallim nga rasti i Abkhasisë, në rastin e Kosovës, Gjykata vëren se Këshilli i Sigurimit nuk ka përcaktuar që zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës duhet zgjidhur brenda Republikës Federale të Jugosllavisë. Tutje, sipas Gjykatës, Këshilli i Sigurimit, gjithashtu, nuk ka rezervuar për vete përcaktimin e statusit përfundimtar (Qerimi, 2013) (Jefferson, 2013).

Weller, duke analizuar vendimin e GjND-së, thekson se Serbia duke tentuar që çështjen ta paraqesë në këndvështrim tërësisht juridik, ndoshta gaboi strategjikisht në zgjedhjen e pyetjes. Andaj, Gjykata u fokusua vetëm në përgjigjen e pyetjes konkrete, pa dhënë shqyrtime shtesë që nuk iu kërkuan në pyetjen specifike. Dhe pasi e drejta ndërkombëtare është sistem i kodifikuar rregullash, nuk kishte normë eksplicite për ndalimin e shpalljes së pavarësisë apo që ndalonte shkëputjen, andaj çka nuk është e ndaluar, rrjedhimisht është e lejuar (Weller, 2011, fv. 474-494). Gjykata e ka sqaruar metodologjinë e ndjekur në rast dhe pyetjen e parashtruar nga AP se “A është shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë në përputhje me të drejtën

ndërkombëtare“. Për dallim nga raste tjera kur gjykata kishte lëvizur nga pyetja për shkak të mosformulimit të duhur, në këtë rast e ka lënë si të tillë pasi që ishte e qartë dhe specifike. Ngjashëm edhe për identitetin e atyre që shpallën pavarësinë se a u bë shpallja nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë (IPVQ), (International Court of Justice, 2010) përkundër që për këtë të fundit Qerimi mendon se edhe nëse gjykata do të kishte theksuar se shpallja e pavarësisë ndodhi nga IPVQ, nuk do të kishte ndryshuar asgjë në opinionin final të GjND (Qerimi, 2011, f. 11).

Ker-Lindsay është kritik ndaj vendimit të GjND-së, ku kritikon që gjyqtarët u limituan në qasjen e tyre dhe vetëm u përgjigjën në pyetjen konkrete që a është shpallja e pavarësisë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Ata u përgjigjën për një deklaratë, jo një secesion, duke e trajtuar gati si një liri të shprehjes apo të fjalimit. Në këtë linjë sipas saj ishte edhe vendimi. Sepse sikur Gjykata të kishte vendosur që akti i shkëputjes që dilte nga shpallja e pavarësisë të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, shumë shtete udhëheqëse perëndimore do ta kishin gjetur veten në pozitë të pakëndshme dhe anasjelltas, nëse Gjykata do të vendoste që deklarata e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme, si për nga natyra e saj deklarative ashtu edhe nga efekti i saj aktual, rruga do të ishte hapur për shumë akte të tjera të shkëputjes (secesionit) (Ker-Lindsay J. , 2011, f. 8). Ker-Lindsay kritikon edhe qasjen e përdorur pas vendimit, që shpallja e pavarësisë është në dakordim me të drejtën ndërkombëtare, duke e quajtur këtë më së paku një keqinterpretim (Ker-Lindsay J. , 2011). Fundja, në luftën politikë, për njohje politike, mjetet e përdorura dhe interpretimet janë të nevojshme për të arritur rezultatin. Gjykata e kishte sqaruar e argumentuar mirë metodologjinë e ndjekur. Në rastin e Kebekut ishte kërkuar se a e lejon e drejta ndërkombëtare asamblesë kombëtare, legjislativitet apo qeverisë në Kebek për tu shkëputur njëanshëm nga Kanada? Por në rastin e Kosovës nuk ishte shtruar pyetje e tillë nga AP, e cila i ishte referuar kërkesës së Serbisë (International Court of Justice, 2010).

Richemond-Barak e vlerëson vendimin e GjND-së si një kompromis të llogaritur mirë për të shmangur antagonizmat e mëtejshme ndërmjet palëve. Gjykata mori vendim për të qetësuar armiqësitë mes palëve në një situatë, në kurriz të kontributit në të drejtën ndërkombëtare. Dhe sipas autores bëri mirë (Richemond-Barak, 2011, fv. 18-19).

Politikisht, është e diskutueshme se a ka mundur Kosova të shfrytëzojë më në optimum opinionin e GjND-së<sup>12</sup> në favor të rritjes së numrit të njohjeve. Përderisa nga rezoluta e KB-së që i kërkonte GjND-së opinionin për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, e deri në daljen e vendimit (korrik 2010), shumë shtete mbanin qëndrimin e mosngutjes së njohjes së Kosovës, me arsyetimin e pritjes së opinionit nga Gjykata. Andaj, ekzistonte një optimizëm se në rast të mendimit të favorshëm, do të ketë “bum” njohjesh për Kosovën. Madje për këtë në prag të dyvjetorit të pavarësisë, nga MPJ e Kosovës ishte dërguar promemorie shteteve për të njohur pavarësinë e Kosovës (Radio Evropa e Lirë, 2010). Pak ditë pas verdiktit, në klimën pozitive, një letër nga kryeparlamentarja e Grenadës dërguar kryeparlamentarës së Shqipërisë, Topalli, e informon që shteti i saj dhe të gjitha shtetet e CARICOM-it së shpejti do të marrin vendim për njohjen e pavarësisë së Kosovës (WayBackMachine, 2013). Megjithatë, Grenada njohu Kosovën 3 vite pas kësaj letre.<sup>13</sup>

Menjëherë pas verdiktit të Gjykatës, Kosovës iu imponua një rezolutë tjetër e KB-së, (shtator 2010) për fillimin e procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Kjo rezolutë u sponsorizua nga Serbia dhe 27 shtetet e BE-së (Rezoluta e AP-së së KB-së A/64/L.65/Rev.1). Pra, Serbia arriti që përkundër disfatës në GjND, të reagojë shpejt dhe të lakojë fokusin ndërkombëtar nga opinioni i GjND-së në dialog, madje atë rezolutë të dialogut e paraqiti si kompromis të saj në raport me BE-në. Në rezolutë nuk parashihej të bisedohej për statusin, pasi që qoftë në mënyrë implicite njihej opinioni i GjND-së dhe statusi konsiderohej çështje e mbyllyr.

Rolin që kishte luajtur periudha deri në vendimin e GjND-së për një numër shtetesh që të mos merrnin vendimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës, tani të njëjtin ndikim e mori dialogu Kosovë-Serbi. Shtete të largëta, që nuk kishin qenë në mesin e shteteve mbështetëse, që morën vendimin e shpejtë për njohjen e pavarësisë në atë klimën pozitive që ekzistonte, po hezitonin të merrnin hapa të tillë.

Në këtë linjë të argumentimit, nëse analizojmë numrin e njohjeve për Kosovën gjatë periudhës kur rasti ishte në shqyrtim në GjND, vërejmë që Kosova para GjND-së kishte 48 njohje (njohja e fundit ishte nga Portugalia një ditë para rezolutës së KB-së që dërgoi çështjen në GjND), ndërsa kur doli vendimi i GjND-së, Kosova kishte arritur numrin 69 të njohjeve (d.m.th. rritje prej 21 shtete) (MPJD). Në këtë periudhë pa dyshim njohjet më të

<sup>12</sup> Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është njëra nga 6 organet kyçe të KB-së.

<sup>13</sup> Pavarësinë e Kosovës aktualisht e njohin 10 nga 15 shtete të Komunitetit të Karaibeve (CARICOM). Në shkurt 2020 raportime zyrtare nga MPJ informuan që Xhamajka njohu Kosovën, gjë e cila pastaj u mohua nga ky shtet.

rëndësishme kishin ardhur vetëm një ditë pas dërgimit të rastit për shqyrtim në GjND, ku Kosova u njoh nga dy fqinjët e saj, Mali i Zi dhe Maqedonia (tani Maqedonia e Veriut), gjë që solli reagim të ashpër të Serbisë, duke dëbuar ambasadorët e këtyre dy shteteve (Welle, 2008). Gjithashtu, gjatë kësaj faze Kosova u njoh nga tre shtete të gadishullit arabik (Arabia Saudite, Mbretëria e Jordanisë dhe Bahrejni).

Gjithashtu trendi i njohjeve pas opinionit të GjND-së vazhdoi, por nuk është që ka qenë shumë i lartë për nga numrat. Në periudhën njëvjeçare pas GjND-së që mund të supozojmë që ka qenë faza njohëse e shteteve pritëse se çka po vendos GjND-ja, Kosova u njoh nga 8 shtete (deri më korrik 2011). Por 6 njohje të tjera të shpejta erdhën në mes të gushtit dhe shtatorit 2011. Këto 14 shtete për 14 muaj që njohën Kosovën, ishin kryesisht shtete të vogla dhe gjeografikisht larg Kosovës, andaj mund të jetë hipotezë e saktë që vendimi i GjND-së ndikoi në vendimmarrjen e tyre. Megjithatë pse ky numër njohjesh nuk ishte edhe më i lartë, mund të kishte ndodhur për dy arsye kryesore. Për shkak që tani më shtetet që kishin pasur qëndrim pozitiv veçse e kishin njohur Kosovën, ndërsa në shtetet e mbetura mosnjohëse, tani më shumë kishin mbetur kundërshtarë të pavarësisë, shtete me probleme të brendshme apo shtete të paimteresuara për të trajtuar njohjen. Arsye tjetër mund të ishte që siç e përmendëm shpejt pas vendimit të GjND-së, erdhi rezoluta tjetër e KB-së për dialogun Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE.

Ish-ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Islam Lauka, vlerëson se përkundër mendimit këshillues të GjND-së për Kosovën, ndikimi i tij në shtimin e njohjeve, mbeti larg pritshmërive. Sipas tij dy janë shkaqet kryesore që çuan në këtë dukuri: i pari ka natyrë të brendshme dhe lidhet me euforinë e faktorëve politikë në Kosovë, ku në vend që të përdoret ky mendim për shtim të aktivitetit, zyrtarët në Prishtinë u pasivizuan, ndërsa faktori i dytë ka natyrë të jashtme dhe lidhet me zhvendosjen e vëmendjes perëndimore nga Kosova, sa për shkak të zhvendosjes së prioritetëve gjeopolitike në zona dhe rajone të tjera të botës, aq edhe për shkak të krizave të brendshme në BE dhe ShBA (Lauka, 2021).

Megjithatë në këtë periudhë kur Kosova ishte (ose duhet të ishte) në ofensivë diplomatike për rritjen e numrit të njohjeve, ndodhi edhe një ngjarje me impakt të madh në politikën e Kosovës, por gjithashtu jo pa impakt në raport me qëndrimin e shteteve ndaj Kosovës, gjegjësisht njohjes që mund t'i bënin asaj. Ndodhi Raporti i Dick Martyt në Këshillin e Evropës, një kundërshtari të Kosovës që shtroi disa teza të cilat në sytë e ndërkombëtarëve

janë mjaft të ndjeshme mbi krimet të supozuara serioze gjatë luftës në Kosovë nga ana e zingjirit komandues të UÇK-së. Shembull në njohjen e Guinesë në janar 2011, Pacolli që po merrej me lobim për shtimin e njohjeve, sidomos në kontinentin e Afrikës, kishte deklaruar se raporti i Martyt po ia bënte tepër të vështirë punën lobuese (TopLajm, 2011). Edhe Xhambazi në punimin e tij 8 vite pas opinionit të GjND-së mendon që Kosova nuk ka shfrytëzuar momentumin e opinionit për të fituar njohje të reja e për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare (Xhambazi, 2008, f. 82). Duke shtuar krizën politike të brendshme që solli ngecje në punën e diplomacisë së re e të papërvojë të Kosovës që t'i kundërvihet suksesshëm kësaj fushate.

Duke i bërë një analizë dhe ndarje të 70 njohjeve të para të Kosovës, Bolton dhe Visoka kanë analizuar deklaratat e dhëna nga ato shtete që kanë bërë arsyetime mbi njohjen e Kosovës (pasi shumë shtete kanë bërë njohjen pa bërë elaborime shtesë), në bazë të thirrjeve se si është arsyetuar njohja, kanë formuar tabelën në vijim (Bolton & Visoka, 2010, f. 19).

*Tabela 1. Baza e përdorur nga shtetet që kanë njohur Kosovën*

Baza e përdorur	Gjithsejtë	Shtetet
E drejta për vetëvendosje në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë	5	Shqipëria, Sllovenia, Burkina Faso, San Marino dhe Emiratet e Bashkuara Arabe
Vullneti i shumicës së popullit	5	Kosta Rika, Afganistani, Australia, Irlanda dhe Arabia Saudite
Abuzimi i të drejtave të njeriut	5	Australia, Irlanda, Kosta Rika, Kanada dhe Samoa
Ndërhyrja dhe administrata humanitare ndërkombëtare	9	Austria, Peru, Irlanda, Zvicra, Suedia, Kanada, Burkina Faso dhe Malta
Shterimi i negociatave për statusin përfundimtar	13	Luksemburgu, Austria, Irlanda, Kosta Rika, Peru, Islanda, Kroacia, Hungaria, Bullgaria, Maqedonia, Mali i Zi, Kanada dhe Malta
Kapacitetet e shtetësisë	9	ShBA, Turqia, Kosta Rika, Kanada, Norvegjia, Burkina Faso, Mali i Zi, Maqedonia dhe Republika Domenikane
Pranimi i "Pavarësisë së Mbikëqyrur" dhe Propozimi i Ahtisaarit	17	ShBA, Estonia, Italia, Luksemburgu, Zvicra, Irlanda, Suedia, Finlanda, Japonia, Kanada, Hungaria, Kroacia, Norvegjia, San Marino, Sierra Leone dhe Kosta Rika
Paqja dhe siguria rajonale	25	ShBA, Franca, Shqipëria, Turqia, Australia, Senegali, Luksemburgu, Zvicra, Austria, Suedia, Japonia,

		Finlanda, Kanada, Kroacia, Bullgaria, Korea e Jugut, Burkina Faso, San Marino, Maqedonia, Mali i Zi, Arabia Saudite, Lituania, Samoa, Republika Domenikane dhe Kosta Rika
--	--	---

Në bazë të tabelës, vërehet që siç e kemi theksuar edhe në kapitullin për njohjen në të drejtën ndërkombëtare, në njohjen e Kosovës është një ndërthurje e dy teorive: konstituive dhe deklarative, gjithashtu arsyet janë të natyrës legale, për të përligjur vendimin për njohjen e Kosovës sipas së drejtës ndërkombëtare, por edhe arsye politike për njohjen. Ky konglomerat i arsyeve të ofruara, ku shtete të veçanta kanë përmendur edhe më shumë se një arsye për njohjen e Kosovës, i jep mundësinë edhe shteteve të tjera jonjohëse, që në rast të vendimmarrjes për njohjen e Kosovës, të zgjedhin arsyetimet për njohje në njërin nga kategoritë e shumta, ashtu siç atyre shteteve do t'u shkonte për shtati në raport me situatën e tyre të brendshme ose të jashtme. Gjithashtu përherë ekziston mundësia e vendimit të njohjes së Kosovës, pa dhënë shpjegime shtesë të arsyeve të vendimmarrjes, ashtu siç kanë vepruar një sërë shtetesh.

Shteti i parë që ka njohur Kosovën sipas listës është Kosta Rika. Në bazë të tabelës ajo i ka përdorur shumicën e argumenteve të së drejtës ndërkombëtare dhe veçantisë së rastit të Kosovës kur kanë shpallur njohjen. Aty përmendet Marrëveshja e Rambujesë, dispozitat e Rezolutës 1244, Raporti i Ahtisaarit, efektiviteti i institucioneve të Kosovës, vullnetin e shumicës, shterimi i negociatave, krimet kundër njerëzimit nga ana e Millosheviqit:

*“...Bazuar në Marrëveshjet e Rambujesë (Marrëveshja e Përkohshme e Paqes dhe Qeveria Autonome në Kosovë e vitit 1999), dispozitat e përfshira në rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe anekset e tij, dhe konkluzionet e Raportit të Ahtisaarit, dhe duke marrë parasysh efektiviteti dhe legjitimiteti i arritur nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, Qeveria e Kosta Rikës miraton shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës.*

*Për Kosta Rikën, pasi ka shteruar mundësitë për të arritur një zgjidhje të negociuar ndërmjet autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë, shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës paraqet një rrugëdalje që ruan vullnetin e shumicës së banorëve të atij shteti të ri. Ajo gjithashtu kupton se pas krimeve kundër njerëzimit (spastrimit etnik) të kryera nga regjimi i Slllobodan Millosheviqit, vendimi i autoriteteve dhe banorëve të Kosovës për të mos qenë në gjendje të vazhdojnë të jenë pjesë e Republikës së Serbisë, madje duke gëzuar kompetencat më të gjera të vetvetes. - Qeveria...”* (Ministerio de Relaciones Exteriores y Culto, 2008).

### 2.3 Kosova, rast *sui generis*, precedent? Ose të dyja bashkë? Apo asnjëra?

Më lart cekëm që në fazën e diskutimeve për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, njëri nga pretendimet kryesore nga aleatët perëndimorë të Kosovës, ishte që ta paraqesin Kosovën si rast *sui generis*. Madje kolektivisht Bashkimi Evropian para shpalljes së pavarësisë, “nënvizoi bindjen se zgjidhja e statusit në pritje të Kosovës përbën një rast *sui generis* që nuk krijon ndonjë precedent.” (European Commission, 2007).

Përderisa në fazën e parë para shpalljes së pavarësisë, *sui generis* i Kosovës argumentohej nga aleatët me atë që zgjidhja e statusit final duhej të konturohej në bazë të parimit të të drejtave të njeriut, e kjo i konkurronte parimit klasik në të drejtën ndërkombëtare të integritetit territorial të shtetit (Weller, 2011, fv. 317-320). Pas pavarësisë dhe procesit të njohjeve<sup>14</sup> (Himmrich, 2017) (Bolton & Visoka, 2010), përfshirë vendimin e GjND-së, mund të flisnim për një tip tjetër të Kosovës si rast *sui generis*. Kjo kishte të bënte me shtetet jashtë KB-së, por të cilat sipas kriterëve të shtetësisë paraqesin entitete shtetërore, të cilat i kemi diskutuar në kapitullin e parë.

Pegg dallon shtetet *de facto* nga subjektet e tjera atipike, siç janë: vakumet e pushtetit, grupet terroriste, subjektet e tjera, të cilat kanë karakter politik, por nuk kërkojnë njohje ndërkombëtare, shtete kukulla, rajone separatiste, të cilat kanë zgjedhur shkëputjen paqësore, shtete, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht nga të paktën dy anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të KB-së ose shumica e shteteve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së, dhe subjektet politike në ekzistencë më të shkurtër se dy vjet (Pegg, 1988, fv. 28-42).

Sipas këtyre kriterëve, Kosova assesi nuk mund të grupizohet në ndonjërin nga 7 kategoritë e josteteve sipas Pegg, pasi Kosova është rast i veçantë edhe në mesin e shteteve joanëtare të KB-së.

Berg dhe Toomla kanë analizuar dhe matur disa variabla për t’i grupizuar shtetet që nuk janë anëtare të KB-së në disa kategori. Variablat që i vendosen nga 1 deri 3 pikë ishin: përhapja e

---

<sup>14</sup> Edhe shtetet që njihnin Kosovën, e theksonin që Kosova është rast *sui generis*. Shembull Gjermania njohjen e Kosovës e shihte edhe si *sui generis* dhe si njohje në menaxhim konflikti.

Autorët Bolton dhe Visoka përdornin termin “‘remedial sovereignty’ përmes së cilës një popull realizon shtetësinë duke u thirrur në shkëputjen korigjuese dhe duke kaluar një periudhë tranzitore të administratës ndërkombëtare të ndërmjetësuar, e karakterizuar nga elementë të sovranitetit të cilat janë të dizajnuara nga jashtë dhe të fituara nga brenda.



njohjes, numri i përfaqësimeve jashtë vendit, misionet e huaja brenda shtetit *de facto* dhe treguesit e tregtisë së jashtme. Variablat ekonomike përbëjnë deri në 25% të vlerës së indeksit, ndërsa indikatorët e komunikimit 30%. Në bazë të variablave, nëse një shtet kishte nga 0 deri 2.5 pikë a ishte shtet i mohuar, nga 2.6 deri 5.0 ishte shtet i bojkotuar, nga 5.1 deri 7.5 pikë shtet i toleruar, ndërsa nga 7.6 deri 10 njihej si shtet pothuajse i njohur (quazi recognition) (Berg & Toomla, 2009, fv. 31-33).

Siç pritej, Tajvani (8.6 pikë) dhe Kosova (8.2 pikë) kryesuan shkallën me rezultate mjaft të larta për t'u klasifikuar si quazi-njohje. Të dy vendet morën rezultate të larta në variablat politike me disa njohje zyrtare dhe si anëtare të disa organizatave ndërkombëtare. Tajvani, përsëri siç pritej, shënoi më të lartën në variablat ekonomike, ndërsa të dy kishin rezultate të larta në treguesit e komunikimit. Autorët ishin të vetëdijshëm mbi trajektoren më pesimiste të Tajvanit dhe optimistë të Kosovës por ata paraqiten gjendjen momentale, siç theksonin "Tajvani po humbet gradualisht njohjen ndërkombëtare (me gjithnjë e më shumë shtete që zhvendosin njohjen e tyre në Republikën Popullore të Kinës) dhe Kosova po avancon statusin e saj ligjor (shpallja e saj e njëanshme e pavarësisë në 2008 është njohur gjerësisht nga fuqitë e mëdha perëndimore) dhe ka ende një indeks më të lartë të normalizimit." (Berg & Toomla, 2009) Për habinë edhe të autorit, studimi nxori Qipron Veriore të toleruar me 6.4 pikë, më shumë se Abhazia që kishte njohje nga Rusia, Venezuela dhe Nikaragua (Berg & Toomla, 2009). Ky analizim krahasues është bërë në vitin 2009, ndërsa nëse fakteve të deriatëhershme, i shtojmë trajektoren e ndjekur të njohjeve dhe integritit në mekanizma ndërkombëtarë të Kosovës dhe Tajvanit, atëherë sipas të njëjtit model, Kosova del më lart (e para) në klasifikim. Abhazia me 4,1 pikë, Somailandi dhe Transnitria me 4.1 qëndronin në zonën që bojkotoheshin, ndërsa më së paku pikë Nagorno-Karabaku 2.7.

Rusia me ndërhyrjen në Krime, gjithmonë është munduar të tërheqë paralele me Kosovën (Kremlin.ru, 2014). Megjithatë si është e mundur që Rusia të tërheqë paralele dhe të thirret në precedentin e Kosovës (të cilës nuk ia ka njohur pavarësinë), për të arsyetuar njohjen dhe aneksimin e Krimesë? Rotaru dhe Troncotă vënë theksin në atë që Rusia i keqinterpretoi jashtëligjshëm normat e së drejtës ndërkombëtare duke imponuar një narrativ për Krimenë që realisht ka ndikuar edhe në praktikën diplomatike dhe influencuar edhe studiues të ndryshëm, me këtë duke thelluar politizimin e së drejtës ndërkombëtare (Rotaru &

Troncotă, 2017, f. 16). Në fakt, Krimea është rast unik, në kuptimin e shkeljes së secilës normë të së drejtës ndërkombëtare (Moskalenko, 2018, fv. 97-98).

Opinion i GjND-së ndihmoi në një masë që Kosova të shihet si *sui generis*. Ai opinion nuk trajtoi shkëputjen, shtetësinë në të drejtën ndërkombëtare, njohjen apo parimin e uti possidetis, si dhe mënyra e trajtimit u dërgoi mesazh Katalunasve, Skocezëve, Baskëve, Korzëve dhe Kebekeve që nuk mund të mbështeten në opinionin e GjND-së në rastin e Kosovës (Peters, 2014, f. 7). Andaj, është e qartë që Kosova paraqet një rast sui generis, si në rrafshin e bërjes së shtetësisë, ashtu edhe në stadin aktual të njohjeve dhe marrëdhënieve me shtete të tjera, siç thekson edhe profesor Hasani që Kosova nuk ka problem të natyrës juridike pasi kjo u pastrua nga GjND, por të natyrës politike të aleatëve tanë me Rusinë (Hasani, 2020).

## **2.4 Marrëveshjet e Brukselit në kontekst të njohjes së Kosovës**

Kosova kishte negociuar me Serbinë për një zgjidhje të mundshme të pajtueshme për të dy palët në kuadër të negociatave të Vjenës deri në vjeshtën e 2007-tës, pra pak para shpalljes së pavarësisë. Dështimi i tyre që solli shpalljen e dakorduar me aleatët e pavarësisë së Kosovës dhe kundërshtimin serb në GjND, e kthyen në domosdoshmëri një proces dialogu Kosovë-Serbi. Kjo siç e kemi cekur, ndodhi nëpërmjet një Rezolutive në AP të KB-së, ku njihej vendimi i GjND-së dhe bëhej thirrje për dialog të mbështetur nga BE. Ky dialog ndër vite ka përcjellë shumë qeveri të Kosovës, të Serbisë dhe ndërmjetës të ndryshëm në kuadër të BE-së, ka ndjekur një trajektore të rrëshqitjes nga dialogu teknik, në dialog politik për normalizim të marrëdhënieve dhe tentimit për një solucion ligjërisht obligues mes dy vendeve.

Beha në analizën që i bëri kurbës së njohjeve deri në vitin 2015 (Beha, 2019, fv. 99-102), e ndan në disa faza, që padyshim një pjesë e konsiderueshme kohore dhe energjie është e ndërthurur me dialogun:

Në fazën e parë, roli i partnerëve ndërkombëtarë ka qenë determinues, të cilët e kanë njohur Kosovën dhe kanë lobuar në sferat e tyre të interesit me gjithë aparatin e tyre diplomatik për njohjen e Kosovës. Paralelisht roli i institucioneve vendore ka qenë i shpërfillshëm në këtë periudhë për të fituar njohje. Roli i fushatës “Europeanët e Rinj” nuk ka

qenë mjaft efikas për njohje të reja. Megjithatë këtë mund ta marrim si një përpjekje të Kosovës për të komunikuar me opinionin publik të gjerë edhe në vendet që nuk e kishin njohur Kosovën.

Faza e dytë e përfshin periudhën nga fillimi i procesit të GjND-së nëpërmjet rezolutës në KB, e deri në daljen e opinionit nga Gjykata. Në këtë periudhë, edhe partnerët ndërkombëtarë kanë hasur në vështirësi për të lobuar për Kosovës për shkak që procesi i Kosovës shihej me dioptrinë “në ndërtim e sipër”. Kjo qasje ka ndikuar negativisht sidomos në mesin e shteteve që kanë qenë skeptike në njohje, ku me kohë, njohja e Kosovës ka dalë nga agenda e tyre.<sup>15</sup> Përkrah këtyre zhvillimeve, në këtë fazë rrodhi raporti i Martyt i cili lë gjurmë në shtimin e njohjeve për Kosovën si dhe fillimi i negociatave Kosovë-Serbi në mars 2011 që po vazhdojnë ka pasur ndikim jashtëzakonisht të madh.

Faza e tretë fillon pas mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës në shtator 2012. Tutje institucionet vendore kanë përgjegjësinë kryesore për shtimin e njohjeve, angazhimet e aleatëve janë në rënie, njohjet gjithashtu ndjekin një trajektore rënie nga viti në vit. Zgjedhjet 2010<sup>16</sup> (Hoxhaj, 2016, f. 85) që u cilësuan “vjedhje industriale e votës” dhe ato 2014 që sollën 6 muaj krizë të mosformimit të institucioneve, zhvillimet rreth Gjykatës Speciale ndërthurur me zhvillimet ndërkombëtare si çështja e Krimesë më 2014 dhe shkuarjen e kosovarëve në luftërat në Lindjen e Mesme, flisnin për probleme të mëdha dhe komplikim të situatës që diplomacia e Kosovës të arrijë të sigurojë njohje të reja.

Nëse shikojmë në përgjithësi fazën që Kosova ka qenë në dialog me Serbinë, pra nga fillimi i procesit të dialogut (mars 2011) e deri në qershor 2022, Kosova ka marrë gjithsej 33 njohje, me një trend rënie. Nga këto 9 njohje erdhën më 2011, 12 njohje më 2012, 8 më 2013, 4 më 2014, vetëm 3 më 2015, nga 2 njohje në vitet 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa njohja e radhës dhe e fundit në përgjithësi daton në vitin 2020.

Pra, trendit të njohjeve të Kosovës mund t’i qasemi në mënyra të ndryshme dhe ta ndajmë në faza të ndryshme, varësisht se çka marrim si pikë referuese (GjND-në, dialogun, pavarësinë e mbikëqyrur apo fillimin e tërheqjeve të njohjeve).

---

<sup>15</sup> Siç do të argumentojmë në kapitullin 3, shtete të ndryshme me deklaratat e tyre në fillim kanë qenë në proces të shqyrtimit të njohjes së pavarësisë së Kosovës, megjithatë deklaratat e tyre me kalimin e kohës kanë evoluar për të keq.

<sup>16</sup> Krizës politike të 2010 edhe Hoxhaj ia atribuon ndaljen e ritmit të njohjeve.

Ambasadori i karrierës, Kiçmari, identifikon dy faza të procesit të njohjes: në fazën e parë vitet 2008-2015 ku numri i njohjeve ka qenë në rritje progresive, deri në momentin e dështimit për anëtarësim në UNESCO, që paraqet hyrje në fazën e dytë që vazhdon deri më sot. Ai këtë moment e paraqet si pikë kyçe, ku përkundër që shumica e shteteve votuan pro Kosovën, megjithatë ishte e pamjaftueshme për të siguruar 2/3 e nevojshme për anëtarësim. Pastaj të gjitha përpjekjet e Kosovës për të treguar që anëtarësimi vërtet ishte në prag, të gjitha mediat ndërkombëtare me tituj bombastik filluan të flasin për dështimin e Kosovës dhe fitoren e Serbisë. Këtë momentum e shfrytëzoi diplomacia serbe për ta paraqitur shtetin e Kosovës si të pakonsoliduar dhe si alibi për të lobuar kundër njohjeve (Kiçmari, 2020, f. 50).

Pothuajse pas secilës marrëveshje, kishte tentime që këto marrëveshje (sidomos gjatë fazës teknike e deri në arritjen e marrëveshjes së parë politike 2013 mes Thaçit e Daçiq) të paraqiteshin si njohje nga Serbia. Marrëveshjen e normalizimit të prillit 2013, Engel e kishte quajtur si njohje *de facto* të Kosovës nga ana e Serbisë. “Për herë të parë serbët pranojnë se qeveria në Prishtinë është kompetente për të gjithë Kosovën dhe kjo është një gjë shumë e rëndësishme. Serbia nuk është pajtuar të njohë Kosovën, por me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Serbia de fakto po njeh Kosovën, faktin që Kosova ekziston.” (Rajonipress, 2013) Zatën përveç kësaj Marrëveshje të 2013-tës, asnjë tjetër në kuadër të Dialogut të Brukselit nuk është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës (madje Serbia në Kuvendin e saj e ka votuar me shumicë të thjeshtë, pra duke mos dhënë indicie që është marrëveshje ndërkombëtare), madje janë quajtur konkluzione, dakordime, konkluzua (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2020, f. 8). Megjithatë diskursi që Serbia po e njeh Kosovën ishte prezent. Presidenti Thaçi, në një rast pas marrëveshjes së doganave, kishte deklaruar që Serbia edhe *de jure* po e njeh Kosovën (Botasot, 2011). Njëjtë deklaronte edhe ministri i jashtëm Enver Hoxhaj (Rettmna, 2013). Deklarata të ngjashme kishin ardhur edhe nga liderët e atëhershëm të Shqipërisë, kryeministri Sali Berisha (Ekonomia-ks, 2013) dhe presidenti Bujar Nishani (Arbresh.info, 2015).

Njëra ndër marrëveshjet më famoze, që impakton drejtpërdrejt Kosovën në arenën ndërkombëtare ishte Marrëveshja për bashkëpunim dhe pjesëmarrje rajonale, e cila u arrit më 24 shkurt 2012. Sipas kësaj marrëveshje, Kosova në takimet rajonale dhe me BE-në paraqitet me fusnotë (yll), por që paraqitet vetë e jo nëpërmjet UNMIK-ut. Fusnota i

referohet Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Nëpërmjet kësaj marrëveshje, aty ku Kosova nuk ka pasur mundësi të anëtarësohet pa fusnotë, ka filluar pjesëmarrjen me këtë model. U bë anëtare e Gjykatës së Arbitrazhit, e Konventës së Hagës mbi Apostilin dhe pjesë e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës më 2016. Oda Ekonomike e Kosovës u bë anëtare e plotë e Shoqatës Evropiane të Dhomave të Tregtisë (Euro-Dhoma) më 18 tetor 2016. Gjithashtu Kosova mori pjesë në nismat rajonale përgjatë viteve (RIDEA, 2019). Sidoqoftë, fusnota nuk është e paraparë të përdoret që Kosova në raport me shtetet që e kanë njohur pavarësinë e saj, qoftë në takime bilaterale, qoftë në dokumente zyrtare të këtyre shteteve. Në dhjetor 2020 qeveria e sapozgjedhur në Mal të Zi, në një dokument përdori fusnotën të Kosovës, gjë e cila solli reagime në Kosovë por edhe sqarim që ka qenë një gabim teknik (MFAD).

Ndryshimi në pozicionet kyçe që mbikëqyrin procesin e dialogut Kosovë-Serbi, ka ndryshuar edhe qasjen. Lajcak deklaroi që Kosova duhet të ndryshojë edhe Kushtetutën në mënyrë që të akomodojë interesat serbe për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (Euronews, 2020). Kjo e shtyu ish-kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafën, të publikojë letrën e pararendësit të Lajcak, znj. Mogherini<sup>17</sup> që i kishte dërguar Mustafës më 2015, një ditë para nënshkrimit të Marrëveshjes mbi Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore të Asociacionit, që parashihte një Asociacion pa kompetenca ekzekutive dhe jo si një pushtet i tretë në Kosovë (Mustafa, 2020).

Përderisa nuk është formuar Asociacioni, është shumë e vështirë të parashikohet kahja që do të marrë ajo. Beteja diplomatike mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe me ndryshimet e qëndrimeve nga ndërmjetësit e BE-së, rezulton që të mos përjashtohet dhe neglizhohet asnjë skenar, qoftë edhe më negativ. Një ndër kërkesat maksimaliste serbe është që Asociacioni të funksionojë si pushtet i ndërmjetëm mes qeverisë dhe komunave, si dhe të ketë përfaqësues për marrëdhënie me jashtë (duke i dhënë këtë atribut të shtetësisë sipas së drejtës ndërkombëtare). Krahas probleme funksionale të sistemit politik unitar të Kosovës, kjo shpalos probleme esenciale për funksionimin e politikës së jashtme të shtetit. Në politikën e jashtme janë të njohura rastet kur aktorët sub-shtetërorë ushtrojnë

---

<sup>17</sup> Mogherini për dallim nga Lajcak, mbante pozitën e zëvendëskryetares së Komisionit Evropian dhe ishte shefe e politikës së jashtme të BE-së.

kompetenca në politikën e jashtme<sup>18</sup> (Paquin, 2020, fv. 51-52), por që zakonisht bëhen për çështje jopolitike, të bashkëpunimeve ndërkufitare, interesave ekonomike etj., por që gjithherë duhet të jenë në dakordancë me nivelin e parë qeveritar dhe të ekzistojnë trupa koordinuese për këtë qëllim. Megjithatë kjo në Kosovë nuk duhet të lejohet, për shkak që në antagonizmat etnike që ekzistojnë mes nivelit qendror dhe një Asociacioni monoetnik, do të rrishte rrezikun për çakordim në politikën e jashtme të vendit, krahas problemeve që do të shkaktonte në funksionimin e brendshëm të sistemit politik në Kosovë.<sup>19</sup>

Dialogu Kosovë-Serbi, ia ka lënë një argument të fortë shtetit serb që ta përdorë në narracionin e vet për Kosovën. Nëpërmjet një rrjeti diplomatik të gjerë e të konsoliduar, të trashëguar dhe nga Jugosllavia, e që është jo e zakonshme për një shtet sikur Serbia, ajo tenton të paraqesë dialogun Kosovë-Serbi, si dialog për statusin e Kosovës, kinse ende është pezull çështja e Kosovës, andaj çdo njohje e saj, do të ishte e ngutshme dhe e parakohshme para se të përfundojë dialogu.<sup>20</sup> Kjo është një keqpërdorim i qëllimshëm i dialogut, instrumentalizim i saj në funksion të qëllimeve diplomatike serbe. Dialogu, negociata janë shprehje që zakonisht përdoren në kuadër të zgjidhjeve për konflikte të pazgjidhura dhe për territore të panjohura ndërkombëtarisht. Kosova që nga negociatat në Rambuje, më shumë kohë ka kaluar me negociata me Serbinë, sesa pa to, andaj duhet që të largohet mjegulla që disa shtete mund të kenë që këto negociata janë vazhdimësi e negociatave të parapavarësisë.

Deklaratat e tilla që po bisedohet për Kosovën, e jo me Kosovën, janë të pasakta, për shkak që dialogu ka filluar në bazë të një rezolute të BE-së dhe Serbisë, por që e njeh vendimin e GjND-së që shpallja e pavarësisë nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Andaj, diplomacia e Kosovës, rekomandohet që të gjejë dhe mbështetje nga Shqipëria, ShBA dhe aleatët e tjerë evropianë (Franca, Anglia, Gjermania, Italia), qoftë ata me fuqi rajonale si Turqia, Kanada, Japonia e Australia, në mënyrë që të depërtojë në rajone të largëta gjeografike, aty ku mungojnë misionet diplomatike të Kosovës, me qëllimin që të shpjegojë

---

<sup>18</sup> Paquin aktivitetet e tilla me jashtë nga aktorët sub-shtetërorë e quan paradiplomacy. Megjithatë bën dallimin me “protodiplomacy” si diplomaci e një entiteti joshtetëror për të fituar sovranitet dhe njohje nga jashtë dhe “identity paradiplomacy” aktivitetet identitare por që nuk kërkojnë pavarësi.

<sup>19</sup> Këtë rrezik kalimi nga paradiplomacia (çështje jopolitike) në protodiplomaci (kërkimi i sovranitetit) e sheh të mundur dhe Noe Cornago (2018).

<sup>20</sup> Në komunikimin më 02.06.2020, Daçiç falënderon homologun tunizian që nuk e ka njohur Kosovën dhe pikërisht përmend që është duke vazhduar Dialogu për gjetjen e e një zgjidhjeje për Kosovën (MFA Serbia).

se çka është esenca e dialogut Kosovë-Serbi. Madje dialogu Kosovë-Serbi është përdorur si argument serb në fushatën e tyre për tërheqjen e njohjeve për Kosovën.

Megjithatë mendime për t'u evidentuar kanë dhënë të intervistuarit për këtë tezë doktrate sa i përket rolit të dialogut në njohjen e Kosovës. Sipas pjesëmarrësit në dialog, Dren Zekës, edhe pse nuk është bërë një analizë e ndikimit të vendimit të GjND-së dhe e dialogut në njohjet e Kosovës, dialogu në një masë të madhe është parë si pozitive, pasi Kosova po ndikon në një proces që është pro paqes e pro sigurisë. Dhe shumë takime ndërkombëtare janë realizuar për shkak të këtij kontributi të Kosovës, sidomos vizita të nivelit të lartë, p.sh. znj. Klinton, znj. Ashton dhe liderëve të tjerë botërorë. Megjithatë edhe Zeka pranon se ndoshta është mundur të bëhet më shumë në këtë drejtim (Zeka, 2020). Ndërsa Brajshori mendon që është gabim të mendohet që Dialogu ka ndalur njohjet. Ai thekson se Dialogun e kemi përdorur shumë si argument për të fituar njohje. Sipas tij dhe njohjet e Egjiptit, Pakistanit apo El Salvadorit janë arritur edhe me argumentin e Dialogut. Në këtë kontekst është përdorur edhe hapja e Zyrës Ndërlidhëse në Beograd ku kemi argumentuar që kjo është një marrëdhënie paradiplomatike, si p.sh. modeli i dy Gjermanive, dhe me qëllim në Beograd është dërguar për shef të zyrës, një diplomat i rangut Ambasador (Ambasadorët Lulzim Peci, Valdet Sadiku) (Brajshori, 2021).

Normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën është një kusht që Serbia të bashkohet me BE, por Brukseli nuk kërkon në mënyrë të qartë njohjen, kurse qëndrimi i qeverisë së Beogradit është që të dy çështjet të mbahen të ndara. Teorikisht, të dy vendet mund të bien dakord me të vërtetë për një marrëveshje që do të zhbllokojë njohjen e Kosovës nga vendet e tjera dhe anëtarësimin e saj në BE, pa kërkuar njohje të plotë zyrtare nga Serbia - ndoshta diçka në vijën e Traktatit Themelor të vitit 1972 midis dy gjysmave të Gjermanisë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që Kosova gjithashtu shpreson të bashkohet me BE, është e vështirë të imagjinohet që të dy vendet mund të bashkëjetojnë si Shtete Anëtare pa njohje reciproke (Rusell, 2019, f. 7). Marrëveshja Ligjërishme e Obligueshme vazhdon të kërkohej me ngulm nga Brukseli, por nuk flitet për njohje specifike të Kosovës, gjë e cila do t'i hapte rrugën Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe njohje të reja. Zvarritja e procesit më së shumti i konvenon Serbisë, duke rritur pasigurinë në rajon, duke luajtur me kartë të dyfishtë në marrëdhëniet me BE-në dhe Rusinë, si dhe duke përdorur metoda të ndryshme për të minuar shtetësinë e Kosovës.

Kosova duhet të shfrytëzojë dialogun për të rritur raportet me 5 shtetet mosnjohëse në kuadër të BE-së. Kjo për arsyen që këto shtete (Sllovakia (Voanews, 2010), Spanja (Exteriores), Qipro, Greqia(Liason Office in Pristina, 2015) dhe Rumania (Ministry of Foreign Affairs of Rumania, 2010)) janë mbështetëse të dialogut, dhe eventualisht qëndrimi i tyre mund të evoluojë në kuptimin pozitiv ndaj statusit të Kosovës, në rast të një marrëveshje Kosovë-Serbi.

Ajo që pamë deri këtu, me negociatat Kosovë-Serbi, procesin në GjND, mbikëqyrjen e pavarësisë, përplasjet në KB për Kosovën janë ndikime të jashtme që padyshim determinojnë dhe vendimmarrjen pasi politika e jashtme është veprimtari në kuadër të mundësive reale të shtetit, në të cilën kufizimet e brendshme dhe të jashtme janë të pashmangshme, dhe secili shtet duhet t'i ketë parasysh gjatë hartimit dhe ekzekutimit të politikës së jashtme në mënyrë që të ruajë balancën e nevojshme (Brighi & Hill, 2012, f. 192).

Krahas këtyre ndikimeve të jashtme, kompleksiteti i brendshëm politik në Kosovë ka dëmtuar këtë proces. Ashtu siç argumentojnë shumë autorë (Elman (1995), McGraw (1994) etj.) vendimmarrja e brendshme ndikon shumë në politikën e jashtme. Ndërrimi i shpeshtë i qeverive në Kosovë të cilat nuk arrinin të përfundonin asnjëra mandatin dhe problemet në formimin e institucioneve e kanë dhënë padyshim efektin negativ në politikën e jashtme, ashtu siç Gashi thekson se “ndërrimi i shpeshtë i qeverive e ka afektuar vendimmarrjen brenda MPJ” (Gashi, 2021).

Përderisa në Serbi kemi një Vuçiq të fuqishëm e ende të pasfidueshëm në skenën politike serbe, i cili mund të bisedojë me Kosovën pa përfillur forcat e tjera politike<sup>21</sup>, në Kosovë kemi një polarizim të madh politik, por edhe këndvështrime diametralisht të kundërta për dialogun mes institucioneve të ndryshme, pastaj pozitë-opozitë por edhe brenda vetë qeverisë. Pra, kundërthëniet që kanë qenë edhe më parë në qeveritë e kaluara (kundërshtimet mes ish-kryeministrit Haradinaj dhe ish-presidentit Thaçi, pastaj më parë protestat masive kundër Asociacionit) vazhduan edhe në kohë të qeverisë Hoti. Ish-kryeministri Hoti theksonte gatishmërinë për dialog, por që nuk mund të merren vesh për asnjë temë, pa u marrë vesh për të gjitha, kryeparlamentarja bën thirrje për ndërprerje të

---

<sup>21</sup> Përkundër që Vuçiq ka pretenduar që është në presion në dialog me Kosovën. Këto presione aludohen që vijnë nga politikanë me prirje më ekstremiste dhe më të afërt me Rusinë si Vulin.



tërësishme të dialogut (Visionpress). Partneri qeveritar AAK shprehte haptas pakënaqësitë me procesin e dialogut (Insajderi, 2020). Partia më e madhe, Lëvizja Vetëvendosje, kritikonte qeverinë për qasjen me Serbinë dhe largimin e reciprocitetit më 2020. Kur erdhi në qeveri për herë të dytë ndryshoi qasjen dhe iu qas dialogut, por në një formë më ndryshe. Andaj, konsolidimi i brendshëm është shumë me rëndësi në përcimin e mesazheve drejt palës tjetër negociuese por edhe ndaj palës ndërmjetësuese, në këtë rast BE-së. Dalja e shumë zërave të ndryshëm nga Kosova siç ka ndodhur në të kaluarën, shkaktojnë paqartësi të ndërmjetësi, sidomos kur në anën tjetër ka një strategji të menduar qartë dhe koordinim institucional.

Ky sindrom i mosbashkëpunimit dhe mosbashkimit përballë Serbisë, i ka kushtuar Kosovës edhe në aspektin e njohjeve. Të tillë e sheh edhe Palokaj në analizën që i ka bërë procesit të njohjes. Ai këtë fenomen më 2015 e ka quajtur “ministri paralele të jashtme”, ku shumë akterë, ministri, zv. kryeministra, politikanë merren ndaras, pa koordinim edhe me dialogun por edhe me lobimin për njohje (Paloka, 2012). Edhe diplomati Muhamet Brajshori kur flet për këtë çështje thekson se nga viti 2011 kemi si Ministrinë e Punëve të Jashtme, ashtu edhe Behxhet Pacollin që merren me lobimin për njohje. Sipas tij, Pacolli ishte më shumë i koncentruar në kontinentin e Afrikës, kurse MPJ më shumë në vende të tjera. Pra, një “dublifikim në lobim”, por që shikuar në retrospektive, ai e cilëson si të dobishëm këtë periudhë, gjë që shfaqet me numrin e njohjeve të arritura (Brajshori, 2021). Të njëjtin mendim e ndanë edhe profesori Gashi, i cili në atë kohë ishte dhe zv. ministër i punëve të jashtme (Gashi, 2021).

Mbështetur në sistemin politik në Kosovë, sipas nenit 93, pika 1 e Kushtetutës së Kosovës, qeveria është ajo që propozon dhe zbaton politikën e jashtme, megjithatë disa mund ta interpretojnë si një dualizëm në politikën e jashtme mes qeverisë dhe presidentit, i cili me kushtetutë formalisht është shef i politikës së jashtme (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84.1). Në fakt nuk duhet të ketë vend për dualizëm të tillë, pasi formalisht presidenti mbështet qeverinë, por në demokracinë ende jo gjithaq të konsoliduar të Kosovës, siç e cekëm kemi pasur raste kur për çështje tejet jetike shtetërore, presidenca dhe qeveria kanë dalë me qëndrime të kundërta (rasti i dialogut me Serbinë dhe mundësia për korrigjimin e territoreve gjatë qeverisë Haradinaj). Reagime ka ngjallur edhe kërkesa që presidenti Thaçi kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e nenit 18 të Kushtetutës për

ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë si precedent rastin e vazhdimin të mandatit të EULEX-it me këmbim letrash (pa ratifikim në Kuvend) ta përdorë dhe në rastin e marrëveshjes Kosovë-Serbi (Konushevci, 2018).

Ndikimet e brendshme nuk janë vetëm nga partitë politike apo mes organeve shtetërore që kanë paqartësi apo tendencë për tejinterpretim të kompetencave në politikën e jashtme. Ndikimet mund të jenë të ndryshme, siç mund të vijnë nga “e keqja e domosdoshme” sipas interpretimit të Madison për grupet e interesit, (Porta, 2010) pastaj lobet e ndryshme që mundohen të shtrijnë ndikimin e tyre në të gjitha fazat që nga debatet parlamentare, gjatë hartimit të ligjeve, influencën e deputetëve, influencën në hartimin e strategjive, nëpërmjet mediave etj. Tutje si një bashkëveprim brenda-jashtë nëpërmjet instrumenteve financiare ndikojnë organizatat joqeveritare vendore e transnacionale, kompanitë multinacionale (shembull lobin për gazpërçues) janë faktorë e aktorë që ndikojnë në politikë të jashtme të një shteti, në këtë rast të Kosovës.

Ndërsa si storie suksesi të politikës së brendshme reflektuar në politikën e jashtme, Hoxhaj rendit 5 faktorë: 1. Stabiliteti politik dhe qeverisja, 2. Siguria e brendshme, 3. Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik, 4. Marrëdhëniet e përmirësuara ndëretnike, 5. Shoqëria civile dhe media (Hoxhaj, 2016, fv. 73-76). Ky konsolidim i brendshëm është përdorur si argument në kërkimin e njohjeve (Hoxhaj, 2016, f. 81). Kjo duhet vazhduar të bëhet pasi në fakt ekziston një diskurs nga Serbia dhe aleatët e saj për ta paraqitur Kosovën si shtet i dështuar (failed state). Kjo ndodh nëpërmjet një diplomacie aktive të tyre, investim në grupe lobuese, që ka influencuar edhe autorë që të imponojnë këtë narrativë edhe në ambientet shkencore ndërkombëtare.<sup>22</sup> Prandaj, është me rëndësi që edhe në këtë rrafsh, shkencëtarët e shkencave sociale të shpalosin argumente në mbështetje të një narrative që Kosova është shtet me të gjitha parametrat edhe të së drejtës ndërkombëtare, por edhe në rrafshin e mbijetueshmërisë dhe sistemit politik të saj.

---

<sup>22</sup> Një ndër punimet e përhapura që e paraqesin Kosovën si “shtet të dështuar” është Wiktor Hedba. “The Issue of Problematic States: Kosovo - A Failed State? Political and Economic Analysis” American International Journal of Social Science 3(4), 2014.

## 2.5 Negociatat dhe problemi i tërheqjes së njohjeve

Njëri ndër problemet që ka sjellë dialogu me Serbinë është instrumentalizimi i tij nga ana e shtetit serb në funksionon të luftimit të shtetësisë së Kosovës, gjegjësisht njohjeve. Në kapitullin e parë kemi shtjelluar tërheqjen e njohjes, si koncept në të drejtën ndërkombëtare, ku kemi theksuar që krahas të qenurit vështirë i akomodueshëm si nocion në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, është i aplikueshëm në praktikën shtetërore të realizmit në marrëdhënie ndërkombëtare.

Tërheqja e njohjeve për Kosovën ka qenë një fushatë e ndërmarrë nga shteti serb, gjegjësisht i koordinuar nga ministri Daçiq, në një periudhë kohore së paku deri në arritjen e marrëveshjes së Uashingtonit në shtator 2020. Megjithatë Serbia ka dhënë sinjale që kjo fushatë do të vazhdojë, përderisa Kosova vazhdon lobimin për njohje (Daçiç). Gjyshinca mendon që procesi i tërheqjes së njohjeve ka qenë i sinkronizuar me Dialogun, ku sipas tij Serbia ka arritur në mënyrë perfide të shfrytëzojë këtë zbrapsje të përfaqësuesve të Kosovës në Dialog, pasi vetë kemi hapur diskutime për statusin e Kosovës dhe kjo u shfrytëzua nga Serbia (Gjyshinca, 2021). Megjithatë, nga fushata disavjeçare e Serbisë, shihet një trajektore rënie në bindjen e saj të shteteve të tjera mbi tërheqjen e njohjeve. Ka gjasë që shtetet e luhatshme, me sjellje joserioze dhe probleme funksionale që Serbia i ka bindur për të ndërmarrë veprime të caktuara, e kanë bërë një gjë të tillë, dhe pak e pritshme që Serbia do të mund të bindte shtete të tjera për hapa të ngjashëm. Kosova në këmbim të ndaljes së kësaj fushate të orkestruar nga Serbia, dha zotimin që për periudhë 1-vjeçare nuk do të aplikojë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Shumica e këtyre zhvillimeve, mbi tërheqjet eventuale të njohjeve, pastaj përgënjeshttrimet, rikonfirmimet apo jo të njohjeve kanë ndodhur me shtete të vogla dhe të largëta gjeografike, me të cilat është më i vështirë komunikimi dhe më i lehtë manipulimi. Pikërisht Serbia ka përdorur si argument negociatat për të bindur këto shtete që të ndërmarrin hapa të tillë. Ashtu siç është shprehur ministri i jashtëm Pacolli<sup>23</sup> “Beogradi ka përdorur se gjoja se jemi në bisedime me Kosovën dhe njohja juaj ndaj Kosovës pengon zhvillimin e dialogut.” (Radio Evropa e Lirë), ai gjithashtu ka ofruar dëshmi që Serbia paguan para të majme te zyrtarët që shtetet të deklarojnë që çnjohin Kosovën (Top-Channel, 2019). Ndërsa këshilltari

---

<sup>23</sup> Fenomeni i tërheqjes së njohjeve është zhvilluar kryesisht në periudhën kur ministër ka qenë Pacolli.

i tij kryesor Zyberaj deklaronte se shteti serb po jep armë në këmbim të tërheqjes së njohjes për Kosovën (KoSSev, 2019). Sipas pretendimeve të Serbisë, këto shtete kanë tërhequr njohjen e Kosovës: Sao Tome dhe Principe, Surinam, Guineja Bisao, Burundi, Liberia, Papua Guinea e Re, Lesoto, Komonvelt Dominika, Grenada, Unioni i Komoras, Ishujt Solomon, Madagaskar<sup>24</sup>, Palau<sup>25</sup> (Island Times, 2019), Gana dhe Sierra Leone.

Kjo sigurisht ka sjellë reagime të diplomacisë së Kosovës. Në gusht 2019 në një reagim të MPJ-së janë demantuar një sërë pretendimesh për tërheqje të njohjes. Në komunikatën e lëshuar thuhet se “Serbia ka ftuar zyrtarë të huaj në Beograd në vizita pa marrë parasysh legjitimitetin e tyre dhe përmes ryshfeteve janë lëshuar “nota diplomatike” dhe dokumente të rreme që janë hedhur poshtë nga vendet përkatëse mandej, si rasti i Liberisë (para TV liberian presidenti i Liberisë e demanton dhe lëshon komunikatë), Ganës, Guinea-Bissaut (akreditimi i Ambasadorit të Kosovës), Burkina Fasos (dërgon dokument që demanton Beogradin), Republikës së Afrikës Qendrore (po zhvillohen hetime për aferë korruptive) rasti i Sao Tome and Principe (ku në takimet e nivelit të lartë mohohet deklarata e shefit të diplomacisë serbe, Daçiq; si dhe raste të ngjashme ku Kosova nuk ka pranuar nota diplomatike nga këto vende për veprimet e tyre të supozuara” (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, 2019). Sipas MPJ-së “Kosova, në koordinim me vendet e Quint-it, ka kundërshtuar këtë fushatë dhe ka ndërmarrë hapat e saj dhe se Serbia ka përdorur ryshfete, afera korruptive, shitje të armëve dhe marrëveshje për heqjen e vizave, si dhe afera amorale duke iu referuar rastit të aplikimit të Kosovës në INTERPOL, të gjitha këto për të kundërshtuar Kosovën.” (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, 2019). Sidoqoftë arsyetimet që Kosova nuk ka pranuar nota diplomatike për tërheqjen e njohjeve, nuk është dashur të potencohen (përveç nëse janë bërë në funksion të antipropagandës), për shkak që në rast të tërheqjes së njohjes, shteti që e bën këtë sigurisht që nuk dërgon notë diplomatike në një shtet që tashmë nuk e njeh, por atë e dorëzon në shtetin paraprak (në

---

<sup>24</sup> Sipas të dhënave, njohja e Kosovës nga ish-ministri i jashtëm Henry Rabary Njaka. Pastaj 5 dhjetor 2018 lajmërohet çnjohja e Kosovës nga ish-ministri i jashtëm Eloi Alphonse Maxime Dovo, i cili ka shërbyer si Ambasador në Moskë nga 2003 deri 2018. Dhe pasi u emërtua në 2018 ministër i jashtëm, ndër vizitat e para e pati në Moskë, ku i është kërkuar çnjohja e Kosovës. Ndërsa ministri aktual ka lidhje të forta me Kinën ku ka sjellë shumë kompani kineze që kanë krijuar monopole në vend, por që tërheqja e njohjes i atribuohet lobimit rus e jo kinez.

<sup>25</sup> Edhe kjo tërheqje e njohjes është demantuar nga misioni diplomatik i Kosovës në një vend (informatë konfidenciale), në një takim të mbajtur me ambasadorin e Palaut në prill 2021, ku është konfirmuar që Palau ka marrëdhënie edhe me Kosovën edhe me Serbinë. Edhe Palau kishte qenë cak i mësymjes së Cizelj në fushatën e ryshfetit për tërheqjen e njohjeve ndaj Kosovës.

këtë rast Serbisë) duke i konfirmuar njohjen e tërësisë territoriale të saj sipas pretendimeve që ka. Megjithatë argumenti mund të shtrohet edhe në anën tjetër, që përderisa këto shtete nuk kanë informuar Kosovën (përveç Ishujve Solomon që kanë dërguar notë diplomatike te institucionet e Kosovës që tërheqin njohjen), atëherë ekziston një mundësi që prapë të rikthehen marrëdhëniet, me ndërrim të qeverive apo të rrethanave në këto vende.

Ka qenë shumë e arsyeshme kundërvënia e Kosovës për ta shpërfaqur fushatën serbe në këtë drejtim. Komunikatat e MPJ-së, qarkullimi i nonpaper në kanalet diplomatike duke ndërtuar një narracion mbi metodat e Serbisë për fushatën e çnjohjeve kanë tërhequr vëmendjen e shteteve të ndryshme mbi seriozitetin e çështjes. Megjithatë kjo periudhë jo e ndritur në politikën e jashtme të Kosovës ka ndodhur kur Kosova ka pasur përplasje edhe me aleatët apo sponsoruesit e pavarësisë së saj, gjë e cila pastaj ka rezultuar edhe me abstenimin e këtyre shteteve në ndalimin e tërheqjeve të njohjeve për Kosovën<sup>26</sup> (Brajshori, 2021). Zaten thekson se kjo ka qenë fuqia dhe resurset e MPJ-së, përkundër që pretendohet që pothuaj për secilin rast të tërheqjes së njohjes, MPJ ka pasur informatat edhe javë më herët, por që ka qenë proces vështirë i ndalshëm (Brajshori, 2021).

Mendim të ngjashëm ka edhe profesori Enver Hasani. Sipas tij fenomeni i çnjohjeve ka qenë fiktiv dhe është përdorur nga miqtë tanë ndërkombëtarë për t'i frikësuar liderët e Kosovës që kishin sjellje të papërgjegjshme ndaj fqinjëve të Kosovës (në rend të parë Malit të Zi). Përveç kësaj, çnjohjet kanë pasur të bëjnë edhe me disiplinimin e lidershipit të Kosovës dhe bërja e qartë atyre se kanë probleme me ligjin në Hagë dhe se nuk mund të jenë perspektiva e Kosovës në marrëdhëniet e saj me fqinjët (Hasani, 2020). Ndërsa profesor i diplomacisë Murtezaj, ish-zëvendësministër i punëve të jashtme, refuzon të pranojë tërheqjen e njohjeve si koncept, por që pranon ekzistimin e tij si fenomen, si një luftë speciale e Serbisë, dhe me ushtrimin e presioneve të ndryshme të vendeve që janë kundër pavarësisë së Kosovës, si Kina dhe Rusia të cilët me presione, probleme etike, frikësime, shantazhe etj. ndikojnë te vendet që kanë mundësi (Murtezaj, 2021).

Në këtë periudhë shpërtheu skandali “kofer diplomacia e Serbisë” ku u argumentua që Serbia po blen apo sajon çnjohjet nëpërmjet praktikave mafioze të tregtisë me armë dhe ryshfetit. Si sekser në këtë fushatë të Serbisë u zbulua që shërben një person me pasaportë

---

<sup>26</sup> Brajshori thekson se Turqia është ndoshta shteti i vetëm që ka ndihmuar Kosovën në ndaljen e kësaj fushate ku ka pasur mundësi.

serbe dhe izraelite por me prejardhje sllovene i quajtur Vladimir Cizelj. Madje u përmendën shtete konkrete: Surinami (Institute Vlatacom, 2018)<sup>27</sup> (Brajshori, 2021), Komoret, Lesoto dhe Burundi, në të cilat ndodhën kontestimet si rezultat i veprimeve të Cizelj (Krasniqi, 2019).

Përkundër sqarimeve të bëra, kjo periudhë paraqiti probleme serioze në diplomacinë e Kosovës pasi u përballën me një fenomen që nuk ishin ballafaquar dhe përgatitur. Se sa ishte ndikimi i kësaj fushate serbe, tregon fakti që Serbia sa herë ka probleme me Kosovën, përmend këtë temë, duke theksuar që shtete të tjera janë në radhë për të bërë tërheqjen e njohjes. Megjithatë kërcënimi i fundit që nëse Kosova aplikon për anëtarësim në organizata ndërkombëtare siç ndodhi me Këshillin e Evropës, nuk rezultoi me tërheqje të njohjeve, siç proklamuan zyrtarët serbë për katër të tilla që në start pas aplikimit.

Praktika të tilla në orvatjet diplomatike të Serbisë për të bindur shtetet për të tërhequr njohjen ndaj Kosovës nuk janë të paprecedentë. Kina dhe Tajvani kanë zhvilluar beteja të gjata diplomatike për njohje. Akuza dhe raporte janë dhënë që keqpërdorimet financiare, rryshfetet e metoda të ngjashme janë përdorur në këto fushata nga të dy vendet (Office of the President Republic of China (Taiwan), 2020). Një raport i Wikileaks dokumentoi pagesat e Tajvanit për Nauruan në këmbim të mbajtjes së marrëdhënieve diplomatike. Pas skandalit më 2008 me Papa Guinenë e Re ku u zbulua që Tajvani ka paguar shuma të majme që kanë shkuar në xhepa të biznesmenëve nga ky shtet në këmbim të marrëdhënieve (Office of the President Republic of China (Taiwan), 2020), mes Kinës dhe Tajvanit ka ekzistuar një pakt 8-vjeçar që nuk do të kishte lobime diplomatike për njohje apo ndërrim të njohjes nga Tajvani për Kinën, i cili skadoi më 2016. Që nga atëherë, ofensiva diplomatike e Pekinit ka bërë që edhe shtetet të tërheqin njohjen për Tajvanin, të cilin aktualisht e njohin 14 shtete. Përderisa Tajvani refuzoi të paguajë 210 milionë dollarë ndihmë për Sao Tome dhe Príncipe, Republika Popullore e Kinës ishte e gatshme ta bëjë këtë (Shattuck, 2020).

Në të njëjtën mënyrë është raportuar që Maroku ka përdorur financat për të bindur shtete të tjera që të tërheqin njohjet ndaj Saharës Perëndimore.<sup>28</sup> Policët ndërmorën një hetim

---

<sup>27</sup> Takimi i Cizelj me zyrtarë të këtij shteti. Sa i përket njohjes nga Surinami, në takimin në Samitin e vendeve të CARICOM, presidenti i Suriname pati takim me ministrin e jashtëm Hoxhaj, dhe përkundër që ministria e jashtme e tyre ishte kundërt, pas dy javësh erdhi njohja.

<sup>28</sup> Saharaja Perëndimore është njohur nga 84 shtete anëtare të KB-së. Mirëpo 44 prej tyre e kanë pezulluar ose tërhequr njohjen për arsye të ndryshme.

zyrtar ndaj ish-ministrit të jashtëm në Lesoto mbi lidhjet e tij të rryshfetit me Marokon, që ndikuan vendimin për tërheqjen e mbështetjes ndaj Saharës Perëndimore (Kabi, 2002). Ngjashëm kishte ndodhur edhe me Zambinë (Zambian, 2011). Interesant është fakti që 7 shtete që në të kaluarën kanë tërhequr njohjen ndaj Republikës Demokratike Arabe të Saharës sipas emrit zyrtar me të cilën njihen Sahara Perëndimore, më vonë e kanë rikthyer atë. Kjo paraqet sinjal që edhe Kosova mund të restaurojë marrëdhëniet me shtetet të cilat në praktikë kanë tërhequr njohjen, sidomos të cilat e kanë bërë për ndonjë përfitim material serb, apo nga keqinterpretimet e dialogut<sup>29</sup> (Gjyshinca, 2021).

Pra, mbështetur mbi këto fakte praktike, tërheqja e njohjes as nuk zgjidh konfliktet e vetëvendosjes apo shpëputjeve të shteteve dhe as nuk zvogëlon rrezikun e përkeqësimit të situatës dhe krijimit të brishtësisë në shtete dhe në rajonin ku gravitojnë. Përkundrazi, tërheqja e njohjes mund të ketë një efekt të atillë që jo vetëm minon përpjekjet për të normalizuar marrëdhëniet midis palëve në konflikt, por gjithashtu shkakton tensione rajonale. Krijon zona territoriale të paqeverisura nga e drejta ndërkombëtare dhe inkurajon praktikën grabitqare, klienteliste dhe të paligjshme transnacionale. Maroku kishte tërhequr paqeruajtësit nga Haiti i shkatërruar, në momentin që ky shtet njohu Saharën Perëndimore. Në kohën kur Maqedonia kishte normalizuar marrëdhëniet me Tajvanin më 1999, Kina u hakmor dhe përdori veton me ç'rast paqeruajtësit u detyruan të largohen, të cilët eventualisht do të kishin shmangur konfliktin dy vite më vonë (Visoka, 2020, f. 328).

Nuk do shumë mend që tërheqjet e njohjes ndaj Kosovës sollën reagime të ashpra në Kosovë, që ishte njëra ndër arsyet kryesore që Kosova vendosi tarifë 100% në ndaj importit të produkteve serbe në nëntor 2018. Kjo pastaj rezultoi me një periudhë tensionesh jo vetëm rajonale, por që shkaktuan tensione të Kosovës me BE-në, si dhe shtetet e Quintit që tradicionalisht kishin përkrahur Kosovën në të gjitha proceset. Tarifa u largua në pranverë 2020, por tensioni, dëmi i shkaktuar diplomatik ishte vështirë i rikuperueshëm. Ky ilustrim konkret na dokumenton që një veprim që mund të quhet i papeshuar mirë nga një shtet në

---

<sup>29</sup> Ishujt Solomon në notë verbale kanë potencuar dialogun "...duke marrë parasysh vazhdimin e negociatave ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për statusin final të Kosovës... Vendimi i marrë nga Ishujt Solomon mbetet në fuqi derisa të përfundojnë negociatat nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian". Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Gazmend Gjyshinca, e bën ndërlidhjen e dialogut, gjegjësisht zbrapsjes së përfaqësuesve të Kosovës dhe tërheqjes së njohjeve. Sipas tij Serbia ka arritur që në mënyrë perfide ta shfrytëzojë këtë lloj zbrapsje të përfaqësuesve tanë në dialog, ku kemi pasur hapje të bisedimeve për statusin e Kosovës, e cila është shfrytëzuar nga politika e jashtme serbe, e cila përkundër që nuk ka ndonjë kualitet aq të lartë siç disa elitistë dhe snobë në Kosovë tentojnë ta paraqesin.

anën tjetër të globit, vendim i cili mund të vijë edhe në mënyra të kontestuara të cekura më lart, ka ndikim të konsiderueshëm jo vetëm në shtetin të cilit i tërhiqet njohja apo në shtetin të cilit i rikonfirmohet njohja e sovranitetit nominal mbi shtetin e ri, por ndikimi është në një shkallë të gjerë gjeopolitik dhe të sigurisë.

Kjo flet për kompleksitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare, shkallën e vështirësisë të politikës së jashtme të shteteve të vogla dhe seriozitetin me të cilin duhet të operohet në diplomaci. Kosova me mungesë të resurseve financiare, kuadrove dhe administrative mbështetet kryesisht në parimet dhe praktikën e mirëfillta diplomatike për të luftuar fushatën e tërheqjes së njohjeve nga shteti serb, i cili në këtë fushatë padyshim që përdorë metodat e ryshfetit, këmbimit të favoreve, propagandës dezinformuese si dhe mbështetjen në aleatin rus për të minuar shtetësinë e Kosovës.

E njohur me terme të ndryshme si “chequebook diplomacy” (Moyle & Dayant, 2020) “briber diplomacy” (Gvosdev, 2010), “caviar diplomacy” (The Guardian, 2013), “dodgy diplomacy” (Transparency International, 2015), kjo përfshin forma joetike dhe jokonvencionale diplomatike për të fituar favore të cilat nuk rezultojnë praktikë të mirëfilltë dhe në dakordancë me rregullat ndërkombëtare.

Ky elaborim i luftës për fitimin e njohjeve apo tërheqjen e tyre, pamë që bëhet duke përdorur një sërë mjetesh që shtetet kanë në dispozicion në politikën e jashtme. Në parim, shtetet janë të lira të zgjedhin mjetet e tyre në politikën e jashtme (Petriç, 2012, f. 408), mirëpo për shtetet e vogla si Kosova këto mjete kufizohen në mjetet e buta siç është diplomacia. Përdorimi i të gjitha mjeteve në politikë të jashtme (diplomacia, propaganda, instrumentet financiare, instrumenti i forcës ushtarake) (Vukadinović, 2009, fv. 209-210) nuk mund të bëhet nga shtete si Kosova. Kjo për shtete të kategorisë si Kosova mund të arsyetohet dhe realizohet në suaza të kapaciteteve vetëm në raste kur rrezikohen interesat thelbësore të shtetit, siç është sovraniteti apo territori kur shteti nuk zgjedh mjet për të mbrojtur ekzistencën e vet. Megjithatë është e qartë që pjesa më e madhe e konflikteve në botë nuk e përdorin mjetin ushtarak si formë të zgjidhjes së konflikteve (Goldstein, 2003, f. 28). Prandaj përkundër tentimeve për inskenime që mund të vijnë nga qarqe anti-Kosovë për ta ngrehur Kosovën në konflikte dhe ta detyrojnë që eventualisht të përdorë mjete të forta, Kosova mençur deri më tani me bashkërendim edhe me aleatët e saj, ka ditur t’i shmangë situatat dhe skenarët e përgatitura. Nocioni i shpikur nga Joseph Nye, i njohur si



Fuqia e Butë (Soft Power) (Nye, 1990, fv. 153–71) është qasja e paalternativë që Kosova duhet ndjekur në politikën e jashtme, qoftë në mendimin dhe hartimin strategjik të planit të veprimit, qoftë në situata ad hoc dhe të përditshmërisë diplomatike (Haxhimehmeti, 2015).

Pashmangshëm këto zhvillime rreth njohjeve që kanë ndodhur dhe ndodhin në marrëdhënie ndërkombëtare, janë pjesë e operimit dhe orvatjeve diplomatike që shtetet në kuadër të politikës së tyre të jashtme bëjnë për t'i akomoduar interesat e tyre në raport me shtetet e tjera apo organizatat ndërkombëtare. Diplomacia e Kosovës deri tani është dashur ta mësojë këtë leksion, por jo në kuptimin e ushtrimit të diplomacisë në këto forma, pasi nuk duhet humbur seriozitetin dhe stabilitetin e shtetit të Kosovës, sepse një përfitim momental i arritur me metodat që i përdor Serbia, mund të jetë me pasoja fatale për shtetësinë e Kosovës dhe raportin tonë me shtetet e zhvilluara dhe demokratike të botës, të cilat bëjnë pjesë në grupin e shteteve mbështetëse të shtetësisë së Kosovës.

## KAPITULLI III

### **3. MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME VENDET E BE-SË DHE ME VENDET E TJERA TË CILAT NUK E KANË NJOHUR AKOMA SHTETIN E KOSOVËS**

Secili shtet mundohet, brenda kapaciteteve që ka, të krijojë dhe mirëmbajë raportet me shtetet e tjera. Falë organizatave ndërkombëtare, të tilla si KB, është mundësuar që edhe shtetet më të vogla dhe në distancë të largët, të kenë marrëdhënie në mes tyre. Këtij procesi i ka kontribuar edhe globalizmi dhe zhvillimi teknologjik i decenieve të fundit. Përkundër kësaj, pak shtete mund të posedojnë kapacitete në politikën e jashtme që të kenë marrëdhënie intensive me shtrirje globale. Shtetet e vogla si Kosova me rëndësi e kanë që raportet më intensive t'i kenë me fqinjët e tyre dhe me shtetet e afërta gjeografike por edhe me qendrat politike botërore. Në këtë rast Kosova gjeografikisht i përket kontinentin të Evropës, në të cilën bëjnë pjesë edhe disa nga qendrat më të rëndësishme të ekonomisë dhe politikës globale (3 nga 5 anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të KB-së). Tërë rrjedha historike e Kosovës, por edhe e tashmja e saj është mjaft e determinuar nga faktorët e fuqisë mes shteteve të Evropës. Kosova duke qenë pjesë edhe e agjendave të politikës së jashtme të shteteve të Evropës, me pikëpamje të ndryshme ndaj saj, shpesh paraqitet në qendër të diskutimeve të niveleve të larta.

Në këtë kapitull trajtohen raportet e Kosovës së pari me vendet e Evropës Perëndimore, ku veçantia e kësaj është marrëdhënia e Kosovës me Bashkimin Evropian, e që si pjesë të rëndësishme të ndërlidhjes me temën tonë janë raportet e Kosovës me shtetet mosnjohëse të Bashkimit Evropian. Duke lëvizur në lindje të kontinentit, harta e shteteve njohëse të Kosovës rrallohet, andaj raportet e Kosovës me këto shtete janë të determinuara nga kjo asimetri politike. Ndërsa për shkak të rëndësisë së fitimit të njohjeve si kuantitet, do të analizohen edhe raportet e Kosovës me kontinente më të largëta në të cilat gravitojnë shumë shtete jonjohëse: Afrika, Azia apo Amerika Latine. Marrëdhëniet e Kosovës me këto shtete ndikohen shumë nga faktorët rajonalë në rajonin tonë, faktorët rajonalë në rajonin ku këto shtete gravitojnë, problemet e brendshme në këto shtete si dhe marrëdhëniet e tyre me shtetet e mëdha, posaçërisht me ShBA-në, Rusinë dhe Kinën. Vetëm marrja në

element i tërë këtyre faktorëve mund ta japë përgjigjen se pse është niveli i tillë i marrëdhënieve të një “x shteti” të largët dhe qëndrimi i ashpër apo më i butë ndaj Kosovës.

Sa i përket Bashkimit Evropian, edhe në aspektin normativ, qasja e BE-së nuk ka qenë unike për zgjerimet. “Marrëveshja e Evropës” ishte me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, tutje e njohur si “Marrëveshja e Asociimit” aplikuar me Turqinë, Maltën dhe Qipron. Krahas saj, pastaj ishte dhe “Marrëveshja e Stabilizim Asociimit” që është në fuqi për vendet e Ballkanit Perëndimor ku Kosova graviton. Në këtë rast, BE tenton që këto vende përmes injeksioneve të ndihmës financiare me një proporcion të drejtë të progresit të tyre të reformave dhe përfundimit të Acquis Communautaire, tenton t'i stabilizojë këto shtete përpara pranimit. Ndërsa nëse merret modeli i ndjekur për njohje, BE-ja, si një organizatë rajonale, nuk njeh shtete në kuptimin tradicional, por mund të gjenerojë qëndrime të përbashkëta midis anëtarëve të saj, të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në veprimet e politikës së jashtme të këtyre shteteve dhe gjithashtu drejtojnë opinionin global dhe ndonjëherë edhe praktikën mbi raste të veçanta. Kështu autorët Newman dhe Visoka duke analizuar qasjen e BE-së (gjegjësisht shteteve të saja) ndaj njohjes së shteteve të reja kanë arritur në përfundim se BE merr parasysh ndërveprimin e faktorëve të brendshëm (shkallën e konsensusit ndërqeveritar, autoritetin institucional supranacional), faktorëve të jashtëm (rrugën drejt pavarësisë, shkalla në të cilën subjekti përmbush kriteret e shtetësisë, gjeopolitika) dhe rezultatet (Newman & Visoka, 2018, fv. 760-786).

*Tabela 2. Ndërveprimi i faktorëve nga BE në njohjen e shteteve të reja (Newman & Visoka, 2018, fv. 760-786)*

Shteti	Faktorët e brendshëm			Faktorët e jashtëm			Rezultati
	Shkalla e konsensusit ndërqeveritar	Roli i autoritetit institucional supranacional	Prezenca e mbështetësit të fuqishëm	Rruga e pavarësisë	Përmbushja e kriterëve të shtetësisë	Interesat gjeopolitike	
Kosova	Konsensus i pjesshëm (kundërshtimi i 5 shteteve jonjohëse)	Roli i madh	Britania e Madhe, Gjermania dhe Franca	Shpallja e koordinuar e pavarësisë pas bisedimeve të dështuara të ndërmjetësuara nga KB	Kriteret themelore të shtetësisë të përmbushura	Siguria rajonale dhe ndërtimi i shteteve anëtare	Njohje bilaterale

Sipas disa autorëve të tjerë në thelb, BE ka pozicion paralel me shtetet ekzistuese në sistemin ndërkombëtar në lidhje me “shtetet *de facto*”. Ekzistojnë katër politika të BE-së kundruall shteteve *de facto*:

- izolim aktiv (embargo dhe ose mbështetje për riintegrimin në shtetin nga i cili është ndarë);
- izolim pasiv (pa marrëdhënie);
- angazhim pa njohje;
- njohje. (Sławomir, Bartosz, & Wojciech, 2017, f. 3)

Siç mund të shihet, Bashkimi Evropian nuk paraqet një qasje uniforme ndaj njohjes apo mosnjohjes së shteteve të reja. Në raste të ndryshme ka qasje të ndryshme, në varësi të shumë faktorëve të tjerë.

### **3.1 Raporti Kosovë-BE**

BE dhe Ballkani Perëndimor kanë një raport specifik, natyrë kjo e marrëdhënieve që shfaqet edhe në raportin e Kosovës me BE-në. Ky raport bëhet specifik, sepse agjenda e BE-së është e koncentruar në disa faza në Ballkan, ku Serbia dhe Mali i Zi të cilat janë në negociata për pranim në BE, Shqipëria dhe Maqedonia kanë statusin e shtetit kandidat dhe Bosnja e cila është në një fazë më prapa. Kosova është me raport specifik për shkak të mosnjohjes nga 5 shtete të BE-së. Samitet e niveleve të larta, Procesi e Berlinit, perspektiva e përbashkët e këtyre vendeve drejt BE-së apo mekanizmat financiarë janë disa nga programet e BE-së përmes të cilave ajo komunikon me Ballkanin Perëndimor.

Sipas Rekës, një shteti sovran i duhet të kalojë në këto faza, nëse ai shfaq pretendimet që të jetë pjesë e një organizate ndërkombëtare sikurse BE-ja, si:

- një shtet që pretendon,
- një shtet që aspirojnë të anëtarësimin,
- një shtet kandidat potencial,
- një shtet kërkues të statusit kandidat,
- shtet negociues deri në gjendjen e statusit përfundimtar si shtet i BE-së. (Reka, 2010, f. 385)

Evropa e Bashkuar pati gjetur mbështetje në zgjerimin e anëtarësimit të shteteve të reja, deri në anëtarësimin e vitit 2004, ku pas kësaj në referendimet në Francë dhe Holandë e hodhën poshtë Traktatin Kushtetues për një Evropë të re (Bebler, 2008, f. 212)<sup>30</sup>. Këto zhvillime merren edhe pas gjithë këtyre viteve si moment kthese në politikën zgjeruese të BE-së.

Kontributi kryesor i BE-së në Kosovë deri më tani, vjen përmes misionit të saj për sundim të ligjit EULEX, mandati i të cilit vazhdohet nga viti në vit. Gjithsesi, ky aspekt nuk mjafton që Kosova ta ketë rrugën e lehtë për BE, sepse mosnjohja nga ana e 5 shteteve të BE-së, Kosovën e vendosë para një sfide gjeopolitike të anëtarësimit të saj në BE. Njohja e Kosovës si shtet nga ana e një organi të BE-së siç është parlamenti Evropian dhe thirrja e tij nga shtet të tjera anëtare që ta njohin Kosovën (Parlamenti i BE-së, 08.07.2010), nuk e ka penguar BE-në dhe organet e tjera të saj që shtetit të mos i referohen si Republika e Kosovës, por me shënimin në fund të emrit (fusnotën) sipas marrëveshjes së dakorduar në kuadër të Dialogut Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga vetë BE-ja. Këtë veçanti të Kosovës, BE e ka menaxhuar në këtë mënyrë pasi Kosova nuk mund të mbetej tërësisht si i vetmi shtet pa raporte me BE-në.

BE ka vendosur marrëdhëniet kontraktuale me Kosovën përmes MSA-së<sup>31</sup>, si një marrëveshje ndërkombëtare midis BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, si rruga për ta arritur te statusi kandidat përmes një programi të reformave në sfera të ndryshme, por assesi si rrugë për negociata të anëtarësimit në BE (Azizi, 2010, f. 354). Kështu si një formë kompromisi u akomoduan kundërshtitë e shteteve mosnjohëse jonjohëse.

Rruga e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe dialogut për këtë çështje me BE-në, si një hap i parë drejt sagës për integrim të plotë, daton që nga viti 2012. Përmes një udhërrëfyese për liberalizimin e vizave (Komisioni Evropian, 2012) dorëzuar autoriteteve të Kosovës,

---

<sup>30</sup> Prandaj, edhe para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në prill 2005 Komisioni Evropian publikoi një njoftim për shtyp "E Ardhmja Evropiane për Kosovën" (Komisioni Evropian, 20.04.2005), dhe në 2006 Këshilli miratoi Partneritetin e parë Evropian për Kosovën (Këshilli, 30.01.2006). Partneriteti i dytë Evropian u miratua në vitin 2008 (Këshilli, 18.02.2008).

<sup>31</sup> Negociatat për një Marrëveshje Stabilizimi dhe Asociimi (MSA) midis BE-së dhe Kosovës filluan në 2013. Marrëveshja u nënshkrua më 27 tetor 2015 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2016. Si vijim filloi Axhenda Evropiane e Reformës (ERA) përfshirë masat konkrete për zbatimin e MSA-së. Ky proces është paraparë të përfundonte deri në fund të vitit 2017, ende mbetet i papërfunduar. Pastaj në vitin 2015, u hartua Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (NPISAA), i cili çdo vit po rishikohet, në mënyrë që të azhurnojë masat afatshkurtra dhe afatmesme që çdo ministri është e detyruar të përmbushë. Këshilli i Stabilizim Asociimit është organ i institucioneve të Kosovës, i cili përfaqëson Kosovën në takime të nivelit politik me BE-në, ngjashëm sikurse konsultimet politike mes shteteve.

Komisioni Evropian identifikoi legjislacionin dhe masat institucionale që Kosova duhet të miratojë dhe zbatojë për të çuar përpara drejt liberalizimit të vizave më 18 korrik 2018, dhe pas kësaj, Komisioni lëshoi një rekomandim për heqjen e regjimit të vizave me Kosovën (Komisioni Evropian, 2018). Megjithatë liberalizimi i vizave nuk ndodhi për shkak të bllokimit në Këshillin Evropian nga ana e disa shteteve skeptike, njohëse të pavarësisë.

Zhvillimet e brendshme në BE, që sollën edhe forcimin e partive me ideologji ekstreme që janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vlerat sublimë të BE-së, kanë rezultuar në një "lodhje të zgjerimit", gjë që ka ndikuar në krijimin e një klime të përgjithshme e cila ushqen pesimizmin për shtetet aspiruese, por edhe përkundër kësaj, Kosovës i duhet gjithsesi të vazhdojë me reformat e saj për të përmbushur kriteret teknike. Kosova, edhe pse vazhdimisht merr një goditje të izolimit për mungesën e liberalizimit të vizave, nuk duhet të largohet nga evropianizimi, duke mishëruar identitetin e saj, pikërisht me vlerat e BE-së siç janë sundimi i ligjit, ekonomia e tregut, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Pra, në BE, vërehet se ligjërimi zyrtar për Kosovën është i matur, por jo i konkretizuar për shkak të vështirësive politike për avancimin e saj të mëtejshëm (liberalizimi i vizave dhe statusi i kandidatit si qëllime të së ardhmes), me gjithë vendimmarrjen komplekse në BE dhe ekzistimit të papajtueshmërive ndërmjet institucioneve të ndryshme të BE-së në qasjen e tyre ndaj Kosovës.

Takimi i Këshillit Evropian më 2019, si institucioni më i lartë politik i Bashkimit Evropian, ka risjellë (pavarësisht që asnjëherë nuk ka qenë i larguar) një nga debatet më të mëdha dhe më të vjetra që nga themelimi i BE-së, debati midis "zgjerimit" dhe "thelimit", dhe kjo dëshmon çështjen se Bashkimi Evropian është një organizatë unike në botë ku zhvillimi i tij nuk ka pasur asnjë model të mëparshëm, gjë që për pasojë, do të zgjojë gjithmonë debate teorike të trajektores së integritimit brenda Bashkimit dhe zgjerimit të tij. Rrjedha historike e zhvillimit të BE-së ka qenë e tillë që e ka mbajtur atë të ekuilibruar sipas parimit të "zgjerimit dhe konsolidimit, jozgjerimit ose konsolidimit", dhe kjo çështje në vazhdimësi ka qenë në krye të debateve, të cilat historikisht shikuar nuk janë të reja. Aktualizimi i debatit varet nga prishja e këtij ekuilibri, të cilin po mundohet ta mbajë presidenti francez Macron. Ndonëse "lodhja e zgjerimit" ishte maskimë e dekadës së parë të shek. XXI për BE-në, me ardhjen e Macron dhe politikën e tij, ajo u zëvendësua me "qasjen e re" për zgjerim, i cili vendos thellimin përpara zgjerimit ose para anëtarësimit të shteteve të reja, ai bën thirrje për

reformë të brendshme institucionale të BE-së (Lleshi, 2019). Edhe në mandatin e ri të fituar, Macron po vijon me testimin në publik të planeve të ndryshme për zgjerimin e BE-së, sidomos në raport me Ballkanin Perëndimor. Mirëpo lufta në Ukrainë duhet të jetë kamberë alarmi se anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor në BE nuk është vetëm proces teknik, por interes strategjik.

Mosuniteti ndërinstitucional brenda BE-së manifestohet në rastet kur ndërsa Këshilli Evropian dhe Këshilli i Ministrave mbrojnë pozicionet e vendeve anëtare dhe kanë fuqinë përfundimtare të vendimmarrjes në BE, kurse institucione të tilla si Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian mbrojnë një qasje mbikombëtare, dhe kanë mbështetur hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore, por edhe heqjen e vizave për Kosovën. Parlamenti Evropian që grupon deputetë sipas parimeve ideologjike, të cilat pavarësisht sfondit nacional, mbrojnë idetë e tyre që më 2010 miratoi rezolutën ku kërkon nga 5 vendet mosnjohëse të BE-së të bëjnë hapa drejt njohjes së Kosovës (European Parliament, 2010).

Boshti i idesë së Macron për "thellimin" është reforma institucionale e Bashkimit Evropian, por edhe vetë reforma e politikës së zgjerimit, gjë që e bën të dallojë këtë qasje të BE-së nga ajo e kaluara. Rishikimi i shengenit, si propozim i Macron, do të thotë që politika e tanishme e BE-së dhe ndryshimi i saj, nuk ka të bëjë vetëm me integrimin e mëtejshëm brenda BE-së se ata janë gati për zgjerimin e ri, por ndryshime të mëdha brenda vetë BE-së, e cila është ajo që është quajtur një "Evropë me dy shpejtësi", ku disa vende po lëvizin përpara të tjerave me format e reja të integritit. Ky ndryshim i qasjes në BE, gjithsesi, nuk ka sjellë qartësi se cila është saktësisht rruga përpara dhe hapat që BE duhet të ndërmarrë përpara se të vazhdojë zgjerimin e pritur në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë kriza brenda BE-së qartazi është e manifestuar dhe në procesin e integritit është shumëdimensionale dhe me faktorë të jashtëm e të brendshëm. Këtu përfshihen që nga problemet institucionale më 2005, Traktati i Lisbonës, lëvizjet separatiste në disa shtete evropiane, problemet e së djathtës ekstreme, imigrimi, krizat ekonomike, intervenimet ushtarake ruse, BREXIT, pandemia COVID-19 etj. (Grin, 2022).

Kosova ka bërë një progres drejt BE-së, nëse gjykojmë mbi kriteret që integrimi evropian përcaktohet nga faktorët e brendshëm të shtetit aspirant, faktorët rajonale në Ballkanin Perëndimor, si dhe faktorët brenda BE-së dhe shteteve anëtare, dhe për këtë fakt Kosova

padryshim meriton liberalizimin e vizave. Por, asaj i mbetet ende punë për të përparuar në politikat e tjera të zgjerimit të BE-së, sidomos në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbutjes së faktorit të gjerë të BE-së (mosnjohja nga 5 shtete, dhe vetë prirja për të vonuar zgjerimin nga faktorët thelbësorë në BE). Tërë këtë ndryshim të politikës së BE-së për zgjerim, dhe ngurtësimin e saj në dekadat e fundit, autorët si (Reka, 2010 dhe Nilsson, 2011) me të drejtë e kanë quajtur "një sindromë kërmilli". Shtete e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme para anëtarësimit, dhe pavarësisht ndryshimit të politikave në BE, në një të ardhme me një vullnet politik dhe mbështetje financiare, këto shtete mund të arrijnë një fazë të zhvillimit të mjaftueshëm për t'u përfshirë në "bllok" në BE, duke shmangur potencialisht rreziqet e bllokimit të njëri-tjetrit.

### **3.2 Modalitetet me 5 shtetet jonjohëse të BE-së**

Jo shumë kohë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në valët e para të njohjeve, erdhën ato nga shtetet e Bashkimit Evropian, përpos 5 të tilla, numër që nuk ka ndryshuar në dekadën e fundit. Greqia, Sllovakia, Spanja, Qipro dhe Rumania janë 5 shtetet e BE-së që nuk kanë lëvizur drejt njohjes së Kosovës. Këto shtete zakonisht përmenden si grup, por megjithatë secila nga to i ka veçantitë dhe kompleksitetin për mosnjohjen e Kosovës. Andaj, përveç për nga rëndësia e njohjes nga fakti që janë anëtare të Bashkimit Evropian, arsytet për këtë dhe niveli i raporteve të Kosovës me këto shtete dallon nga njëra-tjetra, sikurse që bie fjala për secilin shtet tjetër mosnjohës diku në botë.

Ambasador Kiçmari thekson se 5 shtetet jonjohëse të BE-së kanë të paktën tre qëndrime të ndryshme në raport me Kosovën:

- Greqia dhe Sllovakia, dy shtete që kanë një raport relativisht korrekt në komunikim me Kosovën;
- Rumania, e cila është diku në mes, që nuk është e avancuar sa dy të parat, por që ka një zyre në Prishtinë;
- Spanja dhe Qipro, ku niveli i komunikimit me këto dy shtete është minimal, që mundohen në çdo rast, madje edhe në sport të bëjnë eksese dhe insinuata për të penguar integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare (Kiçmari, 2021).



Ndërsa James Ker-Lindsay dhe Ioannis Armatolas, duke analizuar qëndrimet e shteteve të Bashkimit Evropian kundruall Kosovës (pavarësisht a janë njohëse të pavarësisë apo jo), i kategorizojnë ato në 4 kategori të ndryshme: njohës të fuqishëm, njohës të dobët, jonjohës të butë dhe jonjohës të ashpër (Ker-Lindsay & Armatolas, 2019). Në grupin e njohësve të fuqishëm e evidentojnë Britaninë<sup>32</sup> dhe Gjermaninë. Në grupin e njohësve të dobët bëjnë pjesë Çekia dhe Polonia. Në grupin e mosnjohësve të butë: Greqia, Sllovakia dhe Rumania. Ndërsa në grupin e mosnjohësve të ashpër: Qipro dhe Spanja.

Qartësisht Kosova ka mbështetës më të mëdhenj në kuadër të shteteve njohëse me të cilat ka marrëdhënie të plotë diplomatike por edhe intensive. Ndërsa ka hasur në vështirësi në marrëdhëniet me Çekinë dhe Poloninë. Është i njohur “kompromisi Kazhinski” (Wisniewki, 2007, f. 26). Përderisa qeveria polake është deklaruar pro pavarësisë së Kosovës, presidenti i atëhershëm Lech Kaczynski pati deklaruar se do të përdorte mekanizmat që kishte në dispozicion ndaj çdo tentimi për vendosje të marrëdhënieve diplomatike mes këtyre dy shteteve. Kaczynski si politikan i rryer në Evropën Lindore si duket kishte informata për planet ruse ndaj Gjeorgjisë dhe përmend paralelet e Kosovës me Osetinë, Abkhazinë dhe Transnitrinë. Kërkesa amerikane për njohje të Kosovës dhe hezitimi i presidentit polak është i argumentuar edhe nga një dokument i Wikileaks (Embassy in Warshaw, 2008). Prandaj u vendos që të shkohet me njohje të Kosovës, por pa vendosje të marrëdhënieve diplomatike. Polonia ka qenë e luhatshme edhe në mbështetje të Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Polonia ka votuar pro anëtarësimit të Kosovës në BERZH dhe në Komisionin e Venecias, mirëpo ka abstenuar në votimin për anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe BB në filllet e para pas pavarësisë, pastaj në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit. Megjithatë abstenimi polak, ndër të pakët nga shtetet njohëse në tentimin e Kosovës për anëtarësim në UNESCO më 2015, ka qenë një “votë e artë e munguar” për Kosovën për shkak të margjinës së vogël të mossuksesit për anëtarësim dhe konsekuencave që ka bartur politika e jashtme e Kosovës nga ai zhvillim. Wisniewki është i mendimit që Polonia votën abstenuese e bazoi në tre premise të cilat kishin si referim rastin e anëtarësimit rishtazi të Palestinës në UNESCO: anëtarësimi i Kosovës do të ndikonte në prishjen e Dialogut Kosovë-Serbi, UNESCO kishte probleme financiare dhe organizative me të cilat po përballej si dhe anëtarësimi i Kosovës do të ndikonte në politizimin e organizatës (Wisniewki, 2007, f. 26).

---

<sup>32</sup> Edhe pse Britania tani më nuk është anëtare e BE-së.

Me Çekinë për shkak të debateve të brendshme është shkuar me opsionin që të vendosen marrëdhënie diplomatike por ato të mbeten në rangun e të ngarkuarve me punë, pra Kosova dhe Çekia mbajnë ambasadat në shtetet respektive, por ato nuk udhëhiqen nga ambasadorë. Kjo ka ndodhur pasi presidenti i atëhershëm çek, Václav Klaus, nuk ishte pajtuar me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe nuk dërgoi ambasadorë në Prishtinë. Kosova madje pati problem edhe me presidentin aktual Miloš Zeman i cili më 2019 i tha Serbisë se do të shikojë mundësinë e tërheqjes së njohjes së Kosovës (Radio Free Europe/Radio Liberty, 2011). Megjithatë qeveria çeke nëpërmjet kryeministrit Babis shpejt reagoi dhe siguroi Kosovën se një gjë e tillë nuk është në diskutim dhe se i kanë bërë të ditur këtë edhe presidentit Zeman. Kjo ngjalli reagime edhe në Kosovë, të cilët në atë periudhë nuk morën pjesë në takimin e paraparë të përbashkët në Pragë në kuadër të Grupit të Vishegradit dhe Ballkanit Perëndimor.

Pra, ky është niveli i marrëdhënieve dhe qasjes së këtyre shteteve ndaj shtetësisë së Kosovës. Ndryshimet e një shteti në raport me shtetësinë e Kosovës mund të jenë të menjëhershme, si rezultat i ndonjë shkakut të atypëratyshëm, zhvillimi ndërkombëtar, marrëveshje ndërkombëtare etj., apo graduale që vijnë me investim të madh në krijimin e klimës së përshtatshme duke përçarur mesazhe pozitive drejt atij shteti dhe duke rritur intensitetin e komunikimit. Edhe në këtë rast ndikimi i zhvillimeve në marrëdhënie ndërkombëtare është prezent, por këto ndryshime nuk janë drastike si në rastin e parë. Por cilat janë mënyrat për të rritur nivelin e komunikimit, që pastaj eventualisht mund të çojnë në ndryshim gradual të qasjes. Kjo bëhet përmes mjeteve që Kosova i ka në dispozicion si dhe mbështetja nga aleatët. Njëra prej shkathtësive dhe mjeteve të diplomacisë së Kosovës është që edhe nëse nuk mban raporte të drejtpërdrejta shtetërore me një vend, nëpërmjet përfaqësive diplomatike në vende të tjera, mund të krijohen ura komunikimi. Kiçmari (2021) kështu komunikime në kontaktet e tij me diplomatë të këtyre shteteve ishte munduar t'u shpjegojë keqkuptimet që ata mund të kenë për Kosovën. Madje ka pasur raste edhe vajtje-ardhje në pritjet respektive të ambasadave për ditët nacionale, por edhe këto me dallime në varësi të shtetit, diplomatit dhe misionit. Ngjashëm iu ndodh edhe diplomatëve të tjerë të Kosovës, ku ftohen, kanë komunikim me diplomatë të shteteve jonjohëse. Këto takime por edhe kontaktet e drejtpërdrejta komunikuese mes udhëheqësit të MPJ-së me homologë të vendeve mosnjohëse mbahen vazhdimisht por nuk bëhen komunikata publike për to. Këtë

qasje diskrete në relacionet me shtetet jonjohëse e theksoi edhe ministrja Gërvalla në paraqitjen e saj në debatin për politikë të jashtme në Kuvend më 12.04.2022. Ngjashëm u veprua në takimet në qershor 2022 në "Summit of the Americas" ku u njoftua për takime me shtete jonjohëse por pa dhënë detaje tjera. Takimi me përfaqësuesin palestinez në Turqi që rrodhi në publik nga media të huaja, ngjalli polemika.

### 3.2.1 Greqia

Në mesin e shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por që kanë avancuar marrëdhëniet me Kosovën (si angazhim pa njohje) është edhe Greqia. Takimet bilaterale, vizitat e ndërsjella, forume ekonomike, bisedat në margjina të ngjarjeve ndërkombëtare, takimet e diplomatëve të të dyja vendeve në shtete të tjera, shkëmbimet tregtare, zyrat respektive kanë qenë në nivel të kënaqshëm, marrë parasysh që këto dy shtete nuk janë fqinje dhe rrjedhimisht Kosova nuk mund të jetë në linjën e parë të agjendës së politikës së jashtme të një shteti si Greqia. Më 2013 (Flickr, 2013) (Dimitris Avramopoulos, 2013)<sup>33</sup> (Multimedia Centre), kryediplomati Hoxhaj u prit në Athinë nga homologu i tij Avramopoulos, që merret si vizita e parë zyrtare e Kosovës në Athinë.

Në 2015, kur Kosova po bënte fushatë për t'u bërë anëtare e UNESCO-s, Greqia fillimisht u zotua të mbështesë kërkesën e anëtarësimit të Kosovës. Ministri i ri i jashtëm i Greqisë nga qeveria e sapozgjedhur Syriza, Nikos Kotzias, deklaroi publikisht se Greqia "do të mbështesë anëtarësimin e Kosovës në organet ndërkombëtare dhe organizatat e sigurisë". Sidoqoftë, kjo mbështetje nuk ndodhi kur u votua. Kosova dështoi për vetëm 3 vota për t'u bërë pjesë e UNESCO-s, ku Greqia abstenoj e cila për Kosovën ishte votë mangu. Kjo ndodhi pavarësisht nga këto premtime të mëparshme nga Kotzias. Kishte spekulime se lobi serb kishte bërë presion mbi pozicionin grek në lidhje me aplikimin e Kosovës në UNESCO. Pas deklaratës publike të Kotzias, ministri i jashtëm serb, Ivica Daçiç, i dërgoi një notë zyrtare homologut të tij grek duke pyetur për deklaratat e tij në mbështetje të anëtarësimit të Kosovës. Një muaj para votimit për pranimin e Kosovës, kryeministri serb, Aleksandar Vuçiç, i kërkoi homologut të tij grek Alexis Tsipras të votojë kundër aplikimit të Kosovës (Fazliu, 2016).

Avancimi i zyrës ekonomike dhe tregtare të Kosovës në Athinë në një nivel më të lartë ndodhi në qershor 2021 kur ministri i jashtëm, Nikos Dendias, vizitoi Kosovën dhe takoi

---

<sup>33</sup> Hoxhaj takoi edhe në 2016 Avramopolous, kur ky tani ishte në cilësinë e komisionerit të BE-së.

homologen Donika Gërvalla, ku palët u pajtuan që të ngrenë statusin e Zyrës së Kosovës në Athinë nga një zyrë e thjeshtë ekonomike në një zyrë që do të emërtohet ndryshe, zyrë interesi me qasje jo vetëm ekonomike, por edhe politike si “Zyrë e interesave të Kosovës në Athinë” (MFAD, 2021). Ky avancim raportesh e kishte shqetësuar edhe kryeministrin serb Aleksandar Vuçiq, i cili u shpreh që pavarësisht kësaj Greqia e ka njoftuar që nuk do të ketë njohje të Kosovës. Të njëjtën gjë e kishte përsëritur për Radio Evropa e Lirë edhe Ambasadorja Chryssoula Aliferi, udhëheqëse e Zyrës Ndërlidhëse të Athinës në Prishtinë (Radio Evropa e Lirë, 2021). Mediat në Serbi madje flisnin për presione amerikane drejt Greqisë që ky vend të lëvizë në njohjen e Kosovës (Kallxo.com, 2021).

Kërkesa për njohje nga Greqia u përsërit edhe në vizitën që kryeministri i Kosovës, z. Kurti, vizitoi Athinën në korrik 2021 dhe takoi homologun Mitsotakis (Zyra e Kryeministrit, 2021). Ngjashëm edhe në takimin e prillit 2022, kur kryeministri Kurti përveç kërkesës për njohje nga Greqia, theksoi që njohja greke mund edhe të kontribuojë edhe në njohje të tjera për Kosovën (Gazetaexpress, 2022), apo në takimin në maj 2022 në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror që u mbajt në Davos (Kurti, 2022).

Ministri i jashtëm grek, Nikos Dendias, në një intervistë përçoi sinjale që mund të ndodhë njohja e Kosovës, duke përmendur opinionin e GjND-së mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë dhe krahasuar si të ndryshëm rastin me Qipron e Veriut<sup>34</sup> e cila shpalli pavarësinë në mënyrë ilegale nga një agresion i jashtëm (MFA Greece, 2021). Dendias në cilësinë e ministrit të jashtëm kishte vizituar Kosovën në tetor 2020 (MFAD, 2020) dhe përsëri në qershor 2021. Ndërsa vizitën ia ktheu kryediplomatja Gërvalla në janar 2021 e cila në një intervistë për To Vima deklaroi se nuk e lusim Greqinë për njohje përderisa tashmë njihemi nga shumica e shteteve liderë të BE-së dhe NATO-s (ToBHMA, 2022). Kjo deklaratë u mundua të paraqitet si e dëmshme, por duke marrë parasysh deklaratimet e mëparshme që njohja nga Greqia është e mirëpritur dhe e stabilizon rajonin, konteksti i deklaratës së ministres edhe kësaj here ishte për të mos dhënë indice që Kosova ka vetëm interes të marrë një njohje zyrtare nga Greqia pa i vënë shumë në diskutim interesat e tjera reciproke.

---

<sup>34</sup> Përkundër dallimeve të mëdha ka pasur opinione që Greqia ka frikë nga precedenti i Kosovës në rastin e Qipros së Veriut. Këtë gjë e thonë dhe autorët Armakolas dhe Karabairis duke cituar një intervistë të tyre nga brenda MPJ-së greke. Burimi Ioannis Armakolas dhe Apostolis Karabairis, Greqia – Kosova - Një marrëdhënie e ndërlikuar Kosova Thërret: Konferencë ndërkombëtare për Kosovën, BE-në dhe rajonin – Promovimi i studimeve për marrëdhëniet e BE-së, disa vende të rajonit dhe Kosovës, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe British Council, tetor 2011, f. 115.

Këtë intensitet të raporteve Kosovë-Greqi, e ka komentur edhe ish-ambasadori grek në ShBA e në Shqipëri, Alexandros Mallias, duke theksuar se “në fund, ne do ta njohim pavarësinë e të ashtuquajturës Kosovë” (Mallias, 2021).

Vërehet që Greqia është më e interesuar që të shtojë raportet ekonomike me Kosovën pa pjesën politike të njohjes për të mos ndërlikuar marrëdhëniet me Serbinë. Kjo argumentohet me Forumet ekonomike të mbajtura më 2017, 2019, 2022 pastaj vizitat e Dendias ku përkundër që pala e Kosovës synonte afërsinë politike duke aluduar në njohje, fokusi i tij ishte ekonomia, gjegjësisht marrëveshja për gazin dhe energjinë, si derivate nga takimi në Uashington mes Kosovës dhe Serbisë. Duket që qasja e tyre në rritjen e nivelit të raporteve me Republikën e Kosovës, pa ofruar njohje formale, pra duke pasur mirëkuptim për Serbinë, deri më tani ka funksionuar. Sepse edhe siç aludon Chen se traktatet ekonomike, pa përmbajtje politike nuk mund të konsiderohet njohje (Chen, 1951, f. 9).

### **3.2.2 Sllovakia**

Sllovakia ka paraqitur deklaratë kundër në GjND, ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe FMN por ka abstenuar në Bankën Botërore, Komisionin e Venecia dhe në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit. Ndërsa ka përkrahur anëtarësimet e Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës. Sidoqoftë Sllovakia si pjesë e grupit të Vishegradit (Visegrad Group)<sup>35</sup> përherë ka përkrahur Kosovën në procesin e integrimit evropian.

Pozicioni i mosnjohjes së Sllovakisë është zyrtarizuar në një rezolutë parlamentare (Nr. 563/2007), që kërkon një rezolutë tjetër që qeveria ta ndryshojë zyrtarisht atë. Përderisa sot vetëm njëra parti nga ato që sollën rezolutën më 2007 vazhdon të jetë në Parlament. Megjithatë mosnjohja sllovaqe ndërlidhet shumë me problemet e brendshme dhe frika për lëvizje separatiste të minoritetit hungarez në vend, çka e ka përcaktuar qëndrimin sllovak për ruajtjen e parimit të sovranitetit dhe integritetit të shteteve.

---

<sup>35</sup> V4 apo Grupi i Vishegradit përbëhet nga tre shtete njohëse (Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia) dhe një shtet mosnjohës (Sllovakia). V4 në kontinuitet bën thirrje që Ballkanit Perendimor t'i përshejtohet rruga për integrim në BE (V4, Deklaratë e Përbashkët, 28.06.2021, 12.02.2020, 12.09.2019, 26.01.2018, 11.10.2018).

Kosova e ka të përcaktuar një diplomat i cili merret me Sllovakinë. Ky diplomat i Kosovës është i akredituar në Vjenë, dhe në baza të rregullta takon autoritetet sllovaqe. Sllovakia në anën tjetër ka zyrën e saj ndërlidhëse në Prishtinë.

Në qershor të vitit 2019 ish-ministri i jashtëm sllovak, Lajcak, edhe përderisa ishte në detyrë kishte vizituar Kosovën, në mënyrë jozyrtare, por edhe pse kishte takuar tërë liderët institucionalë, takimet e Lajcak gjatë kësaj vizite të tij në Kosovë janë bërë jo në zyre institucionale, por në vende alternative, shtëpi, restorante etj. Lajcak kishte takuar kryediplomatit Behxhet Pacolli, pastaj Fatmir Limajn, Ramush Haradinajn dhe Shpend Ahmetin.

Me iniciativë të presidentes Jahjaga në janar 2016 ishte ngritur një pllakë përkujtimore në nder të ushtarëve sllovakë që kishin humbur jetën në një aksident ajror duke u kthyer nga shërbimi në Kosovë. Me këtë rast një delegacion sllovak i kryesuar nga ministri Lajcak kishte marrë pjesë. Delegacioni kishin realizuar takim edhe me kryeministrin Mustafa (Zyra e Kryeministrit, 2016) dhe atëherë ministrin e jashtëm Thaçi (MFAD, 2016).

Takime mes zyrtarëve kosovarë dhe sllovakë janë mbajtur vazhdimisht edhe në forume ndërkombëtare. Presidenti Hashim Thaçi kishte marrë pjesë në Forumin GLOBSEC 2019 në Bratisllava. Në margjina të samitit V4+WB i organizuar në Varshavë më 2016, kryediplomati Enver Hoxhaj, ka takuar homologun e tij Miroslav Lajcak, me të cilin u takua edhe në margjina të Konferencës së Munihut për Siguri në muajin shkurt 2017.

Kryediplomatja e Shqipërisë, Olta Xhaçka, në një takim me homologun sllovak, Ivan Korcok, më 2021 i kishte kërkuar këtij të fundit që të lejojë hapjen e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Bratisllavë, për të përçar një sinjal pozitiv në Dialogun Kosovë-Serbi (Albanian MEFA, 2021).

Pikërisht Kosova këtu e ka të fokusuar energjinë e saj në raport me Sllovakinë, duke kërkuar lejen për hapjen e zyrës në Bratisllavë. Përkundër ca sinjaleve që kjo mund të ndodhë dhe që do të gjendeshin modalitete për statusin e një zyre të tillë, deri më tani nuk ka pasur konkretizim.

### **3.2.3 Spanja**

Tani kur kemi hyrë në vitin e 15-të të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ende Spanja është në grupin e shteteve të cilat nuk e njohin Kosovën, dhe marrëdhëniet e Kosovës me Spanjën

kanë qenë mjaft të limituara, për shkak të kokëfortësisë spanjolle që të mos ketë kontakte fare me Kosovën, të cilën e konsideron si pjesë të Serbisë. Problemet e brendshme në Spanjë (çështja katalune dhe baske), të cilat u aktualizuan pas pavarësisë së Kosovës, vetëm që e vështirësuan një ndryshim të qasjes spanjolle ndaj Kosovës. Megjithatë do të ishte gabim të konkludohet që 14 vite marrëdhënie Spanjë-Kosovë kanë qenë lineare. Sinjale sporadike janë përçarur, të diktuar nga ndryshimet e brendshme politike por edhe rrjedhat ndërkombëtare.

Spanja përveç që doli kundër pavarësisë së Kosovës, nuk ishte as në grupin e “mosjohësve konstruktivë” pasi dolën informata se Spanja u angazhua aktivisht kundër njohjes së Kosovës, saqë zyrtarët diplomatikë kishin marrë udhëzime me argumente kundër pavarësisë së Kosovës në mënyrë që t’i bindin partnerët nga Amerika Latine, Afrika dhe bota arabe që të mos njohin Kosovën (Fanés, 2021).

Sinjale të para të ndryshimit të qëndrimit spanjoll ndaj Kosovës ka dhënë politikani socialist López Aguilar në prill të 2009. Ai krahasoi qëndrimin ndaj Kosovës me qëndrimin që kishte mbajtur Spanja për Izraelin. Kandidati socialist konsideroi se krahasimi me rastin e Izraelit, me të cilin Spanja nuk kishte vendosur marrëdhënie diplomatike deri në vitin 1986, është shumë "i dobishëm". “Na u deshën 48 orë për të vendosur veten në paqe me historinë, për të pranuar se nuk kishte kthim prapa. Por ne e kemi bërë këtë dhe kemi 20 vjet marrëdhënie miqësore me shtetin e Izraelit” (ABC Espana, 2009). Megjithatë partia e tani eurodeputetit Aguilar është në pushtet në Spanjë që nga 2018 dhe ka qenë edhe më parë por pa ndryshime praktike në njohjen e Kosovës. Gjatë kësaj qeverisje, sinjal pozitiv mund të potencohet fakti që kryeministri Pedro Sanchez mori pjesë në një Samit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, ku participoi dhe Kosova (Samiti i Zagrebit 2020), por që u mbajt pa simbole apo flamuj shtetërorë, dhe nuk është që u shqua si ndonjë Samit i suksesshëm, sidomos pasi po mbahej në filllet e pandemisë COVID-19 (Samiti u mbajt në formatin online).

Ajo që u mendua që do të mundë të ndryshonte qasjen spanjolle, vendimi i GjND-së, nuk rezultoi i tillë, pasi në reagimin e saj, ministrja e jashtme spanjolle, Trinidad Jiménez, pas takimit me ministrin e jashtëm serb, Vuk Jeremiq, në janar 2011, kishte theksuar gjithashtu se opinioni këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të pavarësisë së Kosovës nuk e modifikon qëndrimin e Spanjës për këtë çështje (MFA Spain, 2022). Ministrja e njëjtë, Jiménez, në një vizitë të mëvonshme në Beograd e përsëriti qëndrimin e saj, mirëpo

theksoi se Spanja nuk do të bllokojë një marrëveshje kontraktuale të BE-së me Kosovën, përderisa statusi mbetet neutral, pasi “Kosova nuk mund të bëhet një ‘vrimë e zezë’ në Evropë” (MFA Spain, 2022).

Ndërsa edhe për rezolutën e Parlamentit Evropian ku i bëhej thirrje shteteve anëtare mosnjohëse që ta bëjnë hapin drejt njohjes formale të Kosovës, rezolutë të cilën e kemi përmendur tashmë në punim, kishte ardhur reagimi nga Spanja ku ambasadori spanjoll në Beograd, Ignacio de Palacio España, tha se qëndrimi i Spanjës nuk do të ndryshojë (UNPO, 2009).

Spanja kishte reaguar edhe me rastin e vendimit për formimin e ushtrisë së Kosovës, duke e quajtur si një akt unilateral dhe duke bërë thirrje për revokimin e vendimit (MFA Spain, 2022), ndërsa ka përshëndetur arritjen e marrëveshjes në Uashington 2020 (MFA Spain, 2022). Pas marrëveshjes në Uashington, një reagim tjetër që erdhi nga ministria e jashtme e Spanjës ishte që “Spanja do të ishte e përgatitur të njihte Kosovën nëse arrin një marrëveshje me Serbinë” si dhe “Pozicioni ynë nuk është pengues, por, përkundrazi konstruktiv”. Këto deklarime u dhanë për mediumin EUObserver dhe ishte përshëndetur nga raportuesja për Kosovën në PE, Viola von Cramon, duke e cilësuar që qeveria aktuale është më fleksibile në raport me Kosovën se ato të mëparshmet (Krasniqi & Rettman, 2020).

Pranimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA i imponoi shteteve mosnjohëse të zhvillojnë ndeshjet me Kosovën, përkundër rezistencës dhe tentimeve për t’i bishtnuar trajtimit dinjitoz të Kosovës. Në mars 2021 u zhvillua ndeshja kualifikuese në kuadër të FIFA-s ndërmjet Spanjës dhe Kosovës, dhe televizioni publik spanjoll RTVE nuk i referohej Kosovës si shtet dhe gjithashtu të afishuar në ekran emrin “Kosovë” e mbajti me shkronja të vogla gjatë ndeshjes.

Në nëntor 2021, dy deputetë spanjollë të Dhomës së Ulët kërkuan nga qeveria e tyre që ta njohë Kosovën (Campo, 2021). Përkundër që të dy vijnë nga parti të ndryshme por janë baske (Aizpurua dhe Esteban) ata reagues ndaj kryeministrit të tyre që anashkalonte Kosovën, sidomos në Samitin për Ballkanin Perëndimor. Esteban e përmendi faktin që pasi veçse është zhvilluar ndeshje futbollit mes Spanjës dhe Kosovës, duhet njohur pavarësia e saj. Ndërsa Aizpurua ka përmendur çështjen e vullnetit të popullit të Kosovës për pavarësi.

Qëndrimi spanjoll ndaj Kosovës, nuk është si rezultat i ndonjë miqësie historike spanjolle-serbe apo i qasjes anti-amerikane të Spanjës siç mund të jetë rasti me disa shtete të



kontinenteve të tjera, por më shumë hezitimi spanjoll ka ardhur si rezultat i frikës së reflektimit të njohjes së Kosovës në problemet e brendshme dhe lëvizjes separatiste baske dhe katalune.

Për të bindur Spanjës që të mos hidhen paralele të tilla, tentoi edhe kryeministri Kurti. Ai në gazetën e madhe spanjolle El Pais theksoi se “Kosova nuk duhet të krahasohet me asnjë rajon të Spanjës. Është absurde të përpiqesh ta vendosësh Spanjën në të njëjtën kategori me Serbinë sepse Serbia po zbatonte aparteidin në vitet 1990 që kulmoi me gjenocid në 1999.” (Pita, 2022).

Këtë frikë spanjolle për njohjen e Kosovës duke e ndërlidhur me problemet e brendshme, e theksoi edhe ish-lideri i Katalonias, Carles Puigdemont, i cili theksoi se “Kosova viktimë e Katalonjes! Sikur t’mos ishte Katalonja, Spanja nesër do të njihte shtetin e Kosovës”. Ai duke u përgjigjur për mediumin zviceran “LeCanton27” potencoi vendimin e GjND-së si arsye që Spanja do të duhej të njihte Kosovën<sup>36</sup> (Rédaction, 2021).

Këto deklarime baske dhe katalunase për Kosovën, nga ana e Madridit zyrtar mund të interpretohen edhe si përpjekje për legjitimitetin e çështjeve/synimeve baske dhe katalunase. Në anën tjetër Kosova është treguar e kujdesshme që të mos hyjë në aventura kontakti me këto lëvizje.

Në maj 2021 u raportua në media për një hap i cili do të mundë të ishte goxha domethënës në marrëdhëniet paradiplomatike Kosovë-Spanjë. U raportua se Spanja ka vendosur që të hapë Zyrë Ndërlidhëse në Kosovë. Mediat duke raportuar burime anonime diplomatike theksuan që për këtë rol të madh ka luajtur ish-ministri i punëve të jashtme i Spanjës, Joseph Borrell, tash përgjegjës për Politikën e Jashtme të BE-së, dhe se zyra do të ishte e modeleve ekzistuese ruse apo kineze (Demokracia, 2021). Ngjashëm u raportua edhe për njohjen e pasaportave kosovare nga ana e Spanjës. Megjithatë një vit pas, ende nuk ka diçka konkrete nga këto raportime. Përkundrazi në prill 2022 MPJ spanjolle (Klankosova, 2022) deklaroi se vazhdon qëndrimi i tyre i njëjtë për mosnjohjen e Kosovës dhe se zgjidhja duhet të vijë nga dialogu Beograd-Prishtinë. Pra, shohim një rikthim në pozicionin spanjoll antinjohjes dhe që nuk do të lëvizin drejt njohjes pa pasur marrëveshje me Serbinë.

---

<sup>36</sup> Mediumi “Lecanton27” ka pasur raste që është demantuar për raportimet e bëra, por për rastin e cituar nuk është gjetur ndonjë demantim.

### 3.2.4 Qipro

Në mesin e shteteve mosnjohëse brenda BE-së, Qipro merret si kundërshtuesja më e ashpër e pavarësisë së Kosovës, apo shteti që më së shumti injoron Kosovën. Kjo më së shumti për shkak se Qipro është një shtet i cili për shumë dekada nuk ka pasur mundësi të ushtrijë kontroll efektiv mbi një pjesë të territorit të saj, në të cilën funksionon *de facto* një shtet tjetër, Republika Turke e Qipros Veriore. Madje ishulli i Qipros si i tillë i ndarë, është bërë anëtare e BE-së më 2004 në grup me ato shtete që njihet si “zgjerimi lindor”.

Duke ditur rrethanat politike në Qipro, që është i banuar nga grekoqipriotët që administrojnë nominalisht tërë ishullin dhe turkoqipriotët në veri që pretendojnë pavarësinë e tyre (të njohur vetëm nga Turqia), e që Greqia si sponsori kryesor i krijimit të Qipros nuk e njeh Kosovën, apo që sponsoruesja e Qipros Veriore është Turqia e cila ka mbështetur sistematikisht pavarësinë e Kosovës e bën më të komplikuar mundësinë e afrimit të tyre me Kosovën. Madje edhe zyrtarë të Turqisë dhe Greqisë në paraqitjet e tyre e ndërlidhin Qipron dhe Kosovën (MFA Greece, 2021)<sup>37</sup> (Vuksanovic & Tzifakis, 2021) (MFA Malaysia, 2008)<sup>38</sup>.

Kontaktet e para me Qipron janë evidentuar ato të viteve 2013-2014. Kryediplomati Enver Hoxhaj dhe kryeministri Hashim Thaçi ishin takuar me kryediplomatin qipriot Ioannis Kasoulides në margjina të KB-së. Ndërsa më 2014 British Council me anë të një projekti synonte të krijonte ura komunikimi mes shoqërive civile, think tankeve dhe mediave të dy vendeve, duke zvogëluar nivelin e perceptimeve të gabuara për njëra-tjetrën (Fazliu, 2016). Megjithatë një vit më vonë, më 2015, përderisa Kasoulides ishte ende ministër i jashtëm, Qipro votoi kundër Kosovës në tentimin për anëtarësim në UNESCO. Në realitet është i regjistruar edhe një takim i Kasoulides në vitin 2010 me ministrin e jashtëm Hyseni (Ekonomia-ks, 2010), por që atëkohë Kasoulides ishte në cilësinë si kryetar i grupit punues për Marrëdhënie me Jashtë të Parlamentit Evropian. Vijimësinë e mosnjohjes së Kosovës, Qipro e ka shfaqur edhe së fundi në prill 2021 në takimin trilateral në Beograd së bashku me Greqinë dhe Serbinë (MFA Cyprus, 2021).

---

<sup>37</sup> Në intervistën e Dendias kur flet për pikëpamjet konstruktive të Greqisë ndaj Kosovës e bën dallimin me Kosovën, duke iu referuar vendimit të GjND-së për Kosovën që nuk ishte produkt i përdorimit të dhunës së paligjshme të dënuar nga Këshilli i Sigurimit, siç ishte shpallja e pseudo-shtetit të Qipros Turke në vitin 1983. (MFA Greece, 2021).

<sup>38</sup> Ndërsa Erdogan u prononcua për Kosovën para vizitës së tij në Qipron Veriore në korrik 2021.

Tendencat edhe nga Turqia e Erdogan që ta ndërlihdë çështjen e Kosovës me një zgjidhje për Qipron siç ishte intervista e tij para nisjes për Qipro, i kanë përmendur edhe vetë zyrtarë turkoqipriot. Deputeti Oğuzhan Hasipoğlu i Partisë së Unitetit Kombëtar të Qipros Veriore më 2020 theksoi se “procesi i bërjes së shtetit të pavarur të Kosovës mund të hedhë dritë mbi hapat që do të ndërmerren nga pala turke qipriote” dhe se edhe turkoqipriotët kanë të drejtë të kërkojnë njohje të pavarësisë së tyre sikurse Kosova (Hasipoğlu, 2020).

Ekziston një mendim (Bieber (Krasniqi & Rettman, 2020), Kiçmari (2021) etj.) se njohja Kosovës nga ana e Qipros është shumë e varur nga njohja greke, dhe se një njohje eventuale nga Greqia do të kishte refleksione tejet pozitive në ndryshimin e pozicionit qipriot. Kjo qasje mund të jetë e vërtetë për shkak të ndikimit historik grek mbi Qipron, megjithatë në këtë analizë përherë duhet marrë parasysh edhe elementi i Qipros Veriore, gjë që e vështirëson një njohje nga Qipro edhe me rastin kur Greqia potencialisht do të lëvizë drejt njohjes së Kosovës. Këtë mendim e ndanë edhe ish-ministri i jashtëm Skender Hyseni, i cili njohjen e Kosovës nga Qipro e cilëson si më të vështirën për ta marrë nga shtetet mosnjohëse të BE-së, madje thekson se Qipro nuk do ta njohë Kosovën, por do të shkojnë me opsionin që “marrin dijeni që Kosova është shtet por nuk e njohin” për dallim nga opsioni që “e njohim dhe marrim shënim” (Tëvë, 2022).

### **3.2.5 Rumania**

Edhe Rumania është nga grupi i shteteve mosnjohëse të BE-së, e që bazuar nga ky kriter hyn në shtetet mosnjohëse me peshë politike. Sikurse rasti me Spanjën, në mënyrë quazi të ngjashme edhe Rumania e ka drojën e lëvizjeve seperatiste, të minoritetit hungarez në Székely e sidomos të Transnitrisë në Moldavinë fqinje, në të cilën shteti nuk ka kontroll efektiv por vetëm me sovranitetin “*de jure*”.

Por pozicioni rumun nuk është i ngurtë sa ai spanjoll, pasi është treguar konstruktive në shumë situata me Kosovën. Rumania nuk ka votuar kundër Kosovës në aplikimin për UNESCO (ka abstenuar), përkrah agjendën eurointegruese të vendit, ka zyrën e saj në Kosovë në kuadër të UNMIK-ut, lejon udhëtimet nga Kosova etj. Pra, mund të themi që Rumania hyn në grupin e atyre shteteve që për shkak të frikës nga telashet e brendshme me lëvizjet e mundshme seperatiste, e ushqyer kjo nga zhvillimet ndërkombëtare në Gjeorgji,

Ukrainë, Spanjë, Irak etj., e arsyeton mosnjohjen e Kosovës në baza parimore të së drejtës ndërkombëtare, parimit të integritetit territorial etj.

Përplasjet e brendshme në raport me pozicionin viz-a-vi Kosovës i dolën në pah në kohën kur ish-kryeministri atëherë në funksion Ponta pati qëndrime pro njohjes së Kosovës. Së pari më 2013 në parlamentin rumun ku kërkonte krijimin e një Grupi Punues mbi studimin e qëndrimit ndaj Kosovës (Romania Government), pastaj më 2015 theksoi se Rumania mund ta njohë Kosovën pasi rrethanat nga viti 2008 kanë ndryshuar (Grigoras, 2015). Kjo mund të ishte edhe arsyeja që më vonë gjatë atij viti, Rumania abstenoj në tentimin e Kosovës për UNESCO, por që pas asaj fiasko, siç e kemi theksuar, politika e jashtme e Kosovës u çakordua dhe nuk pati mundësi materializimi të momentumit konstruktiv të qasjes rumune.

Në fakt në pozicionin rumun për mosnjohjen e Kosovës, kanë qenë pothuajse uniforme tërë spektri politik i vendit, me përjashtim të partisë hungareze UDMR, e cila ishte e vetmja që votoi kundër rezolutës për mosnjohjen e Kosovës më 2008. Kjo rezolutë u votua me shumicë 357 pro dhe 27 kundër (Reuters, 2008).

Një sondazh që u realizua nga Qendra Rumune për Politikën Evropiane me anëtarë të parlamentit rumun nxori rezultate interesante. Të dhënat nga studimi tregojnë se 39% e deputetëve besonin se Rumania duhet ta njohë Kosovën, 35% ishin kundër njohjes dhe 26% nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Si arsye të këtyre qëndrimeve kundër njohjes, 36% e deputetëve theksuan se "krijon një precedent për Rusinë dhe Hungarinë", ndërsa 13% argumentuan se "ndikon në integritetin territorial të Serbisë", ndërsa pala pro njohjes argumentoi se "Rumania duhet të ndjekë partnerët e BE-së dhe ShBA-në dhe të njohë Kosovën" (Damian & Demjaha, 2019). Pra, deputetët në numër të konsiderueshëm u deklaruan pro shtetësisë së Kosovës dhe njohjes së saj, por janë të prirur të ndjekin linjën zyrtare partiake të përcaktuar. Befasuese është parë edhe vota pro e rreth 16 eurodeputetëve rumunë që i bënin thirrje vendeve të BE-së ta njohin Kosovën.

Ambasadori Kiçmari mendon se qasja që Kosova duhet të ndjekë në raport me Rumaninë është të fokusohemi në Bruksel dhe të bëhet presion përmes Brukselit për hapje të zyrës sonë në Bukuresht, pasi nëpërmjet saj krijohet rrethi i ndikimit. Gjithashtu sipas Kiçmarit duhet të punohet edhe me diasporën tonë në Rumani pasi ka shumë rrethe në nivel intelektualësh anëtarë të kësaj diaspore që do të mund të japin kontribut (Kiçmari, 2021). Të njëjtin rekomandim që të shfrytëzohet diaspora jonë e ka dhënë vite më parë edhe George-

Vadim Tiugea, duke theksuar që pakica e rëndësishme shqiptare në Rumani nga të cilët madje ka një përfaqësues në Parlament por edhe shkëmbimet studentore duhet të shfrytëzohen më mirë (Tiugea, 2011).

### **3.3 Raporti Kosovë me rajonet e tjera gjeografike**

#### **3.3.1 Evropa Lindore**

Evropa Lindore, në të cilën gravitojnë shtetet që kanë qenë ish-Republika Socialiste Sovjetike, është një rajon gjeografik në të cilin Kosova ka mungesë të konsideruar të qasjes, gjegjësisht mungesë të njohjeve nga shtetet e atij rajoni. Këto shtete kanë arsye të përbashkëta për një qëndrim të tillë ndaj Kosovës, por edhe veçori specifike, që bëjnë që ashpërsia e tyre në raport me kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës të dallojë. Andaj, qasja e institucioneve të Kosovës duhet të jetë e kujdesshme në raport me këto shtete.

Kreshnik Ahmeti, tani zv. ministër i MPJD-së, që kishte shërbyer edhe si shef i kabinetit të kryediplomatit Glauk Konjufca, kishte deklaruar se Ministria e Jashtme e Kosovës duhet të investojë më shumë në raportet me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, por edhe me Azerbejxhanin, Turkmenistanin, Armeninë dhe Kazakistanin (Ahmeti, Intervistë, 2021).

Për t'i arritur këto por edhe njohje në rajone të tjera, Ahmeti (2021) propozon:

- Krijimin e grupeve të ekspertëve brenda MPJD-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile;
- Duke vënë në funksion shërbimin diplomatik, angazhimin ndërinstitutional, përkrahjen e shteteve mike, si dhe lobimin formal e joformal;
- Krijimin e pozitës së Përfaqësuesit Special për njohjet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Përcaktimin e përfaqësuesit të Kosovës në Nju Jork, përfshirë edhe përgjegjësitë e bashkëpunimit dhe lobimit në KB;
- Krijimin e grupit ndërkombëtar për lobim;
- Angazhimi direkt i mërgatës nëpër shtetet ku jetojnë;
- Përkrahja e gazetarëve, pjesëtarëve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të grupeve kulturore dhe të artistëve për t'i promovuar vlerat e vërteta dhe rëndësinë e njohjes së rolit të Kosovës.

- Procesi i njohjeve do të koordinohet dhe funksionalizohet nga institucionet legjitime të Kosovës dhe do të parandalohet çdo privatizim dhe manipulim i procesit.

Sa i përket **Ukrainës**, qëndrimi i saj ndaj shtetësisë së Kosovës ka ndjekur një trajektore lëvizëse. Në fillim ka përçuar sinjale që mund të marrë kohë por konsiderohet edhe mundësia e njohjes. Kjo u bë e ditur nga një kabllogram i Wikileaks që mban datën 22 shkurt 2008 ku ministri i jashtëm Ohryzko thekson se Ukraina po i shqyrton të gjitha mundësitë por që njohja mund të marrë kohë, e tutje që ai e kupton pozicionin amerikan për çështjen e Kosovës (Embassy in Kyiv, 2008). Pastaj për vite të tëra, qëndrimi i saj është betonizuar në mosnjohje të Kosovës.<sup>39</sup> Edhe ndërrimet politike që ndodhën në Ukrainë, nuk sollën ndryshim. Problemet e saja të brendshme territoriale, të cilat ende pritet të marrin kohë deri në zgjidhje, apo të mbesin si konflikte të hapura me Rusinë, e pamundësonin të shfaqet në horizont mundësinë e njohjes së Kosovës. Ukraina për më shumë, ende ka probleme të ratifikimit të kufirit me fqinjin e saj Bjellorusinë, dhe në përfundim kufizohet me rajonin *de facto* të pavarur të Transnitrisë që *de jure* i përket Moldavisë.

Pavarësisht këtyre, MPJ e Kosovës disa herë dërgoi sinjale mbështetëse drejt Ukrainës në mbështetje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës. Ishte viti 2018 kur organizoheshin zgjedhjet nga rajonet e pushtuara nga separatistët prorus në lindje të Ukrainës, MPJ doli me komunikatë në të cilën “kundërshton mbajtjen e “zgjedhjeve” më 11 nëntor, 2018 në të ashtuquajturën ‘Republikën Popullore të Donetskut dhe Luhanskut’, pasi kjo është kundër frymës dhe përmbajtjes së Marrëveshjeve të Minskut, të cilat me dispozita të veçanta e rregullojnë organizimin e zgjedhjeve lokale në atë rajon” (MFAD, 2018). Këto sinjale pozitive ndoshta ishin arsye që Ukraina nga viti 2020 ka filluar të njohë pasaportat e Kosovës. (Eurointegration). Zëvendësministri i jashtëm Vasyl Bodnar theksoi se “Ndoshta duke u nisur nga hapa kaq të vegjël, ne mund të shkojmë drejt rezultateve të prekshme” (Gazeta Express, 2020). Kjo megjithatë ishte sinjal i mirë, për arsye se më 2016, si rezultat i mospranimit të dokumenteve të udhëtimit të Kosovës, ndeshja në futboll për kualifikimet e Kupës së Botës 2018, Ukrainë-Kosovë që duhej të zhvillohej në Ukrainë, ishte zhvendosur në Poloni.

---

<sup>39</sup> Më 2010 duke krahasuar Kosovën, Abhazinë dhe Osetinë e Jugut, Presidenti Yanukovich thekson se njohja e këtyre vendeve shkel ligjin ndërkombëtar.

Sikurse shumë shtete të tjera, rrjedhën e dialogut Kosovë-Serbi dhe njohjen e Kosovës e ka ndërlidhur edhe zv. ministri ukrainas Bodnar (Gazeta Express, 2020). Gjithashtu krahasimet e bëra me Krimenë është munduar t'i mohojë, duke thënë që Kosova dhe Krimea nuk kanë asgjë të përbashkët (Joseph, Radeljic, Peci, Joja, Cingel, & Sarria, 2022, f. 59).

Kriza e madhe Ukrainë-Rusi, dhe mbështetja politike që i erdhi Ukrainës nga Kosova, me vetë deklaratën e presidentes Vjosa Osmani Sadriu, e këtë veprim miqësor të presidentes dhe të ish-ambasadores në ShBA Vlora Çitaku, e ka përshëndetur deputetja e Parlamentit të Ukrainës Iryna Friz, e cila ka bërë thirrje për njohje të Kosovës dhe vendosjes së marrëdhënieve miqësore me Prishtinën (Friz, 2022). Ndërsa ambasadori ukrainas në Tiranë, Volodymyr Shkurov, deklaroi se janë në dijeni të mbështetjes nga shqiptarët e Kosovës dhe theksoi që iu vijnë pyetje edhe nga qytetarët që kërkojnë informata se si shkohet në Ukrainë për të luftuar dhe se këto thirrje e propozime ne i transmetojmë ministrisë sonë të jashtme, pasi Ukraina ende është në fazën e studimit të njohjes së Kosovës dhe ende nuk kemi një vendim përfundimtar pasi ndërlidhet me problematikën tonë të Krimesë. Ai deklaroi se kjo nuk është në agjendën e ditës dhe mendon që do të shqyrtohet më vonë (Euronews, 2022).

Më 14 mars 2022 zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, ka zhvilluar një telefonatë me homologen e tij ukrainase, Emine Dzhaparova, ku shprehu përkrahje të pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës (MFAD, 2022). Diplomatët e Kosovës në vende të ndryshme kanë marrë pjesë në aktivitete publike në përkrahje të Ukrainës.

**Bjellorusia** është në mesin e shteteve me pozicion kokëfortë kundër pavarësisë së Kosovës. Presidenti Lukashenko në detyrë nga 1994 kishte qenë i vetmi lider botëror që kishte vizituar Beogradin në kohën e bombardimeve të NATO-s, në prill 1999. Kjo ritheksohet vazhdimisht në vizitat mjaft të shpeshta mes dy vendeve.

Në kohën para pavarësisë, Ministria e Jashtme e Bjellorusisë publikoi një deklaratë (MFA Belarus, 2008) duke thënë se “zgjidhja e statusit të Kosovës dhe Metohisë duhet të përparojë në bazë të ligjit ndërkombëtar, bazuar në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 (të vitit 1999) i cili është një dokument themelor për zgjidhjen e Kosovës që vërteton sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Serbisë, dhe bazuar në dispozitat kryesore të Kartës së KB-së dhe Aktit Përfundimtar të Helsinkit, me rolin thelbësor

të Këshillit të Sigurimit të KB-së që mbart një përgjegjësi mbizotëruese për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare".

Ngjashëm reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishin të shpejta nga institucionet e ndryshme në vend. Presidenti Lukashenko i shkroi letër mbështetëse homologut serb, reagoi Asambleja e vendit si dhe u lëshua deklaratë nga ministria e jashtme, në përmbajtje me deklaratën e ministrisë së jashtme të lartcekur (MFA Belarus, 2008). Pra, kemi një pozicion konstant linear ndaj Kosovës para dhe pas pavarësisë. Ky pozicion manifestohej edhe në forume multilaterale, madje edhe në procesin e GjND-së, Bjellorusia me ngulm mbrojti qëndrimet serbe, sidomos në argumentimin që Kosova nuk ka të drejtë për vetëvendosje të jashtme (RTS, 2009).

Në vizitën e fundit të Vuçiq në Bjellorusi në qershor 2019, e cila ndodhi një vit pas vizitës së kryeministres Brnabic, deklaroi se "duket se kam arritur të shpjegoj pozicionin e Serbisë në detaje përveç mirënjohjes së zakonshme që shpreha sepse Bjellorusia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe sepse respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë" (The President of the Republic Serbia, 2019), Lukashenko po atë vit në dhjetor e ktheu vizitën në Serbi ku Vuçiq e falënderoi që asnjëherë nuk ka ndodhur që Bjellorusia të votojë kundër Serbisë në ndonjë çështje (The President of the Republic Serbia, 2019). Presidenti Vuçiq theksoi se Lukashenko ishte shefi i vetëm i shtetit që erdhi në vendin tonë gjatë bombardimeve të NATO-s, të cilën Serbia nuk mund ta harrojë. Me atë rast ai tregoi zemrën dhe dashurinë e tij të madhe ndaj popullit serb.

Aktualisht Lukashenko është në marrëdhëniet shumë të afërt me presidentin rus, Vladimir Putin, që kur ai e ndihmoi në shuarjen e protestave opozitare. Por raportet Rusi-Bjellorusi nuk kanë qenë gjithmonë kaq të afërta siç janë tani. Këto marrëdhënie kanë pësuar luhatje duke u impaktuar nga zhvillimet rajonale, duke ndikuar edhe në orientimin e popullatës bjelloruse<sup>40</sup> (The Guardian, 2014). Megjithatë edhe në periudha kur Lukashenko është munduar që të ruajë pavarësinë e vendit dhe ka lëvizur drejt përmirësimit të raporteve me BE-në dhe ShBA-n ë, si dhe ta ndalë sa më shumë ndikimin nga Moska, qëndrimi bjellorus ndaj Kosovës nuk ka lëvizur.

---

<sup>40</sup> Në një sondazh të botuar nga Instituti për Kërkime të Pavarura Sociale dhe Ekonomike Politike (IISEPS) në dhjetor 2013, 36.4% e bjellorusëve ishin në favor të lidhjeve më të ngushta me Rusinë, kundër 44.6% në favor të BE-së. Në mars, ndërsa kriza në Ukrainë u përshkallëzua, kjo shifër u ndryshua në 51.5% në favor të integritetit të mëtejshëm me Rusinë, mbi 32.9% duke zgjedhur integrimin me BE.



Ky betonizim i qëndrimit bjellorus ndaj Kosovës, dhe pushteti i gjatë disadekadësh i Lukashenkos ka pamundësuar edhe tentativat për qasje të Kosovës ndaj këtij shteti që eventualisht të ndryshojë qëndrimi për Kosovën. Problemet e Bjellorusisë me Perëndimin, që tani janë më të theksuara se kurrë më parë, bënë që edhe Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Kreshnik Ahmetaj, të reagoj ë për arrestimin skandaloz të gazetarit bjellorus Roman Protasevich, duke e cilësuar pushtetin e Lukashenkos si diktaturë (Ahmeti, 2021).

**Moldavia** ka problem me rajonin e Transnistrisë, e cila funksionon *de facto* e pavarur nga Moldavia dhe është nën ndikimin rus. Ushtarët rusë si paqeruajtës mbetën në rajon, përkundër marrëveshjeve për largimin e tyre. Zyrtarët moldavë e kanë pranuar në përgjigjen e tyre ndaj demarshit amerikan për njohje të Kosovës se nuk e njohin pavarësinë e Kosovës për shkak të Transnistrisë (Embassy Chisinau, 2009). Transnistria dhe kisha ortodokse, mbeten si leva kryesore të Rusisë për mbajtjen e Moldavisë larg Perëndimit. Aktualisht rreziku i madh ekziston që Transnistria të lidhet territorialisht me territoret e kontrolluara nga rusët, nëse këta arrijnë ta marrin nën kontroll qarkun e Odessas në Ukrainë, një rajon me popullatë të konsiderueshme ruse.

Zyrtarë të Transnistrisë kanë bërë rëndom paralele mes rajonit të tyre dhe Kosovës. Më 2007 Kryetari parlamentar i Dniester, në Transnistri, Yevgeniy Shevchuk deklaroi se “rajoni do të kërkojë të arrijë statusin dhe kushtet që nuk duhet të jenë më keq sesa ato që komuniteti ndërkombëtar do t'i japë Kosovës” (Dujisin, 2007). Gjithashtu përderisa po zhvilloheshin konsultimet e fundit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, pas dështimit të negociatave të Trojkës në dhjetor 2007, udhëheqësi i Transnistrisë, Igor Smirnov, deklaronte se republika e tij ka më shumë arsye të jetë e pavarur se Kosova. Sipas tij “precedenti i Kosovës është një faktor i rëndësishëm, por jo i vetmi kyç. Faktorët historikë dhe juridikë, dhe vetë realiteti sugjerojnë se ne kemi më shumë të drejtë për pavarësi” (Sputnik, 2007).

Menjëherë pas pushtimit rus të Abkhasisë dhe të Osetisë së Jugut, Transnistria deklaroi njohjen e pavarësisë së tyre, e cila ngjalli reagimin e Moldavisë zyrtare të cilët deklaruan që nuk do të njohin rajonet e ndara nga Gjeorgjia pasi nuk do të ishte “faktor në stabilizimin e situatës” dhe hodhën paralele me Kosovën duke thënë se “si në rastin e njohjes së Kosovës, ky hap vetëm pakëson përgjegjësinë e palëve në kërkimin e një kompromisi” (Newsru.com, 2008).

Në një numër takimesh mes zyrtarëve moldavë dhe serbë është potencuar respekti i integritetit territorial mes dy vendeve, siç ishte rasti në vizitën e ministres së mbrojtjes moldave, znj. Marinuta, në Serbi më 2013 në takim me sekretaren e shtetit në MPJ serbe, znj. Janković (MFA Serbia, 2013), në takimin e ministrave të jashtëm Daçiq dhe Galbur në shtator 2017 dhe në takimin tjetër të tyre në tetor të atij viti në Samitin e OSBE-së (MFA Serbia), si dhe në takimet e shpeshta në margjina të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së.

**Gjeorgjia** bën pjesë në shtetet që kanë probleme në ushtrimin e kontrollit efektiv të territorit. Ajo nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe edhe para shpalljes së pavarësisë, i është ndrojtur ndikimit të Kosovës, si paralele me problemet e saja me rajonet e brendshme.

Reagimi gjeorgjian ndaj deklaratës së pavarësisë së Kosovës ishte kundërshtues nëpërmjet ministrit të jashtëm David Bakradze (Reuters, 2008). Më pas, një intervistë e cila për shkak të reagimeve u cilësua si “keqinterpretim”, kryeministri Lado Gurgenidze për një medium estonez deklaronte se pasi miqtë tanë kanë njohur Kosovën, është e natyrshme që edhe ne mund ta bëjmë një gjë të tillë (Civile.ge). Por në verën e vitit 2008 tensionet Rusi-Gjeorgji eskaluan dhe ndërhyrja ruse në Abkhazi dhe Oseti të Jugut u “përligj” me parimin R2P (Përgjegjësia për të Mbrojtur), si një parim i KB-së, i cili u zhvillua pas ndërhyrjes humanitare ndërkombëtare në Kosovë, pavarësisht që ky ishte një keqpërdorim dhe keqinterpretim i qëllimshëm i këtij parimi. Këto zhvillime e venitën një njohje eventuale gjeorgjiane.

Është evidentuar një rritje e marrëdhënieve Gjeorgji-Serbi nga viti 2017 me shkëmbim të një numri vizitash reciproke të niveleve të larta dhe një numër të marrëveshjeve. Të njohura vizitat e ndara të Brnabic dhe Daçiq më 2019. Në mars 2019, Gjeorgjia hapi konsullatën në Beograd (në mënyrë jorezidente e mbulon nga Athina). Është paralajmëruar hapja e përfaqësisë diplomatike serbe në Tbilisi, në të cilën veçse ekziston konsullata serbe.

Edhe **Armenia** ka qenë një republikë sovjetike, andaj ndikimi rus është evident. Qëndrimi i Armenisë në raport me shpalljen e pavarësisë së Kosovës ka shkuar duke u bërë më negativ. Në fillim ka pasur një qëndrim për mundësinë e njohjes kur presidenti Sargsyan deklaroi se “Armenia ka qenë gjithmonë aderuese e të drejtës së kombeve për vetëvendosje dhe në këtë aspekt ne e mirëpresim pavarësinë e Kosovës” (Asbarez, 2010). Kjo ndoshta bëhej duke shpresuar në fitimin e njohjes së Nagorno-Karabahut, por me krizat në Abhazi dhe Oseti të Jugut, pastaj në Krime, janë ngritur shumë paralele dhe është larguar mundësia e njohjes së

Kosovës, duke kërkuar që këto të njohin Nagorno-Karabahun, në mënyrë që të fitojnë njohje të Armenisë. Presidenti armen në një intervistë në mars 2008 (President of the Armenia, 2008) deklaronte se nuk mund ta njohin Kosovën pasi ende se kemi njohur as Nagorno-Karabah.

Paralelet e mundshme mes Kosovës dhe Nagorno-Karabah, u mundua t'i ngritë edhe lideri i këtij të fundit menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, ku ministri i jashtëm i tyre deklaronte se shpallja e pavarësisë së Kosovës mund të çojë në njohje ndërkombëtare edhe për Nagorno-Karabah (Reuters, 2008). Ngjashëm deklaroin edhe zyrtarët armenë pas vendimit të GjND-së duke shpresuar që kjo mund të vlejë edhe për Nagorno-Karabah (RFERL, 2010).

Në një takim në maj 2009 midis ministrit të jashtëm kosovar, Skënder Hyseni, dhe homologut Armen Martirosyan, i cili ishte përfaqësues i Armenisë në KB, z. Martirosyan raportoi se premtoi që kërkesa për njohje do t'i dërgohej qeverisë së tij. Edhe më 2010 ministri i jashtëm Skender Hyseni u takua në Nju Jork me homologun armen Edward Nalbandian të cilit i kërkoj njohjen e Kosovës duke u thirrur në vendimin e GjND-së që ishte i freskët (Asbarez, 2010).

**Azerbajxhani** për dallim nga fqinji i saj Armenia, ka mbajtur një qëndrim anti-Kosovë që nga fillimi. Kjo për shkak të mosparalelizimit me Nagorno-Karabahun të cilën nuk e kontrolloi efektivisht për dekada të tëra.

Kontaktet me Azerbajxhanin janë kryesisht joformale apo në nivele të ulëta. P.sh. me datën 15 janar 2020, me rastin e 100 vjetorit të lindjes së skenaristit dhe regjisorit azerbajxhanas, z. Hasan Seyidbeyli, Ambasada e Republikës së Azerbajxhanit në Ankara dhe organizata ndërkombëtare kulturore Túrksöy, bashkëorganizuan eventin ku nga Ambasada e Republikës së Kosovës kishte pjesëmarrje. Një ndikim turk si shtet aleat themelor i Azerbajxhanit dhe kalim i një periudhe nga zgjidhja për Nagorno-Karabah, eventualisht do të mund të shpinte në një ndryshim qëndrimi të Azerbajxhanit kundruall Kosovës.

**Kazakistani** është një vend, i cili gjeografikisht më shumë i përket Azisë Qendrore se Evropës, një ish-republikë në kuadër të BRSS-së, ku 21.5% e popullatës deklarohen si rusë. Ajo mundohet të ndjekë një politikë të jashtme “shumëvektorësh” apo marrëdhënie të mira me ShBA-në, Rusinë dhe Kinën, por influenca financiare kineze dhe politike ruse është evidente.

Megjithatë ashtu sikurse ish-republikat e tjera të BRSS-së edhe Kazakistani nuk njeh Kosovën. Kryeministri kazak, Karim Masimov, në dhjetor 2008 dha deklaratë kundër njohjes së Kosovës: “Ne kemi një qëndrim zyrtar. Kazakistani nuk e ka njohur Kosovën dhe nuk e njeh Abkhazinë dhe Osetinë e Jugut. Ne besojmë se kufijtë janë përcaktuar dhe Kazakistani nuk do të njohë shtete të reja" tha Masimov.” (Polit.ru).

Marrëdhëniet kanë qenë të rralla mes Kosovës dhe Kazakistanit. Ato kanë ndodhur më shumë në margjina të samiteve ndërkombëtare. Kryediplomati Pacolli në maj 2018 në Daka, kryeqytetin e Bangladeshit, në kuadër të Konferencës së 45-të të ministrave të jashtëm të vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik ndër të tjerash u takua edhe me homologun kazak (MFAD, 2018). Në dhjetor 2021 ish-presidenti i Kazakistanit, Nursultan Nazarbayev, duke theksuar mbi mosnjohjen e Krimesë si pjesë të Rusisë, theksoi se nuk e kanë bërë sikurse nuk kanë njohur as Osetinë, Abhazinë apo Kosovën, e cila po kërkon njohje (KazTAG, 2021).

Të gjitha këto shtete ish-sovjetike (Bjellorusi, Moldavi, Ukrainë, Kazakistan, Armeni, Azerbajxhan dhe Gjeorgji), pavarësisht që disa mbajnë marrëdhënie të balancuar mes ShBA-së dhe Rusisë, apo janë më afër njërës fuqi politike, në mënyrë uniforme nuk njohin pavarësinë e Kosovës.

Arsyet janë të ndryshme, por kryesisht problemet e brendshme territoriale (Azerbajxhan, Armeni, Ukrainë, Gjeorgji, Moldavi), apo sistemi politik jodemokratik dhe influenca e madhe ruse (Bjellorusi) dhe asaj ruso-kineze (Kazakistan).

Fatkeqësisht, disa nga këto shtete janë në grupin që qëndrimi i tyre ndaj Kosovës, nga viti 2008 e tutje ka ndjekur një trajektore negative, ku në fillim kanë qenë më neutrale dhe kanë konsideruar njohjen, por zhvillimet e mëtutjeshme kanë bërë efekt negativ (Ukrainë, Armeni), edhe pse siç analizuam më lart në Ukrainë kanë filluar sinjale pozitive.

Po ashtu vërehet një ngritje e vizitave zyrtare mes zyrtarëve të Serbisë dhe këtyre vendeve nga vitet 2015-2016, e cila ka dhënë efektin e tyre në qëndrimin ndaj Kosovës dhe manifestimin e saj në përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Numri i marrëveshjeve bilaterale që këto shtete kanë në raport me shtetet e rajonit tonë, është në ngritje, ndërsa aty ku kanë munguar deri më tani, janë hedhur hapat e para për arritjet e tyre, nëpërmjet konsultimeve politike që janë shpeshtuar në agjendë. Andaj,

përkundër asaj që këto shtete, në sistemin ndërkombëtar dhe në bazë të parametrave hyjnë në grupin e shteteve të vogla, veçori të cilat i kanë edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, tendenca e ngritjes së marrëdhënieve mes tyre, përkundër dhe distancës gjeografike, paraqet sinjal që edhe Kosova duhet të veprojë në këtë drejtim, me kujdes të shtuar dhe qasje të veçantë varësisht nga specifikat se me cilin shtet kemi synim, përkundër vështirësive që Kosova has, sidomos në qasje dhe vendosje të kontakteve me këto shtete.

Megjithatë, duke qenë shtete në një rajon me ndikim të madh rus, me popullatë ruse në territoret e tyre, me konflikte të brendshme të cilat për dekada kanë qenë të ngrira por që janë “nxehur” shumë viteve të fundit si rezultat i lëvizjeve të mëdha gjeopolitike duke rikrijuar përplasje që kanë vënë në lëvizje edhe shtete të mëdha, e vë në vështirësi një ndikim më të madh të mundshëm të Kosovës. Por edhe pse në shikim të parë duket më vështirë kur këto kriza kthehen në agjenda të politikës ndërkombëtare, në raste të caktuara kjo mund të vë në lëvizje edhe ndryshime indirekte në raportet e tyre me Kosovën. Shembulli i disa sinjaleve pozitive nga Ukraina demonstroi këtë gjë. Pra, jo domosdoshmërisht ky ndryshim determinohet nga veprimi i Kosovës (edhe pse edhe mund ta ndikojë këtë) por më shumë si rezultat i rirreshtimeve gjeopolitike.

### **3.3.2 Afrika**

Deri më tani nga 54 shtete në kontinentin afrikan, janë 29 shtete që kanë deklaruar njohjen e Kosovës sipas listës së MPJ-së. Shteti i parë afrikan që njohu pavarësinë e Kosovës ishte Senegali më 18 shkurt 2008. Historia prapa kësaj njohje është interesante. Pavarësia u shpall të dielën më 17 shkurt, ndërsa të hënën në vizitë zyrtare në Ankara qëndronte ministri i jashtëm senegalez. Në takim me kryeministrin Erdogan, pyetet se keni dëgjuar që tani është një shtet i ri, Kosova e cila ka shpallur pavarësinë, dhe cili është qëndrimi juaj për këtë zhvillim? Kryediplomati senegalez ishte i njoftuar për aktin e shpalljes së pavarësisë por thekson se vendi i tij nuk ka marrë ndonjë qëndrim. Aty nga ana e kryeministrit turk i kërkohet njohja e Kosovës ku i vihet në dispozicion dhe një telefon satelitor dhe kryediplomatik senegalez kontakton presidentin e tij dhe pas dakordimit, shpall njohjen e Kosovës. Kjo u evidentua në listën e njohjeve të Kosovës edhe pse nota zyrtare mungoi, deri më 2014 kur u vendosën marrëdhëniet diplomatike (Brajshori, 2021).

Në kapitullin e kaluar përmendëm një numër shtetesh nga Afrika që kishin qenë cak i fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjes së Kosovës dhe betejës demantuese pastaj nga ana e Kosovës. Krahas këtyre, më herët ka pasur njohje të supozuar nga ky kontinent, që janë mohuar dhe natyrshëm nuk figurojnë në listën e shteteve njohëse. Ashtu siç deklaroi Chen se ky është një fenomen i rrallë i njohjes së paautorizuar por i njohur në praktikën ndërkombëtare (Chen, 1951, f. 262). Në rastin e mohimeve të njohjes ndaj Kosovës është rasti i Ugandas e cila kishte dhënë sinjale që janë duke shqyrtuar njohjen edhe më herët, prandaj në notën e dërguar nga presidenti i shtetit drejtuar zv. kryeministrit Pacolli theksohet se “ne jemi prapa vendeve të tjera që kanë njohur Republikës e Kosovës”. Mirëpo kjo u mohua nga ministri i jashtëm i tyre, Oryem Henry Okello, në takim me homologun serb Vuk Jeremiq (Tanjug, 2012). Rast i ngjashëm kishte ndodhur me Nigerinë, kur Pacolli kishte njoftuar njohjen nga ky shtet, e cila më pastaj u mohua dhe sot nuk figuron në listën e njohjeve. Madje nga zyrtari i MPJ-së nigeriane u spekulua që Nigeria do të hapë një zyre tregtare në Kosovë (NAN, 2011)<sup>41</sup> (Okeke, 2011). Pra, krahas shteteve që kanë tërhequr njohjen apo rikthyer më pastaj dhe janë në grupin e njohjeve të kontestuara nga Serbia, për këto dy shtete Ugandan dhe Nigerinë, nuk ka për momentin pretendime nga Kosova që janë në grupin e shteteve njohëse. Pra, këto janë vitet kur në lobimin për njohje nga ana e Kosovës kishte një lloj dublifikimi në mes të ministrisë së punëve të jashtme, udhëhequr nga Enver Hoxhaj dhe zv. kryeministrit Behxhet Pacolli, i cili ishte i fokusuar shumë sidomos në Afrikë.

### 3.3.3 Azia

Në kontinentin e Azisë, njohjen e Kosovës e kanë deklaruar gjithsejt 20 shtete nga 49,<sup>42</sup> ku njohje me peshë të madhe ka qenë njohja nga Japonia më 8 mars 2008. Sipas Brajshorit, Japonia e ka shtyrë njohjen e Kosovës për shkak të Kanadasë e cila i druhej problemeve të brendshme me rajonin e Kebekut. Ndërsa u prit që të bëhej njohja e përbashkët në mënyrë që të përmbillet njohja nga vendet e G7 (Brajshori, 2021). Gjithashtu me peshë ishte edhe

---

<sup>41</sup> Ndërsa ministri i jashtëm nigerian Abuja të nesërmen i mohoi këto spekulime nga zyrtari i tij, dhe theksoi që Kosova është ajo që po bën presion që të hapë zyrë ekonomike në Nigeri dhe që ka interesim për investime.

<sup>42</sup> Në këtë shifër janë përfshirë edhe shtete me territore edhe në kontinente të tjera: Turqia, Qipro, Rusia, Gjeorgjia, Azerbajxhani, Kazakistani.

njohja nga Korea e Jugut që Kosovës i vjen në fund të marsit 2008 por nuk arrihen të vendosen marrëdhëniet diplomatike.

Në Azi njohja nga Malajzia shënon njohjen e parë të kontestuar (Brajshori, 2021). Malajzia ka pasur një zyrë ndërlidhëse në Kosovë edhe para pavarësisë. Kur ndodhi shpallja e pavarësisë, Malajzia lëshon një komunikatë më 18 shkurt ku uron popullin e Kosovës dhe mirëpret shpalljen e pavarësisë, por nuk përmendet decidivisht njohja (KUNA, 2008). Shefi i zyrës së tyre në Prishtinë e merr këtë deklaram dhe e dorëzon te presidenti Sejdiu dhe shpallet njohja e Malajzisë. Në mars erdhi demantimi nga Malajzia, pra është njohja e parë diskutabile. Pason vizita e Jeremiq në Malajzi (MFA Malaysia, 2008) ku kërkon që të përmbahen nga njohja. Malajzia vazhdon të luajë rol konstruktiv dhe njeh Kosovën më 30 tetor 2008, e cila ishte njohje mjaft me peshë, pasi ndodhi pas shkuarjes së rastit në GjND. Shikuar nga ky aspekt, njohja ndodhi në një moment më të përshtatshëm për Kosovën, sesa të ndodhte në fluksin e madh të njohjeve të para.

Singapori është shtet i zhvilluar ekonomikisht në atë rajon por me një qasje të kujdeshme në politikën e jashtme. Prandaj është dashur shumë investim sistematik diplomatik deri në njohje më 2016. Brajshori thekson se Singapori nuk njihete as pasaportat e Kosovës, dhe me njohje të pasaportave do të nënkuptonte njohjen e Kosovës sipas praktikës së tyre. Ministrat e jashtëm mbajnë takim jopublik në KB dhe dakordohet njohja, megjithatë nuk shpallet deri në dhjetor për shkak që të tejkalohet vizita në Singapor e ministrit të jashtëm kinez që ishte paraparë për nëntor (Brajshori, 2021).

Një shtet i madh në Azinë Juglindore është Indonezia, që është shteti me numrin më të madh të popullsisë të konfesionit mysliman në botë, por e cila deri më tani nuk ka njohur pavarësinë e Kosovës. Sipas Ambasadorit Kiçmari, ka pasur përpjekje për të thyer akullin me këtë shtet dhe eventualisht për të lëvizur drejt njohjes. Si ambasador në Australi kishte vizituar dy herë Indonezinë duke realizuar takime në nivele të mira, por sipas informatave në atë fazë Indonezia kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Rusinë në fushën e armatimit dhe duket që ka pasur ndërhyrje ruse për të stopuar njohjen e Kosovës (Kiçmari, Intervistë, 2021). Edhe Ukelli përmend tentimet pa sukses nëpërmjet Japonisë për të thyer akullin e komunikimit me Indonezinë (Ukelli, 2021). Gjithashtu Indonezia është raportuar që ka qenë shtet me qasje problematike ndaj Kosovës edhe në kuadër të Organizatës për Bashkëpunim Islamik.

Timori Lindor kishte njohur pavarësinë e Kosovës më 2012. Megjithatë nuk ishin vendosur marrëdhënie diplomatike. Shembulli i menaxhimit të Timorit Lindor për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike është simptomatik dhe ilustrativ për të kuptuar se si është një model i ndjekur nga shtetet që në njërin anë duan të njohin Kosovën dhe të kenë marrëdhënie diplomatike, por në anën tjetër janë të kujdesshëm për ruajtjen e marrëdhënieve me Serbinë, duke mos dashur t'i acarojnë ato. Dhe këtë e manifestojnë në mënyra të ndryshme, shembull duke pritur marrëveshje Kosovë-Serbi (siç duket që po bën Koreja e Jugut). Pati raportime që Timori Lindor tentoi të lidhë marrëdhëniet diplomatike me Serbinë dhe me Kosovën në ditën e njëjtë, për t'u ikur keqkuptimeve dhe presionit diplomatik nga Serbia apo aleatët e saj, megjithatë kjo nuk ndodhi siç duket për çështje teknike. Përderisa me Serbinë u vendosën marrëdhëniet diplomatike në dhjetor 2021, me Kosovën u realizua më 9 mars 2022 në Nju Jork në ambientet e Misionit Permanent të Republikës Demokratike të Timorit Lindor në KB (MFAD, 2022).

Në anën tjetër të Azisë, në gadishullin arabik, në fillim vjen njohja nga Emiratet e Bashkuara Arabe më 14 tetor 2008, ndërsa njohja e ardhur nga Arabia Saudite në prill 2009 i hap rrugë një vale njohjesh nga ai regjion me Bahrejnin dhe Jordaninë.

Njohja e fundit në Azi ishte nga Bangladeshi, me të cilën është dashur një qasje e ngadalshme hap pas hapi, mjaft e gjatë deri sa të merret vendimi i tyre për njohje të Kosovës. Ndikimi i shteteve mosnjohëse në këtë vend nuk është për t'u injoruar. Njohja erdhi në shkurt 2017, e që tani më Kosova ka dhe ambasadën funksionale në këtë vend, që është e vetmja në atë pjesë të Azisë, pasi rrethohet nga shtete mosnjohëse si India, Kina, Mjanmari etj.

Kina dhe India si dy shtetet më të mëdha të kontinentit (abstrahuar Rusinë me shtrirje Euro-Aziate) nuk e njohin Kosovën, si shtete që i druhen separatizmave të brendshme, por edhe rivalitetit gjeopolitik që është i theksuar në raportet kinezo-amerikane. Në këtë sens, mbyllja e ambasadës shqiptare në Nju Dehli nuk është që ka ndihmuar çështjen e Kosovës. Ndërsa Hoxhaj (2016, f. 381) konfirmon që me Kinën ka pasur përherë kanale komunikimi por jo sa për të ndryshuar qasjen e tyre, madje Kosova ka mbështetur aplikimin kinez për anëtarësim në BERZh.

Në Australi-Paqësor në një periudhë u arrit të rrumbullaksohet njohja nga gjitha 14 shtetet e këtij rajoni. Madje Kosova lidhi marrëdhënie diplomatike edhe me Niue dhe Ishujt Kuk (Cook



Islands) të cilat nuk janë anëtare të KB-së. Arsyeja e fokusit të Kosovës në këto dy vende ishte për shkak që ato ishin anëtare të Agjencisë së specializuar të KB-së ku Kosovës i duhej vota, pra ishin anëtare në UNESCO.

Për fatin e keq të Kosovës, pasi u arrit të përmbillet njohja nga tërë ky rajon i largët gjeografik, filloi influenca e madhe ruso-kineze në rajon dhe fushata e trajtuar e tërheqjes së njohjeve përfshiu edhe këtë pjesë me disa nga shtetet që së paku u shndërruan në njohje të kontestuara për një kohë si Palau, Papa Guinea e Re, Vanuatu apo dhe Ishujt Solomon.

### **3.3.4 Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut**

Në Amerikë, nga veriu në jug situata ndryshon. Përderisa në Amerikën e Veriut, ShBA-ja dhe Kanadaja njohin Kosovën, Meksika është shteti më i madh i kësaj pjese që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Pjesë e këtij kontinenti janë edhe shtetet e regjionit të Karaibeve, ku nga 13 shtete, 8 e kanë njohur Kosovën. Nga lista që nuk njohin Kosovën, Xhamajka është rast për t'u potencuar për shkak të raportimeve më 2020 që ajo e njohu Kosovën, lajm i cili mori hov, por që shumë shpejt u demantua nga kryediplomatja xhamajkase Kamina Johnson-Smith (Smith, 2020). Ky lajm dhe demantim që u bë, shkaktoi stuhitë politike në Kosovë, për shkak të moskordinimit ndërinstitucional dhe brenda MPJ-së, mes MPJ-së, ambasadës në Uashington dhe Presidencës së Kosovës. Kjo anomali duhet evituar për shkak të pasojave dhe sinjaleve të joseriozitetit që dërgojmë te shtetet përkatëse. Nga rrjedhja e dokumenteve të Wikileaks, mësojmë se edhe Trinidad dhe Tobago ka shqyrtuar njohjen e Kosovës si rezultat i lobimit amerikan, (PGOV, 2008) por që asnjëherë nuk arriti në stadin e njohjes formale.

Në Amerikën e Jugut (Sanchez & Bullard, 2013), Kosova ka marrë njohjet nga Kolumbia, Guajana, Peru<sup>43</sup> dhe Surinami nga 13 shtete të kontinentin. Ndërsa Panama është shtet transkontinental e mund të merret edhe si shtet i këtij kontinenti. Dy shtetet më të mëdha të kontinentit Brazili<sup>44</sup> dhe Argjentina<sup>45</sup> (Clarín.com, 2008) deri më tani janë treguar

---

<sup>43</sup> Njohja e hershme nga Perua në shkurt 2008 erdhi edhe si rezultat i njohjes së rrethanave nga ana e tyre me çështjen e Kosovës. Peru kishte qenë anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit në kohën e negociatave, ku Ekipi i Unitetit takohen me ta, po ashtu edhe Ahtisaari dhe ata binden për njohje (Muhamet Brajshori, intervistë, dhjetor 2021).

<sup>44</sup> Brazili që nga viti 2009 është anëtare e BRISC-së, së bashku me Rusinë, Indinë, Kinën dhe Afrikën e Jugut. Të gjitha shtete jonjohëse të pavarësisë së Kosovës, kurse të gjitha njohëse të Palestinës. Njohja e Kosovës nga Izraeli nëpërmjet ndikimit të presidentit Trump, është parë si mundësi që ka mundur të shfrytëzohet për të

kundërshtare të pavarësisë. Ngjashëm edhe Kili që ka preferuar se nuk mund të jetë udhëheqëse e atij rajonit në njohjen e Kosovës, duke ia lënë këtë rol eventualisht Brazilit (Embassy Santiago, 2008). Shteti i Venezuelës, i cili nën udhëheqjen e Hugo Chavez ka qenë kundër Kosovës që nga koha e bombardimeve të NATO-s, e natyrshëm ka vazhduar kundërshtitë edhe pas shpalljes së pavarësisë, Kosova iu është qasur në vitin 2019 kur në trazirat politike në këtë vend, ka njohur si president legjitim Juan Guaidó (Pacoli, 2019). Megjithatë që nga ajo kohë, përkundër vazhdimit të krizës, Maduro ka fituar terren ndaj Guaidó dhe nëse mbetet pushteti i tij, atëherë gjasat për njohje të Kosovës janë minimale. Kosova që nga 2008 pak ka pasur interaksion me këto shtete. Vizita e Presidentes Osmani më 2022 në rajonin e Amerikës Qendrore është një përjashtim i mirë.

### **3.4 Shtrirja e aparatit diplomatik të Kosovës**

Që pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe themelimit të MPJ-së, u shtrua nevoja e themelimit të misioneve diplomatike të Kosovës. Rrjeti i ambasadave dhe konsullatave të Kosovës përherë është determinuar nga njohjet ndërkombëtare. Trendi është i kuptueshëm që në gjeografitë nga ku njohjet janë më të shumta, edhe rrjeti diplomatiko-konsullor është me prezencë më të ngjeshur. Në anën tjetër në gjeografi, sidomos ato të largëta e nga ku Kosovën e njohin më pak shtete, edhe shtrirja e rrjetit diplomatiko-konsullor është me peripeci të shumta dhe mungesë të madhe. Pra, shtrirja diplomatike e Kosovës, nuk është e varur vetëm nga aspekti organizativ, financiar por edhe nga rrethanat objektive politike të pamundësisë së shtrirjes.

Ashtu siç i kemi analizuar më parë (Haxhimehmeti, 2020) për shtetet e vogla në këtë rast edhe Kosovës, prezenca diplomatike varet nga faktorë të ndryshëm, por rëndom shtetet e vogla nëpërmjet strategjive që hartojnë në kuadër të Ministrive të Punëve të Jashtme, i vendosin përfaqësitë diplomatike së pari në rajonin ku ata gravitojnë, pra në shtetet fqinje, tutje në shtetet e mëdha dhe me peshë në politikën dhe ekonominë globale, por edhe në fuqi rajonale (shembull në Afrikën e Jugut për Afrikën Subsahariane, në Egjipt për Afrikën Veriore, eventualisht edhe në Nigeri). Gjithashtu fokus i kushtohet edhe shteteve ku ka prezencë të mërgatës. Të rëndësishme së posaçme janë misionet pranë organizatave

---

shtyrë përpara njohjen nga Brazili në të njëjtën mënyrë, për shkak të marrëdhënieve të shkëlqyera që presidenti Trump kishte me presidentin Bolsonaro të Brazilit.

<sup>45</sup> Raportimet sugjerorin se Argjentina nuk njeh Kosovën për shkak të ishujve Falkland.

ndërkombëtare, që për Kosovën për shkak të specifikave të mosnjohjes nga organizatat ndërkombëtare këto misione janë joformalisht “misione pranë organizatave ndërkombëtare” që zyrtarisht e zakonisht janë Konsullata të Përgjithshme (Nju Jork, Gjenevë, Strasburg).

Nga gjithsej 33 ambasada, Kosova prezencën më të madhe diplomatike e ka në kontinentin e Evropës, veçanërisht në Perëndim, pasi duke u zhvendosur gjeografikisht në lindje, janë shtetet mosnjohëse e në të cilat ka mungesë të misioneve të Kosovës. Është cekur më herët “Kopromisi Kaczynski” me të cilin Polonia njeh Kosovën por nuk vendos marrëdhënie diplomatike. Që nga atëherë janë bërë përpjekje të vazhdueshme të tejkalohet kjo dhe pasi Kosova është seriozisht e interesuar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Poloninë dhe që të hapë misionin e vet në këtë shtet. Mbulimi jozyrtar nga Praga në rrethana të tashme i paevitueshëm, por për shkak të rëndësisë së shtetit, duhet investuar në themelimin e ambasadës në Poloni, e cila do të ishte hapje e Kosovës drejt vendeve së Evropës Lindore.

Ambasada e fundit e hapur në Evropë është në Portugali. Portugalia ka qenë shteti i fundit i BE-së, pa pasur probleme të brendshme separatiste që njeh Kosovën.

Amerika e Jugut është një rajon me specifika, ndikimi spanjoll në këto shtete, marrëdhëniet e luhatshme me ShBA-të, pastaj devocioni i tyre ndaj së drejtës ndërkombëtare por edhe distanca gjeografike janë disa prej arsyeve që kanë mundur të çojnë në mungesën serioze të njohjeve. Situata rëndohet pasi dy shtetet më të mëdha Brazili (Hoxhaj, 2016, f. 373)<sup>46</sup> dhe Argjentina deri më tani kanë kundërshtuar dhe aktivisht pavarësinë e Kosovës. Ambasada e Kosovës në Panama e hapur më 2013 është e vetmja në rajon por që e ka vështirë mbulimin e një gjeografie të madhe. Nga Panama, Ambasada e Kosovës është e akredituar edhe për Kosta Rika, Honduras, El Salvador, St. Kitts dhe Nevis, St. Lucia, Guajana, Barbados, Grenada, Domenikë dhe Belize. Është raportuar në media që Kosova do të hapë ambasadë në Kolumbi, në mënyrë që ta zgjerojë prezencën në Amerikën e Jugut, por deri më tani ky mision nuk është arritur të jetësohet.

Në kontinentin e madh të Azisë, nëse abstrahojmë rajonin e gadishullit arabik i cili është mirë i mbuluar me ambasadat në Arabi Saudite, Katar dhe Emirate të Bashkuara Arabe,

---

<sup>46</sup> Hoxhaj mendon që duhet përpjekur për t'i sqaruar Brazilit se njohja e Kosovës është në përputhje me doktrinën e promovuar nga Brazili për përgjegjësinë gjatë ndërhyrjes globale.

Kosova për një kohë të gjatë ka funksionuar vetëm me ambasadën në Japoni, qartazi e pamjaftueshme për mbulimin e tërë kontinentit. Hapjet e ambasadave në Tajlandë dhe Bangladesh e kanë zbutur disi situatën duke krijuar një prezencë të Kosovës në atë rajon. Përherë problematike ka qenë mosthemelimi i marrëdhënieve diplomatike dhe misionit diplomatik me Korenë e Jugut. Siç transmeton ambasadori Brajshori (2021) i cili sa ka qenë në detyrë në Tajlandë, ka zhvilluar një takim me ambasadorin korean që kishte qenë drejtor për Evropë në MPJ koreane në kohën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Sipas tij, kur ka mosmarrëveshje apo konteste mes shteteve si në rastin Kosovë-Serbi, është politikë e tyre parimore që nuk vendosin marrëdhënie diplomatike. Bazuar në këtë princip, Korea ngjashëm kishte vepruar edhe me Maqedoninë, të cilën e ka njohur në vitet '90, por që marrëdhëniet diplomatike i kanë lidhur në vitin 2019, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespes mes Maqedonisë me Greqinë. Prandaj është në kuadër të pritshmërive dhe skenarëve realist që Kosova nuk do të vendosë marrëdhënie diplomatike me Korenë e Jugut deri në një marrëveshje Kosovë-Serbi. Kësaj i shtohet fakti që Jugosllavia kishte qenë përkrahëse e Koresë së Jugut në konfliktin korean në vitet 50-ta. Megjithatë diplomatët nga Tokio kanë mbuluar këtë shtet me peshë ekonomike në rajon dhe kanë pasur dhe vizita për të shtyrë përpara çështjet, sidomos të mundësive të thellimit të marrëdhënieve si dhe të votimeve për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kjo është bërë për shkak të rrethanave të shpjeguara, pasi rëndom nuk është e udhës që misioni në Tokio të mbulojë Seul, për shkak edhe të rivaliteteve për influencë mes tyre. Ndërsa pjesa e Paqësorit konsiderohet mirë e mbuluar, nëpërmjet ambasadës në Australi, dhe akreditimeve jorezidente në Zelandën e Re<sup>47</sup>, Vanuatu, Samoa, Fixhi, Nauru dhe Ishujt Kuk. Gjithashtu ambasada në Tokio është e akredituar edhe për Ishujt Marshall, Mikronezinë, Tuvalun dhe Palaun. Pavarësisht kësaj, për shkak të aktivitetit diplomatik-financiar kinez, nga i cili tenton të korrë përfitime Serbia në raport me Kosovën, duhet të jemi të vëmendshëm edhe për atë rajon.

---

<sup>47</sup> Jo secila njohje në dukje e lehtë, ishte e tillë. Për të argumentuar ndryshimin e pozicioneve të shteteve në raport me njohjen e shteteve të reja, këtë e kanë bërë edhe shtetet të cilat janë tejet të kujdesshme në respektimin e së drejtës ndërkombëtare, siç është Zelanda e Re. Duke ndjekur deklaratën e pavarësisë së Kosovës, kryeministrja e Zelandës së Re, Helen Clark, lëshoi deklaratën vijuese: "Nuk ka qenë kurrë pozicioni i Qeverisë së Zelandës së Re të njohë në rrethana të tilla. Nuk do të njohë. Me kalimin e kohës, çështja me të cilën merret me ata që qeverisin në territorin, supozoj se nënkupton nëse ka njohje, por nuk kemi ndërmend të bëjmë një deklaratë zyrtare." Sidoqoftë, në nëntor 2009, Zelanda e Re njoftoi përfundimisht se e kishte njohur zyrtarisht Kosovën.

Kosova në Afrikë e ka mjaft të limituar shtrirjen e shërbimit diplomatik. Ambasada e vetme funksionale në Senegal dhe stafi i vogël (aktualisht vetëm 1 diplomat e pa ambasador) është i pamjaftueshëm për mbulimin e tërë Afrikës. Kosova në të kaluarën ka mbajtur dhe zyrën në Egjipt, por që tani më nuk është funksionale. Vazhdimisht është trumbetuar që synohet zgjerimi i prezencës në Afrikë, madje janë përmendur dhe Gana e Tanzania si shtete ku do të hapeshin misionet e reja diplomatike, gjë e cila do të shënonte zgjerimin e prezencës në Afrikën NënSahariane si dhe në Afrikën Lindore por deri më tani nuk ka ndodhur. Mbulueshmëria jorezidente që është në disa shtete nëpërmjet Senegalit si në Çad, Guine, Liberi, Gabon, Burkina Faso, Breg të Fildisht, Togo, Niger, Lesoto, Liberi, Ganë, e Libi është e vështirë e menaxhueshme dhe e pamjaftueshme. Me organogramin e ri të MPJD-së, është paraparë departament i veçantë për Afrikë, që mund të merret si sinjal i rritjes së vëmendjes në këtë kontinent me numër të madh të shteteve, e cila paraqet rëndësi të lartë sidomos në diplomacinë multilaterale.

Për shkaqe të njohura, marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë janë specifike, rrjedhimisht edhe përfaqësimi reciprok. Hapja e “zyrës ndërlidhëse” të Kosovës në Beograd dhe të Serbisë në Prishtinë është bërë sipas një marrëveshje në Bruksel. Kjo është një praktikë ndërkombëtare, aplikuar edhe në të kaluarën, shembull në marrëdhëniet mes ShBA-ve dhe Kinës, kur nuk bëhej fjalë që të hapej një përfaqësi, pasi ShBA kishte ambasadën e saj në Tajvan që e njihte si qeveri legjitime të Kinës, por interesat për komunikim me Kinën ishin të larta. Andaj në këto raste hapet zyra ndërlidhëse e cila ka funksionin e ambasadës, me veçantinë e saj informalitetin (Berridge, 2007, f. 180).

Edhe me Bosnjën marrëdhëniet janë mjaft specifike. Bosnja nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe ndryshimi i qasjes është vështirë në rrethanat aktuale të funksionimit të sistemit politik të Bosnjës, në të cilin anëtari i Presidencës nga Republika Srpska ka të drejtën e vetos. Kjo u manifestua në dy tentimet e pasuksesshme e njëpasnjëshme në shtator dhe tetor 2020 që Presidenca e Bosnjës tentoi për të votuar njohjen e Kosovës. Krahas kësaj është tentuar për të shtyrë përpara hapjen e një zyre ndërlidhëse në Bosnjë, por as kjo nuk ka pasur sukses, pavarësisht nismës së deputetes boshnjake Duda Balje në Kuvendin e Kosovës (Balje, 2020), apo të telefonatës së kryeministrit Hoti në nëntor 2020 me anëtarin boshnjak të presidencës. Të gjitha këto bllokoheshin nga anëtari serb i presidencës, Dodik (Indeksonline, 2020).

Shtetet e Ballkanit Perëndimor<sup>48</sup> shërbejnë si një rast i mirë për t'u krahasuar me Kosovën në rrafshin e shërbimit diplomatik, sepse, përkundër traditës më të gjatë se Kosova, kanë një zhvillim të përafërt me prioritete të ngjashme dhe që të gjitha janë shtete të vogla me resurse të limituara profesionale, ekonomike e administrative.

Në lidhje me shtrirjen dhe prezencën e shërbimeve diplomatike në Evropë dhe jashtë saj, konstatojmë se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë prezencë të kënaqshme të përfaqësive rezidente, kryesisht në Evropë për shkak të peshës politike, ekonomike dhe afërsisë gjeografike. Ndërkohë, në kontinentin e Afrikës situata qëndron shumë më ndryshe, sepse shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë prezence tejet të kufizuara. Mali i Zi nuk ka fare përfaqësi diplomatike në këtë kontinent, ndërsa Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia kanë vetëm ambasadë në Egjipt. Kroacia ka katër ambasada (Egjipt, Algjeri, Maroko dhe Afrikën e Jugut), ndërsa Serbia ka plot 12 ambasada në Afrikë, që mbulojnë edhe rreth 28 shtete të tjera në mënyrë jorezidente.

Shtetet e rajonit, përfaqësimin në Amerikën e Jugut, rëndom e kanë në njërin nga dy qendrat me peshë të kontinentit. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë ambasadë në Brazil, kurse Mali i Zi në Argjentinë. Sllovenia dhe Serbia kanë prezencë në të dyja shtetet, ndërsa Kroacia përveç Argjentinës dhe Brazilit, ka ambasadën e saj në Kili, kurse Bosnja nuk ka prezencë diplomatike në rajon. Të gjitha këto shtete kanë ambasadat e tyre në ShBA dhe Kanada (përveç Bosnjës e cila është prezentë vetëm në ShBA)<sup>49</sup>.

Në Azi, ndërkaq ndryshon gjendja për sa i përket shtrirjes së misioneve diplomatike, dhe kjo për faktin e vet natyrës së kontinentit, numrit të shteteve, dhe faktorëve të tjerë socialë dhe politikë. Si rrjedhojë, shtetet e rajonit kanë numër të caktuar të ambasadave, por me një shtrirje të mirë gjeografike për të mbuluar sa më shumë kontinentin më të madh i cili mund të "interpretohet" edhe si shumësi e rajoneve mjaft të ndryshme e specifike nga njëri-tjetri (bota arabe, Azia Qendrore, Azia Lindore, Azia Juglindore etj.).

Nga shtetet e rajonit, Serbia edhe në Azi ka prezencën më të madhe me 18 ambasada rezidente, ndërsa Mali i Zi ka vetëm 3 ambasada (Kinë, Turqi dhe Emirate të Bashkuara

---

<sup>48</sup> Shqipëria ([punetejashtme.gov.al](http://punetejashtme.gov.al)), Maqedonia e Veriut ([mfa.gov.mk](http://mfa.gov.mk)), Mali i Zi ([mvp.gov.me](http://mvp.gov.me)), Serbia ([mfa.gov.rs](http://mfa.gov.rs)), Bosnja ([mvp.gov.ba](http://mvp.gov.ba)), Sllovenia ([mzz.gov.si](http://mzz.gov.si)) dhe Kroacia ([mvep.gov.hr](http://mvep.gov.hr)), qasur më 13.08.2020.

<sup>49</sup> Vlen të theksohet se Serbia, për dallim nga shtetet e tjera, ka prezencë të mirë edhe në Amerikën e Mesme, gjegjësisht në Meksikë dhe Kubë, që nuk është rasti i fqinjëve të saj.

Arabe). Maqedonia ka 7 ambasada, Shqipëria dhe Sllovenia nga 8, Kroacia 13, kurse Bosnja 14. Kurse përveç Malit të Zi, të gjitha shtetet e rajonit kanë ambasadën e tyre në shtetkontinentin e Australisë. Shqipëria në Australi e ka hapur ambasadën rishtazi, në fund të vitit 2020.

Për shkak të trashëgimisë nga Jugosllavia, të cilën është munduar nëpërmjet propagandimit ta përvetësojë Serbia kinse pasardhëse e saj, nëse bëjmë një analizë krahasuese, mund të konkludojmë se prezenca diplomatike e Serbisë në botë është shumë më e madhe se e shteteve të tjera të rajonit, përfshirë Kosovën, të cilat me përjashtim të Malit të Zi, kanë prezencë të përafërt të aparatit diplomatik në botë. Është prezente fushata dhe trysnia e madhe diplomatike serbe kundër shtetësisë së Kosovës, veçanërisht fushata e viteve të fundit në lobimin për tërheqjen e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës. Kjo fushatë është parë dhe reflektuar edhe në fitoret diplomatike të Serbisë në tentimet e pasuksesshme të Kosovës për anëtarësim në UNESCO dhe Interpol, ku nga njëri rast në tjetrin vetëm se pati rënie të votave për Kosovën, pastaj dhe tërheqje në momentin e fundit për të mos aplikuar fare siç ndodhi me rastin për Interpol në Kili në tetor 2019.<sup>50</sup>

Si rrjedhojë, Kosova pashmangmërisht duhet të rrisë prezencën e saj diplomatike në rajonet ku nuk është prezente, edhe pse ky investim ka kosto të lartë, dhe do të tejkalonte edhe prezencën diplomatike të vendeve të tjera të rajonit me kapacitete të përafërta me Kosovën, por kjo është e domosdoshme, për shkak të sfidave sui generis që i ka Kosova (njohjet ndërkombëtare dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare) në dallim me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Haxhimehmeti, 2020). Kjo pasi siç kujton Hoxhaj se ka dëgjuar mendime negative për Kosovën në këto kontinente për shkak të qëndrimit refuzues të vendeve BRISC si Afrika e Jugut, Brazili e India. Madje ka pasur edhe lobim kundër Kosovës në këso gjeografi të largëta ku Argjentina, Meksika e Indonezia kanë bllokuar njohjen e Kosovës nga disa shtete të vogla (Hoxhaj, 2016, f. 377). Ish-Ambasadori i Kosovës në Katar, thekson se Kosova duhet të hap ambasada me modelin 1+1 (ambasadori plus një diplomat) në çdo vend që mundet pasi që ndikimi serb është shumë i madh në gjeografi të largëta. Ai e ka parë të rëndësishëm prezencën e Kosovës në Katar për shtyrjen

---

<sup>50</sup> Edhe largësia e këtyre regjioneve në të cilat është i fokusuar lobimi serb e ku propaganda dhe dezinformimi i tyre penetron më lehtë është një faktor që ka ndikuar në suksesin e Serbisë në disa aspekte.

përpara të narratives së shtetit të Kosovës, por edhe lobimin për njohje nga këto shtete, në këtë rast Katari (RTI, 2020).

Mirëpo prezenca diplomatike nuk është apriori garancë për sukses. Ashtu siç sugjeron dhe rekomandon Gashi që të kthehet një praktikë e cila ka ekzistuar në të kaluarën në MPJ, duke u mbledhur në baza javore, kabineti, ministri, zv. ministrat për të bërë një brainstorming, për të bërë analizë të regjioneve me specifika të caktuara dhe strategjinë si t'iu qasemi atyre. Rrjedhimisht njëkohësisht duke rritur aktivitetin lobues në terren. Ai rekomandon ndërtimin e një strategjie edhe me ekspertë të jashtëm, bashkëpunim me institute, think tanks siç veprohet edhe në shtete të tjera, që bëhen hulumtime për qëllime të ministrive përkatëse (Gashi, 2021). Në fakt MPJD siç njofton ka riaktualizuar Grupin për Lobim për Njohje, por diplomati Brajshori është skeptik për përvojën, ekspertizën e njerëzve që janë brenda tij (Brajshori, 2021).



## KAPITULLI IV

### 4. DIPLOMACIA MULTILATERALE E KOSOVËS

Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova përveç fokusit në njohje bilaterale, vëmendje i kushtoi edhe multilateralizmit, përkatësisht të qenit anëtare e organizatave ndërkombëtare (Bayne & Woolcock, 2007, f. 30).<sup>51</sup> Si shtet i krijuar jashtë sistemit të KB-së, në kohën kur KB paraqet sistemin ndërkombëtar që është tashmë dominues për afro 8 dekada dhe merret si i mirëqenë, Kosova pati vështirësi në qasje në organizata ndërkombëtare.

Përkundër pengesave juridike e politike, kundërshtisë së madhe nga Serbia, Rusia e shtete të tjera, politika e jashtme e Kosovës ka menaxhuar që të bëhet anëtare e dhjetëra organizmave multilaterale. Këto organizata ndërkombëtare përfshijnë një gamë të gjerë veprimtarish dhe janë të rëndësive të ndryshme që nga krejt teknike e deri politike. Qasja për t'u anëtarësuar në to dhe më pas statusi i Kosovës në këto organizata varion nga njëra në tjetrën.

Ky është një proces që vazhdon edhe sot për ngritjen e statusit të Kosovës në organizata ndërkombëtare në të cilat është anëtare apo për anëtarësime të reja. Megjithatë emërues i përbashkët është që pozita ndërkombëtare e Kosovës forcohet me pjesëmarrje në diplomaci multilaterale. Rëndësia e kësaj nuk mund të mohohet, sidomos në epokën e rritjes enorme të numrit të organizatave ndërkombëtare që mbulojnë fusha nga më të ndryshmet.

Secili anëtarësim, apo tentim i pasuksesshëm për t'u bërë anëtar i një organizate ndërkombëtare është proces dhe histori e veçantë. Studimi i procesit, përgatitja, lobimi, ndihma e aleatëve, relativizimi i argumenteve të kundërshtarit, përgatitja e terrenit, dinamika e ngjarjeve ndërkombëtare (qoftë edhe vetë vendi i mbajtjes së një konference) janë ato që shpesh kanë përcaktuar suksesin apo mosesuesin nga rasti në rast. Lobimi, përllogaritjet që bëhen janë tejet dinamike dhe fluide, saqë nuk mund të merren të sigurta

---

<sup>51</sup> Pavarësisht që autorët (Bayne & Woolck, 2007) kanë bërë dallimin mes diplomacisë multilaterale dhe diplomacisë plurilaterale, ku e para është e hapur për të gjitha shtetet, ndërsa e dyta për portofolio të caktuar p.sh. anëtarët e OPEC. Në punimin tonë me multilateralizëm nënkuptojmë të gjitha format e diplomacisë shumëpalëshe: samitet, konferencat, kongreset, organazatat ndërkombëtare të të gjitha llojeve, misionet e përhershme, ato ad hoc etj.

deri në momentin e fundit final, votimit. Prandaj, beteja është e ashpër, me përdorim të mjeteve të ndryshme, shpeshherë edhe joetike e aspak diplomatike, për të arritur rezultatin e dëshiruar të anëtarësimit apo nga pala tjetër të pengimit për anëtarësim.

Në këtë trajtesë do të fokusohemi në disa raste specifike, që përfshijnë elemente të tilla të përbashkëta por edhe elemente të ndryshme nga njëra-tjetra, me rezultat të suksesit të plotë, të pjesshëm apo të dështimit, por që janë të mjaftueshme të japin një tablo të qartë se si është zhvilluar diplomacia e Kosovës në objektivin e qartë të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

#### **4.1 Kombet e Bashkuara**

Në kapitullin e parë tashmë kemi diskutuar mbi njohjen e shtetit dhe Kombet e Bashkuara. Përveç gjërave të cekura, janë dhjetëra autorë që trajtojnë këtë dimension të legalitetit shtetëror, sovranitetit, shtetësisë dhe KB-së. Për atë që është përmendur, mjafton për të ilustruar për nevojat e këtij punimi, prandaj në këtë pjesë do të fokusohemi në raportin e Kosovës me KB-në dhe mundësitë e anëtarësimit. Kjo do të bëhet duke përdorur dhe metodën e analizës krahasuese, pasi elementet nga rastet që kanë pasur sukses (Timori Lindor, Izraeli) dhe atyre që kanë dështuar (Palestina, Tajvani etj.) mund t'i shërbejnë diplomacisë së Kosovës në ndërtimin e strategjisë për qasje në KB.

Anëtarësimi në KB është një proces teknik i përmbushjes së kriterëve legale të shtetësisë dhe politik në kuptimin e “pranimit” nga shtetet ekzistuese. Sipas Kartës së KB-së, gjegjësisht Nenit 4: “Anëtarë të Kombeve të Bashkuara mund të bëhen të gjitha shtetet e tjera paqedashëse që pranojnë detyrimet e kësaj Karte dhe që, sipas gjykimit të Organizatës, janë të afta dhe të gatshme t'i përmbushin ato.” Por, është e qartë që përmbushja e kriterëve të shtetësisë dhe gatishmëria për pranimin e detyrimeve të Kartës nuk të bën me automatizëm anëtar në KB. Paragrafi i dytë i Nenit 4 e vë në rrafshin procedural praktik se si ndodh ky anëtarësim: “Pranimi i çdo shteti që i përmbush këto kushte si Anëtar i Kombeve të Bashkuara bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit.” Ndërsa procedura e votimit në Këshillin e Sigurimit sipas Nenit 27, paragrafit 3 përcakton se nevojiten 9 vota nga 15 për votime të suksesshëm në Këshill të Sigurimit, por duke përfshirë votën PRO të të gjithë pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit.

Prandaj, çështja e anëtarësimit të Kosovës në KB nuk është vetëm çështje e legalitetit në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, por është çështje e konstelacioneve gjeopolitike dhe mekanizmave anëtarësues të krijuara që pas Luftës së Dytë Botërore. Ish-ministri i jashtëm Hoxhaj theksonte se MPJ ka bërë një analizë të detajuar të skenarëve të anëtarësimit të Kosovës në KB, por që ai dokumentet mbetet konfidencë shtetërore (Hoxhaj, 2016, f. 368). Edhe pse mundësia për arritjen e 9 votave pro në KS është target i mundshëm dhe real në varësi të anëtarëve jo të përhershëm të KS të cilët ndërrohen me rotacion çdo 2 vite, por është e drejta e vetos e përcaktuar për Rusinë dhe Kinën, të cilat janë shtete që kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, është pengesa kryesore për anëtarësimin e Kosovës në KB. Kjo është pengesë edhe në rast të marrjes së një njohje formale nga Serbia.

Ky problem i pranimin të shteteve në KB, ka ekzistuar që nga fillimet e KB-së, madje si rezultat i problemeve në pranimin e shteteve relativisht të mëdha është bërë një përpjekje nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1950 për të tejkaluar këtë fuqi rekomanduese të Këshillit të Sigurimit. Por përpjekja e Asamblesë dështoi në vitin 1950, kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi se Asambleja e Përgjithshme mund të pranojë një anëtar vetëm me "rekomandim të favorshëm" nga Këshilli i Sigurimit. Përkundër kësaj (rezultati i votimit 12-2), njëri gjyqtar në këtë rast, Alvarez dha një opinion interesant por i cili nuk është që është zhvilluar më tej për t'u bërë normë pozitive. Alvarez deklaronte se "Edhe nëse pranohet se e drejta e vetos mund të ushtrohet lirisht nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit në lidhje me rekomandimin e anëtarëve të rinj, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ende nëse kjo e drejtë është abuzuar apo jo dhe, nëse përgjigja është pozitive, mund të vazhdojë me pranimin pa asnjë rekomandim nga Këshilli" (Efevwerhan, 2012, f. 107).

Nëse Këshilli i Sigurimit nuk e ka rekomanduar një kërkesë për anëtarësim ose e shtyn shqyrtimin e tij, atëherë Rregulla 137 e Asamblesë së Përgjithshme (Rregullore e Asamblesë së Përgjithshme së KB-së) parashikon që Asambleja, pas shqyrtimit të plotë të raportit të posaçëm të Këshillit të Sigurimit, mund t'ia kthejë kërkesën Këshillit, së bashku me një procesverbal të plotë të diskutimit në Kuvend, për shqyrtim dhe rekomandim të mëtejshëm. Megjithatë çdo tentim për anëtarësim në KB duhet t'i përmbushë dy kritere procedurale të patejkalueshme: REKOMANDIM nga KS dhe VENDIM nga AP.

Njëri skenar se si mund të tejkalohet kjo pengesë, e që sinjale për simpati ndaj këtij skenari ka thënë Presidenti rus është duke ndjekur një precedent të aplikuar gjatë luftës së ftohtë,

por aspak i favorizuar tani për tani sidomos nga aleatët e Kosovës, pasi Kosova cilësohet si rast sui generis. Në vitin 1955 në kohën e ndarjes politike bipolare të botës, ndodhi pranimi i 16 shteteve përnjëherë si anëtare të KB-së (Shqipëria në mesin e tyre). Kjo u arrit fal një kompromisi mes Perëndimit dhe Lindjes në Këshillin e Sigurimit që të pranojnë shtetet aleate të të dyja kampeve. Ka të ngjarë që Rusia ngjashëm pranimin e Kosovës në KB, do të mund ta ndërlidhë me pranimin e entiteteve të cilat ajo i njeh si shtete, si Abkhazia, Osetia e Jugut etj. Pra, përkundër që është e dëshmuar që Kosova është sui generis, dhe edhe në rast të arritjes së një marrëveshje me Serbinë (njohje nga Serbia), pranimi në KB është i varur nga veto ruse në KS. Në këtë linjë rezulton edhe krahasimi që Putin i bën Kosovës me Donetskun dhe Luhansk, si një matje e “opinionit” mbi gatishmërinë perëndimore të “tregtisë” me Kosovën. Megjithatë nuk mund të flitet për paralele praktike mes rastit të Kosovës dhe “pseudoshteteve” të krijuara nga ndërhyrjet ushtarake ruse. Kosova ka qenë njësi federative edhe në kuadër të Jugosllavisë, ajo ka kaluar nëpër një proces të shtypjes me elemente gjenocidale dhe pastaj duke kaluar nëpër një administrim ndërkombëtar të udhëhequr nga KB, ku në bazë të saj është rekomanduar pavarësia e mbikëqyrur për Kosovën. Krejt kundërt nga shembujt e Krimesë, apo Donetsk e Luhansk të cilat janë krijesa si rezultat i një ndërhyrje nga një shtet sovran në territorin e një shteti tjetër sovran. Po të mos ishte veto ruse në KS të KB-së, me gjasë të madhe edhe për Donetsk dhe Luhansk do të kishte vendim për “mosnjohje kolektive” nga KB, ngjashëm si me Qipron Veriore.

Edhe një abstenim kinez nuk është i garantuar për shkak që Kina është mjaft shtet rigoroz dhe i ngurtë kur vjen çështja e integritetit territorial të shtetit. Ajo ende e konsideron Tajvanin si pjesë të saj dhe është shumë e ndjeshme ndaj çështjeve si Tibeli apo Xinjangu (ujgurët). Kosova ndaj Tajvanit ndjek politikën e “një Kine” dhe i shmang të gjitha kontaktet me përfaqësues tajvanezë.

Kundërshtimi rus që i bëhet anëtarësimit të Kosovës në KB, nuk është parimor, përkundër të arsyetimeve me “ligjin ndërkombëtar” dhe aludimi i tyre para shpalljes së pavarësisë në nevojën për gjetjen e konsensusit për statusin final të Kosovës. Argumenti që duhet të përdorë Kosova është që Federata Ruse si anëtare e Këshillit të Sigurimit të KB-së dhe e Grupit të Kontaktit ka qenë pjesë e procesit që çon në pavarësinë e Kosovës dhe ka miratuar parimet e Grupit të Kontaktit i cili përmes Parimeve Udhëheqëse të Grupit të Kontaktit të nëntorit 2005 (Guiding principles of the Contact Group for a settlement of the status of

Kosovo) e ka bërë të qartë se duhet të jetë: të mos ketë kthim të Kosovës në situatën e para 1999 (në Serbi), asnjë ndarje apo ndryshim territorial të Kosovës dhe asnjë bashkim të Kosovës me ndonjë ose pjesë të një shteti tjetër, dhe që të kihet parasysh se zgjidhja ka nevojë, ndër të tjera, të jenë të pranueshme për popullin e Kosovës, duke theksuar se në qendër të problemeve qëndrojnë politikat katastrofike të së kaluarës.

Këto parime të pranuar nga vetë Rusia në një proces në korniza të KB-së, kanë rezultuar me Propozimin e Ahtisaarit i cili pastaj nuk u pranua nga ana e Ruisë. Megjithatë parimet e cekura më lart janë të dokumentuara dhe duhet të përdoren si argument nga diplomacia e Kosovës në ndërtimin e narracionit të saj lobues.

Proceduralisht në rast të arritjes së “konsensusit” mes anëtarëve me të drejtë veto të KS të KB-së dhe arritjes së votave, rekomandimi i dërguar në Asamble të Përgjithshme, sipas nenit 18 të Kartës duhet të votohet nga ana e 2/3 të shteteve të AP së KB-së. Dita e votimit në Asamble, shënohet si dita e pranimit të shtetit në KB. Njoftimi shtetit i bëhet nga ana e Sekretarit Gjeneral, të cilit i duhet dërguar aplikimi në fillim të procesit<sup>52</sup> (Rregullore e Asamblesë së Përgjithshme së KB-së).

Pra, përveç anëtarëve themelues, shumica e shteteve të tjera janë anëtare të mëvonshme të KB-së. Kjo ka ndodhur në rrethana dhe kohë të caktuara, me raste të ngjashme dhe të anëtarësuar në grupe, por edhe me raste specifike. Diplomacia e Kosovës duhet të studiojë në mënyrë të kujdesshme secilin rast, pavarësisht që në dukje mund të jetë tërësisht natyrë e ndryshme nga Kosova, por në specifika mund të ketë përfitime për diplomacinë e Kosovës.

Baliqui në analizën e tij krahasuese (Baliqui, 2020)ka marrë për bazë anëtarësimet e suksesshme të Izraelit dhe të Timorit Lindor në KB, dhe përfitimet që Kosova mund të marrë nga sukseset e shteteve respektive. Izraeli kishte pasur një dështim më 1948 për t’u anëtarësuar në KB si rezultat i hezitimit të dy anëtarëve të përhershëm të KS-së, Anglisë dhe Francës. Megjithatë diplomacia e Izraelit ishte tejet aktive në argumentimin për arritjen e paqes, barazisë dhe kredibilitetin e KB-së, prandaj dhe aplikuan prapë më 24 shkurt 1949. Ata marrëveshjen e arritur me Egjiptin e “shitën” mirë duke e paraqitur si dëshmi për përkushtimin e tyre paqedashës dhe ky ishte një mjet presioni diplomatik ndaj Anglisë dhe Francës. Kështu arritën sukses në kërkesën e tyre në KS dhe pastaj me 37 vota për, 12

---

<sup>52</sup> Rregulla 134 dhe 138 e AP-së.

kundër e 1 abstenim kaluan me margjinë të vogël por mjaftueshëm suksesshëm në AP më 11 maj 1949. Baliqi (2020) thekson se Izraeli kapitalizoi krimet e Holokaustit shumë më mirë se Kosova që bëri me krimet e Serbisë dhe arriti që të fitojë njohjen e dy superfuqive të Kohës, BRSS-së (njohu *de jure* Izraelin) dhe ShBA-së (njohu defakto Izraelin). Rasti i Timorit Lindor ka ngjashmëri me Kosovën për shkak që sikurse në Kosovë me mandatin e UNMIK-ut, edhe në Timorin Lindor u vendos një mision administrues UNTAET, por krahasuar me Kosovën, Timori Lindor shpejt u pavarësua dhe u bë anëtar i KB-së në shtator 2002. Rasti i Timorit Lindor më shumë se meritë e politikës së jashtme ishte plotësim i kriterëve formale për anëtarësim, dhe moskontestim nga ish-shteti okupues Indonezia apo nga ish shteti-koloni Portugalia.

#### **4.1.1 Modaliteti “alternativ” për një status jo të plotë në KB**

Diplomacia e Kosovës deri më tani nuk ka qenë e interesuar për të shqyrtuar mundësinë që të ketë një hyrje të Kosovës në KB, por jo të plotë. Ky skenar i shtruar në debate të ndryshme siç mendon Daku që “duhet të mendohet aplikimi për anëtarësim si shtet vëzhgues në KB” (Daku, 2019, f. 204). Ky opsion që mund të duket i favorshëm për arsye që do të rritë gjasat e Kosovës që të bëhet pjesë e diskutimeve të ndryshme në trupa të KB-së, të marrë një “status zyrtar” njohës nga ana e KB-së, por në anën tjetër kritikët e kësaj qasje janë të mendimit që veçantia e Kosovës është e tillë që nuk duhet të eksperimentojë me solucione të tilla gjysmake, pasi qëndrueshmëria e Kosovës si shtet dhe njohja e gjerë që iu është bërë, përkundër pengesës për anëtarësim të plotë në KB, e bëjnë Kosovën të denjë vetëm për një anëtarësim të plotë në të ardhmen. Çdo “zgjdhje” gjysmake, e menduar si tranzicionale/ e përkohshme, mund të komplikojë mundësinë e Kosovës për të ardhmen duke e stagnuar në një status nga i cili do ta ketë vështirë që të dalë pastaj. Edhe Hoxhaj pranon se është diskutuar ideja për aplikim për shtet vëzhgues nëse anëtarësimi i plotë stagnon pafundësisht, por që nuk preferon një zgjidhje të tillë. Ai si arsye përmend që shtetet që nuk e njohin pavarësinë do të mbesin neutralë duke theksuar që Kosova tani në një formë veçse është pjesë e KB-së, Serbia do ta përdorte si argument që Kosova nuk është shtet i plotë duke e krahasuar me Palestinën, marrja e statusit si shtet vëzhgues do ta largonte vëmendjen ndërkombëtare edhe të miqve tanë, do të shikoheshim me inferioritet

në Evropë, ndërsa për imazhin do të mund të kishte pasoja të paparashikueshme (Hoxhaj, 2016, fv. 372-373).

Mundësi të tillë për vëzhgues e ka ofruar në praktikë KB përgjatë procesit historik të saj, mundësia e cila është shfrytëzuar nga disa shtete. Kjo praktikë nuk është e përshkruar në Kartën e KB-së por, ajo ka evoluar në praktikë gjatë shumë viteve, duke filluar nga aplikimi i Zvicrës për statusin e vëzhguesit të përhershëm në vitin 1946. Shumë shtete që dikur ishin vëzhgues të KB-së, si Austria, Bangladeshi, Japonia, Zvicra dhe Vietnami, ndërkohë aplikuan dhe morën përfundimisht anëtarësimin në KB. Aktualisht ekzistojnë dy shtete vëzhguese joanëtare: Selia e Shenjtë (Vatikani), e cila fitoi statusin e vëzhguesit të përhershëm në 1964 dhe Palestina, e cila fitoi statusin e "entitetit" vëzhgues në 1964 dhe statusin e vëzhguesit "shtet joanëtar" në 2012 (Blanchfield & Browne, 2014, f. 8). Entitete vëzhguese në KB tani mbeten Urdhri Sovran Ushtarak i Maltës dhe Bashkimi Evropian të cilat nuk janë shtete sipas ligjit ndërkombëtar.

Pra, Palestina tani në kuadër të KB-së ka statusin e njëjtë me të Vatikanit. Kjo u arrit duke shmangur Këshillin e Sigurimit, në të cilin ShBA-të e kishin bërë të qartë që do të vendosnin veto në aplikimin e bërë nga ana e Palestinës. Megjithatë Asambleja e Përgjithshme me 138 vota për, 9 kundërt dhe 41 abstenime vendosi për ngritjen e statusit të Palestinës në "shtet vëzhgues joanëtar" (Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (GA/11317), 2012). Shtetet vëzhguese janë të ftuara të marrin pjesë në mbledhjet e trupave të KB-së por pa të drejtë vote. Më 2015, AP votoi një rezolutë që lejoi ngritjen e flamurëve të shteteve vëzhguese në KB pas atyre të shteteve anëtare (Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (GA/11676), 2015).

Kosova ka vënë në listë të prioriteteve të politikën e jashtme anëtarësimin në KB. Por ambasadori Kiçmari thekson se Kosova duhet ta shohë në mënyrë të relaksuar këtë proces. Sipas tij pasi Serbia i ka përcaktuar dy tema të patejkalueshme për interesin nacional të Kosovës, si shkëmbimi i territoreve apo asociacioni me kompetenca ekzekutive si nivel i tretë i pushtetit, dhe që opsion të tretë nuk ka, përveç status quos, atëherë politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë e relaksuar dhe të pret rastin për anëtarësim i cili me gjasë mund të mos vijë fare në 10 vitet e ardhshme.

Kemi rastin e Zvicrës që mos të qenit anëtar në KB nuk i ka penguar fare të funksionojë si shtet, apo që Vietnami ka pritur mjaft gjatë me konflikte që të bëhet anëtar (Kiçmari, 2021).

Edhe Murtezaj është i mendimit të ngjashëm që Kosova duhet të bëhet anëtare e KB-së në mënyrë normale sikur të gjitha shtetet, ndërsa çështja e kohës është e dorës së dytë. Kjo pasi nuk mund të rrezikosh shtetin për t'u bërë anëtar i KB-së, sepse nëse i heq atributet e shtetit, atëherë me çka do të bëhesh anëtar. Murtezaj thekson se fokusi në njohjet bilaterale dhe konsolidimi i shtetësisë (demokracia, të drejtat e njeriut, forcimi ekonomik) do të rrisin natyrshëm presionin edhe te organizatat ndërkombëtare si KB që të pranojnë Kosovën (Murtezaj, 2021).

Të qenët anëtar i KB-së, e bën një shtet më të respektueshëm dhe me subjektivitet ndërkombëtar, por sigurisht që kjo nuk është e vetëmjaftueshme dhe këtu luajnë rol të madh edhe faktorët si vetiniciativa, aftësia për të bërë koalicione brenda organizatës, aftësitë diplomatike të diplomatëve të shtetit përbrenda organizatës etj. (Haxhimehmeti, 2020, f. 141). Pasi ka shtete anëtare të KB-së, por që kanë stad të ulët zhvillimi, institucione të brishta që nuk kanë kontroll mbi territorin dhe popullsinë e shtetit, e nga të cilat nuk mund të pritet ndonjë politikë e jashtme efikase.

Konsullata e Përgjithshme e Kosovës e akredituar në Nju Jork, *de facto* kryen funksionin dhe rolin si Mision pranë KB-së ku diplomatët e akredituar, përveç ofrimit të shërbimeve konsullore, si detyrë kryesore kanë aktivitetet në KB.

#### **4.1.2 Agjencitë e specializuara të KB-së**

Përveç anëtarësimit të plotë në KB, me rëndësi të posaçme është edhe anëtarësimi në agjencitë e specializuara të cilat funksionojnë nën ombrellë të KB-së por që funksionojnë në mënyrë mjaft autonome nga njëra-tjetra në varësi të fushave me të cilat merren. Aktualisht janë 17 agjenci të specializuara.<sup>53</sup>

Të qenurit anëtar i KB-së, i jep shtetit anëtarësi në 11 agjenci të specializuara pa pasur nevojë për votim të anëtarëve të saj (ICAO, IFAD, ILO, IMO, ITU (Lepaja, 2020)<sup>54</sup>, UNIDO, UPU, WHO, WIPO, WMO dhe UNESCO) (Blanchfield & Browne, 2014, f. 8), mirëpo pasi Kosova nuk ka mundur deri më tani të bëhet pjesë e këtyre agjencive nëpërmjet çelësit të KB-së, atëherë është tentuar t'u qaset disa prej këtyre mekanizmave veç e veç. Kosova më

---

<sup>53</sup> Në literaturë mund të hasen që janë edhe 15 të tilla, pasi Banka Botërore i ka tre nënagjenci.

<sup>54</sup> Për mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit – ITU, shih studimin e Salem Lepaja.



2009 ka arritur të anëtarësohet në dy agjencitë e specializuara si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe agjencitë e Bankës Botërore. Kjo ishte një procedurë e ndjekur nga Kosova pasi për t'u bërë anëtar i Bankës Botërore, së pari duhet të jesh anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, pastaj në IDA, IFC dhe MIGA që janë parakushte për të nënshkruar Marrëveshjen me IBRD, ku pas kësaj vjen anëtarësimi në Bankën Botërore.

Ndërsa sipas autorëve Blanchfield dhe Browne anëtarësimi në IFAD, UNIDO dhe WIPO është i hapur për të gjitha shtetet që janë pjesë të një agjencie të specializuar (Blanchfield & Browne, 2014). Referuar në nenin 3, pika A të Kushtetutës së Organizimit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), vërtet e thekson mundësinë e anëtarësimit nëse je anëtar i një agjencie tjetër të specializuar, siç është Kosova, por pika C e po atij neni thekson se anëtarësimi duhet të rekomandohet nga Bordi dhe të aprovohet nga 2/3 e anëtarëve të pranishëm (UNIDO, 2020). Gjithashtu edhe në WIPO apo Konventa për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale theksohet që për t'u anëtarësuar në këtë agjenci të specializuar duhet të jesh i ftuar nga Asambleja e Përgjithshme e organizatës (WIPO Lex, 1979).

Në kapitujt e kaluar kemi theksuar që viti 2015 shënoi një pikë kthese jo për të mirë në politikën e jashtme të Kosovës, si rezultat i dështimit për anëtarësim në agjencinë e specializuar të KB-së e njohur në shqip edhe si Organizata Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, apo me akronimin origjinal UNESCO. Për Kosovën të pamjaftueshme ishin 92 vota pro, pasi ishin 50 kundërt dhe 29 abstenime. Për dallim nga dështimi i Kosovës për pak vota (3), Palestina më parë kishte arritur të anëtarësohet në UNESCO. Për Palestinën ishin 107 vota për, 14 kundërt dhe 52 abstenime. Si rezultat i kësaj, ShBA-të u larguan nga UNESCO dhe kjo e hendikepoi fushatën lobuese të Kosovës për anëtarësim.

Megjithatë Kosova ishte munduar të përgatitej mjaft shumë për UNESCO, por ndonjëherë konstelacionet janë të tilla që nuk mjafton. Përkundër mungesës direkte, ShBA lobi për Kosovën në UNESCO, me angazhim të drejtpërdrejtë edhe të sekretarit Blinken. Madje siç kujton Brajshori (2021), Samantha Power telefonon presidentin e Perusë dhe Kolumbisë, jo si ambasadore në KB, por si State Department, anëtare e kabinetit të presidentit Obama, që të votojnë Kosovën në UNESCO, por e refuzojnë duke premtuar vetëm abstenimin.

Për këtë arsye kemi përmendur më parë në trajtesë që u lidhën edhe marrëdhëniet diplomatike me Ishujt Kuk dhe Niue, si dy vende anëtare të UNESCO-s por jo të KB-së. Pra, u

mundua që asgjë të mos i lihet rastit dhe të bëhej një punë sistematike shumëdimensionale. Megjithatë përkundër përgatitjeve, paparashikueshmëria është ajo që i karakterizon këto procese. Ndonjëherë dinamikat dhe mundësitë janë përtej neve dhe aleatëve tanë. Siç kujton Brajshori që ka qenë pjesë e grupit punues për UNESCO, deri në fund kanë qenë 4 shtete nga të cilat Kosova ka pasur konfirmime që do të votojnë pro, por që kanë ndryshuar mendim në fund, kjo si rezultat i presionit të hatashëm rus (Brajshori, 2021). Prandaj në këto procese, përveç strategjisë lobuese, duhet pasur parasysh edhe strategjia dhe forca lobuese e kundërshtarit.

Çështja e trashëgimisë serbe në Kosovë ishte pika fragjile në të cilën thirrej Serbia për të bindur shtetet e tjera që të mos përkrahin anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Në këtë temë, ndihmë të madhe Kosovës për të luftuar këtë propagandë i kishte dhënë edhe Ambasadori (ish-udhëheqësi i Zyrës Greke në Prishtinë) Dimitris Moschopoulos, i cili lloboi për pranimin e Kosovës. Dhe përkundër që nuk u pranua insistimi serb për shtyrje të votimit për Kosovën për dy vite, Komiteti Ekzekutiv i UNESCO-s më tetor 2015 rekomandoi anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë, megjithatë dështimi erdhi në votimin e shteteve në asamblenë e UNESCO-s.

Është menduar dhe punuar që Kosova të riaplikojë sërish më 2017 për anëtarësim në UNESCO, por si rezultat edhe i konstelacioneve ndërkombëtare por edhe të problemeve të brendshme politike (zgjedhjet), ku Kuvendi nuk pati mundësi t'i miratojë dy ligje kryesore në bindjen e shteteve për votë pro Kosovës, Ligji për Liritë Fetare si dhe Ligji për Trashëgiminë Kulturore. Pikërisht mosmiratimi i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore sipas Brajshorit kombinuar me rrethanat gjeopolitike kanë qenë arsytet për mospasurë në UNESCO (Brajshori, 2021).

Më 2018 Kosova u përgatit për aplikim në INTERPOL si një organizatë ndërkombëtare e policisë, por që përkundër përpjekjeve, nuk u arritën votat e mjaftueshme prej 2/3 për të rezultuar aplikimin e suksesshëm. Madje në këtë rast në dy raundet e votimit, pati më pak vota se në UNESCO. Në votimin e parë, Kosova mori 76 vota pro, 56 kundërt dhe 22 abstenime, ndërsa në rrethin e dytë vetëm 68 vota pro. Kosova kishte fajësuar fushatën lobuese serbe me metoda joetike (Telegrafi, 2018). Pra, kemi një rënie të suksesit të Kosovës në aplikim për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, gjë që Gjyshinca aludon

që tani kemi një ambient gjeopolitik më pak miqësor për Kosovën se që ka qenë në vitet 2008-2012 (Gjyshinca, 2021).

Rezultatet maksimalisht të ngushta në (mos)anëtarësime që i ndodhin Kosovës, e impaktojnë mjaft shumë tërë ecjen e Kosovës si shtet. Krahasimi në dështimin për anëtarësim UNESCO për 3 vota, dhe anëtarësimi në UEFA për 1 votë më shumë se pragu për të dështuar, tregojnë vështirësinë e procesit që mund të ndryshojë tërë rrjedhën e ngjarjeve pasuese. Përderisa Kosovës nuk i janë pjekur kushtet ende që të bëhet pjesë e UNESCO-s dhe përfitimeve nga ajo, në segmentin sportiv të futbollit ka arritur rezultate të lakmueshme në pak kohë.

Por, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare nuk është ekuacion me një të panjohur, se a i ke votat për anëtarësim, pasi diplomacia është më e komplikuar se kaq. Në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), në relacion me kriteret e kërkuara Kosova ka pasur që moti mundësi anëtarësimi, por kjo nuk ka ndodhur. Njëjta gjë i ka ngjarë dhe Palestinës, pasi anëtarësimi në këtë organizatë është me shumicë të thjeshtë, dhe si Kosovën si Palestinën e njohin mbi këtë numër. Raportimet (Zarocostas, 2018) theksonin se Palestina është përmbajtur nga aplikimi në OBT si rezultat i presionit të madh diplomatik për të mos aplikuar në këtë organizatë. Është e mundshme që Kosovës i është kërkuar nga aleatët që të përmbahet nga një aplikim i mundshëm, i cili do të mundë të nxiste aplikimin e Palestinën në anën tjetër, gjë e cila do të mund të rezultonte me komplikime politike për këtë organizatë të rëndësishme.

#### **4.2 Kosova në mekanizmat rajonalë**

Sikurse Brajshori që kemi theksuar që është i mendimit që Dialogu Kosovë-Serbi ka sjellë njohje për Kosovën, edhe Zeka ndanë mendimin që ky Dialog ka mundësuar anëtarësimin e Kosovës në gjitha mekanizmat rajonalë por edhe më gjerë, si në FIFA e UEFA kur para anëtarësimit të plotë, Kosova zhvilloi ndeshje me modelin e arritur në marrëveshje në kuadër të Dialogut (Zeka, 2020). Kjo u arrit me Marrëveshjen për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal më 2012. Megjithatë pas kësaj, Serbia thirrej që tentimet e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, e mbysin dialogun, duke i vënë shtetet përkrahëse të pavarësisë, njëkohësisht përkrahëse të Dialogut në një situatë jo të favorshme.

Kosova është anëtare e mekanizmave rajonalë, e ku në një pjesë përkundër përfaqësimit me fusnotë ka rritur ndjeshëm ndikimin dhe prezencën e saj. Ajo madje mbajti dhe presidencat e organizatave të tilla, shembull SEECP më 2021 apo në MARRI. Ngjashëm si SEECP, madje e ndërlidhur me këtë ku Kosova është pjesëmarrëse e saj është Këshilli për Bashkëpunim Rajonal – RCC. Pastaj Iniciativa Rajonale për Migracion, Azil dhe kthim të Refugjatëve - MARRI, Fondi për Ballkanin Perëndimor, Zyra Rajonale e Bashkëpunimit të Rinjve – RYCO, Traktati i Komunitetit të Transportit –TCT , Komuniteti i Energjisë – ENC etj.

Ndërsa në Qendrën Rajonale e Asistencës për Verifikimin dhe Zbatimin e Kontrollit të Armëve (RACVIAC) e cila është organizatë rajonale me profil politiko-ushtarak, Kosova (me modelin e përdorimit të fusnotës) u ftua më 2014 të marrë pjesë në të gjitha nismat dhe nivelet e saj, por jo me status të plotë të anëtarit (Racviac). Deri më tani tentimet e Kosovës për anëtarësi të plotë nuk kanë qenë të suksesshme, pasi aty vendimet merren me konsensus dhe ndër të tjerash edhe Serbia është anëtare. Por RACVIAC, me seli në Zagreb ku Kosova rëndom e dërgon një zyrtar të MPJ-së paraqet shembull tipik të kreativitetit të gjetjes së modelit sui generis për përfaqësimin e Kosovës.

Nga organizatat rajonale, Kosova një status më pak të favorshëm përfaqësimi e ka në CEFTA, pasi në emër të Kosovës e ka nënshkruar UNMIK-u dhe ende nuk ka arritur të bëhet ndryshimi i saj, ku ende vazhdon përfaqësimi në nivel vendimmarrje nga ana e UNMIK-ut.

Përkundër përfitimeve të ndryshme nga iniciativat rajonale që ka pasur Kosova, rritjes së prezencës në to në vitet e fundit, prapë Kosova qëndron e fundit për nga numri i shtetasve të saj në këto organizata rajonale me 9%, poshtë Malit të Zi me 10%. Shqipëria përfaqësohet më së miri me 30%. Krahas kësaj, Kosova mbetet i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që nuk është seli e ndonjë initiative të tillë me karakter rajonal (Balkans Policy Research Group, 2021, f. 11).

### 4.3 NATO

NATO është aleancë politiko-ushtarake e krijuar më 1949 nga 12 shtete të bllokut perëndimor udhëhequr nga ShBA. Sot numëron 30 shtete anëtare, ku pranimi i tyre bëhet me konsensus.<sup>55</sup> Kosova nuk është anëtare e NATO-s dhe pengesën kryesore e ka që nuk njihet nga 4 shtete të kësaj aleance (Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia).

Formalisht aderimi në NATO është i përcaktuar në Nenin 10 të Traktatit themelues të Uashingtonit: “palët, me marrëveshje të njëzëshme, mund të ftojnë çdo shtet tjetër evropian që është në gjendje të çojë përpara parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut për t’u anëtarësuar në këtë Traktat” (NATO, 1949). Pra, për dallim nga shumica e organizatave të tjera, aderimi në NATO vjen pas ftesës së saj, e jo pas aplikimit të shtetit aspirues.

Synimet e Kosovës për t’u bërë anëtare të NATO-s janë shumë të qarta dhe të kahershme. Me agresionin rus në Ukrainë, Kosova i shtoi zërat duke synuar që si rezultat i kësaj lëvizje tektonike në politikën botërore, të ketë lëvizje të shpejtë eventuale drejt pranimin të Kosovës në NATO pavarësisht pengesave që ka. Kuvendi i Kosovës me 3 mars 2022 miratoi rezolutë që i bën thirrje qeverisë të nisë negociatat me NATO-n për anëtarësim. U themelua edhe Grupi Punues për anëtarësimin e Kosovës në NATO si një grup ndërministror dhe ndërinstitucional që synon afrimin e Kosovës me NATO nëpërmjet përfshirjes së Kosovës në Partneritetin për Paqe por edhe aderimin në ShBA-Kartën e Adriatiku (A5) (MFAD, 2022).<sup>56</sup> Megjithatë zërat e Kosovës për t’u bashkuar me aleancën hasën në vesh të shurdhër. Prandaj një lëvizje e shpejtë, siç po tentohet të bëhet me Suedinë dhe Finlandën nuk duket në horizont. Kryeministri Kurti bëri thirrje që së paku Kosova të bëhet pjesë e Programit të Partneritetit për Paqe që NATO e ka me vendet partnere. Në fakt Kosova ka aplikuar për Partneritet për Paqe me NATO edhe më 2012 por pa sukses (Kruijver & Xhambazi, 2020). Kjo për arsye se sikurse aderimi në NATO edhe për Partneritet për Paqe kërkon unanimitet të plotë mes anëtarëve të NATO-s<sup>57</sup> (Rama, 2022). Enver Hasani e ndërlidh Dialogun e Brukselit

---

<sup>55</sup> Në të kaluarën ka ndodhur që me vite të tëra të mbahet pezull një shtet nga hyrja në NATO si rezultat i kundërshtimit nga vetëm një shtet anëtar (kundërshtimi i Greqisë ndaj Maqedonisë), ndërsa aktualisht gjasat janë që vetëm Turqia mund të jetë pengesë që Finlanda e Suedia të mos anëtarësohen në NATO.

<sup>56</sup>

<sup>57</sup> Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në Samitin fundit të NATO-s në qershor 2022 kërkon që Kosova të ftohet menjëherë në mekanizmin e Partneritetit për Paqe. Ai po ashtu ka kërkuar nga vendet e NATO-s që nuk e njohin Kosovën, që ta bëjnë atë sa më shpejt.

me përparimin e Kosovës, eventualisht anëtarësimin në NATO. Sipas tij, anëtarësimi në NATO nuk përcaktohet nga agresioni rus në Ukrainë, por nga dinamikat e brendshme në Kosovë dhe Dialogu i Brukselit me Serbinë (Kosovapress, 2022). Suksesit të negociimit në kuadër të Dialogut me Serbinë, ia atribuon suksesin që sot Kosova sipas Edita Tahirit ka arritur marrëdhënie me NATO-n më 2016, ku zhvillon një lloj kontraktualiteti me të për herë të parë. Kjo ka ndodhur pas marrëveshjes Kosovë-Serbi në Bruksel (Tahiri, 2021). Kosova ka akredituar në kuadër të ambasadës në Bruksel, një diplomat të rangut ambasador për marrëdhënie me NATO-n. Kjo e ka shtuar intensitetin e takimeve në Bruksel. Megjithatë në adresimet zyrtare të NATO-s askund nuk figuron që Kosova është pjesë e ndonjë nga programeve zyrtare të saj. Pavarësisht kësaj, mbahen disa kontakte.

Kosova është vetëm anëtare vëzhguese e Kartës së Adriatikut A5 që nga viti 2012, por tentimet për anëtarësi të plotë deri më tani kanë dështuar si rezultat i kundërshtive të Bosnjës. Aderimin e Kosovës në A5 e ka kërkuar edhe Shqipëria disa herë nëpërmjet ministrave të jashtëm Bushati (TRT Balkan, 2014) apo Cakaj (MEFA Albania, 2019).

Forcat e Sigurisë së Kosovës – FSK sipas planit dhe mandatit kishin arritur kapacitetet e plota më 2013. Tentimet për krijim të ushtrisë, nuk u arritën me ndryshime kushtetuese por u ndoq mënyra alternative me ndryshime ligjore. Kjo u arrit më 2018, i cili nuk ishte një opsion i preferuar për NATO-n, të cilët reagues nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Megjithatë ShBA kanë mbështetur në vijimësi transformimin e FSK-së sipas planit 10-vjeçar për periudhën 2018-2028. Edhe në thirrjet e fundit të Kosovës për anëtarësim në NATO, ShBA nëpërmjet ambasadës në Prishtinë iu përgjigj që kjo është një procedurë komplekse dhe Kosova duhet të fokusohet në zbatimin e këtij plani 10-vjeçar (Fana, 2022).

#### **4.4 Këshilli i Evropës**

Këshilli i Evropës është organizatë panevropiane e themeluar më 1949 me 46 shtete anëtare që merret me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë. Turbulencat në marrëdhënie ndërkombëtare si rezultat i luftës në Ukrainë, që rezultuan ndër të tjerash edhe me përjashtimin e Ruisë nga Këshilli i Evropës, bëri që Kosova të shikojë një mundësi reale për anëtarësim në këtë organizatë, andaj dorëzoi aplikimin më 12 maj 2022.

Janë dy kritere kryesore për të qenë i kualifikuar për t'u pranuar në Këshillin e Evropës. Kriteri gjeografik sipas nenit 4 të Statutit të Këshillit të Evropës ku duhet të jesh shtet Evropian si dhe kriteri tjetër të pranosh vlerat demokratike (Council of Europe, 1949). Sa i përket Kosovës, edhe më parë nuk ka pasur dilema për përmbushjen e këtyre kritereve. Kosova i ka paraprirë disa gjërave në këtë proces, pasi edhe pa qenë anëtar në Këshill të Evropës, i ka inkorporuar në sistemin juridik të saj Konventat si Konventën Evropiane, Konventën kornizë për mbrojtje të pakicave dhe Konventën kundër torturës, pastaj Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare.

Me aplikimin e Kosovës, fillon një procedurë e cila nuk është e përcaktuar në kohë se sa mund të zgjasë. Pengesën e parë më 20 maj 2022 në diskutimet në Komitetin e Ministrave në Torino, Kosova nuk arriti ta kalojë pavarësisht që disa shtete në deklaratat e tyre dhanë mbështetje për Kosovën. Kosova duhet të presë majin e 2023-tës kur Komiteti i Ministrave mund ta fusë Kosovën në agjendë në takimin e tyre të planifikuar në Rejkjavik të Islandës. Nuk duket e rastësishme edhe ndërlihdja e aplikimit të Kosovës dhe menjëherë deklaratës së ambasadorëve të shteteve të Quintit (Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe ShBA-së) në Kosovë për respektimin dhe zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për manastirin e Deçanit (Ambasada e Italisë në Prishtinë, 2022). Kjo deklaratë u ripërsërit pas të njëjtës në nëntor 2021 (Ambasada e ShBA-së në Prishtinë, 2021). Për këtë reagoi edhe ish-Ambasadori Peci duke bërë thirrje që të respektohet vendimi i GjK-së sepse do të na hakmerret në tentimin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare (Peci, 2022).

Për anëtarësim në Këshill të Evropës, fjalën përfundimtare pastaj e ka Asambleja e Përgjithshme e cila vendos me 2/3 të votave. Kosovën e njohin si shtet mbi këtë prag (34 shtete e njohin Kosovën), megjithatë Kosova synon që të marrë votat edhe nga shtetet mosnjohëse si Spanja, Greqia etj., por që duhet të punojë shumë në bindjen e shteteve njohëse që të mos kushtëzojnë anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës me avancimin e Dialogut Kosovë-Serbi.

Dy shtetet e mëdha evropiane, Gjermania dhe Franca kanë dhënë sinjale të ndryshme sa i përket anëtarësimin të Kosovës në KE. Diskursi i Francës në fillim ishte pak i rezervuar duke i ftuar palët "të përmbahen nga çdo veprim i njëanshëm që mund të nxisë tensione"

(Ambasada e Francës në Kosovë, 2022). Ndërsa qëndrimi gjerman ishte paekuivoke në përkrahje të Kosovës (Rohde, 2022).

Këshilli i Evropës, si organizatë vendosi për herë të parë përjashtimin e një shteti anëtar duke u thirrur në nenin 8 të Statutit, duke përjashtuar Rusinë efektivisht më 16 mars 2022 (Rezoluta e Këshillit të Evropës, (CM/Res(2022)2, 2022). Përveç përjashtimit, instrument tjetër në Këshillin e Evropës për përgjigje ndaj shkeljeve të shteteve anëtare është pezullimi e cila ishte aplikuar më 2014 po ndaj Rusisë, që paraqiti mundësi për Kosovën.

#### **4.5 Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë**

ONF<sup>58</sup> është një nga storiet ku Kosova gradualisht ka filluar me marrëdhëniet zyrtare me këtë mekanizëm duke avancuar me kohë statusin e saj në organizatë dhe në mekanizmat e veçantë të saj, gjë të cilën synon ta vazhdojë edhe më tutje. Më 2014, Kosova u bë anëtare vëzhguese në ONF e cila është një organizatë që mbledh vendet anëtare të cilat si gjuhë zyrtare ose që e flasin një pjesë e popullsisë e ka frëngjishten, apo që kanë afërsi me kulturën franceze. Më 2018 Kosova e avancon statusin e saj, duke u bërë anëtare e asociuar në Frankofoni. Gjithashtu Kuvendi i Kosovës iu bashkua Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, kurse Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” u bë pjesë e Agjencisë Universitare Frankofone.

Procesin e anëtarësimit si vëzhguese në Samitin e Dakarit më 2014, Brajshori e cilëson që ka qenë si parapërgatitje për UNESCO, të testojë gatishmërinë e shteteve jonjohëse për mbështetje ndaj Kosovës. Aty suksesi ka qenë i konsiderueshëm pasi votimi ka qenë me konsensus dhe kanë qenë 21 shtete që nuk njihnin pavarësinë e Kosovës por që votuan pro. Sipas tij, shteti më problematik në këtë aspekt ka qenë Libani, por që nëpërmjet ndihmës së Emirateve kemi arritur ta bindim edhe këtë shtet. Ndërsa si formulë për tejkalimin e shqetësimeve të këtyre shteteve jonjohëse ka qenë Sekretari i Përgjithshëm (nga Senegali) i cili thekson se shtetet që nuk e pranojnë Kosovën mund të deponojnë një deklaratë që vota pro anëtarësimit të Kosovës në Frankofoni nuk është njohje e shtetit të Kosovës (Brajshori, 2021).

---

<sup>58</sup> Original OIF - Organisation Internationale de la Francophonie



Anëtarësimi i Kosovës në ONF është më rëndësi politike, saqë kundërshtimi i mohuesve të pavarësisë së Kosovës ka qenë mjaft i lartë në përpjekjet për anëtarësim. Por fakti që në ONF janë 88 shtete, prej tyre 54 anëtare të plota, 7 anëtare të asociuara, 27 vëzhguese (Francophonie.org) që përfshijnë një numër të madh shtetesh jonjohëse paraqet rëndësi të madhe. E Kosova këtë e ka shfrytëzuar duke shpreshtuar komunikimin e lobuar edhe për njohje por edhe duke kërkuar mbështetje për anëtarësime në organizata të tjera gjatë takimeve në kuadër të Frankofonisë<sup>59</sup> (Telegrafi, 2018) <sup>60</sup> (Telegrafi, 2019).

#### 4.6 Konventat e Gjenevës

Konventat e Gjenevës dhe Protokollet shtesë të saj janë strumbullari i së drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilat si Traktate Ndërkombëtare përcaktojnë rregullat e sjelljes në luftë. Kosova nuk është anëtare e tyre. Të qenurit anëtar i Konventave të Gjenevës do të ishte e rëndësishme për Kosovën, por sikurse në disa organizata të tjera që i kemi përmendur, duhet gjetur gjuha e përbashkët me aleatët tanë për të aplikuar në të. Autorja Rashica mendon se Kosova është dashur deri më tani të aplikojë për t'u bërë pjesë e Konventave të Gjenevës. Nga 196 shtete pjesë të KGJ-së, Kosova nuk njihet nga rreth 81 prej tyre, ndërsa Vatikani, Ishujt Kuk dhe Palestina janë pjesë përbërëse të Konventës, pa qenë anëtare të plota në KB. Kosova nuk është bërë pjesë e KGJ-së nëpërmjet suksecionit, siç janë bërë shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë, prandaj rruga e Kosovës duhet të jetë ndryshe.

Teknikisht, procedura e anëtarësimit kërkon depozitimin e instrumentit të anëtarësimit te Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, nëpërmjet Zvicrës. Sipas Rashicës (Rashica, 2021, fv. 93-94), Kosova duhet ta bëjë këtë aplikim duke përdorur argumentin e suksesimit, pasi SP nuk ka rol influencues dhe politik, por vetëm teknik dhe që duhet t'i informojë shtetet anëtare për aplikimin e Kosovës. Mirëpo sipas Brajshorit (2021) kjo do të ishte e rrezikshme pasi pa një koordinim të madh me aleatët, dhe një refuzim (i cili është skenar shumë real) nga ana e SP-së që mund të thotë që Kosova nuk ka të drejtë të aplikojë, do të ishte një disfatë e madhe për arsyen se atëherë Serbia do të kishte një dokument që Kosova refuzohet që është shtet nga ana e KB-së. Një ish-udhëheqës i dikasterit të politikës së jashtme në Kosovë ka synuar

---

<sup>59</sup> Ministri Pacolli kërkon mbështetje për Interpol dhe njohje për Kosovën gjatë takimit të Frankonisë në tetor 2018.

<sup>60</sup> Ngjashëm më 2019.

të fillojë një vetiniciativë për anëtarësim në Konventat e Gjenevës, mirëpo është tërhequr menjëherë për shkak të mosdakordimit paraprak me aleatët tanë.

#### **4.7 Organizata e Bashkëpunimit Islamik**

OBI<sup>61</sup> është një organizatë ndërkombëtare që mbledh vendet me popullsi kryesisht të provinencës islame dhe aktualisht ka 57 vende anëtare (OIC-OIC.org) dhe 5 vëzhgues (Bosnjën, Afrikën Qendrore, Tailandën, Rusinë dhe Qipron Veriore).

Menjëherë me shpalljen e pavarësisë, Sekretari i Përgjithshëm i OBI-së, Ekmeleddin Ihsanoglu lëshoi një deklaratë ku tha: "...një ngjarje shumë e rëndësishme ndodhi dje. Kosova më në fund ka shpallur pavarësinë e saj pas një beteje të gjatë dhe të vendosur nga populli i saj. Ndërsa gëzohemi për këtë rezultat të lumtur, ne deklarojmë solidaritetin dhe mbështetjen tonë për vëllezërit dhe motrat tona atje, të një shteti të fortë dhe të begatë, të aftë për të kënaqur popullin e vet. Nuk ka dyshim se pavarësia e Kosovës do të jetë një pasuri për botën myslimane dhe do të forcojë më tej veprimin e përbashkët islamik" (Secretary of State, 2008).

Në fakt janë një sërë rezolutash të OBI-së që u bënë thirrje vendeve anëtare të njohin pavarësinë e Kosovës. Kryesisht të sponsoruara nga Turqia, Shqipëria por edhe Arabia Saudite. E fundit në prill 2022, kur edhe presidentja Osmani falënderoi për këtë gjë (Osmani, 2022). Ngjashëm në Samitin e 12 në Kajro, më 2013 (Info Arkiva, 2018). Këtë fakt e pohon edhe Ambasadori Ukelli që në OBI, Kosova ka qenë e ftuar përherë dhe që kanë qenë pro Kosovës. Sipas Ukellit Kosova nuk është dashur të hezitojë për aplikim në OBI, pavarësisht që një numër i shteteve nuk e njohin, pasi në OBI ka shtete anëtare apo vëzhguese që as nuk kanë popullatë islame e as ndonjë lidhje tjetër me këtë religjion (Ukelli, 2021). OBI siç tregon praktika ndaj Kosovës ka ndjekur shembullin e BE-së duke i lënë në dorë të shteteve anëtare individualisht a do ta njohin Kosovën.

Diplomati Brajshori (2021) kujton se Kosova ka lëshuar një rast të artë në vigjilje të Pavarësisë, kur në dhjetor 2007 është mbajtur Konferenca e OBI-së në Pakistan. Kosova nuk mori pjesë, e që është dashur, pasi në këtë Konferencë u vendos reformimi i OBI-së që për

---

<sup>61</sup> Original OIC - Organisation de la Coopération Islamique

arsye të veta ndryshojnë Statutin, që shtet anëtar ose vëzhgues bëhen vetëm shtetet anëtare të KB-së, e kjo hyn në fuqi në mars 2008.

Duke qenë vend anëtar që më 1992 pas rrëzimit të sistemit komunist, Shqipëria në këtë periudhë më 2008, lobonte në këtë Konferencë për njohjen e Kosovës. Madje Basha që përfaqësoi Shqipërinë në njërin nga mbledhjet në OBI, referuar dokumenteve të Wikileaks ishte shumë i frustruar dhe kërcënoi me rishqyrtim të statusit të Shqipërinë në organizatë. Kjo për shkak edhe të marginalizimit të Shqipërisë që i bëhej nga disa shtete anëtare por edhe me njohjet e pakta që Kosova kishte nga shtetet anëtare të OBI-së. Sipas Bashës, shteti më problematik për Kosovën në OBI ishte Indonezia (Embassy Tirana, 2008).

Kosova nuk e ka synim strategjik anëtarësimin në OBI për faktin që i duhet të jetë pjesë e kësaj organizate, por numri i lartë i shteteve anëtare i shërben Kosovës që të rrisë subjektivitetin e saj në kuadër të influencës që këto shtete kanë.

Procesi i anëtarësimin të Kosovës si shtet në organizata ndërkombëtare ka filluar që me shpalljen e pavarësisë dhe është proces i vazhdueshëm. Plotësimi i kriterëve formale për anëtarësim jo gjithëherë është sinjal që duhet të vraposh që të bëhesh pjesë e një organizate. Analizat e kosto/dobisë përherë duhet të jenë të pranishme, pavarësisht që nuk mund të mohohet që për Kosovën është me rëndësi edhe elementi i prezencës diplomatike në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Kosovës në një mekanizëm ndërkombëtar mbart me veti kosto dhe dobi të dyfishtë, financiare por edhe politike. Kosto financiare është kuotimi kontribuues që jepet në një mekanizëm, p.sh. në Fondin Monetar Ndërkombëtar apo në Frankofoni, por janë edhe dobitë financiare që Kosova ka nga pjesëmarrja në nisma multilaterale. Gjithashtu kosto politike e anëtarësimeve ndërkombëtare janë të tilla sidomos në aleanca politiko-ushtarake, pavarësisht që hyrja e Kosovës në to (siç është rasti me Koalicionin Global kundër Terrorizmit), paraqet më shumë një hyrje morale dhe politike në të për të rritur "legjitimitetin", sesa kontribut real financiar apo tjetër. Shembull kemi rastin e pjesëmarrjes së FSK-së me resurse humane në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, dhe kjo politikë sipas Ishizukas (1999, fv. 18-21) sjell të mira për shtetin e vogël si punësimi i njerëzve të saj, përfitime financiare, shkathtësim në artet luftarake dhe përmirësim imazhi.

Pra, diplomacia multilaterale është koncept më i gjerë sesa integrimi në organizata ndërkombëtare, por që e përfshin edhe integrimin në ON. Gjithashtu diplomatët e Kosovës përherë duhet që diplomacinë multilaterale ta vënë në funksion të diplomacisë bilaterale. Të tilla janë nismat dhe takimet që Kosova i realizon në këto forume, sidomos në margjina të takimeve të tilla, sepse siç thekson Watson (2005, f. 142) që diplomacia multilaterale nuk është zëvendësim i dialogut të drejtpërdrejtë mes shteteve individuale, por një plotësim për të.

Aq më shumë që Kosova në samite ndërkombëtare, e ka shfrytëzuar për komunikim me shtetet jonjohëse, që nëse jo votë pro, të mos bllokojnë Kosovën në procese ndërkombëtare. Dhe kur flasim për takimet me shtetet jonjohëse, përkundër dëshirës së udhëheqësve institucionalë për t'i evidentuar këto takime dhe për t'i raportuar në publik si sukses, është shumë me rëndësi përmbajtja nga raportimet mediale të takimeve me shtete jonjohëse për të mos i vënë në siklet këto shtete. Pa veçuar , por ka pasur raste kur si rezultat i publikimeve të këtyre takimeve Kosovë me shtete jonjohëse, këtyre shteteve iu janë shkaktuar pastaj telashe nga presionet serbe apo ruse.

## KAPITULLI V

### 5. MBËSHTETJA E ALEATËVE, ROLI I SHQIPËRISË DHE I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA DIPLOMATIKE

Përderisa kemi shtjelluar në kapitujt paraprak (kapitujt dy, tre dhe katër) tema që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të Kosovës, aspektin e njohjes, diplomacinë multilaterale në organizata ndërkombëtare, problemet me tërheqjet e njohjeve e tema të ngjashme, natyrshëm kemi cekur bashkëpunimin që Kosova ka pasur me aleatët e saj në këto orvatje diplomatike. Prandaj shumë aspekte të kësaj teme veçse janë cekur dhe nuk do të përsëriten në këtë kapitull.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, së paku në rrafshin formal, që nga Paqja e Westfalisë më 1648 është i garantuar parimi i barazisë juridike mes shteteve, gjë e cila është e stampuar edhe në Kartën e KB-së ku potencohet që “Organizata bazohet në parimin e barazisë sovrane të të gjithë anëtarëve të saj.”<sup>62</sup>

Në të kaluarën, në epokën e Luftës së Ftohtë të ndarjes bipolare të botës, shtetet e tjera e kanë pasur aleat njëri nga superfuqitë e kohës, ShBA-në ose BRSS-në, me përjashtim deri diku të shteteve të Lëvizjes së Painkuadruarve. Sot sistemi ndërkombëtar është ndryshe, shumë më fluid dhe më i papërcaktuar, që lëviz nga nuancat e unipolaritetit, në një botë bi-tri- apo multipolare, varësisht nga cili aspekt shikohet. Megjithatë për shtetet më të vogla, e rëndësishme mbetet një gjë, gjetja e një sponsori për shtyrjen përpara të interesave në politikën e jashtme. Në realitet aleancat janë të vjetra për aq sa ekzistojnë shoqëritë njerëzore. Megjithatë historia na mëson se që nga Lufta e Peloponezitet, gjatë së cilës Athina dhe Sparta ndërtuan aleanca për luftë mes tyre, Traktati i Kadeshit që përcaktoi aleancë mes Ramzesit II të Egjiptit dhe Hatushilit III të Hititëve, aleancat gjatë luftërave 30-vjeçare në Evropë 1618-1648, Traktati i Fshehtë të Londrës 1915 dhe në përgjithësi Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, e deri në fund shek. XX dhe fillim shek. XXI kur shtetet e ish-Traktatit të Varshavës aderuan në NATO, si emërues të përbashkët kanë maksimën anglosaksone që

---

<sup>62</sup> Karta e KB-së, neni 2.

nuk ekzistojnë miq të përhershëm por vetëm interesa të përhershme, prandaj aleancat ndërtohen, zhvillohen, thyhen dhe rikrijohen të tjera.

Siç edhe ndërlidhet me disertacionin dhe vetë kapitullin e teorive mbi njohjen dhe argumentimin e trajtuar të Visokes të kritikave mbi normativën e njohjes dhe njohjen pragmatiste që vjen si rezultat i aleancave apo shtysave nga aleatët e fuqishëm. Pra, sipas Visokes “detyra për të njohur ose mosnjohur nuk drejtohet nga ndonjë kornizë rregullatore normative ose institucionale, por nga presioni i jashtëm dhe i situatës ose stimulimet që vijnë nga aleatët diplomatikë.” (Visoka, 2019, f. 489).

Së këndejmi në një sistem ndërkombëtar ku teoritë realiste, gjegjësisht neorealiste janë ende shtysë e mendimeve dhe zhvillimeve në një masë të konsiderueshme, i kthejnë në domosdoshmëri aleancat e natyrave të ndryshme për arritjen e qëllimeve të caktuara. Këto qëllime dallojnë në varësi të fuqisë dhe statusit të shtetit, që nga mbijetesa, deri te zgjerimi i influencës në nivel global. Apo si thotë Rothstein (Rothstein, 1968, f. 24) që për shtetet e vogla të konvencueshme janë aleancat e nivelit multilateral dhe ato me shtete realisht të fuqishme. Studimet teorike për aleancat në marrëdhëniet ndërkombëtare zënë një vend mjaft të rëndësishëm në studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi. Autorët si Walt (1985), Waltz (2010), Snyder (1997), etj. kanë dhënë kontribut të çmueshëm në këtë drejtim. Debatet mes tyre dhe studimet mbi këto vepra kapitale janë të njohura gjerësisht në mesin e studiuesve të fushës.

Marrë në përgjithësi, secili shtet është i prirur drejt aleancave për realizimin e qëllimeve të ndryshme në politikën e jashtme. Një nocion i ri që ka hyrë në përdorim, sidomos nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, siç vëren Nadjkarni është “Partneriteti” i cili po zëvendëson “aleancën” (Nadkarni, 2010).

Nga gjetja e aleatëve qoftë natyrorë, strategjikë, taktikë (Ghez, 2011)<sup>63</sup> nuk përjashtohet as Kosova, si shtet i ri dhe i vogël, me specifikat e saja të njohura, prandaj këtu do të jetë fokusi i kësaj pjese të trajtesës, madje duke u fokusuar vetëm në periudhën post-pavarësi, marrë parasysh se edhe në epokën e mëhershme të protodiplomacisë Kosova ka pasur aleatët e saj në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, pastaj në periudhën intensive për statusin final të Kosovës dhe gjatë negociatave për pavarësi. E periudha nga 2008 i ngërthen në vete

---

<sup>63</sup> Këtë kategorizim të aleancave e bën Ghez.

ndihmën e aleatëve kryesisht në lobimin për njohje dhe në lobimin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Kosova duke mos arritur shpalljen e pavarësisë në kuadër të një marrëveshje ndërkombëtare në sistemin e KB-së, detyroi zgjedhjen e opsionit të “pavarësisë së koordinuar” dhe kjo rrjedhimisht dhe natyrshëm i solli në tryezë aleatët për këtë koordinim. Prandaj edhe Gashi shtetet që ndihmuan në lobimin për njohje në fillet e pas pavarësisë i quan njëkohësisht dhe “akterë të pavarësisë” (Gashi, 2021).

Shtetet e Bashkuara të Amerikës si fuqia më e madhe në botë, u bë sponsori i lindjes së shtetit të Kosovës, duke vënë në dispozicion një kapital të madh diplomatik i cili ka qenë kontinual. Që nga demarshimi i shteteve që ShBA-të bënë në vigjilje të shpalljes së pavarësisë së Kosovës për t’i informuar shtetet e tjera që një shtet i ri po lind dhe duhet të njihet, ShBA vazhdoi aktivitetin e saj lobues edhe pas pavarësisë. ShBA-të ishin madje edhe trajnuesit dhe udhëzuesit e parë të grupit të diplomatëve të parë të shtetit të Kosovës.

Me ndihmë të ShBA-ve, Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Nju Jork, që nga fillimi nuk funksionoi vetëm si e tillë, por ajo me leje nga shteti pritës ishte si një lloj misioni pranë KB-së, me qasje në të për aq sa ishte e mundur si rezultat i mbështetjes amerikane. Vazhdimisht ka ndodhur, por edhe janë raportuar raste që amerikanët kanë ndihmuar dhe lobuar në aranzhimin e takimeve të delegacioneve nga Kosova apo diplomatëve tanë në ShBA me zyrtarë nga vende mosnjohëse që kanë misionet diplomatike në KB. Të tilla si me Irakun (Embassy Baghdad, 2009), Indonezinë (Embassy Jakarta, 2009), Tunizinë (Embassy Tunis, 2009), etj. Apo lobimi amerikan për të mundësuar pjesëmarrjen e diplomatëve nga Kosova në konferenca të ndryshme ndërkombëtare me qëllim të interakcionit me shtetet jonjohëse, pavarësisht që vetë konferenca mund të mos kishte asgjë të bënte me Kosovën, shembull siç kujton Ukelli vitin 2013 kur së bashku me Edita Tahirin në Etiopi morën pjesë (në cilësinë e mysafirëve) në Konferencën e Unionit afrikan sipas instruksioneve dhe lobimit amerikan. Dhe kjo ndihmesë amerikane cilësohet shumë e rëndësishme për faktin se të gjitha shtetet, në selinë e KB-së i dërgojnë diplomatët e tyre më të zellshëm dhe me nam që kanë impakt në politikën e jashtme të vendit të tyre (Ukelli, 2021).

Diplomatët amerikanë të të gjitha niveleve, që nga sekretarja Rice, lobonin për Kosovën<sup>64</sup> (Secretary of State, 2008) (Secretary Rice's, 2008). Ndërsa njëkohësisht diplomatja tjetër Sada Cumber diskutoi me krerët religjiozë në Kosovë se si Kosova të marrë njohje nga shtetet myslimane. Kjo ndodhi në korrik 2008 dhe diskutohej që të arrihen njohje para mbledhjes së radhës së AP të KB-së (Embassy Pristina, 2008).

Pra, lobimi amerikan nuk ishte një nismë vetanake apo e izoluar e diplomatëve të caktuar të cilët mund të kishin afërsi me Kosovën. Por ky lobim vinte nga të gjitha nivelet dhe ishte i organizuar. Prandaj edhe kohë pas kohe lëshoheshin qarkore në të gjitha misionet diplomatike që si punë primare të kenë lobimin për njohjen e Kosovës, duke i mbajtur të azhurnuar edhe me informatat më të fundit, argumentet të cilat duhet të përdornin gjatë lobimit etj. Madje këto qarkore përveç të gjitha shteteve, targetonin edhe fokus grupe si shembull shtetet e OBI-së. Ngjashëm ndodhi në kohën kur rasti i Kosovës vetëm se kishte shkuar në GjND dhe ishte një frikë për rënien e valës së njohjeve, prandaj në dhjetor 2008 përsëri me një qarkore ShBA-të kërkonin nga misionet e tyre diplomatike të lobonin në shtetet pritëse që të njihnin pavarësinë e Kosovës (Secretary of State, 2008).

Si rezultat i mbështetjes së gjerë amerikane, Kosova me kapacitetet e saja të cilat i ka ndërtuar ka treguar devocion dhe integritet të lartë në këtë partneritet me Amerikën. Kosova pa asnjë dilemë është bërë pjesë e nismave dhe aleancave që si partner dhe iniciues kryesor kishin Shtetet e Bashkuara. Të tilla si Koalicioni Global Kundër Terrorizmit ndaj ISIS, pastaj rreshtimi i drejtë krah amerikanëve në konfliktin në Ukrainë, sanksionet kundër Iranit, Koresë së Veriut apo Bjellorusisë, i dhanë Kosovës një kredibilitet ndërkombëtar dhe e treguan si partner serioz. Qartazi mbështetja e Kosovës në këto raste ishte simbolike, më shumë për çështje partneriteti dhe legjitimitet politik ndërkombëtar, por e cila është vlerësuar nga partnerët tanë. Kosova edhe në programet qeveritare e ka të përmendur bashkëpunimin me ShBA për politikën e jashtme dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, siç është programi aktual 2021-2025, (Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2021-2025) apo ai paraprak 2017-2021 (Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021).

Përveç ShBA, Kosovën e kanë ndihmuar edhe shtete e tjera. Në intervale dhe me intensitet të ndryshëm, edhe shtete e tjera kanë lobuar shumë në njohje në zonat e tyre të influencës

---

<sup>64</sup> Raportimet që Sekretarja e Shtetit Rice lobon për Kosovën te shtetet e Spanjës e Panamasë.



por edhe në tentimet e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Shembull Gjermania demarshoi një numër shtetesh për pranimin e Kosovës në kohën e aplikimit të Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (Embassy Berlin, 2009). Ndërsa shteti i Francës ndër të tjerash ishte i fokusuar të llojë në shtetet arabe për të njohur Kosovën me disa nga të cilat ka marrëdhënie të veçanta (Embassy Paris, 2009). Apo që ka ndihmuar në njohjet e Kosovës sidomos në ish-kolonitë, por edhe për anëtarësi në organizata ndërkombëtare. Presidenti i Holandës ndihmoi Kosovën në anëtarësim në ONF (Hoxhaj, 2016, f. 273). Hoxhaj rendit Londrën, Berlinin e Parisin si mbështetësit evropianë të Kosovës (Hoxhaj, 2016, f. 247).

Zaten në Strategjinë për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës evidenton faktin që njohjet e Kosovës ishin arritur në bashkërendim me ShBA-të, Britaninë e Madhe, Francën, Shqipërinë dhe Turqinë (Ministria e Punëve të Jashtme, 2011, f. 9). Megjithatë më shumë se një dekadë pas Strategjisë për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, hartuar nga Qeveria e Kosovës, nuk janë arritur objektivat e vëna në të. Ndryshe nga shtete e tjera që ishin njohur nga KS i KB-së me shumë pak njohje bilaterale, Kosova pas shpalljes së pavarësisë ishte fokusuar në arritjen e njohjeve bilaterale. Në kohën e hartimit të Strategjisë më 2011, numri i njohjeve të Kosovës ishte 75, ndërsa ishin të evidentuar edhe 50 shtete potenciale që kishin qëndrim më të butë e që kishin mbajtur hapur kanalet e komunikimit me Kosovën dhe potencialisht ishin target i radhës për të marrë njohjen. Ndërsa rreth 40 shtete të tjera ishin ose totalisht me qasje indiferente e paqëndrim ndaj Kosovës, ose me qasje të hapur kundër (Ministria e Punëve të Jashtme, 2011, f. 19). Pra, sipas Strategjisë numri optimal i njohjeve bilaterale për Kosovën do të ishte 125, e cila nuk është arritur plotësisht por është jo larg numrit aktual të paraqitur, pa larguar nga llogaritjet njohjet e kontestuara nga Serbia.

Sikurse marrëdhëniet ndërkombëtare që janë tejet interaktive dhe të ndryshueshme, ashtu ndikohen edhe raportet mes shteteve si aktorë themelorë në marrëdhënie ndërkombëtare. Ambasadori Ukelli bën një ndërlidhje të rënies së suksesit të Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare por edhe në njohje me disa faktorë, ndër të cilat edhe dezinteresimin e shteteve mike për t'u marrë me këtë çështje, të cilët vitet e fundit më shumë kanë qenë të fokusuar te Dialogu i Brukselit, ndërsa përkrahjen për Kosovën në agjendat e tjera të politikës sonë të jashtme i kanë pasur më shumë si në mënyrë pasive në

kuptimin e votimit pro Kosovës, por pa ndonjë lobim aktiv. Kjo edhe me argumentin që tashmë jemi vetë shtet dhe ne duhet t'i bindim të tjerët (Ukelli, 2021). Ai si Ambasadori i parë i Kosovës në Japoni thekson kontributin japonez në lobim për Kosovën duke e theksuar si "lobim indirekt" për shkak të specifikave të Japonisë si shtet konservator që nuk e ka kontestuar Kosovën si shtet por që për shkak të historisë dhe traditës së tyre nuk kanë qenë proaktivë. Megjithatë sipas Ukellit këtu është roli i diplomatit dhe relacioneve që ndërton, pasi përkundër kësaj që u tha, Japonia nëpërmjet diplomatëve të saj në pjesë të ndryshme ka ofruar hapësirë për Kosovën, aranzhim e ndërmjetësim të takimeve me të tjerët e të ngjashme (Ukelli, 2021).

Nga sa u tha më sipër, për rolin dhe ndikimin amerikan në ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe subjektivitetit të saj, është shumë me rëndësi mirëmbajtja dhe zhvillimi sistematik i këtyre raporteve. Kjo pasi kundërlobimi serb nuk është për t'u nënçmuar. Këtë mendim ndanë edhe Faton Bislimi, i cili si profesor i diplomacisë dhe lobist në Amerikë është shprehur i shqetësuar për lobimin e madh serb në Uashington. Sipas tij letra e publikuar nga ambasadori serb, Marko Gjuriq, shkruar nga 16 kongresmenë amerikanë për presidentin Biden në të cilën theksohen një mori narrativash anti-Kosovë dëshmon se "serbët e kanë kuptuar fare mirë se ata humbën krejt betejat në Ballkan kur shqiptarët fituan përkrahjen më të madhe në Capitol Hill" (Bislimi, 2022), Bislimi madje iu shkroi këtyre kongresmenëve letër që të largojnë nënshkrimet nga letra e tyre dërguar presidentit Biden për shkak të "të pavërtetave që përmbante ajo letër" (Faton Bislimi, 2022).

Ngjashëm dhe lobisti tjetër dhe ish-zëvendës ministër i jashtëm i Kosovës, Besnik Hoti, thekson rolin e madh dhe të pazëvendësueshëm amerikan në ecjen e Kosovës si shtet, gjë që dëshmohet edhe me letrën e presidentit të tanishëm Biden që i dërgon Vuçiqit për "njohjen reciproke me Kosovën" (Hoti, 2021). Ish-Ambasadori i Kosovës në Uashington, Avni Spahiu nënvizon rolin e madh në lobimin në kongresin amerikan për Kosovën gjatë mandatit të tij, ku aktiv sidomos ishin Grupi për Çështje Shqiptare në Kongres të cilët lobonin madje edhe në vende të ndryshme të botës për njohjen e pavarësisë së Kosovës, sidomos në vendet e Amerikës Latine. Si emër të përveçëm përmend kongresistin Eliot Engel (Spahiu, 2019, fv. 117-121).

Raportimet e fundit në media janë që Kosova nuk ka që dy vite të prenotuar ndonjë kompani amerikane lobuese, duke u bazuar në të dhënat nga Akti i Regjistrimit të Agjentëve

të Jashtëm (FARA). Sipas këtyre raporteve, Kosova ka paguar kompani lobuese amerikane që nga viti 1992, kompaninë “Ruder Finn”, pastaj me radhë nga të gjithë presidentët dhe ministrat e jashtëm si Rugova, Thaçi, Hoxhaj e Pacolli (Gazeta Express, 2022). Kjo nuk do të thotë që është ndalur lobimi në ShBA, pasi lobimi përfshin dimensione të shumta, por sipas statistikave të FARA-s nuk ka kompani të regjistruar për lobimin për Kosovën në platformën e tyre.

Ambasadori Ukelli jep edhe një element interesant kur thekson çështjen e lobimit për njohje. Sipas tij rol mjaft të madh luajnë financat, ku Kosova është tejte e limituar në këtë aspekt. E për krahasim Serbia buxhetin për lobim e ka dhjetramilionësh, një buxhet i ndarë vetëm për organizim të eventeve lobuese, pritjeve të ndryshme etj. (Ukelli, 2021).

Turqia është një nga shtetet përkrahëse aktive e shtetësisë së Kosovës. Udhëheqësi i saj Erdogan në pozita kryeministër apo president që nga para shpalljes së pavarësisë, vazhdimisht ka lobuar për njohjen e Kosovës. Kemi theksuar që njohja e parë nga aktiviteti lobues i një shteti erdhi nga lobimi i Erdoganit te Senegali me t’u shpallur pavarësia e Kosovës. Së fundi si rezultat i një diskutimi dhe debati mbi zgjerimin e NATO-s dhe mbi mundësinë e Kosovës që të afrohet në këtë aleancë politiko-ushtarake, presidenti Erdogan gjatë takimit me presidenten Osmani më 1 mars 2022 përçoi mesazhe përkrahëse për integrimin e Kosovës në NATO dhe për njohje të reja. Gjithashtu Turqia ka pasur rol aktiv në lobim te vendet myslimane për të njohur Kosovën, qoftë në takimet e tyre bilaterale po ashtu edhe në kuadër të Organizatës për Bashkëpunim Islamik. Madje në një kohë kur Kosova po ndihej e pasigurt dhe ishte nën presionin e tërheqjes së njohjeve, sipas diplomatit Brajshori, Turqia ka qenë e vetmja ndihmesë për Kosovën në kundërvënien ndaj kësaj fushate serbe (Brajshori, 2021).

Që në lobimin për njohje, aleatët e Kosovës kanë ndihmuar drejtpërdrejt e deklaruar edhe njëri nga Ambasadorët e grupit të parë të Kosovës, Kiçmari që thekson se “aleatët kanë qenë në një numër të njohjeve pjesëmarrës të drejtpërdrejtë” duke vënë theksin në rolin primar të ShBA-ve në këtë aspekt, por edhe lobimin britanik, francez e turk, ku si raste ilustruese përmend përvojën personale gjatë shërbimit të tij si ambasador në Vjenë, me ç’rast në situata të ndara ambasadorët e Britanisë dhe Turqisë kanë organizuar takime/tryeza me shtete njohëse dhe jonjohëse për të lobuar dhe diskutuar enkas mbi njohjen e Kosovës (Kiçmari, 2021). Ngjashëm aktivitet lobues dhe bashkëpunues në këtë

segment kanë pasur edhe ambasadat e tjera të Kosovës, por që intensiteti i madh në fillet e pas pavarësisë, me kohë ka shkuar duke u zbehur.

Për nga ndikimi, Shqipëria është shtet i vogël, dhe ndikimi i saj është tejet i kufizuar në raport me ndikimin që aleatët e mëdhenj, e kryesisht ShBA kanë dhënë e mund të japin për Kosovën. Por pavarësisht potencialit, gatishmëria, afërsia dhe siguria në mbështetjen e Shqipërisë është e pakrahasueshme me të tjerët. Prandaj në këtë kontekst, avokimi i saj për Kosovën në forumet, vendet dhe instancat ku ka mundësi është për t'u vlerësuar. Madje shpesh ky lobim i tyre, merret si i mirëqenë dhe i nënkuptueshëm. Ky lobim apo edhe më gjerë asistencë e Shqipërisë filloi që nga çështjet krejt teknike siç ishin dhënia e dokumenteve të përkthyer më parë në gjuhë shqipe apo pajisjet me pasaporta shqiptare të zyrtarëve të lartë shtetërorë të Kosovës, të cilët hasnin në vështirësi në aktivitetet e tyre lobuese gjatë udhëtimeve si rezultat që pasaporta e Kosovës ishte pak e njohur.

Në fakt përgjatë viteve janë realizuar një numër memorandumesh që formalizonin këtë bashkëpunim Kosovë-Shqipëri në kuadër të politikës së jashtme. E tillë ishte Marrëveshja për Bashkëpunim Strategjik në Fushën e Politikës së Jashtme e vitit 2019 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2019) e nënshkruar mes ministrave Pacolli dhe Cakaj që formalizonte ngritjen e bashkëpunimit në nivel strategjik. Aty parashiheshin shkëmbimi, sekondimi i diplomatëve dhe konsujve, mbajtjen periodike të Konferencës së Përbashkët të Krerëve të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore, përfaqësimi reciprok në organizata ndërkombëtare, unifikimi i hapësirave etj. Ministri Cakaj edhe në dhjetor 2020 vizitoi Kosovën ku takoi homologen Haradinaj-Stublla me të cilën nënshkruan tre marrëveshje për bashkëpunim në fushën e politikës së jashtme. Është shumë e rëndësishme që nismat e tilla të kenë zbatueshmëri në praktikë dhe të jenë përherë të koordinuara. Shqipëria në vitet e fundit ka mbyllur disa ambasada, që për Kosovën do të ishin mundësi shumë të mira për të ndërtuar kanale komunikimi me ato shtete. Të tilla janë mbyllja e ambasadës në Indi apo në Bosnje, si dy shtete mosnjohëse të Kosovës.

Nga këto marrëveshje rrjedh edhe një projekt për bashkimin e hapësirave diplomatike dhe konsullore aty ku ka mundësi. Normalisht për arsye të punës, hapësirat diplomatike mund të jenë të përbashkëta por jo puna diplomatike, ndërsa për çështje konsullore është dimension më i ndryshëm dhe i relaksuar. Kjo nuk duhet të konsiderohet që bëhet për arsye politike, pasi mund të përçojë mesazhe jo të duhura, por të përdoret argumenti i ekonomizimit të

kostove, praktikë të cilën e aplikojnë edhe shtete shumë të zhvilluara. Në këtë linjë është bashkimi i konsullatave në Mynih, Kopenhagë, Strugë, Milano, hapësira e përbashkët për ambasadë në Australi, etj.

Rrjeti diplomatik i Shqipërisë në shtetet mosnjohëse të pavarësisë së Kosovës mund të ndihmojë jashtëzakonisht shumë për Kosovën. Shqipëria ka 39 ambasadë (MEFA Albania) në shtete të ndryshme, prej të cilave 9 janë në shtete që nuk e njohin Kosovën. Ngjashëm vlen edhe për misionet e tyre pranë organizatave ndërkombëtare ku Kosova nuk është e pranishme dhe ka vështirësi qasjeje. P.sh. Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Gjenevë nëpërmjet misionit të Shqipërisë më së paku që mund të përfitojë është të mbahet e informuar për zhvillimet brenda këtyre organizatave.

Kujdesi këtu që duhet bërë është që të mos krijohet një argument për kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës, që Kosova nuk ka politikë sovranë, dhe është e subordinuar nga Shqipëria, e cila mund të ketë efekt të dëmshëm në segmente të tjera. Afrimi i Kosovës me Shqipërinë është i pashmangshëm në shumë fusha dhe kjo nuk kontestohet nga askush, por Kosova duhet të tregohet e kujdesshme në segmentin e politikës së jashtme e cila është element crucial i kriterëve të shtetësisë në të drejtën ndërkombëtare, në mënyrë që argumenti serb mbi paqëndrueshmërinë e Kosovës të mos kalojë në narracion dominues në kuintat diplomatike ndërkombëtare.

Rritja e rolit diplomatik të Shqipërisë në vitet e fundit, me udhëheqjen e presidencës së OSBE-së, dhe tani me pjesëmarrjen dhe udhëheqjen rotative të Këshillit të Sigurimit të KB-së, paraqiti mundësi të madhe edhe për Kosovën. Në KS të KB-së rëndom përveç paraqitjeve publike që natyrshëm Shqipëria ka përkrahur Kosovën, ndodhi edhe diplomacia e madhe e prapaskenave dhe joformale, ku Shqipëria mund të sensibilizojë dhe llojojë për njohjen e Kosovës. Në fakt gjatë kësaj periudhe në prill 2022, tema e anëtarësimit të Kosovës në KB, ishte temë diskutimi mes komisioneve parlamentare për punë të jashtme të të dyja shteteve.

Si konkluzë e këtij bashkëpunimi tashmë e mbi një dekadë të shtetësisë së Kosovës, Shqipëria ka qenë e gatshme të ndihmojë Kosovën në shumë aspekte. Efikasiteti i kësaj ndihme ndonjëherë është vënë në pikëpyetje por duhet kuptuar që kjo shkon përtej mundësive reale edhe të shtetit shqiptar. Shembull Shqipëria nuk ka arritur që të ndikojë në pranimin e Kosovës në disa prej organizatave ndërkombëtare ku ajo bën pjesë, pavarësisht

lobimit të faktuar që ka bërë, qoftë në OBI, Kartën e Atlantikut, Këshill të Evropës, NATO etj. Pavarësisht kësaj, diplomatët e Shqipërisë dhe ata të Kosovës janë në koordinim dhe komunikim konstant në shtete të ndryshme ku ata shërbejnë. Këtu vijnë në pah edhe shkathtësitë vetanake të diplomatëve, zhdërvjelltësia, aftësitë komunikuese, aftësitë për të bindur të tjerët, niveli i profesionalizmit dhe tërë korpusi i elementeve që e bëjnë një diplomat të denjë dhe të kompletuar.

Gjithherë kur flasim për bashkëpunim të këtillë, paralel me limitet financiare, kuadroviqe që ekzistojnë te të dyja shteteve, nuk duhet harruar edhe limiti i cili nuk është ndonjëherë i suksesshëm por i cili nuk guxon të tejkalohet në politikën e jashtme. Politika e jashtme është veprimtari sovranë e shtetit, dhe bashkëpunimi me subordinimin duhet të jenë të dallueshme gjatë kësaj veprimtarie.

Gjithashtu Shqipëria si shtet i vogël, aparatën diplomatikë e ka të kufizuar, madje krahasuar me Serbinë dukshëm më të dobët, dhe ka temat dhe agjendat e veta për t'u ndjekur. Natyrisht që Kosova është pjesë e agjendës së tyre, por jo e vetmja siç mund ta kemi ne. Përkundër kësaj, Shqipëria pa asnjë dyshim ka shkuar përtej kapaciteteve të saja diplomatike, reflektuar në pozicionin e saj në Këshillin e Sigurimit, apo udhëheqjen e OSBE-së.

Ecja e Kosovës si shtet që nga shpallja e pavarësisë ka qenë unike. Pavarësisht që nuk ka qenë shteti i vetëm i cili has vështirësi për t'u pranuar në KB, cilësuar si objektiv kryesor për gjitha shtetet jashtë këtij sistemi, megjithatë numri i madh i njohjeve për Kosovën, pranimit dhe përkrahja nga shtetet më të fuqishme në botë, nga shtetet që kanë ndërtuar këtë sistem dhe i kanë dhënë vlerat të cilat e mbajnë stabil sistemin ndërkombëtar, tregojnë për suksesin e Kosovës në këto mbi 14 vite shtet.

Në përgjithësi, Kosova fatmirësisht ka ditur të rreshtohet drejt në aleancat ndërkombëtare dhe kjo iu është shpëguar, me aleatët të cilët kanë shpenzuar energji dhe kapital politik për të ndihmuar suksesin e Kosovës. Ky sukses sot është i përkthyer në 117 njohje, anëtarësime të Kosovës apo trupave të veçanta institucionale në qindra mekanizma ndërkombëtarë të cilat i shtojnë vlerë attributeve të shtetësisë së Kosovës.

## KAPITULLI VI

### 6. INTERVISTAT E REALIZUARA SI METODË SHKENCORE

Si metodë kualitative e hulumtimit shkencor, intervistat cilësohen si metodë për vërtetimin e hipotezave shkencore në shkencat sociale. Marrë në konsideratë temën që e kam në trajtesë, aktualitetin e saj dhe mungesën e literaturës konkrete, bëjnë që rëndësia e intervistave të qëlluara të jenë edhe më të rëndësishme.

Përzgjedhja e të intervistuarve nuk ka qenë e rastësishme, ku në mesin e 12 të intervistuarve janë përzgjedhur persona profesionistë të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare, politikës së jashtme dhe diplomacisë, së drejtës ndërkombëtare, të Unionit Evropian, të drejtës ndërkombëtare etj., në mënyrë që këto intervista të shërbejnë si një aureolë e mjaftueshme për mbulimin e tërë kapitujve teorikë në trajtesë.

Përveç përgatitjeve profesionale dhe akademike, të intervistuarit janë përzgjedhur edhe bazuar në kriterin e përvojës dhe shërbimit që kanë bërë ose e bëjnë e që ndërlihet në funksion të trajtesës.

Për shkak të pandemisë COVID-19, një pjesë e intervistave janë realizuar online, qoftë me e-mail ose Skype, por duke pasur në konsideratë tërë kriteriumin shkencor për të arritur rezultatet e dëshiruara. Kurse pjesa më e madhe janë realizuar në bashkëbisedim tet-a-tet të regjistruara me “regjistruues zëri” të cilat janë në dispozicion për Këshillin.

Të intervistuarit për shërbime të këtij disertacioni janë: Enver Hasani, Edita Tahiri, Sabri Kiçmari, Sami Ukelli, Ibrahim Gashi, Islam Lauka, Muhamet Brajshori, Valon Murtezaj, Kreshnik Ahmeti, Besnik Hoti, Gazmend Gjyshinca dhe Dren Zeka.

Intervistat e dhëna kanë kontribuar në varësi të kapitujve, ndërsa në vijim do të japim një rezyme të tyre, jo në kuptimin transkriptiv të tyre, pasi që përgjigjet e dhëna dhe krahasimi i tyre gjenden të inkorporuara në pjesën teorike aty ku ka qenë e nevojshme, por në kuptimin metodik të përzgjedhjes së tyre. Pra, është bërë me qëllim një ndërthurje metodologjike, ku metoda të ndryshme shkencore: analizuese-sintetizuese, krahasuese, të dokumentacionit dhe historike, janë kombinuar me intervistat e realizuara.

Gjithashtu të intervistuarve iu është ofruar edhe mundësia e të mbeturit anonim për shkak të sensitivitetit në pozicionet ku ata shërbejnë, por asnjëri nuk ka paraqitur që është për një alternativë të tillë.

Pyetjet për të intervistuarit:

1. Si e vlerësoni trajektoren e njohjeve për Kosovën që nga viti 2008?
2. Sa ndikojnë ndryshimi i rrethanave gjeopolitike në njohjet për Kosovën?
3. Mendimi i GJND-së për Kosovën në kontekst të njohjeve të reja?
4. Si ka ndikuar Dialogu në njohjet për Kosovën?
5. Cili është vlerësimi i juaj për fushatën serbe të tërheqjes së njohjeve për Kosovën?
6. Si e vlerësoni rolin e aleatëve në rritjen e numrit të njohjeve për Kosovën dhe në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare?
7. Si i vlerësoni gjasat dhe rrugën e Kosovës për anëtarësim në KB duke e ndërlidhur me Dialogun dhe për anëtarësim në BE duke mos pasur ende njohjen e 5 shteteve anëtare?
8. Si e konsideroni qasjen e politikës së jashtme të Kosovës në raport me rajonet e largëta gjeografike?
9. Si ishte qasja e Kosovës në periudhën e viteve '90-ta?<sup>65</sup>

## **Intervista I**

### **Enver Hasani**

Intervista me prof. dr. Enver Hasanin është realizuar në dhjetor 2020, nëpërmjet e-mailit, për shkaqe të gjendjes së rënduar pandemie dhe shëndetësore të të intervistuarit. Profesor Hasani është përzgjedhur për shkak të lëmisë që mbulon, si profesor i së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kushtetuese, si ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese, anëtar i Komisionit të Venecias dhe ish-ректор i Universitetit të Prishtinës.

Profesor Hasani ka kontribuar ndjeshëm në sqarimin e koncepteve të përdorura në punim, siç është koncepti i shtetit, njohjes në të drejtën ndërkombëtare, tërheqjes së njohjes.

---

<sup>65</sup> Pyetja numër 9 iu është shtruar të intervistuarve: Edita Tahiri dhe Sabri Kijçmari për shkak të rolit të tyre në atë periudhë.



Profesori nuk është kufizuar vetëm në aspektin teorik, por ka dhënë refleksionet e tij praktike mbi temat e trajtuara.

Me rëndësi të posaçme ka qenë kontributi i profesorit në pjesën ku Kosova është trajtuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke i bërë një analizë e cila inkorporohet në punim në pjesën përkatëse. Analiza juridike dhe politike e kësaj çështje, duke e ndërlidhur dhe me Marrëveshjen e Uashingtonit 2020, janë kontribut i tij në këtë disertacion.

## **Intervista II**

### **Edita Tahiri**

Intervista e radhës është realizuar me profesoreshë Edita Tahirin, kryenegociatore e Kosovës në dialogun me Serbinë.

Përzgjedhja e saj jo e rastësishme, për shkak të kontributit të saj disadekadësh dhe pjesëmarrjen aktive në proceset e Kosovës, që nga vitet '90 të operimit të saj si ministre e jashtme në një qeveri që nuk njihej ndërkombëtarisht, e deri në pjesëmarrjen e saj si kryenegociatore dhe ministre në dialogun teknik dhe më vonë të atij politik me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, mes Kosovës dhe Serbisë.

Fokusi kryesor i parashtrimit të pyetjeve dhe diskutimeve ka qenë sigurisht periudha e Dialogut Kosovë-Serbi, procesit integruar të Kosovës në BE, i cili për nga kompleksiteti është mjaft sui generis, por gjithëherë këto të ndërlidhura me procesin e njohjes së Kosovës.

Si ka ndikuar Dialogu në njohje të Kosovës, si ndodhën orientimet dhe keqinterpretimet e dialogut, të bëra në mënyrë të qëllimshme nga Serbia dhe cila është përgjigja që institucionet e Kosovës kanë dhënë dhe si realisht diplomacia e Kosovës duhet në kontinuitet t'i përgjigjet këtyre proceseve janë në vatër të përgjigjeve të znj. Tahiri.

## **Intervista III**

### **Sabri Kiçmari**

Profesor Sabri Kiçmari, si profesor universitar, ambasador i karrierës dhe më parë si përfaqësues diplomatik i UÇK-së, ka qenë një gjetje e duhur për kontribut metodologjik dhe përmbajtësor në disertacion. Intervista me të është realizuar drejtpërdrejt në regjistruar zëri dhe është më e gjata në mesin e intervistave të kësaj natyre.

I intervistuari është pyetur dhe ka dhënë përgjigjet në pyetjet e parashtruara mbi përfaqësimin diplomatik që ka bërë në kohë lufte. Kjo ka qenë e rëndësishme për një pjesë të ngushtë të punimit, që ka qenë përcaktuese si hyrje në kapitullin e dytë teorik. Ka qenë e rëndësishme të kuptohet shkalla e vështirësisë, niveli negocues, teknikat e përdorura në atë kohë, të cilat pa dyshim që si të tilla kanë shërbyer dhe mund të shërbejnë edhe në epokën pas-pavarësi. Protodiplomacia e asaj kohe, siç njihet në zhargonin teorik, është edhe një shkallë më e vështirë se diplomacia e një entiteti që nuk njihet universalisht, siç është Kosova.

Si Ambasador i karrierës, në valën e parë të ambasadorëve të dërguar, Kiçmari ka dhënë kontribut të vyeshëm në të gjitha fazat e procesit të njohjeve për Kosovën dhe në proceset e aplikimeve për anëtarësime në organizata ndërkombëtare. Përvoja e tij, e ndarë me ne, në misionet e tij në Vjenë dhe Kanbera kanë kontribuar përmbajtësisht në pasurimin e punimit pikërisht në thelbin e saj, të qasjes së një entiteti që nuk njihet në raport me ato subjekte ndërkombëtare që nuk e njohin pavarësinë e këtij entiteti.

#### **Intervista IV**

##### **Sami Ukelli**

Intervista me ambasador Sami Ukelli është realizuar drejtpërdrejt me regjistrues zëri.

Përzgjedhja e ambasadorit Ukelli për intervistë ka ndodhur për shkak të përvojës së tij të gjatë në diplomaci. Para pavarësisë së Kosovës, z. Ukelli ka shërbyes në ministrinë e punëve të jashtme të Austrisë dhe vëmendja austriake përherë ka pasur në fokus zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, gjegjësisht në shqiptarosferë. Pas pavarësisë së Kosovës z. Ukelli ka shërbyes si ambasador i Kosovës në Tokio, në Budapest, Vjenë dhe në Bern, gjithashtu duke mbajtur për një kohë të caktuar pozitën e drejtorit të përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.

Duke qenë përherë në vijën e parë të diplomacisë, kontributi i tij nga shumë pozicione për lobimin dhe qasjen e Kosovës për njohje, bashkëpunimin me aleatë dhe tentimet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare ka qenë tejet i rëndësishëm pothuaj për tërë kapitujt trajtues të disertacionit tim.

Ai ka trajtuar dhe kontribuar në disertacion edhe mbi rolin e aleatëve që Kosovës i kanë dhënë në këto procese të politikës së jashtme. Këndvështrimi i tij interesant mbi këtë temë

mbi oshilacionet e mbështetjes ndaj Kosovës dhe ndërlidhjen e kësaj me veprimet e institucioneve të Kosovës është unik dhe i vlefshëm për punimin.

## **Intervista V**

### **Ibrahim Gashi**

Përzgjedhja e prof. dr. Ibrahim Gashit ka rezultuar tejet e qëlluar për trajtimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të ngritura në punim. Edhe kjo intervistë është e realizuara tet-a-tet me regjistrues zëri, mbajtur në zyrën e profesorit në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në janar 2020.

Përvoja e profesorit, si profesor universitar në Departamentin e Shkencës Politike, përvoja e tij si kryetar në komisionin për punë të jashtme në parlamentin e Kosovës, pikërisht në kohën e shpalljes së pavarësisë dhe fazën e parë pas saj ku Kosova përballej me valën e njohjeve të mëdha, por edhe kundërshtimet e Serbisë që rezultuan me dërgimin e çështjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë kanë qenë disa nga fokusimet gjatë intervistës. Gjithashtu rëndësi i është kushtuar kohës kur profesori Gashi ka pasur pozicion të lartë në ekzekutiv, gjegjësisht si zv. ministër i punëve të jashtme të Kosovës, gjë që na ka pasuruar punimin e teknikalitete të negociimit dhe operimit diplomatik të Kosovës për të fituar njohje dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Profesori Gashi gjithashtu ka dhënë refleksionet e tij mbi aktualitetin gjeopolitik dhe kahjet e politikës së jashtme të Kosovës, përfshirë, përmbylljen e procesit të njohjeve, problematikën e tërheqjes së njohjeve, dhe mundësive për anëtarësim në KB.

## **Intervista VI**

### **Islam Lauka**

Intervista me autorin dhe diplomatin e Shqipërisë Islam Lauka, është realizuar nëpërmjet e-mailit për shkaqet objektive të ndërlidhura me pandeminë.

Katër çështjet që janë trajtuar dhe përgjigjet e dhëna kontribuojnë substancialisht në disertacion:

1. Si ambasador i Shqipërisë në Kosovë, vlerësimet në bashkëpunimin e atëhershëm Kosovë-Shqipëri në kontekst të njohjeve ndërkombëtare të Kosovës dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Në cilat organizata apo te cilat shtete specifike, Shqipëria ka ndihmuar ose mund të ndihmojë Kosovën të fitojë njohje të reja? Shërbimi i përbashkët diplomatik-konsullor a është i duhur dhe në funksion të ngritjes cilësore të lobimit të Kosovës;
2. Opinioni i GjND-së për shpalljen e pavarësisë në kontekst të njohjeve për Kosovën;
3. Impakti nga Dialogu Kosovë-Serbi në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. A mundet Dialogu të prodhojë njohje për Kosovën?;
4. Ndryshimi i rrethanave gjeopolitike (rritja e rolit të Rusisë paraqitur dhe në librat e autorit Lauka) dhe ndikimi i tyre në pozicionimin ndërkombëtar të Kosovës. Rruga për në KB, integrim evropian dhe njohje të reja.

## **Intervista VII**

### **Muhamet Brajshori**

Z. Brajshori si diplomat karriere në pozita të ndryshme ka qenë i kyçur drejtpërdrejt në shumicën e proceseve që ka kaluar vendi në politikën e jashtme. Pjesëmarrja në grupe punuese për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, pozita si Ambasador në Tajlandë, pozita si zëvendësministër, pastaj në grupin për lobim për njohje dhe në grupin për kundërvënje ndaj fushatës së Serbisë për tërheqjet e njohjeve kanë bërë që kontributi i intervistës me z. Brajshori të jetë tejet i vyeshëm për këtë disertacion.

Z. Brajshori ka pasuruar punimin me detaje të cilat nuk kanë qenë në media publike deri më tani. Lobimi për njohje në një sërë vendesh të gjeografive të largëta, të cilat bëheshin larg syve të publikut por për të pasur sukses dhe për të fituar njohje varionin nga një takim deri në procese.

## **Intervista VIII**

### **Valon Murtezaj**

Intervista me Valon Murtezajt është realizuar në takim tet-a-tet me anë të regjistruarit të zërit. Z. Murtezaj është përzgjedhur për shkak të pozicionit të tij si profesor universitar i

diplomacisë në Paris, si anëtar i kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe si ish-zëvendësministër i punëve të jashtme.

Për shkak të disa pozicioneve të mbajtura, intervista me z. Murtezaj është fokusuar në rrafshin teorik dhe praktik të politikës së jashtme. Përgjigjet e dhëna si profesor universitar i kontribuojnë temës në sqarimin e koncepteve por edhe të orientimit të të bërit politikë të jashtme shteti i Kosovës, gjegjësisht atë çka e kemi në fokus të disertacionit. Të qenurit pjesë e ekzekutivit, si zv. ministër i punëve të jashtme, roli praktik në ballafaqimin me situata të ndryshme në qasje ndaj subjekteve jonjohëse, duke trajtuar edhe temat e gjeopolitikës botërore dhe lidhjen e tyre me ecjen e Kosovës si shtet, ku përgjigjet në të tilla pyetje janë me rol të madh në ngritjen e nivelit të disertacionit.

## **Intervista IX**

### **Kreshnik Ahmeti**

Edhe kjo intervistë për shkaqe pandemie është zhvilluar nëpërmjet e-mailit, ku të intervistuarit me kujdes i janë paraqitur pyetjet, duke qenë koshient për mënyrën e parashtrimit metodologjik të tyre në realizimin e intervistave të tilla me e-mail, që nuk janë të lehta të realizohen metodologjikisht.

Kreshnik Ahmeti, është sekretar për marrëdhënie me jashtë i subjektit kryesor politik në vend, Lëvizjes Vetëvendosje, ka paraqitur refleksionet e subjektit që takon mbi orientimet politike dhe ideologjike të këtij subjekti politik, që deri më tani nuk ka qenë shumë i involvuar në të bërit politikë të jashtme, por që me fitimin e zgjedhjeve në Kosovë, pashmangshëm do të jetë akteri kryesor në politikën e jashtme në vend. Z. Ahmeti njëkohësisht ka shërbyer në pjesën e parë të vitit 2020 si shef i kabinetit të ministri i punëve të jashtme z. Konjufca, dhe intensiteti dhe aktivitetet e bëra gjatë asaj periudhe janë diskutuar. Aktualisht mban pozitën e zv. Ministrit për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Qasjet ndaj marrëveshjes së Uashingtonit, dialogut Kosovë-Serbi, fushatës së tërheqjes së njohjeve për Kosovën dhe mundësive për aplikim për anëtarësim në organizata ndërkombëtare janë ndër temat e trajtuara në intervistë.

## **Intervista X**

### **Besnik Hoti**

Intervista me Besnik Hotin, ligjërues në kolegjin universitar në Kosovë mbi lëndët e politikës së jashtme, ish-zëvendësministër i punëve të jashtme dhe për një periudhë këshilltar i ministrit Pacolli është realizuar nëpërmjet e-mailit për shkaqe pandemie.

Intervista me profesor Hotin është fokusuar në kohën kur ai ka qenë në pozicion të zv. ministrit në dikasterin konkret të politikës së jashtme, të portofolios që ka mbuluar edhe rolin e tij në të bërit politikë të jashtme të Kosovës, tërë kjo përherë në funksion të hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të disertacionit.

Gjithashtu për shkak të angazhimeve të tij në lobin shqiptar në Amerikë, pashmangshëm kontributi i tij si i intervistuar është dhënë edhe në pjesën teorike ku trajtohet bashkëpunimi i Kosovës me aleatët në politikën e jashtme ndaj subjekteve ndërkombëtare që nuk e njohin Kosovën. Për shkak të profilit, me z. Hoti është biseduar pra për lobimin e Kosovës në Amerikë, rëndësinë e aleatëve në sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën, dhe në rolin e tyre në lobimin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Ndryshimet gjeopolitike, përshtatshmëria dhe orientimet e politikës së jashtme të Kosovës në këto ndryshime, kanë qenë gjithashtu në fokus të intervistës.

## **Intervista XI**

### **Gazmend Gjyshinca**

Intervista me z. Gjyshinca është realizuar në takim të drejtpërdrejtë me regjistrues zëri.

Përzgjedhja për intervistë e z. Gjyshincës ka qenë për shkak të përgatitjes së tij akademike në shkollimin e tij jashtë vendit në lëmin e politikës së jashtme si dhe funksioneve që mban në politikën e Kosovës, si deputet në Kuvendin e Kosovës, anëtar në komisionet parlamentare, atij për Politikë të Jashtme si dhe atij për Integrim Evropian. Z. Gjyshinca gjithashtu është anëtar në Këshillin e Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje.

Z. Gjyshinca ka lundruar në temat e organizimit të ministrisë së punëve të jashtme dhe të aparatit diplomatik për një politikë të jashtme efikase dhe rezultatitve. Gjithashtu z. Gjyshinca ka dhënë refleksionet e tij mbi aktualitetin e politikës së jashtme dhe orientimet se si duhet Kosova t'u qaset temave të ndryshme si Dialogu, njohjet apo anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.

## **Intervista XII**

## **Dren Zeka**

Intervista me z. Dren Zeka është realizuar në takim të drejtpërdrejtë me regjistrues zëri.

Përzgjedhja e tij ka kontribuar konkretisht në kapitullin ku është trajtuar efekti në njohje nga dialogu Kosovë-Serbi, pasi z. Zeka ka qenë anëtar në delegacionin negocues të Kosovës. Gjithashtu të qenurit diplomat i karrierës në Kosovë, me të janë diskutuar çështje të aktualitetit në të bërit politikë të jashtme të Kosovës. Reflektimet e tij mbi këto procese e kanë pasuruar më tej punimin dhe ngritur nivelin argumentues të hipotezave të disertacionit.

Siç është paraqitur edhe gjatë trajtesës, z. Zeka argumenton bindshëm që Dialogu ka ndikuar në rritjen e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, duke i sjellë një sërë njohjesh dhe anëtarësim të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Më këtë ai i kundërvihet tezave që Dialogu ka stopuar arritjen e subjektivitetit ndërkombëtar për Kosovën.

## PËRFUNDIM

Politika e jashtme e Kosovës në raport me subjektet ndërkombëtare që nuk e njohin subjektivitetin e saj është tema e cila është trajtuar në këtë disertacion doktore. Dilema e parë e cila më ka shoqëruar gjatë ideimit të temës ka qenë se a ka dhe a mund të quhet politikë e jashtme veprimtari që zhvillohet ndaj shteteve që nuk të njohin? Përgjigja ime studimore është që elementet e politikës së jashtme janë prezente në qasjen e një shteti ndaj subjekteve që nuk e njohin. Vetë kjo trajtesë gjatë tërë përmbajtjes së saj e dëshmon politikën e jashtme të Kosovës kundruall shteteve nga të cilat nuk njihet, politikë e jashtme e udhëhequr nga Ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë që ka bërë që nga themelimi i saj në filllet e para pas shpalljes së pavarësisë e që vazhdon ta bëjë edhe sot.

Hipotezë kryesore të punimit, që më ka shoqëruar në secilin hap të trajtesës, qoftë gjatë hulumtimeve të literaturës, të dokumenteve por duke e pasur parasysh edhe gjatë realizimit të intervistave, ka qenë “Ngecja e njohjes së plotë të Kosovës në arenën ndërkombëtare konsiderohet të jetë si pasojë e pozicionimit gjeostrategjik të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare duke determinuar gjetjen e formave alternative të të bërit politikë të jashtme për Kosovën”. Fakti themeltar se si u bë Kosova si shtet i ri, i themeluar në koordinim me aleatë ndërkombëtarë, por jo në kuadër të sistemit të KB-së si sistem botëror i shteteve në epokën moderne, e vuri në një bazament detyrimisht alternativ të themelimit, rrjedhimisht veprimit të saj si shtet i ri. Kjo e përcolli Kosovën në tërë këtë periudhë të post-2008, gjegjësisht e impaktoi politikën e jashtme të saj.

Nuk është që nuk janë krijuar shtete të tjera me elemente të ngjashme se si është formuar Kosova, pasi nuk e quaj në mënyrë të njëjtë, sepse faktet theksojnë që Kosova u formua në mënyrë të veçantë krahasuar me shtetet apo quazi-shtetet e tjera jashtë sistemit të KB-së, pavarësisht debatit se secili rast është *sui generis* dhe me elemente ndryshe nga të tjerët. Kosova ishte pjesë e sistemit federativ të Jugosllavisë, fatkeqësisht ajo nuk arriti të fitojë pavarësinë në procesin e Badinterit, por që është vazhdimësi e “shpërbërjes” së njësive të Federatës Jugosllave. Kosova përjetoi politikë gjenocidale nga ana e pushtetit serb, duke nxitur një ndërhyrje ndërkombëtare humanitare në Kosovë e cila ishte edhe legale edhe legjitime, pasi kjo ndërhyrje erdhi pas gjenocidit në Srebrenicë dhe në Ruanda dhe përpjekjeve të faktuara për gjenocid edhe në Kosovë si dhe dështimit të negociatave, dhe



sipas Kapitullit VIII të Kartës së KB-së një shtet apo organizatë rajonale mund të ndërhyjë në një shtet për të ruajtur paqen.

Parimi Përgjegjësia për të Mbrojtur (R2P) është Parim i KB-së i cili u konkretizua pas ndërhyrjes humanitare në Kosovë por që askund më mirë se në Kosovë nuk e ka arsyetuar ndërhyrjen, përkundër keqpërdorimeve të këtij parimi që ka mundur të ndodhë në periudha të mëvonshme. Procesi i veçantisë së Kosovës ishte i pranuar edhe nga kundërshtarët e pavarësisë, gjegjësisht Rusia gjatë negociatave të Vjenës në kuadër të Parimeve të Grupit të Kontaktit, ku theksohet që nuk do të ketë kthim prapa në periudhën e para 1999 dhe nuk do të ketë ndarje apo bashkim me ndonjë shtet tjetër. Megjithatë dështimi i Rosisë që të inkuadrohet në pranimin e Pakos së Ahtisaarit në KS të KB-së, imponoi alternativën me të cilën edhe sot e kësaj dite Kosova është duke lundruar në politikën e jashtme.

Pra, vetë procesi deri në pavarësinë e Kosovës dhe akti i shpalljes më 17 Shkurt 2008, ndodhi në një konstelacion të caktuar gjeopolitik, që në mënyrë të hapur e vërteton hipotezën kryesore që ngecja në njohje është rezultat i pozicionit gjeostrategjik të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Megjithatë konstelacioni ndërkombëtar nga 2008 ka ndryshuar shumë. Këtë e kanë thënë edhe të intervistuarit në hulumtim (Ukelli, Ibrahim, Brajshori, Hasani, Kiçmari) të cilët ndërlidhin mungesën e njohjeve në vitet e fundit, pastaj fenomenin e tërheqjes së njohjeve, rrjedhimisht edhe mungesës së votave pra dështimit për anëtarësim në organizata ndërkombëtare me konstelacionet e reja ndërkombëtare. Zatën ndryshimet në marrëdhënie ndërkombëtare janë konstante, ku shpejt pas shpalljes së pavarësisë, Rusia me një lëvizje e cila nuk u mendua më parë që do të ndodhte, pushtoi Gjeorgjinë, e njohu pavarësinë e Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut. Kjo menjëherë u reflektua në numrin e njohjeve për Kosovën, ku në arsyetime të mosnjohjes përmendeshin paralelet me këto krahina gjeorgjiane që tani funksiononin defakto si të pavarura. Madje para ndërhyrjes ruse të gushtit 2008, Polonia kishte hezitime për të njohur Kosovën si rezultat i problemeve Gjeorgji-Rusi.

Rritja e influencës politike e financiare ruse e asaj kineze, problemet me të cilat ballafaqohej Bashkimi Evropian që nga kriza ekonomike, kriza e refugjatëve, kriza politike e rritjes së të djathtës ekstreme e kulmuar me BREXIT, rritjet e lëvizjeve separatiste në disa shtete evropiane e pastaj oshilimet në politikën e jashtme amerikane si rezultat i administratës

Trump e deri te terrorizmi ndërkombëtar kanë dhënë efektet e tyre në mundësinë dhe efikasitetin e politikës së jashtme vendore.

Mirëpo siç kemi argumentuar, është vështirë të bëhet një prerje e plotë mes politikës së jashtme dhe asaj të brendshme. Vetë jostabiliteti politik në Kosovë që së pari u shfaq më 2010, pastaj u rikthye në një formë edhe më të ashpër më 2014 e vijoi më tutje, ndikoi jashtëzakonisht shumë në diplomacinë ende të brishtë të shtetit të Kosovës. Këto ishin momentume të cilat Kosova nuk i shfrytëzoi si duhet dhe pasojat e kësaj nuk ishin te vendqëndrimi në politikën e jashtme, por një regres i cili komplikoi edhe më tutje rrugën për të arritur objektivat të cilat i kishin përcaktuar hartuesit dhe ekzekutuesit e politikës së jashtme. Në vitin 2010 ishim në krizë si rezultat i dorëheqjes së presidentit dhe rrjedhimisht shkuarjes në zgjedhje, duke mos arritur ta kapitailzojmë opinionin e GjND-së për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kurse ngërçi politik i vitit 2014 dhe jostabiliteti që pasoi u reflektua në dështimin më të dhimbshëm dhe me koston më të lartë diplomatike deri më tani për Kosovën, dështimin për anëtarësim në UNESCO, i cili reflektoi pastaj edhe në proceset e tjera që pasuan. Shumë autorë edhe nga të intervistuarit e marrin këtë moment si një moment që ndan dy epoka në diplomacinë e Kosovës. Ngjashëm është diskutuar mbi jostabilitetin e qeverive në vitet 2019-2021 (katër qeveri të ndryshme) dhe humbjen e momentumit për arritje të një marrëveshje finale me Serbinë.

Një nga qëllimet e disertacionit ishte që të ofrojë një pasqyrim analitik, krahasues e sa më të plotë mbi politikën e jashtme të Kosovës. Për ta bërë këtë, në kapitullin e parë përmbledhurazi është shtruar dhe shtjelluar debati mbi njohjen si teori në të drejtën ndërkombëtare. Pavarësisht trajtimit nga autorë të shumtë të këtij segmenti të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare publike, megjithatë njohja është nocion i cili ende është i diskutueshëm edhe në rrethet shkencore.

Ngjashëm është edhe me nocionin e tërheqjes së njohjes, i cili si nocion ka hyrë më vonë në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare, megjithatë i trajtuar por më pak i definuar nga autorët. Komplexiteti i marrëdhënieve ndërkombëtare sot ndikon në zhvillimin e teorisë të së drejtës ndërkombëtare. Këtu kemi të bëjmë me rritjen e numrit të aktorëve, jo vetëm të shteteve si aktorë kryesorë që krahasuar me një shekull më parë është rritje rapide, por theksi është te aktorët joshtetërorë të cilët gjithnjë e më shumë po marrin teren në kuadër

të marrëdhënieve ndërkombëtare, pavarësisht që politika e jashtme mbetet veprimtari ekskluzivisht shtetërore, por ndikimi në të nuk është ekskluziv.

Si rrjedhojë, synimi im nuk ka qenë për të mbuluar këtë debat në mënyrë gjithëpërfshirëse, pasi nuk do të mjaftonin vëllime të tëra vetëm për atë problematikë të së drejtës ndërkombëtare, por paraqitja e një analize aq sa për të mjaftuar për vijimin në kapitujt e tjerë përmbajtësor të disertacionit.

Shtjellimi i evoluimit të Kosovës, gjegjësisht politikës së jashtme të saj në aspekt të njohjes, është realizuar në kapitullin e dytë. Kosova në kuadër të institucioneve paralele gjatë viteve '90 kishte ministrinë e jashtme, pastaj edhe përfaqësuesit diplomatikë të UÇK-së që si instrumente më shumë sensibilizuese diplomatike sesa që mund të ishin aparat diplomatik dhe politikë e jashtme e mirëfilltë. Edhe në periudhën e administrimit ndërkombëtar, Kosova nuk funksiononte si shtet dhe rrjedhimisht nuk kishte ministri të jashtme (Kosovën e përfaqësonte UNMIK-u), por vetëm një zyre në kuadër të Kryeministrit. Megjithatë aktiviteti në arenën ndërkombëtare që zhvillohej, sidomos ishte i orientuar në procesin negociues të Vjenës për shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe në fitimin e përkrahjes ndërkombëtare për një status të pavarësisë për Kosovën. Ky lloj aktiviteti i një entiteti që ende nuk është shtet, është i njohur si paradiplomaci.

Për secilin shtet me shpalljen e pavarësisë shtrohet nevoja për fitimin e njohjes ndërkombëtare nga shtetet ekzistuese. Për Kosovën ky proces u orientua drejt kërkimit të njohjeve bilaterale (njohja nga Serbia si synim i veçantë) në qëllim të arritjes së numrave për anëtarësime në organizata ndërkombëtare, deri në krijimin e momentumit për një njohje të plotë dhe anëtarësim në KB. Këto qëllime strategjike edhe më 2022 mbetën të njëjta. Ku objektivi ende është i paarritur për Kosovën por procesi që ka ndodhur me Kosovën ka pasur uljet dhe ngritjet si rezultat i temave të njëpasnjëshme me të cilat ballafaqohej Kosova dhe që diktonte dhe ritmin e politikës së jashtme të vendit. Shpejt pas pavarësisë, kur ritmi i njohjeve për Kosovën ishte i lakmueshëm në krahasim me periudhat e mëvonshme, Serbia e sfidoi aktin e shpalljes së pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, nëpërmjet KB-së. Kosova nëpërmjet asistencës së aleatëve të saj, arriti që ta fitojë rastin në GjND, me verdiktin e shpallur në korrik 2010. Prosesi që pasoi ishte rezoluta e KB-së që mandatoi fillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim të BE-së. Me anë të Dialogut u mendua që do të akomodoheshin mosmarrëveshjes mes dy vendeve që

potencialisht do të çonte në një zhblokim të luftës diplomatike mes palëve, duke arritur një marrëveshje. Mirëpo zhargitja e dialogut dhe qorrsoaku që hyri ajo pavarësisht marrëveshjeve të arritura në kuadër të saj, rrjedhimisht e sfidoi seriozisht tempon e njohjes për Kosovën, pasi tani ndërlidhja e njohjes ndërkombëtare për Kosovën dhe dialogut ishte e paevitueshme.

Përkundër që këtë Dialog nuk mund ta shikojmë me prizmin bardh e zi, për shkak që siç argumentojnë dhe disa intervistues që nëpërmjet saj Kosova arriti të gjejë mënyra për depërtim në një sërë organizatash ndërkombëtare dhe arriti t'i sigurojë disa njohje, por Dialogu gjithashtu instrumentalizohej nga pala serbe dhe kundërshtarët e tjerë të pavarësisë në funksion të minimumit të shtetësisë së Kosovës, gjegjësisht stopimin e njohjeve për Kosovën. Pas ca viteve kjo betejë diplomatike dhe ndërlidhje me dialogun kaloi në një dimension të ri, atë të tërheqjes së njohjeve që po i bëheshin Kosovës, dhe përpjekja për relativizimin dhe kundër-reagimin nga pala kosovare. Prandaj ndikimi i Dialogut Kosovë-Serbi në politikën e jashtme të Kosovës që 11 vite është bërthama ndikuese që dikton politikën e jashtme të Kosovës, e cila shpenzon një energji të madhe të institucioneve të Kosovës, pavarësisht gatishmërisë së tyre për t'u përballur me këtë temë, që deri më tani ka rezultuar e pamundur për ta shmangur. Prandaj menaxhimi dhe rezultati i Dialogut apo Negociatave shikohet si çelësi i mundshëm që do të mund t'i japë Kosovës një shtysë drejt njohjeve dhe anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare, të cilat me qasjen tradicionale janë thuajse të stopuara, ku nga katër vite kemi vetëm 1 njohje edhe ajo e arritur si rezultat i marrëveshjes së Uashingtonit në shtator 2021.

Ekziston një pajtueshmëri e gjerë që Kosova nuk ka alternativë ndaj integritit në BE. Ky konstatim është edhe reciprok, që nga ana e BE-së për Kosovën ka ardhur që para shpalljes së pavarësisë me sigurimin ndaj "perspektivës evropiane të Kosovës". Përkundër që diskursi i BE-së në raport me Kosovën dhe rajonin me raste ka qenë më i zbehur si zotim, asnjëherë nuk është braktisur tërësisht qëllimi që Kosova dhe Ballkani Perëndimor janë të destinuar për në BE. Në trajtesë është diskutuar ky relacion duke u ndalur pastaj në qasjet bilaterale që Kosova ka me shtetet e BE-së. Raporti Kosovë me shtetet e BE-së, qoftë të atyre që njohin Kosovën, apo të katër shteteve që ende nuk e kanë bërë këtë, bie në një spektër të gjerë të llojllojshmërisë së raporteve. Përderisa Kosova ka aleatë të fuqishëm nga shtetet e BE-së, ka prej tyre që përveç marrjes së njohjes nuk është shënuar ndonjë relacion i gjerë e

madje as lidhje të marrëdhënieve diplomatike. Në anën tjetër edhe shtetet mosnjohëse kanë divergjencat e tyre. Përderisa Qipro është një refuzuese mjaft strikte ndaj Kosovës, Sllovakia në periudhën e fundit sidomos Greqia janë shtete që ndonëse nuk kanë bërë hapin formal drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës, intensiteti i kontakteve është i konsiderueshëm.

Në disertacion është vërtetuar dhe një nga hipotezat ndihmëse që qasja e Kosovës vështirësohet në raport të drejtë me largësinë gjeografike të subjekteve që e kontestojnë, duke e bërë të nevojshëm planifikimin e duhur për qasje në regjionet e largëta. Qartazi Kosova ka shënuar problem për t'u qasur në gjeografitë e largëta, ose së paku qasja e Kosovës nuk ka qenë e mjaftueshme për të rivalizuar në aparatën e shtrirë gjerësisht të Serbisë edhe në rajone të largëta gjeografike që kalon kondiktat e një shteti të vogël. Shtete të shumta që nuk e njohin Kosovën në Amerikën Latine, në Afrikë dhe në disa pjesë të Azisë e kanë determinuar edhe pamundësinë e Kosovës për ta shtrirë rrjetin e vet diplomatik në ato rajone, duke vërtetuar kështu hipotezën e tretë ndihmëse se shtrirja gjeografike e aparatit diplomatik dhe konsullor është e varur në raport të drejtë me numrin e njohjeve nga rajone specifike. Nga këto rajone të largëta pastaj kanë ardhur edhe kontestimi apo tërheqja e njohjeve që iu është bërë Kosovës, pavarësisht që në masë të madhe këto janë demantuar pastaj, për meritë edhe të angazhimit diplomatik të Kosovës, e me raste edhe të aleatëve tanë. Kosova duhet ta ketë të zhvilluar edhe një lloj "inteligjence emocionale në nivel shtetëror", pra një lloj empatie ndaj mendimeve, qëndrimeve dhe karaktereve të shteteve të tjera me të cilat ndërvepron, qofshin shtete njohëse apo jonjohëse.

Një ndër objektivat e politikës së jashtme të Kosovës që nga pavarësia ka qenë anëtarësimi i plotë në mekanizmat multilateralë si segment i rëndësishëm i diplomacisë në epokën moderne. Statutet e ndryshme të organizatave ndërkombëtare, konstelacionet brenda anëtarëve, qasja e Kosovës janë prej faktorëve determinues që kanë sjellë statusin e Kosovës në organizata të ndryshme në të cilat ka aplikuar për anëtarësi. Anëtarësi i plotë, anëtar vëzhgues, anëtar i asociuar, anëtar por me përdorim të fusnotës, i përfaqësuar nga UNMIK-u, zhagjitje në procedura e burokraci për pranim, dështim në marrjen e votave apo refuzim të aplikimit janë disa nga rezultatet apo statusi i Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Kosova pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare pavarësisht statusit në to, qoftë edhe në cilësinë e të ftuarit si mysafir e ka shfrytëzuar për lobim për njohje. Kjo ka rezultuar të jetë një formë alternative e arritjes së kontaktit deri te vendet mosnjohëse, të cilat janë ndjerë më të relaksuara që me përfaqësuesit nga Kosova të takohen në margjina të forumeve ndërkombëtare. Kjo lloj diplomacie, e cila për nga intensiteti më i lartë ka qenë e pranishme gjatë mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së, ku edhe me ndërmjetësim të aleatëve tanë janë aranzhuar takime të tilla, ka pësuar një zbehje në periudhën e pandemisë për shkak të aplikimit të formatit të takimeve online në të cilët Kosova nuk kishte mundësitë të qasjes.

Dhe pikërisht është KB, organizata panbotërore e cila është synimi strategjik i Kosovës për t'u anëtarësuar. Kjo me synimin që të marrë "legjitimitetin" i cili pastaj nuk do të mund të kontestohet nga shtetet e veçanta apo atë kontestim do ta bënte jorelevant. E përkundër që ky mosanëtarësim në KB nuk është në mënyrë absolute barometër i shtetësisë në të drejtën ndërkombëtare, megjithatë rëndësia e të qenurit anëtar i KB-së është i pakontestueshëm në sistemin ndërkombëtar në këtë epokë.

Proceduralisht vështirësia e Kosovës për anëtarësim në KB nuk është vetëm kontestimi i Serbisë si shtet që pretendon sovranitet mbi Kosovën, por është Këshilli i Sigurimit, gjegjësisht vota pro ose abstenuese e anëtarëve të përhershëm të saj, që është akt i patejkalueshëm në procesin e pranimit të një shteti në KB. Rreziku nga një veto ruse apo kineze është skenar tejet real me të cilën mund të përballet Kosova, e kjo edhe në rast të një ujdje eventuale me Serbinë.

Përgatitja e stafit të specializuar është shumë me rëndësi për Kosovën. Përkundër deficitit profesional kuadrovik, ku në misionet e Kosovës (ngjashëm sikurse në gjitha misionet e shteteve të vogla) ka pak staf, dhe u duhet të mbulojnë një gamë të gjerë detyrash, megjithatë është shumë me rëndësi që të përgatiten diplomatë të karrierës të specializuar për organizata ndërkombëtare specifike, për tema specifike (diplomaci publike, diplomaci ekonomike, negocim), për rajone të caktuara të cilët njohin në mënyrë gjithëpërfshirëse gjeografi të caktuara në të gjitha dimensionet. Kjo do t'i shërbente maksimalizimit e profitit në politikën e jashtme nga variablat e varura. Bashkëpunimi i diplomatëve të karrierës nga rangjet e ulëta deri në ambasadorë me ambasadorët e emëruar nga çelësi politik dhe me stafin politik të ministrisë sipas bazës ligjore është prerogativë e një politike të jashtme

efikase. Gjenezja e kësaj është në rekrutimin e stafit të diplomatëve të rinj dhe emërimi i kuadrove të dëshmuar si staf politik, pasi në të kundërtën dëmi që mund të shkaktohet nga çoroditjet strukturore dhe kuadrovike përbrenda ministrisë mund të jenë fatale dhe vështirë të riparueshme në nismat e politikës së jashtme.

Tërë ky aktivitet shumëdimensional në politikën e jashtme të Kosovës, në të cilën përveç shtetit si aktor kryesor, kanë qenë të përfshirë duke dhënë kontribut edhe aktorët e tjerë joshtetërorë në mënyrë të transformimit dhe angazhimit të Kosovës si shoqëri e si shtet që të jetë sa më prezente në marrëdhënie ndërkombëtare, do të ishte minor pa përkrahjen e aleatëve. Në krye të herës është angazhimi i ShBA-ve, për të bindur pastaj dhe shtetet e tjera që të jenë në "bord" si Anglinë, Gjermaninë, Francën, Italinë, Japoninë, Turqinë, etj. që të jenë përkrah projektit të pavarësisht dhe lobimit për fitim të subjektivitetit ndërkombëtar për Kosovën.

Kjo ka mundësuar që Kosova si shtet i ri të rrisë numrin e njohjeve ndërkombëtare si rezultat i lobimit të drejtpërdrejtë që është bërë nga këta aleatë, të marrë anëtarësi në shumë mekanizma ndërkombëtarë të cilat i sjellin shtetit të Kosovës jo vetëm prestigj dhe subjektivitet, por edhe përfitime të shumanshme në varësi të temave të mekanizmave të tillë ndërkombëtarë. Gjithashtu përballja me lobimin e Serbisë dhe aleatëve të saj në krye me Rusinë do të ishte e pamundur pa përkrahjen e shteteve në fjalë. Këtu kemi parasysh që nga fitimi i rastit me kontestimin e pavarësisht që u bë në GjND që pavarësisht procesit legal që ishte, pati natyrën e vet politike të ndikimit, pastaj betejat me tërheqjet e njohjeve të cilat kërkuan angazhim shtesë edhe të aleatëve tanë.

Kontributi i Shqipërisë mund të konsiderohet me cilësi të natyrshme të angazhimit për mbështetjen e Kosovës, që pavarësisht kapaciteteve, pengesave, agjendave të tjera shtetërore, Kosovën e ka pasur përherë në krye të angazhimit diplomatik gjatë gjithë kohës.

Vështirësitë e punimit kanë qenë në faktin që arkiva e njoftimeve në faqen zyrtare të MPJ-së nuk është aktive dhe si rezultat i këtij defekti, nuk janë lajmet e arkivuara të viteve të mëparshme. Sikurse alternimi që Kosova bën në politikën e jashtme për t'iu përshtatur rrethanave që ka, edhe në këtë rast është dashur që në mënyrë alternative të përdorim burimet sekondare, në këtë rast raportimin nga mediat e tjera për këto procese, lajme, publikime, e komunikata të ministrisë së jashtme.

Mungesa e literaturës bazike, si librat në raste konkrete, për shkak që tema e trajtuar ka dhe aktualitetin brenda saj apo narracionin e një të kaluarë të afërt e të pashkëputur me të tashmen por edhe lidhshmërinë me të ardhmen pavarësisht vështirësive në parashikueshmëri të saj, është tejkaluar me anë të metodës shkencore së përdorur, gjegjësisht hulumtimit kualitativ nëpërmjet intervistave të realizuara të cilat kanë mbuluar të gjitha temat e shtjelluara. Pikërisht këtu konsiston rëndësia e këtyre intervistave të cilat e kanë pasuruar punimin në dimensionin shkencor dhe përmbajtësor të çështjes.

Kontestimi që i bëhet sot Kosovës dhe qasja e Kosovës ndaj këtij kontestimi kërkon angazhim të madh. Diplomacia e Kosovës nëpërmjet ministrisë së punëve të jashtme është në ballë të këtij angazhimi në baza ditore, literalisht pa asnjë minutë pushim. Resurset e kufizuara financiare, kuadrovike dhe administrative janë në korrelacion të zhdrejtë me sukseset e arritura. Por, sfidat janë të mëdha, sidomos në politikën e jashtme ndaj shteteve që nuk e njohin Kosovën, por edhe në synimin për t'u bërë pjesë e organizatave ndërkombëtare, pasi siç është bërë e ditur, vullneti dhe angazhimi ndonjëherë nuk mjaftojnë për të pasur sukses, duke qenë i varur nga ndërlidhshmëria e madhe dhe kompleksiteti strukturor dhe gjeopolitik në marrëdhënie ndërkombëtare.

Krejt në fund të këtij trajtimi, Kosova si shtet i ri dhe i vogël në marrëdhëniet ndërkombëtare është storie suksesi dhe në bazë të të gjitha parametrave është shtet i pakontestuar sipas së drejtës ndërkombëtare por edhe në aspektin funksional të shtetit. Kjo është arritur me një angazhim dhe transformim mbarëshoqëror, reflektuar edhe në ideimin, hartimin dhe ekzekutimin e politikës së jashtme.



## CONCLUSION

Kosovo Foreign Policy in relation to international entities that do not recognize its subjectivity is the topic which is addressed in this doctoral dissertation. The first dilemma that accompanied me during the ideation of the topic was whether there is and can be called foreign policy towards states that do not recognize you? My research answer is that elements of foreign policy are present in a state's approach to entities that do not recognize. This very treatment, throughout its content, proves the foreign policy of Kosovo towards the countries from which it is not recognized, a foreign policy led by the Ministry of Foreign Affairs and Diaspora that has been done since its establishment in the first days after the proclamation of independence and which it continues to do even today.

The main hypothesis of the work that accompanied me in each step of the treatment, also during the research of literature, documents even taking into account during the interviews, was "The delay of full recognition of Kosovo in the international environment is considered to be a consequence of the geostrategic positioning of states in international relations by determining the finding of alternative forms of foreign policy for Kosovo". The fundamental fact of how Kosovo became a new state, established in coordination with international allies, but not within the UN system as a world system of states in the modern era, puts it on a necessarily alternative basis of establishment, consequently its action as a new state. This followed Kosovo throughout this post-2008 period, respectively it affected its foreign policy.

It is not that no other states have been created with similar elements to how Kosovo was formed, as I do not call it the same, because the facts emphasize that Kosovo was formed *sui generis* compared to other states or quasi-states outside the system of the UN, despite the debate that can be raised that each case is *sui generis* and with unique elements from the others. Kosovo was part of the federal system of Yugoslavia, unfortunately it failed to gain independence in the Badinter process, but it is a continuation of the "dissolution" of the units of the Yugoslav Federation. Kosovo experienced a genocidal policy by the Serbian occupier, inciting an international humanitarian intervention in Kosovo which was both legal and legitimate, as this intervention came after the genocide in Srebrenica and Rwanda and the genocidal attempts in Kosovo as well as the failure of negotiations, and under Chapter VIII of the UN Charter a state or regional organization may intervene in a state to maintain

